

VENDIM
Nr. 432, datë 10.6.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR PËRSHTATJEN NDAJ
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, 2026–2036

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 5, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026–2036, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kapitulli 6 “Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike”, i vendimit nr. 466, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe të gjitha ministrinë e institucionet përgjegjëse, të përmendura në tekstin e këtij plani, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

PLANI KOMBËTAR PËR PËRSHTATJEN NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
2026–2036 (NAP)

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Hyrje
2. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, procesi i NAP-it dhe arritjet
 - 2.1 Nevoja për përshtatje
 - 2.2 Sfondi i NAP-it dhe udhëzimet
 - 2.3 Përvoja ndërkombëtare me NAP-in
 - 2.4 Përvoja e Shqipërisë me NAP-in
3. Konteksti kombëtar socio-ekonomik, institucional dhe i politikave
 - 3.1 Popullsia
 - 3.2 Treguesit ekonomikë kombëtarë
 - 3.3 Konteksti dhe perspektiva socio-ekonomike sektoriale
 - 3.4 Kuadri ligjor, institucional dhe i politikave
4. Tendencat, skenarët, cenueshmëritë dhe risqet klimatike
 - 4.1 Tendencat dhe skenarët klimatikë
 - 4.2 Cenueshmëritë klimatike dhe risqet në nivel kombëtar
 - 4.3 Vlerësimet e risqeve klimatike në nivel sektorial
 - 4.4 Cenueshmëritë klimatike dhe risqet në nivel vendor
5. Masat e përshtatjes, vlerësimet dhe veprimet prioritare në Shqipëri

- 5.1 Masat e përshtatjes në nivel sektorial
- 5.2 Masat e përshtatjes në nivel vendor
- 5.3 Vlerësimi i përshtatjes dhe veprimet prioritare të përshtatjes në Shqipëri
- 6. Plani i zbatimit të NAP-it
- 6.1 Masat prioritare në kuadër të NAP-it
- 6.2 Qeverisja dhe përgjegjësitë për zbatimin e NAP-it
- 6.3 Afati për zbatimin
- 6.4 Kostot e parashikuara për planin e zbatimit
- 7. Integrimi i perspektivës gjinore
- 7.1 Sfidat e barazisë gjinore në të gjithë sektorët e NAP-it
- 7.2 Veprimet për barazinë gjinore
- 8. Komunikimi dhe angazhimi i palëve të interesit
- 8.1 Objektivat kryesorë të komunikimit dhe angazhimit
- 8.2 Audiencat kryesore
- 8.3 Mesazhet kryesore të komunikimit për NAP-in
- 8.4 Plani i veprimit për komunikim dhe angazhim të palëve të interesit
- 9. Financimi i NAP-it
- 9.1 Nevojat për financim për përshtatje
- 9.2 Angazhimet ekzistuese dhe boshllëqet në financim
- 9.3 Pengesat për të kapërcyer hendekun e financimit për përshtatje
- 9.4 Mekanizmat mundësues për të kapërcyer hendekun e financimit të përshtatjes
- 9.5 Qasje strategjike
- 9.6 Afati dhe zbatimi i propozuar për Strategjinë e Financimit të NAP-it
- 10. Monitorimi, vlerësimi dhe të nxënit
- 10.1 Kuadri i rezultateve
- 10.2 Komponenti i monitorimit
- 10.3 Komponenti i vlerësimit
- 10.4 Komponenti i të nxënit

LISTA E REFERENCAVE

ANEKSET

Aneksi I. Përmbledhje e kuadrit rregullator dhe politikave

Aneksi II. Detaje mbi tendencat klimatike të vëzhguara dhe të parashikuara në nivel vendor

Aneksi III. Plani i detajuar i zbatimit të masave prioritare të përshtatjes në Shqipëri

Aneksi IV. Harta përfshin pylltarinë, bujqësinë dhe vendndodhjet e masave ZBN

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Procesi i NAP-it në Shqipëri, korrik 2021–gusht 2025.

Figura 2. Struktura organizative e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë sipas Ligjit për Ndryshimet klimatike nr. 155/2020, i ndryshuar

Figura 3. Rajonet klimatike kryesore në Shqipëri

Figura 4. Harta e temperaturës mesatare vjetore (°C): reshjet vjetore (mm) (djathtas) të Shqipërisë, 1991–2020

Figura 5. Shpërndarjet e temperaturave vjetore

Figura 6. Tendencat mesatare vjetore të temperaturës sipërfaqësore të ajrit me sinjifikancën e tendencës për çdo dekadë (1951–2023)

Figura 7. Tendencat vjetore të reshjeve me sinjifikancën e tendencës për secilën dekadë (1951–2023)

Figura 8. Luhatja në rritjen e nivelit të detit (në mm) në Shqipëri në periudhën 1993–2015

Figura 9. Ndryshime në temperaturën globale sipërfaqësore krahasuar me periudhën 1850–1900

- Figura 10. Rritja mesatare globale e nivelit të detit krahasuar me periudhën 1850–1900
- Figura 11. Skenarët bazë për PBB-në e Shqipërisë
- Figura 12. Skenarët bazë për popullsinë e Shqipërisë
- Figura 13. Ndryshimet e temperaturës mesatare vjetore sipas skenarëve SPS2-4.5 dhe SPS5-8.5
- Figura 14. Ndryshimet e parashikuara të temperaturës për vitin 2050 në stinë të ndryshme
- Figura 15. Diferencat sezonale për reshjet
- Figura 16. Periudhat e përsëritjes, reshjet maksimale, 1 ditë
- Figura 17. Zonat bregdetare me gjasa për t'u përmbytur me rritjen prej 0,33 m të nivelit të detit
- Figura 18. Marrëdhënia ndërmjet klimës dhe proceseve socio-ekonomike
- Figura 19. Prioritizimi i masave të përshtatjes sipas ndikimit dhe mundësia për pasoja të mëdha
- Figura 20. Marrëveshjet institucionale për planin e zbatimit
- Figura 21. Kuadri i rezultateve të NAP-it
- Figura 22. Tendencat e temperaturës, të vëzhguara për Elbasanin
- Figura 23. Ndryshimet e temperaturave mesatare ditore (vëzhgime) për periudhën 1961–1990 (norma klimatologjike) dhe 2001–2010, në Kukës
- Figura 24. Reshjet ndërvjetore totale të vëzhguara në Kukës
- Figura 25. Ndryshimi i projektuar i temperaturës mesatare (Tmesatare) në dimër dhe verë (°C) për SPSx-y të ndryshme, Kukës
- Figura 26. Ndryshimet e parashikuara të reshjeve, vjetore dhe verore (%), zona e Lezhës
- Figura 27. Ndryshimet e mundshme të reshjeve vjetore në Vlorë
- Figura 28. Ndryshimet e mundshme të reshjeve verore sipas skenarëve të ndryshëm, Gjirokastrë
- Figura 29. Parashikimi i rritjes së nivelit të detit sipas skenarëve të ndryshëm, Durrës

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1. Përmbledhje e ndryshimeve klimatike të vëzhguara dhe të parashikuara në Shqipëri
- Tabela 2. Vlerësimi i riskut: Koncepte dhe përkufizime
- Tabela 3. Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e bujqësisë
- Tabela 4. Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e turizmit
- Tabela 5. Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e energjisë
- Tabela 6. Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e transportit
- Tabela 7. Risqet aktuale dhe të ardhshme klimatike në sektorin e zhvillimit urban
- Tabela 8. Risqet aktuale dhe të ardhshme klimatike ndërsektoriale
- Tabela 9. Masat e përshtatjes të identifikuara në 8 bashki
- Tabela 10. Plani i zbatimit të NAP-it
- Tabela 11. Koha dhe përgjegjësitë për planin e zbatimit
- Tabela 12. Totali i masave dhe kostove për sektor
- Tabela 13. Nevojat e vlerësuara për buxhet sipas llojit të ndërhyrjes
- Tabela 14. Buxheti i përlllogaritur sipas afatit
- Tabela 15. Objektivat e komunikimit të NAP-it
- Tabela 16. Mesazhet e komunikimit të NAP-it
- Tabela 17. Plani i komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit
- Tabela 18. Investimi i parashikuar për periudhën 2026–2042
- Tabela 19. Nevojat e parashikuara për financim për përshtatje, financimi aktual dhe boshllëqet sipas sektorit
- Tabela 20. Plani i detajuar i financimit, 2025–2028

Tabela 21. Treguesit e procesit të NAP-it

Tabela 22. Modalitetet dhe përgjegjësitë e vlerësimit

Tabela 23. Kuadri legjislativ dhe rregullator

Tabela 24. Kuadri i politikave

PARATHËNIE

Ndryshimet klimatike përbëjnë një ndër sfidat më të mëdha të kohëve moderne, duke kërcënuar ekosistemet, ekonominë dhe mirëqenien e popujve në mbarë botën. Shqipëria nuk përbën përjashtim. Vendi ynë po përballët tashmë me efektet e ndryshimeve klimatike nëpërmjet rritjes së temperaturave mesatare, shpeshhtësisë më të madhe të thatësirave, përmytjeve, zjarreve në pyje dhe ngjarjeve të tjera ekstreme të motit. Këto ndikime prekin ecurinë tonë ekonomike dhe mjetet e jetesës së qytetarëve tanë, veçanërisht të komuniteteve më të cënueshme.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Shqipëria ka përparuar ndjeshëm sa i përket forcimit të kuadrit institucional dhe ligjor për trajtimin e ndryshimeve klimatike. Miratimi i Ligjit për Ndryshimet klimatike, në vitin 2020, miratimi i Kontributeve Kombëtare të Pikësnyuara (KKP) në vitin 2021 dhe përafrimi i *acquis*-it të BE-së për klimën kanë përgatitur terrenin për një politikë kombëtare për klimën, e cila është koherente dhe me perspektivë drejt së ardhmes. Në këtë kuadër, procesi i Planit Kombëtar të Përshtatjes (NAP) është shfaqur si një mekanizëm qendror për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin për zhvillim, politikëbërjen dhe kuadrot financiare në nivelin kombëtar dhe atë vendor.

Ky dokument përfaqëson rezultatin e Procesit të Dytë Kombëtar të Përshtatjes, një nismë e Ministrisë së Mjedisit (MM), në përputhje me kërkesën ligjore për një rishikim katërvjeçar të NAP-it dhe në përgjigje të angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, në kuadër të UNFCCC-së dhe Marrëveshjes së Parisit. Procesit mbështetet te përvoja e NAP-it të parë (2015–2019). Strategjia e NAP-it të dytë dhe plani i zbatimit janë orientuar nëpërmjet rishikimit të planit të parë, një game të gjerë studimesh dhe vlerësimesh, dokumenteve të përditësuara të politikave kombëtare dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, e gjithë kjo në bashkëpunim të ngushtë me një sërë palësh interesi kombëtare.

Objektivi i NAP-it të dytë është pakësimi i ndikimeve të lidhura me ndryshimet klimatike në nivel vendi, duke ngritur kapacitetet institucionale dhe ato teknike, që bëjnë të mundur planifikimin afatgjatë dhe të integruar të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet vlerësimeve gjithëpërfshirëse të cënueshmërive dhe risqeve në pesë sektorët prioritarë të bujqësisë, pylltarisë, turizmit, energjisë, transportit dhe zhvillimit urban, NAP-i mundëson një udhërrëfyes të qartë për ndërmarrjen e veprimeve të bashkërenduara. Plani shoqërohet me disa instrumente kyç në mbështetje të zbatimit të tij, si: plani i zbatimit për NAP-in, Strategjia e Financimit, Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVBGJ), Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit (PKAPI), si edhe Kuadri i Monitorimit, Vlerësimit dhe të Nxënës (MVN). Këta komponentë formojnë një sistem të plotë për planifikimin, financimin, zbatimin dhe gjurmimin e veprimeve të përshtatjes në nivel mbarëkombëtar.

Procesi i NAP-it aktual ka pasur një shkallë të lartë pjesëmarrjeje, duke përfshirë ministrinë, bashkitë, akademinë, shoqërinë civile dhe sektorin privat. Ai ka arritur të nxjerrë të dhëna të vyera, të forcojë bashkëpunimin institucional dhe të ndërtojë bazat teknike për zhvillimin me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. Më e rëndësishmja, ky proces mundëson kushtet për shndërrimin e përshtatjes nga një kuadër politikash në një angazhim kombëtar kolektiv dhe afatgjatë.

Nëpërmjet këtij plani kombëtar përshtatjeje të dytë, qeveria shqiptare rritet vendosmërinë e palëkundshme për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme, me aftësi ripërtëritëse dhe nivele të ulëta shkarkimesh. Jemi të vetëdijshëm se përshtatja nuk është një

përpjekje e ndërmarrë vetëm një herë, por një proces i vazhdueshëm, që kërkon institucione të forta, financim të qëndrueshëm dhe përfshirjen e të gjithë sektorëve të shoqërisë.

Dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen më të sinqertë të gjithë kontribuesve ndaj kësaj përpjekjeje, konkretisht institucioneve kombëtare, bashkive, ekspertëve, partnerëve të zhvillimit dhe organizatave ndërkombëtare, bashkëpunimi i të cilëve bëri të mundur këtë arritje. Plani përfaqëson një angazhim kombëtar të rinovuar ndaj aftësisë ripërtëritëse dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe një dëshmi të rolit të Shqipërisë si pararojë në sfidën botërore të ndryshimeve klimatike.

Sofjan Jaupaj
MINISTËR I MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

LISTA E SHKURTESAVE DHE SHKURTIMEVE

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të Shqipërisë
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKEC	Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Analiza kosto-përfitim
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AR6	Raporti i Gjashtë i Vlerësimit i PNNK-së
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Analiza me shumë kritere
BE	Bashkimi Evropian
BPO	Nënkontraktimi i Proceseve të Biznesit
CAPEX	Shpenzimet kapitale
EBK	Etiketimi i buxhetit për klimën
FGJK	Fondi i Gjellbër për Klimën
FP	Fondi për Përshtatje
GEF	Instrumenti Global për Mjedisin
GIZ	Agjencia Gjermane për Zhvillim (sipas nistoreve në gjuhën gjermane)
GNPNK	Grupi Ndërmarrës i Punës për Ndryshimet Klimatike
GPPNK	Grupi i Punës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (në kuadër të GNPKN-së)
GPZNK	Grupi i Punës për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike (në kuadër të GNPKN-së)
GS	Gazet Serrë
GTP	Grupi Teknik i Punës
IGJEO	Instituti i Gjeoshkencave
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA III	Instrumenti i Asistencës së Paraaderimit (BE)
IPGJ	Indeksi i Pabarazisë Gjinore
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
KKP	Kontributet Kombëtare të Pikësnuara (raport në kuadër të UNFCCC-së)
KP	Konferenca e palëve (në kuadër të UNFCCC-së)
KPT	Kuadri i Përmirësuar i Transparencës
MA	Ministria e Arsimit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MDB	Banka Shumëpalëshe për Zhvillim
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Ministria e Mjedisit
MoRV	Monitorimi, raportimi dhe verifikimi
MRF	Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë
MRT	Matrica referencë e treguesve

MRV	Matja, raportimi dhe verifikimi
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (në kuadër të BE-së)
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MTKS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
MV	Monitorimi dhe vlerësimi
MVN	Monitorimi, vlerësimi dhe të nxënit
MZP	Menaxhimi i zjarreve në peizazh
NAP	Plani Vendor i Përshtatjes
NAP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
NAPH	Plani Kombëtar i Përgjithshëm Hapësinor
ND - GAIN	Universiteti i Notre Damit – Nisma Globale e Përshtatjes
NK	Ndryshimet klimatike
NJQV	Njësia e qeverisjes vendore
OBK	Organizatata me bazë komunitare
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OGP	Objektivi Global për Përshtatjen (në kuadër të UNFCCC-së)
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPEX	Shpenzimet operative
OZHQ	Objektivi i zhvillimit të qëndrueshëm
PBA	Programi buxhetor afatmesëm
PKAPI	Plani i komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit
PKEP	Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën
PNK	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
PSK	Përgjegjësia sociale e korporatës
PVBGJ	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore
RDT	Raportet Dyvjeçare të Transparencës
RGJP	Raporti Gjashtëmujor i Përditësimit (në kuadër të UNFCCC-së)
RKP	Raporti kosto-përfitim
RRK	Rrethanat kombëtare (raport në kuadër të UNFCCC-së)
RRND	Rritja e nivelit të detit
SIP	Sistemi i integruar i planifikimit
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SKNK	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike
SKP	Strategjia Kombëtare e Përshtatjes
SKZHI	Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ¹
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SPP	Skenarët përfaqësues të përqendrimit
SPS	Skenarët e përbashkët socio-ekonomikë
SRT	Skeda referencë e treguesve
TIK-BPO	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit 3
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
VNA	Vlera neto aktuale
VNM	Vlerësimi i ndikimit mjedisor
VNNK	Vlerësimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve
VNSE	Vlerësimet e ndikimit socio-ekonomik
VRK	Vlerësimi i riskut klimatik
ZAE	Zonat agro-ekologjike
ZMF	Zona mesdhetare fushore
ZMK	Zona mesdhetare kodrinore
ZMM	Zona mesdhetare malore
ZMP	Zona mesdhetare paramalore
ZRF	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë

¹ SKZHI I prej 2007–2015, SKZHI II prej 2015–2020 dhe Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) prej 2022–2030.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument është rezultat i Procesit të dytë Kombëtar të Përshtatjes, të qeverisë shqiptare, një nismë e Ministrisë së Mjedisit (MM) e zhvilluar gjatë periudhës 2021–2025, në kuadër të projektit të Planit Kombëtar të Përshtatjes (NAP), me mbështetjen e UNDP-së dhe Fondit të Gjellbër për Klimën. NAP-i i dytë mbështetet te rishikimi i NAP-it të parë, te gjetjet e studimeve dhe vlerësimeve të ndryshme, dhe ndjek dokumentet kombëtare aktuale dhe ato të përditësuara, duke u udhëhequr prej udhëzimeve dhe përvojës rajonale dhe ndërkombëtare.

Ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim të paprecedent ndaj jetës dhe mjeteve të jetesës së miliarda njerëzve në mbarë botën. Për shkak të vendndodhjes gjeografike ose kushteve socio-ekonomike, disa vende ose rajone janë më të prekura nga ndikimet e ndryshimeve klimatike, ku 40% e njerëzve tashmë jetojnë në zona me cenueshmëri të lartë ndaj klimës. Si pasojë e pozicionit bregdetar në Evropën Jugore, si edhe rrethanave socio-ekonomike, institucionale dhe rregullatore, Shqipëria përballlet me risqe klimatike veçanërisht të larta. Është thelbësore që këto sfida të tejkalohen nëpërmjet uljes së cenueshmërisë dhe përmirësimit të aftësisë ripërtëritëse ndaj klimës në ndryshim. Përpjekjet për përshtatje janë të nevojshme për organizimin e sistemeve dhe menaxhimin e risqeve klimatike nëpërmjet një procesi identifikimi, planifikimi, zhvillimi dhe hartimi politikash, programesh dhe projektesh.

NAP-i i parë i Shqipërisë (i miratuar në vitin 2019) u përgatit në vijim të UNFCCC-së dhe Marrëveshjes së Parisit. Raport Progresi i NAP-it të parë për periudhën 2019–2023 konstatoi një zbatim të kufizuar. Mësimi kryesor i nxjerrë ishte se shumica e veprimeve karakterizoheshin nga mungesa e koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale ndaj trajtimit të cenueshmërive nga klima në nivel kombëtar. Ky aspekt, krahas rekomandimeve të mëtejshme, u mor parasysh në procesin për Planin e dytë Kombëtar të Përshtatjes (NAP 2021–2025), nëpërmjet vlerësimeve, studimeve dhe programeve të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, në përputhje me UNFCCC-në dhe *acquis*-in e BE-së për klimën, Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa ligjorë, politikash dhe institucionale për përballimin e sfidave të lidhura me ndryshimet klimatike. Është kryer një organizim institucional së bashku me Ministrinë e Mjedisit, si ministria qendrore përgjegjëse për politikën e ndryshimeve klimatike, si edhe për legjislacionin, koordinimin dhe zbatimin në nivel qeveritar, po ashtu edhe me ministrinë e tjetër, ku përfshihet MM-ja, të cilat janë përgjegjëse për çështjet e klimës në sektorët përkatës. Është ngritur një Grup Ndërmnistror Pune për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) me përfaqësues të ministrive dhe agjencive të ndryshme sektoriale, me rol koordinues në mbështetje të MM-së për çështjet e lidhura me klimën, megjithëse ekzekutimi i mandatit vijon të hasë vështirësi.

Çështjet e klimës trajtohen në dokumentet e rëndësishme të politikave, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE III, 2022–2030), ku përfshihen udhëzime dhe përcaktohen prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë në rrugëtimin drejt anëtarësimit të plotë në BE. Dokumentet e tjera të politikave kombëtare për ndryshimet klimatike përfshijnë Dokumentin Strategjik për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, Kontributet Kombëtare të Pikësnuara të rishikuara dhe Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, të Republikës së Shqipërisë. Ligji për Ndryshimet klimatike rregullon kuadrin ligjor të lidhur me ndryshimet klimatike, me ligjet e tjera shoqëruese, si: Ligji për Energjinë, Ligji për Mbrojtjen civile, etj.

Nga një prej vendeve më të varfra në Evropë, Shqipëria u shndërrua në një vend me të ardhura të mesme të larta, me një PBB prej 23 miliardë dollarësh amerikanë dhe PBB për frymë prej 8.300 dollarësh amerikanë në vitin 2023. Sidoqoftë, ndryshimet klimatike rrezikojnë zhbërjen e këtyre arritjeve, duke përkeqësuar goditjet ekonomike, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta, gratë dhe grupet e tjera të cenueshme të popullsisë, që janë më pak të përgatitura për t'u rimëkëmbur pas ngjarjeve ekstreme të motit.

Klima mesdhetare e Shqipërisë karakterizohet nga stinë dimri e butë dhe e lagësht, e ndjekur nga stinë vere e nxehtë dhe e thatë. Që prej vitit 1951, temperaturat mesatare në Shqipëri janë rritur, kryesisht në stinën e pranverës dhe verës, ndërsa reshjet vjetore (pavarësisht se jo me tendencë tepër të veçantë) kanë pësuar rënie, kryesisht gjatë stinës së dimrit dhe pranverës. Parashikimet në skenarin më të keq për vitin 2050 tregojnë se temperatura mesatare e ajrit (Tmes) do të rritet nga 0,9°C në 2,0°C, ndërsa reshjet vjetore do të bien edhe më tej nga -2,7% në -5,8%, ndërsa gjatë stinës së verës nga -8,1% në -17,6%. Ngjarjet e reshjeve ekstreme pritet të shtohen, duke shkaktuar periudha thatësire ose përmbytjeje më të lokalizuara. Të gjithë skenarët e së ardhmes parashikojnë një Rritje në Nivelin e Detit (RRND) përgjatë bregdetit shqiptar deri në 20–28 cm, në vitin 2050, duke prekur më ndjeshëm bregdetin e Adriatikut.

Objektivi i përgjithshëm i procesit të dytë të NAP-it është pakësimi i risqeve të lidhura me ndryshimet klimatike në të gjithë Shqipërinë, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike, çka do të mbështetë integrimin e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (PNK) në planifikimin afatgjatë. Ky objektivi mbulon periudhën 10-vjeçare nga viti 2026 në vitin 2036 dhe fokusohet te sektorët socio-ekonomikë kryesorë në Shqipëri, të cilët janë të cënueshëm prej ndryshimeve klimatike (sektorët prioritarë të NAP-it): bujqësia dhe pylltaria, turizmi, energjia, transporti dhe zhvillimi urban.

Ndryshimet klimatike kanë ndikime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në shëndetin publik, përmes rritjes së frekuencës dhe intensitetit të valëve të të nxehtëtit dhe ngjarjeve të tjera ekstreme klimatike, përkeqësimit të cilësisë së ujit dhe ajrit, shfaqjes dhe përhapjes së sëmundjeve të lidhura me klimën dhe rritjes së presionit mbi shërbimet shëndetësore. Në këtë kontekst, sektori i shëndetësisë përbën një komponent thelbësor të qëndrueshmërisë kombëtare ndaj ndryshimeve klimatike. Për këtë arsye, plani, krahas sektorëve prioritarë të identifikuar, integron edhe dimensionin e shëndetësisë si sektor ndërsektorial, me qëllim adresimin e risqeve klimatike mbi shëndetin publik dhe forcimin e reziliencës së shërbimeve shëndetësore.

Projekti i NAP-it ndërmori vlerësime të hollësishme të riskut klimatik për 5 sektorët prioritarë të identifikuar në Shqipëri. Vlerësimet tregojnë se risqet kombëtare të klimës në Shqipëri vijnë duke u rritur gjatë kohës, si edhe pesimizmin e skenarit. Sektorët e zhvillimit urban, bujqësisë dhe turizmit kanë nivelin më të lartë të riskut, ndërsa sektorët e energjisë dhe transportit kanë nivele më të ulëta (vlen për risqet aktuale dhe ato të ardhshme). Arsyeja kryesore për këtë është ndjeshmëria e bujqësisë dhe turizmit ndaj ndryshimeve të variablave klimatike, ndërsa për sektorin e zhvillimit urban arsyeja kryesore është ndjeshmëria ndaj rritjes së temperaturave dhe valëve të të nxehtëtit, si edhe përqendrimi i konsiderueshëm i sektorit të zhvillimit urban në bregdetin e cënueshëm. Disa zona janë veçanërisht të cënueshme (p.sh.: zonat e ultësirës bregdetare, fushat aluvionale, qytetet me popullsi të dendur), po ashtu edhe grupe të caktuara të popullsisë për shkak të moshës, problemeve mjekësore, varësisë, vendndodhjes, situatës ekonomike, gjinisë ose ndërthurjes së këtyre faktorëve. Menaxhimi mjedisor i papërshtatshëm, ku përfshihet shpyllëzimi, keqmenaxhimi i ujëmbledhësve dhe menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve, theksojnë risqet klimatike në të gjithë sektorët. Mangësitë në legjislacionin për klimën, kapacitetet njerëzore, të dhënat dhe pajisjet mund t'i përkeqësojnë më tej risqet klimatike në vend dhe të pengojnë përpjekjet për përshtatjen dhe menaxhimin e fatkeqësive.

Me qëllim përshtatjen me risqet e mundshme të ndryshimeve klimatike, gjatë procesit të NAP-it u identifikuan 151 “Masa përshtatjeje” të mundshme për të pestë sektorët prioritarë, si edhe masa ndërsektoriale, duke integruar njëkohësisht edhe komponentët e përbashkët dhe vendndodhjet e rreth 356 masave vendore të përshtatjes në 8 bashkitë e përzgjedhura. Një proces i mëtejshëm priorizimi mundësoi identifikimin e 66 masave prioritare në sektorët prioritarë dhe masa ndërsektoriale përmes analizës së shumë kritereve dhe analizës kosto-përfitim. Më pas, këto masa u organizuan në planin e zbatimit të NAP-it, në mënyrë që

prioritetet sektoriale të përshtatjes të shndërrohen në ndërhyrje konkrete, të realizueshme në aspektin teknik dhe financiar dhe përfshirëse në aspektin social. Plani i zbatimit përfshin 10 masa ndërsektoriale përshtatjeje, 8 për bujqësinë, 13 për pylltarinë, 11 për turizmin, 9 për zhvillimin urban, 8 për energjinë dhe 7 për transportin. Këto 66 masa u ndanë më tej në 45 masa “të buta” (ngritje kapacitetesh); 15 masa “të gjelbra” të bazuara te natyra, dhe 6 masa infrastrukturore madhore ose “gri” (6). Secila prej masave të përshtatjes u detajua më tej në 2 deri në 10 veprimtari zbatimi të posaçme. Për planifikimin kohor të zbatimit, masat u ndanë në masa afatshkurtra (2026–2028), masa afatmesme (2029–2032) dhe masa afatgjata (2033–2036), ku zbatimi i disave prej tyre planifikohet të përfundojë në vitin 2042. Në nivel kombëtar, Ministria e Mjedisit është autoriteti udhëheqës i planit të zbatimit për NAP-in. Në praktikë, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike zbatohet nga ministritë dhe agjencitë sektoriale përkatëse, shpeshherë në koordinim të ngushtë me autoritetet bashkiake dhe palët e tjera kryesore të interesit.

Zbatimi i 66 ndërhyrjeve të përshtatjes parashikohet të ketë një kosto të përgjithshme prej 9,8 miliardë dollarësh amerikanë (rreth 8,4 miliardë euro). Zhvillimi urban parashikohet të ketë koston më të lartë, i ndjekur më pas nga pylltaria, ndërsa turizmi parashikohet të ketë koston më të ulët. Sa u përket llojeve të ndërhyrjeve, 15 ndërhyrjet e gjelbra zënë përqindjen më të lartë të kostove të përgjithshme të parashikuara (45%), ndërsa ndërhyrjet e buta zënë 32% dhe ato gri 23%. Në aspektin kohor (fillimi në planin afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë), kostot e parashikuara kanë një shpërndarje thuajse të barabartë. Për shkak të fazave të zbatimit, buxhetet vjetore të parashikuara e kanë vlerën më të lartë duke filluar nga periudha 2033–2035. Kostot vjetore të përgjithshme për secilin sektor dhe masë janë përcaktuar për të mbështetur ministritë e linjës gjatë planifikimit të buxheteve afatmesme dhe vjetore për përshtatjen.

Për planin e zbatimit të NAP-it u hartua një strategji financimi, me qëllim mobilizimin dhe alokimin efektiv të burimeve financiare të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për zbatimin e prioritetëve të përshtatjes të Shqipërisë. Megjithëse financimi i përgjithshëm i nevojshëm për përshtatjen është shumë i lartë dhe arrin në thuajse 2,7% të PBB-së së Shqipërisë për vitin 2025, ai bazohet te një profil investimi i financiar paraprakisht, i përqendruar te vitet e hershme të zbatimit të masave të ndryshme. Pavarësisht shumës së nevojshme, ky nivel investimi konsiderohet i realizueshëm fiskalisht, veçanërisht nëse mbështetet nga financimi koncesionar, alokimet buxhetore me faza dhe integrimi i plotë në kuadrot kombëtare të investimeve publike. Kostoja e mosveprimit do të ishte më e lartë, pasi dëmtimet e rënda prej klimës mund të zhbëjnë vite të tëra zhvillimi.

Qeveria shqiptare ka parashikuar një shumë të konsiderueshme për veprimet e përshtatjes në sektorë të ndryshëm në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe në strategjitë sektoriale kombëtare, dhe partnerët ndërkombëtarë po planifikojnë ta mbështetin përshtatjen nëpërmjet granteve dhe huave. Pavarësisht kësaj, kjo shumë është ndjeshëm nën atë të nevojshme për financimin e përshtatjes, duke krijuar një hendek të përgjithshëm financimi në masën 93%. Për rrjedhojë, do të duhet financim i konsiderueshëm për të mbështetur nevojat e financimit të përshtatjes në këtë NAP. Kjo do të kryhet pavarësisht sfidave të shumta strukturore ekonomike dhe fiskale, si kostot paraprake të larta të masave të përshtatjes, tregjet e pazhvilluara të kapitalit, mungesa e instrumenteve për zbutjen e risqeve, peizazhi i fragmentuar i donatorëve, pjesëmarrja e paktë e sektorit privat dhe oferta e kufizuar e projekteve të përshtatjes që tërheqin financim. Prandaj, është thelbësore që kontributet e brendshme të fuqizohen më tej, gjithashtu, edhe qasja në financim ndërkombëtar për klimën dhe mobilizimi i kapitalit privat. Në planin afatshkurtër (2026–28), që përfshin kryesisht masa “të buta”, Shqipëria zotëron disa burime. Në planin afatmesëm (2029–32), masat janë kritike dhe kërkojnë financim shtesë të konsiderueshëm prej projekteve të planifikuara dhe të reja. Në

planin afatgjatë (2033–50) duhet të trajtohet jo vetëm pjesa e mbetur e planit, por edhe të arrihet përshtatje me kushtet në ndryshim.

Gjatë procesit të NAP-it dhe si një pjesë thelbësore e planit të zbatimit, është hartuar një Plan Veprimi për Barazinë Gjinore (PVBGJ), i cili siguron integrimin e nevojave dhe perspektivave të grave në të gjithë procesin, duke njohur faktin se ndryshimet klimatike ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat. Objektivat e PVBGJ-së përfshinin promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave nëpërmjet planifikimit të përgjigjshëm gjinor, integritit të perspektivës gjinore, si edhe zbatimit dhe monitorimit. PVBGJ-ja është e bashkërenduar me një sërë strategjish kombëtare kryesore dhe angazhimesh ndërkombëtare, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ 2021–2030), strategjitë e posaçme për sektorët, Marrëveshjen e Parisit dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe mbështet zbatimin e tyre.

Në mënyrë të ngjashme, për planin e zbatimit të NAP-it u përgatit edhe një plan për komunikimin dhe angazhimin e palëve të interesit (PKAPI). Nëpërmjet komunikimit të synuar dhe gjithëpërfshirës, PKAPI-ja synon ta shndërrojë përshtatjen ndaj klimës nga një kuadër politikash në një lëvizje të pranuar nga palët e interesit në të gjitha nivelet e shoqërisë. Objektivi Strategjik i PKAPI-së është: “Të pozicionohet përshtatja ndaj klimës si një prioritet kombëtar në Shqipëri nëpërmjet shfrytëzimit të komunikimit efektiv si një mjet për angazhimin e palëve të interesit, nxitjen e veprimit kolektiv dhe përmirësimin e aftësisë ripërtëritëse afatgjatë në të gjithë sektorët e shoqërisë”.

Krahas procesit të NAP-it u zhvillua edhe një sistem për monitorimin, vlerësimin dhe të nxënit (MVN), lidhur me NAP-in për të mbështetur zbatimin e saj. Ky sistem do të: mbështetë transparencën dhe llogaridhënien; sigurojë ndjekjen gjithëpërfshirëse të ecurisë; promovojë bashkëpunimin, koordinimin dhe ndarjen e njohurive në nivel ndërsektorial; përmirësojë efikasitetin e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave dhe mjeteve ekzistuese, dhe do të lehtësojë të nxënit. MM-ja do të jetë organi qendror për koordinimin e monitorimit dhe vlerësimit, mbikëqyrjen e të dhënave dhe raportimin të strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare. Ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore do të mundësojnë të dhëna vjetore për masat e përshtatjes, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) do të verifikojë dhe përpunojë raportet dhe të dhënat.

Zbatimi i sistemit MVN për NAP-in e dytë të Shqipërisë do të ndjekë një qasje me faza, të renditura më poshtë: Organizimi institucional; Ngritja e kapaciteteve; Testimi pilot; Operacionalizimi; Rishikimi dhe përmirësimi. Faza përfundimtare do të përqendrohet në vlerësimin e performancës së NAP-it në krahasim me kuadrin e rezultateve përkatëse, që do të zhvillohet nëpërmjet shqyrtimit afatmesëm të vitit 2030 dhe nëpërmjet një vlerësimi përfundimtar në vitin 2036.

1. HYRJE

Ky dokument është rezultat i Procesit të Dytë Kombëtar të Përshtatjes, të qeverisë shqiptare, një nismë e Ministrisë së Mjedisit (MM) e zhvilluar gjatë periudhës 2021–2025, në kuadër të projektit të Planit Kombëtar të Përshtatjes (NAP)², në përgjigje të kërkesës ligjore për një rishikim 4-vjeçar të NAP-it dhe angazhimeve ndërkombëtare. Në periudhën 2015–2019 u hartua NAP-i i parë me mbështetjen e Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), e cila u miratua si dokumenti kuadër i NAP-it në vitin 2019. Strategjia dhe plani i zbatimit të NAP-it të dytë mbështeten te rishikimi i NAP-it të parë, te gjetjet e studimeve dhe vlerësimeve të caktuara të kryera si pjesë e procesit të NAP-

² “Avancimi i planit të Shqipërisë për përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë përmes zhvillimit të një procesi kombëtar të planifikimit të përshtatjes” i mbështetur nga Fondi i Gjelbër për Klimën (FGJK) dhe i zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

it të dytë, dhe ndjekin dokumentet kombëtare aktuale dhe ato të përditësuara³, duke u orientuar prej udhëzimeve dhe përvojës rajonale dhe ndërkombëtare.⁴

Vizioni i NAP-it

NAP-i udhëhiqet nga një vizion afatgjatë për “*një Shqipëri të sigurt, të begatë dhe të qëndrueshme, të mbështetur tek Evropa*”, çka pasqyron drejtimin e përgjithshëm të përcaktuar nga SKZHIE-ja. Objektivi i përshtatjes është arritja e “*një Shqipërie me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, të përshtatur me ndryshimet klimatike*”, sikurse parashikohet në Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Strategjinë e Përshtatjes të BE-së.

Objektivat e NAP-it

Në këtë kuadër të përgjithshëm, objektivi i përgjithshëm i NAP-it aktual është ***pakësimi i risqeve të lidhura me ndryshimet klimatike në të gjithë Shqipërinë, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike, çka do të mbështetë integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (PNK) në planifikimin afatgjatë***. Ky proces i NAP-it mbështet integrimin e përshtatjes në strategjitë kombëtare dhe vendore të zhvillimit, në politikat sektoriale dhe në kuadrot e planifikimit financiar. Ai, gjithashtu, shërben si një pikë referimi qendrore për koordinimin dhe harmonizimin e përpjekjeve për planifikimin e përshtatjes në nivel kombëtar dhe ndërsektorial.

Duke u mbështetur në këtë qëllim, NAP-i parashikon një të ardhme ku zhvillimi socio-ekonomik i Shqipërisë është i qëndrueshëm dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike. Ky vizion buron drejtpërdrejt nga objektivi i përgjithshëm i NAP-it dhe është plotësisht në përputhje me angazhimet e përgjithshme të Shqipërisë, në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë Marrëveshjen e Parisit, duke kontribuar njëkohësisht në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ).

Për të arritur këto synime, NAP-i fokusohet te disa objektiva thelbësorë:

- **Integrimi i përshtatjes ndaj klimës** në politikat, planet dhe buxhetet kombëtare dhe sektoriale, duke siguruar që të gjitha veprimtaritë e zhvillimit të marrin parasysh sistematikisht risqet klimatike dhe të përfshijnë qëndrueshmërinë në strategjitë e rritjes së Shqipërisë.

- **Ngritja e kapaciteteve përshtatëse** në nivelet institucionale, komunitare dhe individuale, duke përmirësuar aftësinë për të kuptuar, planifikuar dhe menaxhuar ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe për t'u përgatitur më mirë për sfidat e ardhshme.

- **Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm** nëpërmjet përpjekjeve të përshtatjes që kontribuojnë në uljen e varfërisë, barazinë sociale dhe mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar që përshtatja jo vetëm të zvogëlojë cenueshmërinë, por edhe të mbështesë një të ardhme gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

- **Lehtësimi i qasjes në financimet për klimën**, nëpërmjet mobilizimit të burimeve financiare kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të mbështetur zbatimin e masave të përshtatjes dhe për t'i kthyer planet në veprime konkrete.

- **Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit** ndërmjet aktorëve kryesorë, përfshirë institucionet qeveritare, bashkitë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, për të siguruar koherencë, përgjegjësi dhe një reagim të unifikuar ndaj ndryshimeve klimatike.

Përmbajtja e NAP-it

Për t'i kthyer këto objektiva në veprim, procesi i NAP-it ka ndërmarrë një sërë veprimtarish, duke përfshirë analiza institucionale dhe sektoriale, vlerësime të mangësive në kapacitete,

³ Komunikimet Kombëtare (KK1–2002, KK2–2009, KK3–2016, KK4–2022); Raporti gjashtëmujor i përditësimit (RGJP); Kontributet kombëtare të pikësnyuara (KKP–2021), Dokumenti kuadër i PKP-së – 2019.

⁴ P.sh. Konventa kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike i Rrjetit Global (PNNK), Strategjia dhe Mjetet e Përshtatjes të Bashkimit Evropian (BE), si dhe mësimet e nxjerra nga PKP-të e vendeve të tjera.

vlerësime të nevojave, si dhe vlerësime të cenueshmërisë dhe riskut për pesë sektorët prioritarë⁵, dhe janë zhvilluar, gjithashtu, skenarë klimatikë në nivel kombëtar dhe vendor, janë identifikuar dhe priorizuar alternativat e përshtatjes, është mbështetur digjitalizimi i të dhënave, janë identifikuar alternativat e financimit për PNK-në, janë zhvilluar kurrikula dhe mjete për përmirësimin e kapaciteteve për planifikimin, buxhetimin dhe integrimin e përshtatjes me klimën, si dhe janë kryer veprimtari informuese dhe trajnime në nivel kombëtar dhe vendor, ndër të tjera. Këto veprimtari kanë sjellë një sërë produktesh që kanë orientuar dokumentin dhe procesin aktual të NAP-it.

Kapitujt vijues trajtojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe procesin e NAP-it në nivel botëror dhe kombëtar; përshkruajnë rrethanat kombëtare, cenueshmëritë, rreziqet, alternativat dhe vlerësimet e përshtatjes për Shqipërinë dhe sektorët e saj prioritarë; dhe më tej paraqesin ndërhyrjet prioritare në nivel ndërsektorial dhe sektorial. Gjithashtu, dokumenti mundëson një përmbledhje të konsideratave kryesore të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të tij, duke përfshirë detaje mbi organizimet e nevojshme të zbatimit të masave, integrimin gjinor gjatë të gjithë procesit, si dhe komunikimin aktiv dhe përfshirjen e aktorëve.

E gjithë kjo mbështetet nga një strategji financimi, e cila ofron alternativa për financimin e nevojave të identifikuar, si dhe nga një kuadër i përshtatshëm për monitorimin, vlerësimin dhe të nxënit për të lehtësuar ndjekjen e rezultateve. Disa nga këto elemente janë trajtuar më gjerësisht në dokumentet plotësuese të NAP-it: Plani i zbatimit për veprimet e priorizuara të përshtatjes; Strategjia e financimit të NAP-it; Plani i veprimit për barazinë gjinore (PVBGJ) i NAP-it; Plani për komunikimin dhe angazhimin e palëve të interesit (PKAPI) i NAP-it; Kuadri i monitorimit, vlerësimit dhe të nxënit (MVN) i NAP-it.

2. PËRSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, PROCESI I NAP-it DHE ARRITJET

2.1 Nevoja për përshtatje

Ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim të paprecedent ndaj jetës dhe mjeteve të jetesës së miliarda njerëzve **në mbarë botën**. Ato mund të rrisin shpeshtësinë e ngjarjeve ekstreme dhe katastrofike të motit, të ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe të ujit, të rrisin përhapjen e disa sëmundjeve, të ndikojnë në zonat dhe komunitetet bregdetare, të kërcënojnë cilësinë dhe sigurinë ushqimore, të rrisin çmimet e ushqimeve dhe të kërcënojnë ekzistencën e llojeve, habitateve dhe peizazheve. Për pasojë, kanë një ndikim veçanërisht të theksuar te mjetet e jetesës, përfitimet dhe perspektivat e brezave të ardhshëm për një jetë dinjitoze dhe të qëndrueshme.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është procesi i rregullimit të sistemeve dhe menaxhimit të rreziqeve të ndryshimeve klimatike përmes një procesi të identifikimit, planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të politikave, programeve dhe projekteve, me qëllim përballimin, zvogëlimin e cenueshmërisë dhe rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj një klime në ndryshim. Për shkak të vendndodhjes gjeografike ose kushteve socio-ekonomike, disa vende ose rajone janë më të prekura nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Pavarësisht prirjeve inkurajuese, ecuria e arritur deri më sot në nivel botëror sa i përket përshtatjes nuk është në shkallën e nevojshme⁶. Nevoja për të përshpejtuar veprimet për përshtatjen është urgjente, pasi 40% e njerëzimit tashmë jeton në zona me cenueshmëri të lartë ndaj klimës⁷. Pritet që bota do të përballet me nivele të rrezikshme të risqeve klimatike përpara fundit të shekullit XXI.

⁵ Bujqësia dhe pylltaria, energjia, transporti, zhvillimi urban dhe turizmi.

⁶Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (2023). *Adaptation Gap Report 2023: Underfinanced. Underprepared. Inadequate Investment and Planning on Climate Adaptation Leaves World Exposed* [Raporti i mangësive në përshtatje 2023: I nënfinancuar. I papërgatitur. Investimi dhe planifikimi i pamjaftueshëm në përshtatjen ndaj klimës e lënë botën të ekspozuar]. Nairobi

⁷ Raporti i gjashtë vlerësues i Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK, 2023).

Prandaj, përshtatja urgjente është e domosdoshme për të pakësuar risqet klimatike ekzistuese dhe të ardhshme, të cilat, nëse nuk trajtohen, do të çojnë pashmangshmërisht në humbje dhe dëme të mëtejshme të lidhura me klimën, që vlerësohet se kanë tejkaluar 500 miliardë dollarë amerikanë gjatë dy dekadave të fundit në 55 ekonomitë më të cënueshme ndaj klimës⁸.

Evropa po përjeton gjithnjë e më shumë valë të nxehti ekstrem, thatësira, zjarre në pyje dhe përmytje vitet e fundit, dhe risqet klimatike po kërcënojnë sigurinë e saj energjetike dhe ushqimore, ekosistemet, infrastrukturën, burimet ujore, stabilitetin financiar dhe shëndetin e njerëzve. Rajonet e ultësirave bregdetare të Evropës, duke përfshirë shumë qytete me popullsi të dendur, përballen me risqe gjithnjë e më të mëdha nga përmytjet, erozioni dhe depërtimi i ujërave të kripura⁹. Në vitin 2024, Evropa ishte kontinenti që u ngroh më shpejt në botë, ku pjesët juglindore përjetuan nxehtësi dhe thatësira veçanërisht ekstreme, ndërsa temperatura mesatare vjetore e sipërfaqes së Detit Mesdhe arriti nivelin më të lartë të regjistruar ndonjëherë¹⁰.

Edhe pse ndryshimet klimatike prekin çdo vend, **Shqipëria**, për shkak të pozicionit të saj bregdetar në Evropën Jugore, si dhe për shkak të kushteve të saj socio-ekonomike, institucionale dhe rregullatore, përballen me risqe klimatike veçanërisht të larta. Shqipëria ka një nga nivelet më të larta të riskut dhe ekspozimit ndaj fatkeqësive ndër vendet evropiane, ku ngjarje klimatike si përmytjet, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e dheut, së bashku me fatkeqësi të tjera natyrore si tërmetet, kanë prekur 95 për qind të bashkive gjatë dy dekadave të fundit. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në Shqipëri po bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe më të rënda, ku skenarët klimatikë parashikojnë periudha më të gjata, më të nxehta dhe më të thata, si dhe rritje të vazhdueshme të nivelit të detit, duke ndikuar te burimet ujore të vendit, bujqësia, turizmi, shëndeti publik, sektori energjetik dhe zonat bregdetare. Vlerësimet e kujdesshme tregojnë se dëmet ekonomike të lidhura me klimën mund të arrijnë deri në 7% të PBB-së vetëm në vitin 2050.¹¹ Këto cenueshmëri, risqe dhe humbjet shoqëruese janë trajtuar më hollësisht në kapitullin 4. Nëse nuk trajtohen, këto ndikime klimatike do të vazhdojnë të minojnë përparimin dhe të dobësojnë aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve në Shqipëri. Prandaj, investimet në përshtatje janë thelbësore, pasi përfitimet e tyre janë shumë herë më të mëdha sesa kostot. Analizat nga rajoni tregojnë se për çdo 1 euro të investuar, vlera e kthimit varion nga 2 deri në 10 euro, me përfitime që përfshijnë reduktimin e humbjeve, rritjen e potencialit ekonomik dhe bashkëpërfitime sociale e mjedisore.¹²

2.2 Sfondi i NAP-it dhe udhëzimet

Procesi i NAP-it u ndërmor në kuadër të **Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)**, me qëllim trajtimin e nevojave për përshtatje me klimën në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Ky proces u detajua më tej në vitin 2010, sipas Kuadrit të Përshtatjes së Kankunit ¹³gjatë Konferencës së 16-të të palëve (KP) të UNFCCC-së, ndërsa

⁸ Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (2023). *Adaptation Gap Report 2023: Underfinanced. Underprepared. Inadequate Investment and Planning on Climate Adaptation Leaves World Exposed* [Raporti i mangësive në përshtatje 2023: I nënfinancuar. I papërgatitur. Investimi dhe planifikimi i pamjaftueshëm në përshtatjen ndaj klimës e lënë botën të ekspozuar] Nairobi.

⁹ Deklaratë për shtyp e Agjencisë Evropiane të Mjedisit për Vlerësimin e parë Evropian të Riskut Klimatik. Publikuar më 11 mars 2024. Përfshiu një vlerësim ku identifikoheshin 36 risqet klimatike madhore për Evropën sipas pesë grupeve të mëdha: ekosistemet, ushqimi, shëndeti, infrastruktura dhe ekonomia dhe financa.

https://www.eea.europa.eu/en/neesroom/nees/europe-is-not-prepared-for?utm_medium=email&_hs_m_i=84201387&_hsenc=p2ANqtz--zS8bTN2iJ2Y1EDmIOApxA2NiBMTqcMIYqBA8R0oya5yIZm85S1ynHduz_YL9QUZZQpëFjEdqyoëyIptFU75f0aley_YeReaa3_97qFY7Zm7Ok&utm_content=84201387&utm_source=hs_email

¹⁰ Raporti Evropian për Gjendjen Klimatike 2024 (ESOTC 2024), nxjerrë më 15 prill 2025.

¹¹ Shqipëri – Raporti i klimës dhe zhvillimit për vendin, Banka Botërore 2024.

¹² Shqipëri – Raporti i klimës dhe zhvillimit për vendin, Banka Botërore 2024.

¹³ Shihni: <https://unfccc.int/process/conferences/pastconferences/cancun-climate-change-conference-november->

objektivat e tij u përmirësuan si pjesë e Marrëveshjes së Parisit të vitit 2015. Procesi i NAP-it është konceptuar si një proces planifikimi i përsëritur, në pronësi të vetë vendeve, që u mundëson këtyre të fundit të identifikojnë, trajtojnë dhe rishikojnë nevojat e tyre të përshtatjes, problematikat, boshllëqet, prioritetet dhe kërkesat përkatëse për burime, në kuadrin e planeve kombëtare të përshtatjes. Ai, gjithashtu, shihet si një vazhdim organik i formulimit dhe zbatimit të Kontributeve Kombëtare të Pikësnyuara (KKP) të vendeve.

Procesi i NAP-it parashikon “të marrë plotësisht në konsideratë çështjet e ndryshimeve klimatike në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes” dhe “të zhvillojë njohuritë që mbështesin vendimmarrjen, si dhe ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për të mundësuar të gjitha veprimet e nevojshme për një proces planifikimi strategjik të përshtatjes në pronësi të vendit”¹⁴. Në mënyrë të përgjithshme, procesi i NAP-it, në kuadër të UNFCCC-së, synon të arrijë këto objektiva kryesorë:

1. Të reduktohet cenueshmëria ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, përmes ndërtimit të kapaciteteve përshtatëse dhe forcimit të aftësisë ripërtëritëse;

2. Të lehtësohet integrimi i përshtatjes klimatike në politikat, programet dhe veprimtaritë përkatëse të reja dhe ekzistuese, në veçanti në proceset dhe strategjitë e planifikimit të zhvillimit, në të gjithë sektorët përkatës dhe në nivele të ndryshme.

Udhëzimet për zhvillimin dhe zbatimin e procesit të NAP-it vijnë nga UNFCCC-ja dhe aktorë të tjerë, përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe donatorët¹⁵. Udhëzimi kryesor fillestar vjen prej dokumentit “**Udhëzuesi teknik për procesin e planit kombëtar të përshtatjes**”¹⁶, i cili prezanton hapat dhe elementet kryesore të procesit. Parimet udhëzuese për zhvillimin e një NAP-i, siç janë përcaktuar në këtë udhëzues teknik, përfshijnë:

- një proces pjesëmarrës që përfshin palët vendase të interesit (komunitetet, sektorin privat, organizatat joqeveritare dhe aktorë të tjerë përkatës);

- një qasje shumëdisiplinore dhe plotësuese, e cila bazohet te planet dhe programet ekzistuese përkatëse;

- marrjen në konsideratë të veçantë të grupeve të marginalizuara, si gratë;

- shfrytëzimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit;

- efikasitetin në kosto;

- përgjigjshmërinë gjinore në planifikim dhe zbatim; dhe

- elasticitetin e procedurave në përputhje me rrethanat vendore.

2010/statements-and-resources/Agreements

¹⁴ Grupi i ekspertëve për vendet më pak të zhvilluara. 2012. *National Adaptation Plans: Technical Guidelines for the National Adaptation Plan Process* [Planet kombëtare të përshtatjes: udhëzime teknike për procesin e planit kombëtar të përshtatjes]. Bonn: Sekretariati i UNFCCC-së. Bonn, Gjermani, dhjetor 2012.

¹⁵ Shihni edhe: Rrjeti Global i Përshtatjes (<https://www.unep.org/gan/>); Qendra Globale për Përshtatje (<https://gca.org/>); <https://www.adaptation-undp.org/>; <https://climate-adapt.eea.europa.eu/>; etj.

¹⁶ Grupi i ekspertëve për vendet më pak të zhvilluara. 2012. *National Adaptation Plans: Technical Guidelines for the National Adaptation Plan Process* [Planet kombëtare të përshtatjes: udhëzime teknike për procesin e planit kombëtar të përshtatjes]. Bonn: Sekretariati i UNFCCC-së. Bonn, Gjermani, dhjetor 2012.

Janë hartuar dhe përdorur edhe **materiale të tjera udhëzuese** në nivele të ndryshme hapësinore dhe organizative, si: në nivel kombëtar¹⁷, vendor¹⁸, shtetëror/provincial¹⁹, qyteti²⁰, bashkie²¹, bregdetar²², biznesi²³, etj.

Marrëveshja e Parisit, e miratuar nga palët e UNFCCC-së në vitin 2015, përforcon kuadrin ndërkombëtar për veprimin për përshtatje. Palët vendosën “objektivin global për përshtatjen, që synon rritjen e kapaciteteve përshtatëse, forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe reduktimin e cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike”. Në Konferencën e palëve të UNFCCC-së (KP-28), të mbajtur në Dubai, në dhjetor 2023, u miratua “Kuatrë për objektivin global për përshtatjen (OGP)”²⁴, i cili “u bën thirrje palëve dhe fton aktorët jopalë të rrisin ambicien dhe të forcojnë veprimet dhe mbështetjen për përshtatjen, në mënyrë që të përshpejtohet veprimi i shpejtë në shkallë të gjerë dhe në të gjitha nivelet”²⁵. Ky kuadër synon të udhëheqë zbatimin e GGA-së dhe, ndër të tjera, ka për qëllim krijimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm për shumë rreziqe (deri në vitin 2027), zhvillimin e shërbimeve të informacionit klimatik për reduktimin e riskut dhe vëzhgimin sistematik (deri në vitin 2027), realizimin e vlerësimeve të ndikimit, cenueshmërisë dhe riskut (deri në vitin 2030), si dhe hartimin e planeve kombëtare të përshtatjes që janë të drejtuara nga vetë vendet, të përgjigjshme ndaj gjinisë, pjesëmarrëse dhe transparente (deri në vitin 2030), në të gjitha vendet e prekura.

Duke rritur aftësinë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike, NAP-et **kontribuojnë në arritjen e shumë objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm**, rezultateve të Rio +20, si dhe në Kuadrin e Sendait për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015–2030, duke mbështetur kështu objektivat kombëtarë socio-ekonomikë dhe të qëndrueshmërisë.

2.3 Përvoja ndërkombëtare me NAP-in

Rreth 80% e palëve (ose vendeve) të UNFCCC-së kanë hartuar të paktën një **plan, strategji ose politikë kombëtare përshtatjeje**. Shumica e këtyre vendeve kanë identifikuar alternativa përshtatjeje që u përgjigjen cenueshmërive dhe risqeve klimatike të vlerësuara në sektorët prioritarë, si: bujqësia, uji dhe shëndetësia²⁶. Gjetjet sugjerojnë se po rritet ndërgjegjësimi dhe

¹⁷ P.sh. Udhëzimet e BE-së për strategjitë dhe planet e përshtatjes të shteteve anëtare, 2023.

¹⁸ P.sh. *ADAPTING TO CLIMATE CHANGE: CDP Guidance for UK Local Authorities*. [PËRSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE: Udhëzuesi i KMD-së për autoritetet vendore të MB-së]. 2022

¹⁹ P.sh. *CALIFORNIA ADAPTATION PLANNING GUIDE* [UDHËZUESI I PLANIFIKIMIT PËR PËRSHTATJEN NË KALIFORNI] (2020).

²⁰ P.sh. *Climate Change Adaptation and Resilience Planning: Programme Summary and Guide for Cities* [Planifikimi i përshtatjes dhe qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike: Përmbledhje e programit dhe udhëzues për qytetet]. (2023).

KMD, 2023.

²¹ P.sh. *PLANNING FOR ADAPTATION TO CLIMATE CHANGE: GUIDELINES FOR MUNICIPALITIES* [Plani për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike: Udhëzime për bashkitë]. (n.d.). BE/ACT.

²² P.sh. *Adapting to Climate Change: A Planning Guide for State Coastal Managers* (n.d.) [Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike: Një udhëzues planifikimi për menaxherët shtetërorë të zonave bregdetare]. Paketa e masave të SHBA-së për qëndrueshmërinë ndaj klimës.

²³ P.sh. *Climate change: risk assessment and adaptation planning in your management system* [Ndryshimet klimatike: Vlerësimi i riskut dhe planifikimi i përshtatjes në sistemin tuaj të menaxhimit], qeveria e MB-së, 2023.

²⁴ Tashmë i emërtuar “Kuatrë i EBA-s për Qëndrueshmërinë Botërore ndaj Klimës”.

²⁵ Vendimi: FCCC/PA/CMA/2023/L.18. Më tej, u kërkon vendeve që të: “redukojnë ndjeshëm mungesën e ujit të shkaktuar nga ndryshimet klimatike dhe të forcojnë qëndrueshmërinë klimatike ndaj risqeve të lidhura me ujin; të sigurojnë prodhim dhe furnizim ushqimor e bujqësor të qëndrueshëm ndaj klimës, si dhe shpërndarje të qëndrueshme të ushqimit; të forcojnë aftësinë ripërtëritëse ndaj ndikimeve shëndetësore të lidhura me ndryshimet klimatike; të pakësojnë ndikimet klimatike tek ekosistemet dhe biodiversiteti; të rrisin qëndrueshmërinë e infrastrukturës dhe vendbanimeve njerëzore; të zvogëlojnë në mënyrë të ndjeshme efektet negative të ndryshimeve klimatike në zhdukjen e varfërisë dhe mjetet e jetesës, dhe të mbrojnë trashëgiminë kulturore”.

²⁶ Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (2023). *Adaptation Gap Report 2023: Underfinanced. Underprepared. Inadequate Investment and Planning on Climate Adaptation Leaves World Exposed* [Raporti i mangësive në përshtatje 2023: I nënfinancuar. I papërgatitur. Investimi dhe planifikimi i pamjaftueshëm në

kuptimi për rëndësinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, por zbatimi efektiv i planeve ekzistuese mbetet një pengesë kryesore²⁷.

Në vitin 2021, **BE-ja miratoi një strategji për përshtatjen**, e cila përcakton një vizion afatgjatë që BE-ja të “kthehet në një shoqëri të qëndrueshme ndaj klimës, plotësisht e përshtatur me ndikimet e pashmangshme të ndryshimeve klimatike deri në vitin 2050”²⁸. Kjo strategji synon të forcojë kapacitetin përshtatës brenda BE-së dhe të minimizojë cenueshmërinë ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, nëpërmjet: përmirësimit të njohurive mbi ndikimet klimatike dhe zgjidhjet për përshtatje; përforcimit të planifikimit për përshtatje dhe vlerësimeve të riskut klimatik; përshpejtimit të veprimeve për përshtatje, dhe forcimit të qëndrueshmërisë klimatike në nivel botëror. Shumica e vendeve të BE-së kanë strategji përshtatjeje, disa në formën e NAP-eve, të tjerat si strategji apo programe, ku disa janë të bazuara te sektorët²⁹.

2.4 Përvoja e shqipërisë me NAP-in

NAP-i i parë i Shqipërisë

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike ka rëndësi të madhe mjedisore dhe socio-ekonomike për Shqipërinë, si një vend dhe rajon që është veçanërisht i cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Ndërmarrja e një procesi NAP-i dhe zhvillimi i një strategjie dhe plani zbatimi të NAP-it përbën një detyrim ndërkombëtar për Shqipërinë, në kuadër të UNFCCC-së, në të cilën vendi është palë që prej vitit 1994, për shembull, sipas nenit 7 të Marrëveshjes së Parisit, e ratifikuar nga Shqipëria më 21 shtator 2016. Gjithashtu, rishikimi çdo katër vjet i NAP-it është një detyrim ligjor kombëtar në bazë të Ligjit për Ndryshimet klimatike³⁰. Ky është, gjithashtu, një hap i domosdoshëm në kuadrin e përpjekjeve të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ku BE-ja ka rekomanduar përparimin e agjendës së vendit për ndryshimet klimatike, përfshirë hartimin e një NAP-i. Raporti i progresit të BE-së për vitin 2022, mbi procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, theksoi sërish nevojën për zbatimin efektiv të NAP-it të parë dhe miratimin e një strategjie të re dhe të një plani kombëtar të ri të përshtatjes.

NAP-i i parë u hartua në periudhën 2015–2019, me mbështetjen e Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ) dhe UNDP-së, dhe u miratua si dokumenti kuadër i NAP-it në vitin 2019³¹, duke përfshirë 6 fusha ndërhyrjeje madhore³² dhe 16 objektiva. Raporti i progresit për NAP-in e parë për periudhën 2019–2023 në Shqipëri³³ theksoi se nga 118 masat e planifikuara të përshtatjes, vetëm 15% ishin përfunduar, rreth 69% e të gjitha masave kishin pasur përparim të pjesshëm, ndërsa 22% ende nuk ishin nisur. Ndër arritjet kryesore u veçuan krijimi dhe funksionimi i Grupit Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK); integrimi i ndryshimeve klimatike në disa dokumente të tjera strategjike, dhe ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike dhe nevojën për përshtatje. Sfidat përfshinë mangësitë në kapacitete dhe njohuri, kufizimet buxhetore dhe mungesën e burimeve, si edhe ndikimin e tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë COVID-19, të cilat ngadalësuan zbatimin e masave. Raporti i progresit të NAP-it (2019–2023) theksoi, gjithashtu, se financimi i disponueshëm për përshtatjen varej

përshtatjen ndaj klimës e lënë botën të ekspozuar]. Nairobi

²⁷ Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (2023). *National Adaptation Planning: Emerging Lessons Learned from UNEP Projects* [Plani Kombëtar i Përshtatjes: Mësimet e nxjerra nga projektet e UNEP-it] Nairobi.

²⁸ Komunikim prej Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve. Krijimi i një Evrope të qëndrueshme ndaj klimës – Strategjia e re e BE-së për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (2021).

²⁹ P.sh. Vendet e ulëta kanë një strategji përshtatjeje me klimën të bazuar tek uji.

³⁰ Miratuar në vitin 2020.

³¹ Miratuar me VKM-në nr. 466, datë 3.7.2019, si pjesë e “Dokumentit strategjik dhe planeve kombëtare për reduktimin e gazeve serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”.

³² Fushat e ndërhyrjes: rezultatet e përshtatjes; orientimi i zbatimit të PKP-së; integrimi; financimi për klimën; komunikimi dhe mbulimi; organizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve.

³³ Raporti i progresit për PKP-në. Statusi i zbatimit të PKP-së. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023.

pothuajse ekskluzivisht nga donatorët, në kontrast me 99,9% të buxhetit të shtetit për kontributin kombëtar të pikësnyuar (KKP), i cili ishte përcaktuar për zbutje. Mësimi kryesor i nxjerrë nga zbatimi i veprimeve të përshtatjes me klimën në Shqipëri gjatë dekadës së fundit ishte se shumica e veprimeve kishin mangësi në koordinim dhe nuk ndiqnin një qasje ndërsektoriale për trajtimin e cenueshmërive ndaj klimës në nivel kombëtar³⁴.

Raporti i progresit 2023 për NAP-in e parë dha disa rekomandime prioritare për NAP-in e dytë, si më poshtë:

- Të ngrihet një strukturë qeverisjeje e mirorganizuar dhe e mbështetur me burime, si dhe të forcohen institucionet për zbatimin e NAP-it;

- Të hartohen dhe zbatohen plane efektive për mobilizimin e burimeve financiare, njerëzore dhe teknologjike që do të mbështesin zbatimin e NAP-it;

- Të zhvillohet dhe zbatohet një kuadër efikas për monitorimin dhe vlerësimin e NAP-it të ri;

- Të zhvillohet dhe zbatohet një program i përshtatshëm edukimi dhe komunikimi për të mbështetur zbatimin e NAP-it;

- Të rritet mbështetja për veprimet për përshtatje, të udhëhequra nga sektori privat.

Këto rekomandime janë marrë në konsideratë në procesin e hartimit të NAP-it të dytë.

NAP-i i dytë i Shqipërisë

Procesi i hartimit të Planit të dytë Kombëtar të Përshtatjes (NAP) në Shqipëri, për periudhën 2021–2025, ka qenë një nismë e udhëhequr nga vetë vendi, e krijuar për të mbështetur institucionet kombëtare dhe tetë bashki në identifikimin, trajtimin dhe përshtatjen ndaj sfidave që vijnë prej ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet një sërë vlerësimesh, studimesh dhe programesh për ngritjen e kapaciteteve, ky proces ka ndihmuar në përgatitjen e NAP-it të dytë, i cili fokusohet te pesë sektorë kryesorë: bujqësia dhe pylltaria, turizmi, zhvillimi urban, energjia dhe transporti. Disa prej arritjeve dhe dokumenteve më të rëndësishme të prodhuara gjatë këtij procesi të NAP-it përfshijnë (shih edhe figura 1 në të djathtë):

³⁴ Raporti i progresit për PKP-në. Statusi i zbatimit të PKP-së. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023.




Figura 1. Procesi i PKP-së në Shqipëri, korrik 2021–gusht 2025.

- **Raporti i vlerësimit fillestar:** Pikënisja e procesit të NAP-it, që analizoi kuadrin politik, institucional dhe ligjor, si dhe vlerësoi informacionin ekzistues mbi ndikimet, cenueshmëritë dhe masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke identifikuar dobësitë dhe boshllëqet në institucionet kombëtare dhe vendore;
- **Analizat e kapaciteteve institucionale dhe ligjore,** për shembull, për Grupin Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) dhe Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO);
- **Hartimi i legjislacionit,** për shembull, mbështetja për projekt-VKM-në nr. 889: “Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar”; urdhrin e ministrit “Për formatin dhe mënyrat e raportimit të Grupit Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike”; urdhrin e ministrit “Për rregulloren e brendshme për funksionimin e Grupit Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike”;
- **Planet Vendore të Përshtatjes (PVP)** për bashkitë Durrës, Kukës, Krujë, Vlorë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë dhe Përmet;
- **Programi Kombëtar i Trajnimit për Ndryshimet Klimatike,** nën koordinimin e GNPNK-së;
- **Analiza e klimës aktuale dhe skenarëve të ardhshëm** në nivel kombëtar dhe vendor;
- **Skenarët socio-ekonomikë kombëtarë,** bazuar te skenarët e përbashkët socio-ekonomikë (SPS);
- **Vlerësimet e cenueshmërisë dhe rrezikut të realizuara për pesë sektorët prioritarë:** energjinë, transportin, bujqësinë, turizmin dhe zhvillimin urban;
- Përgatitja e një **liste fillestare me 150 masa për përshtatjen;**
- Pas një **procesi prioritizimi,** u përcaktua lista përfundimtare me **66 ndërhyrje prioritare për përshtatjen;**

- **Rishikimi i kuadrit ligjor dhe i politikave sektoriale**, për të siguruar integrimin efektiv të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat përkatëse;

- Hartimi i **Strategjisë përfundimtare të NAP-it dhe i planit të zbatimit për veprimet prioritare të përshtatjes**, duke përfshirë **planin e veprimit për barazinë gjinore dhe planin e angazhimit dhe komunikimit me palët e interesit**;

- **Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit (MV)** për ndjekjen e progresit në zbatimin e procesit të NAP-it dhe të masave të përshtatjes të parashikuara në të;

- **Strategjia e financimit të NAP-it**;

- **Studimi për vlerësimin e tregut të sektorit privat, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve për përshtatje** dhe nxitjen e bashkëpunimit për tërheqjen e investimeve private dhe inovacioneve në teknologjitë me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës.

Përmbledhje e pengesave kryesore dhe mësimet të nxjerra nga proceset e NAP-it në Shqipëri

Procesi i dytë i NAP-it në Shqipëri (2021–2025) kontribuoi në planifikimin dhe përcaktimin e prioritetëve për masat e përshtatjes. Ai theksoi rëndësinë e forcimit të kapaciteteve, angazhimit institucional dhe integritit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Pengesat dhe sfidat

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e **pengesave dhe sfidave** të identifikuara gjatë këtij procesi, bazuar te dokumentet dhe raportet e përgatitura gjatë procesit të NAP-it:



Integrimi: edhe pse integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike është tashmë një kërkesë ligjore, ai ende nuk është përfshirë në mënyrë të mjaftueshme në strategjitë kombëtare dhe sektoriale. Vlerësimet e ndikimit mjedisor (VNM) dhe vlerësimet e ndikimit socio-ekonomik (VNSE) shpesh mungojnë në një vlerësim të riskut klimatik, çka kufizon konsideratat për përshtatjen në proceset vendimmarrëse. Gjatë procesit të NAP-it u bë përpjekje për të forcuar integrimin, por kërkohet përmirësim i mëtejshëm në këtë drejtim.



Angazhimi dhe koordinimi institucional: pavarësisht se struktura institucionale për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike është miratuar me ligj, mandatet përkatëse nuk janë përcaktuar plotësisht ose nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë, dhe koordinimi ndërinstitutional ka mbetur i dobët në vazhdimësi. GNPNK-ja, me rolin e vet të rëndësishëm koordinues, ishte joaktiv në fillim të procesit të dytë të NAP-it dhe kërkoi kohë për t'u riaktivizuar. Edhe pse të pranishëm gjatë të gjithë procesit NAP, pjesëmarrja dhe angazhimi institucional nuk kishin stabilitet dhe vazhdimësi për shkak të ndryshimeve të shpeshta të stafit përgjegjës (pikat fokale për klimën). Për më tepër, mungesa e sistemeve efektive të koordinimit pengoi shkëmbimin e rezultateve dhe raporteve të përshtatjes ndërmjet ministrive dhe institucioneve. Interesat për përshtatje në nivelet e ndryshme të qeverisjes nuk kanë qenë gjithmonë të përputhshme. Aktorët vendorë shpesh kanë pasur prioritet ndërhyrje të menjëhershme, të ndjeshme ndaj kontekstit në përgjigje të risqeve afatshkurtra konkrete, ndërsa institucionet kombëtare fokusohen më shumë tek objektiva strategjike afatgjatë, të bashkërenduar me zhvillimin e qëndrueshëm dhe angazhimet për klimën të vendit.



Burimet njerëzore: Në përgjithësi, institucionet nuk disponojnë staf apo struktura të dedikuara për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke u mbështetur kështu në organizime të përkohshme dhe të posaçme. Vetëm një numër shumë i kufizuar specialistësh në administratën publike punojnë me çështjet e ndryshimeve klimatike. Nuk ofrohen trajnime fillestare apo në vazhdimësi për çështjet e klimës, qoftë në nivel të brendshëm institucional apo gjatë punës. Trajnimet kanë qenë sporadike dhe të lidhura kryesisht me projekte ndërkombëtare, ndërsa njohuritë institucionale humbasin shpesh për shkak të qarkullimit të stafit. Stafi aktual që merret drejtpërdrejt ose tërthorazi me çështjet e klimës është relativisht i ri dhe pothuajse nuk ka pasur trajnime mbi këto tema përpara fillimit të procesit të dytë të NAP-it. Burimet njerëzore dhe financiare të pamjaftueshme kanë penguar hartimin dhe zbatimin në mënyrë të qëndrueshme dhe praktike të NAP-it, duke e bërë Shqipërinë të varur nga mbështetja ndërkombëtare.

Financimi: Aktualisht, financimi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike mbështetet kryesisht te fondet e donatorëve ndërkombëtarë, me kontribute minimale vendore dhe me përfshirje të pamjaftueshme të përfituesve, sidomos në nivel vendor. Financimi i brendshëm ekzistues është kryesisht reaktiv, duke u fokusuar te masat ndihmëse dhe rindërtimi pas fatkeqësive natyrore, në vend të përshtatjes proaktive me ndryshimet klimatike.

Të dhënat: Proceset e mbledhjes së të dhënave janë të fragmentuara, të kufizuara dhe të pakoordinuara në nivel kombëtar. Njohuritë mbi klimën varen kryesisht nga projektet ndërkombëtare, duke krijuar varësi dhe boshllëqe informacioni. Mungesa e të dhënave të besueshme, të mjaftueshme dhe të vazhdueshme (p.sh. nga monitorimi i klimës, projektet dhe masat e përshtatjes, përdorimi i Treguesve Rio për ndryshimet klimatike, kostot dhe financimet e përdorura për përshtatjen, etj.) ka krijuar vështirësi në vlerësimin e riskut dhe cënueshmërisë klimatike, në analizat kosto-përfitim, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve të përshtatjes. Këto vështirësi janë zbutur pjesërisht nëpërmjet diskutimeve me ekspertët kombëtarë, përdorimit të modeleve standarde, GIS-it, shqyrtimit të dokumentacionit dhe gjykitimit të ekspertëve. Mungesa e një sistemi të qëndrueshëm për shkëmbimin e rezultateve dhe raporteve të projekteve të përshtatjes me Ministrinë e Mjedisit (si institucioni koordinues për ndryshimet klimatike në nivel qeveritar) ka cenuar ndërgjegjësimin dhe pasqyrimin e ecurisë së përgjithshme të përshtatjes në nivel sektorial dhe vendor.

Monitorimi dhe vlerësimi: Mungesa e protokolleve të përcaktuara për monitorim dhe vlerësim ka reduktuar llogaridhënien dhe ka vështirësuar vlerësimin e arritjeve konkrete të nismave të përshtatjes të zbatuara deri më sot. Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të përshtatjes nuk janë zbatuar në mënyrë të rregullt dhe të sistematizuar, por vetëm rast pas rasti.

Mësimet e nxjerra: Sa u përket mësimave të nxjerra nga procesi i dytë i NAP-it dhe duke marrë parasysh pengesat dhe sfidat e përmendura më sipër, për zbatimin e ardhshëm të veprimeve për klimën në Shqipëri paraqiten pikat, si më poshtë:

Integrimi: Masat e zbatimit të NAP-it të dytë duhet të përdoren për të integruar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në pesë sektorët prioritarë, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030. Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike është një proces cilësor, që nuk kërkon domosdoshmëri më shumë fonde, por një mënyrë të re të vepruari “të të bërit të gjërave ndryshe”, por jo domosdoshmëri “të të bërit më shumë”. Përdorimi i Treguesve Rio për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për vlerësimin e nivelit të integritit në politikat e tjera sektoriale mund të lehtësojë procesin.

Angazhimi dhe koordinimi institucional: Zbatimi i qëndrueshëm dhe efektiv i NAP-it, si dhe monitorimi dhe rishikimi i saj, kërkojnë një grup ndërministror pune për ndryshimet klimatike (GNPNK) aktiv dhe të qëndrueshëm. Pjesëmarrja e anëtarëve të GNPNK-së duhet të mbështetet me përfshirjen e detyrimeve përkatëse në përshkrimet e tyre të punës.

Burimet njerëzore: Ngritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të rregullta për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike duhet të jetë prioritet, për të ulur varësinë nga mbështetja e jashtme. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike mund të angazhohet për ofrimin e njohurive të vazhdueshme për përshtatjen dhe menaxhimin e projekteve. Zbatimi i Planit të Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesuara (PKAPI) i NAP-it është, gjithashtu, thelbësor.

Financimi: Sigurimi i fondeve të mjaftueshme është thelbësor për zbatimin e NAP-it. Nevojitet një rritje e financimit publik vendor për t'u përballur me efektet e ndryshimeve klimatike dhe për të planifikuar në mënyrë të përshtatshme, ndërsa financimi ndërkombëtar dhe ai nga sektori privat duhet të shërbejë si plotësues. Këto aspekte janë të trajtuara më në hollësi në strategjinë e financimit, e cila duhet të udhëheqë zbatimin e këtij NAP-i.

Të dhënat: Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për monitorimin dhe raportimin e ndryshimeve klimatike dhe të dhënave përkatëse është shumë i rëndësishëm për mbledhjen sistematike, ndarjen dhe integrimin e të dhënave në proceset e hartimit të politikave. Krijimi i një platforme *online* për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe ministrive të linjës për rezultatet dhe raportet e projekteve të përshtatjes (përfshirë raportet administrative), që mbulojnë zbatimin, monitorimin, vlerësimin, mësimet e nxjerra dhe verifikimet, do të forcojë ndjeshëm bazën e informacionit të Ministrisë së Mjedisit, si institucioni koordinues kombëtar për çështjet e përshtatjes.

Monitorimi dhe vlerësimi: Zbatimi i një kuadri gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për monitorimin dhe vlerësimin (MV) e projekteve dhe nismave të përshtatjes, duke vlerësuar arritjet, kostot, përfitimet dhe mësimet e nxjerra, do të mundësojë matjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimeve për klimën dhe do të ndihmojë në përsëritjen dhe/ose përshtatjen e tyre në Shqipëri. Kuadri i MV-së i paraqitur në këtë NAP përbën një pikënisje të mirë dhe duhet të ndiqet gjatë zbatimit të mëtejshëm të NAP-it.

3. KONTEKSTI KOMBËTAR SOCIO-EKONOMIK, INSTITUCIONAL DHE I POLITIKAVE

3.1 Popullsia

Shqipëria është një vend i vogël malor, i pozicionuar në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit, në Evropën juglindore, me një sipërfaqe 28.748 km², me 2.761.785 banorë dhe dendësi popullore prej 98 personash/km² (2023). Projektionet tregojnë se deri në vitin 2030, popullsia e përgjithshme e Shqipërisë do të pësojë një rënie të lehtë në rreth 2.745.996 banorë. Moshë mesatare e popullsisë është rritur nga 33,2 vjeç në vitin 2012 në 38,3 vjeç në vitin 2023 dhe pritet të arrijë në 42,1 vjeç në vitin 2031³⁵. Raporti i varësisë pritet të rritet nga rreth 20,5 persona të moshuar për çdo 100 persona në moshë pune në vitin 2019, në rreth 35,0 persona të moshuar për çdo 100 persona në moshë pune³⁶ deri në vitin 2031, gjë që do të ushtrojë më shumë tryzni mbi popullsinë aktive. Kjo do të ketë, gjithashtu, si pasojë rritjen e ekspozimit të të moshuarve ndaj sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore, duke përfshirë ato që lidhen me rreziqet klimatike, si nxehtësia ekstreme, e cila mund të ketë ndikime të rënda te personat me sëmundje ekzistuese apo me lëvizshmëri të kufizuar, si dhe të rrisë kostot shëndetësore për frymë.

Popullsia urbane është rritur nga rreth një e treta e popullsisë totale në fillim të viteve 1990 në pothuajse dy të tretat (62%) në vitin 2020 dhe pritet të vazhdojë të rritet në 78,2% deri në vitin 2050³⁷. Popullsia rurale, veçanërisht fermerët e vegjël, preken në mënyrë të zhdrejtë nga ndryshueshmëria klimatike, përfshirë thatësitat, përmbytjet dhe modelet e paparashikueshme të motit, të cilat rrezikojnë prodhimtarinë bujqësore dhe mjetet e jetesës. Si rezultat i migrimin

³⁵ INSTAT, 2024.

³⁶ INSTAT, 2023.

³⁷ Profili i riskut klimatik për vendin, Shqipëri (2021).

rural-urban, popullsia e mbetur rurale do t'u përkasë grupeve më të moshuara, të cilat janë më të cenueshme nga ndryshimet klimatike. Fëmijët në zonat rurale dhe ata që u përkasin grupeve të marginalizuara apo familjeve me të ardhura të ulëta, mund të përballen me ndërprerje të ndjeshme në arsim dhe sfida të tjera si pasojë e fatkeqësive të lidhura me klimën, të cilat mund të ndikojnë te lëvizshmëria socio-ekonomike afatgjatë. Popullsia bregdetare është rritur gjithashtu (në 36% në vitin 2020), duke vendosur më shumë njerëz në rrezik në një zonë që preket ndjeshëm nga përmbytjet bregdetare. Por edhe popullsia urbane në rritje përballlet me risqe klimatike gjithnjë e më të mëdha, veçanërisht ato që lidhen me shëndetin, siç do të trajtohet më tej në kapitullin 4.

Një analizë gjinore e kryer për këtë NAP zbuloi pabarazi gjinore që lidhen me varfërinë dhe përfshirjen sociale, duke përfshirë hendekët në punësim në të gjithë sektorët, dhe faktin që gratë përballen me sfida të pabarabarta sa i përket qasjes në burime, pronësisë, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe përmirësimin të aftësisë ripërtëritëse³⁸. Ky aspekt do të trajtohet më tej në kapitullin 7.

3.2 Treguesit ekonomikë kombëtarë

Nga një prej vendeve më të varfra në Evropë, Shqipëria u shndërrua në një vend me të ardhura të mesme të larta, me një PBB prej 23 miliardë dollarësh amerikanë dhe PBB për frymë prej 8300 dollarësh amerikanë në vitin 2023³⁹. Kjo rritje ekonomike është shoqëruar me një tranzicion nga një ekonomi e planifikuar e bazuar tek lëndët e para, bujqësia dhe industria, drejt një ekonomie më të larmishme, të mbështetur kryesisht nga sektori privat. Pas një rritjeje prej 3,9% në vitin 2023, rritja reale e PBB-së parashikohet të jetë mesatarisht rreth 3,5% gjatë periudhës 2024–2029, e nxitur nga konsumi vendas, turizmi dhe veprimtaria ndërtimore⁴⁰. Gjatë tri dekadave të fundit, treguesit socialë janë përmirësuar ndjeshëm në Shqipëri. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IZHNJ) i Shqipërisë⁴¹ për vitin 2023 ishte 0,81, duke e renditur vendin në kategorinë e zhvillimit shumë të lartë njerëzor, në vendin e 71-të nga 193 vende dhe territore, megjithatë, rreth 21,7% e popullsisë ende jetonte nën kufirin kombëtar të varfërisë⁴². Papunësia arriti nivelin më të ulët historik prej 8,8% në vitin 2024, por papunësia e të rinjve mbeti e lartë, në 19,1%.

Ndryshimet klimatike rrezikojnë zhbërjen e këtyre arritjeve, duke përkeqësuar goditjet ekonomike, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta, që janë më pak të përgatitura për t'u rimëkëmbur pas ngjarjeve ekstreme të motit. Gjatë 33 viteve të fundit, humbjet ekonomike të shkaktuara nga përmbytjet janë vlerësuar në 2,3 miliardë dollarë amerikanë⁴³. Përparimi socio-ekonomik i Shqipërisë është penguar së fundmi nga dy goditje të mëdha. Në nëntor 2019, vendi u godit nga një tërmet shkatërrues me magnitudë 6,3 ballë të shkallës Rihter (më i forti në 30 vitet e fundit), që shkaktoi 51 viktima, preku mbi 200.000 persona dhe solli humbje të barasvlershme me rreth 7,5% të PBB-së. Në mes të përpjekjeve për rindërtim, vendi u godit nga kriza e COVID-19-s, duke rritur presionin mbi buxhetin dhe reagimin qeveritar, pasi Shqipëria u detyrua të mbyllë sektorë kyç të ekonomisë⁴⁴. Duke e përkeqësuar më tej këtë situatë, shtrëngimi aktual i kushteve ekonomike dhe financiare globale mund të vështirësojë qasjen e Shqipërisë në tregjet e jashtme të financimit, duke përfshirë financimin për klimën.

³⁸ INSTAT (Instituti i Statistikave të Shqipërisë), 2023.

³⁹ FMN: 2024, Konsultim për nenin iv–Deklaratë për shtyp; Raport i stafit; dhe deklarata nga drejtori ekzekutiv për Shqipërinë, 2025.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ IZHNJ-ja merr parasysh jetëgjatësinë në lindje, arsimin, të ardhurat kombëtare bruto për frymë, etj.

⁴² Po aty.

⁴³ *The Future of Water in Agriculture in Albania: A Broad Sector Rethinking* [E ardhmja e ujit për bujqësinë në Shqipëri: Një rikonceptim i gjerë sektorial], Banka Botërore, 2014.

⁴⁴ *Report on Socio-Economic Scenarios* [Raport për skenarët socio-ekonomikë]. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në 2023–2025.

Ekonomia është e ndjeshme ndaj kushteve të pafavorshme të vazhdueshme të motit⁴⁵, të cilat mund të ndikojnë veçanërisht te grupet e marginalizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta, që shpenzojnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre për produkte të domosdoshme. Kjo situatë mund të përkeqësojë pasigurinë ushqimore dhe të thellojë pabarazitë ekzistuese për gratë, të moshuarit dhe komunitetet rurale e bregdetare. Ekzistojnë pabarazi të dukshme gjinore në punësim ndërmjet grave dhe burrave: në nivel kombëtar, gratë janë më pak të punësuar se burrat, përkatësisht 52,8% kundrejt 67,7% në vitin 2023⁴⁶. Në bujqësi, më shumë gra janë të punësuar (40,1% e fuqisë punëtore femërore të përgjithshme) krahasuar me burrat (28,7% e fuqisë punëtore mashkullore të përgjithshme), ndryshe nga shumica e sektorëve të tjerë ku mbizotërojnë burrat, përfshirë ndërtimin (13,5% burra kundrejt 0,6% gra) dhe energjinë/shërbimet komunale (4,3% burra kundrejt 0,9% gra)⁴⁷.

3.3 Konteksti dhe perspektiva socio-ekonomike sektoriale

Kjo pjesë paraqet situatën aktuale, vizionin, ecurinë e kohëve të fundit dhe sfidat për sektorët kryesorë ekonomikë në Shqipëri, me një referencë të veçantë për 5 sektorët prioritarë të NAP-it⁴⁸. Ajo bazohet në analizën sektoriale të kryer në kuadër të projektit të NAP-it të UNDP-së dhe krahasohet me vizionin sektorial qeveritar të dhënë në SKZHIE III, 2022–2030. Përveç sfidave ekonomike konkrete, këta sektorë përballen, gjithashtu, me risqe dhe sfida specifike të lidhura me ndryshimet klimatike, të cilat janë trajtuar më hollësisht në kapitullin 9 për 5 sektorët prioritarë të NAP-it.

Bujqësia dhe pylltaria

Bujqësia, përfshirë blegtorinë, mbetet një sektor jetik në Shqipëri, duke punësuar gati 34% të fuqisë punëtore dhe duke kontribuar me 16,9% në PBB në vitin 2022⁴⁹. Shqipëria ka 696,000 hektarë tokë bujqësore, të ndarë në katër zona agro-ekologjike (ZAE): ultësitrat, kodrat e ndërmjetme, malet veriore dhe qendrore dhe malësitë jugore. Prodhimi i kulturave bujqësore është përqendruar kryesisht në ultësira, me prani të kufizuar në zonat e tjera agro-ekologjike. Shpërndarja e blegtorisë ndryshon sipas rajoneve: gjedhët dhe kuajt gjenden në të katër ZAE-të, ndërsa mbarështimi i derrave dhe shpendëve është i përqendruar në ultësira dhe në zonën kodrinore të ndërmjetme. Sektori përbëhet kryesisht nga ferma të vogla familjare (85%), me një madhësi mesatare prej 1,2 hektarësh. Kërkesa kombëtare dhe ndërkombëtare për produkte bujqësore, blegtorale dhe pyjore pritet të vazhdojë të rritet, me kusht që të realizohen investime të rëndësishme në ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet (lumore dhe detare) dhe të plotësohet kërkesa në rritje për ujë⁵⁰. Madhësia e vogël e fermave, fragmentimi i tokës dhe të drejtat e paqarta të pronësisë mbeten sfidat kryesore të sektorit. Ndryshimet klimatike rrezikojnë prodhimtarinë bujqësore për shkak të rritjes së shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit, thatësirave dhe përmbytjeve (shihni kapitullin 4 dhe kapitullin 5 për masat e identifikuar të përshtatjes).

Pyjet mbulojnë rreth 39% të sipërfaqes së territorit të Shqipërisë dhe përbëjnë një burim thelbësor të druve të zjarrit për familjet rurale. Megjithatë, sipërfaqja pyjore është ulur nga 1,385 milionë hektarë në vitin 1938 në 1,051 milionë hektarë në vitin 2018. Sektori i pylltarisë përballen me sfida të konsiderueshme klimatike, ku përfshihet rritja e shpeshtësisë së zjarreve në pyje, ndryshimi i shpërndarjes së llojeve dhe përhapjet e dëmtuesve dhe sëmundjeve. Gjatë periudhës 2007–2019, janë djegur rreth 337.800 hektarë pyje, që përfaqësojnë 33% të

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Portali i Bankës Botërore për të Dhënat Gjinore, “Profili Ekonomik i Shqipërisë”, 2023.

⁴⁷ Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVBGJ) i Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë. Hartuar në kuadër të Projektit të PKP-së nga UNDP-ja, 2023–2025.

⁴⁸ Bujqësia dhe pylltaria, turizmi, energjia, transporti, zhvillimi urban.

⁴⁹ Shqipëri - Shpërndarja e PBB-së sipas sektorëve ekonomikë 2013–2023 | Statista

⁵⁰ Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

sipërfaqes pyjore kombëtare. Prerja e jashtëligjshme dhe menaxhimi i pamjaftueshëm i pyjeve e thellojnë më tej këtë cenueshmëri, duke dobësuar aftësinë ripërtëritëse të ekosistemeve pyjore ndaj ndryshimeve klimatike. Për këtë arsye, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, përmirësimi i përpjekjeve për ripyllëzime dhe integrimi i menaxhimit të zjarreve në peizazh janë thelbësore për sektorin. MZP-ja është një qasje përshtatëse gjithëpërfshirëse dhe proaktive që lidh parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe restaurimin pas zjarrit me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura dhe përdorimin e tokës, me qëllim zvogëlimin e kushteve që favorizojnë ndezjen dhe përhapjen e zjarreve dhe forcimin afatgjatë të qëndrueshmërisë së burimeve pyjore dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e pyjeve dhe përmirësimi i përpjekjeve për ripyllëzim janë thelbësore për zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe për sigurimin e qëndrueshmërisë së burimeve pyjore.

Turizmi

Turizmi është një shtyllë kryesore e ekonomisë shqiptare, duke kontribuar me gati 25% të PBB-së në vitin 2024 dhe duke punësuar 20% të fuqisë punëtore në Shqipëri. Sektori ka shfaqur një rimëkëmbje të jashtëzakonshme pas pandemisë, me rritjen e numrit të turistëve me 56% në vitin 2023 dhe me një rritje shtesë prej 15% në vitin 2024, duke arritur në 11,7 milionë vizitorë. Turizmi bregdetar mbetet forca kryesore e industrisë, por turizmi natyror dhe ai rural po bëhen gjithnjë e më të parapëlqyer. Turizmi do të promovohet më tej nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturave të reja të rëndësishme turistike, kryesisht në zonat bregdetare. Megjithatë, turizmi është shumë i ndjeshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, përfshirë rritjen e nivelit të detit, erozionin bregdetar dhe ngjarjet ekstreme të motit, siç përshkruhet më tej në kapitullin 4. Përshtatja e industrisë së turizmit ndaj ndryshimeve klimatike kërkon diversifikimin e produkteve turistike (p.sh. turizëm kulturor dhe eko-turizëm) dhe përmirësimin e infrastrukturës së qëndrueshme ndaj klimës (shihni kapitullin 5 për masat e identifikuar dhe të prioritetuara të përshtatjes në turizëm).

Energjia

Shqipëria zotëron një shpërndarje të gjerë burimesh **energjetike**, që përfshijnë naftën dhe gazin, qymyrin, hidroenergjinë, biomasën pyjore natyrore dhe burime të tjera të ripërtëritshme (energji diellore, eolike, gjeotermale). Në vitin 2023, nafta përbënte 43% të furnizimit me energji, e ndjekur nga hidroenergjetika (34%) dhe biokarburantet dhe mbetjet (12,9%). Objektivi kombëtar për sigurinë energjetike është të sigurohet furnizim i qëndrueshëm, i sigurt dhe cilësor nga të gjitha sistemet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, çka nënkupton se energjia duhet të jetë e disponueshme, e qasshme, e përbalueshme dhe e pranueshme në raport me zhvillimin e vendit. Ngjarjet klimatike ekstreme mund ta ndikojnë dhe ta kërcënojnë këtë siguri energjetike nëpërmjet ndërprerjeve në furnizim dhe shpërndarje (shihni, gjithashtu, kapitullin 4 për detaje), dhe kjo duhet të merret më shumë në konsideratë në politikat dhe strategjitë e ardhshme energjetike.

Transporti

Sektori i transportit në Shqipëri mbështetet kryesisht te rrjeti rrugor, me një gjatësi totale prej 18.000 km, dhe me rritje të ngarkesës së qarkullimit si për mallrat, ashtu edhe për pasagjerët. Vëllimi i qarkullimit rrugor pritet të tejkalojë kapacitetin e sistemit në të ardhmen e afërt, veçanërisht në korridoret e ngarkuara, si Tiranë–Durrës dhe autostrada Adriatiko–Joniane. Trafiku i rënduar tashmë shkakton probleme të konsiderueshme kongestionit në qytete, si: Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra, etj. Nga ana tjetër, rrjeti hekurudhor mbetet i nënpërdorur, me 200 km nga 416 km të linjës kryesore hekurudhore jashtë funksionit. Transporti detar është mënyra kryesore për transportin e mallrave drejt Shqipërisë dhe jashtë saj, ku 67,6% e eksporteve dhe 51,6% e importeve të mallrave janë transportuar me rrugë detare në vitin 2022. Transporti ajror është rritur me 212% gjatë periudhës 2014–2022 (duke

arritur 39.062 fluturime në vitin 2022), ndërsa numri i pasagjerëve ajrorë është rritur nga rreth 1,8 milionë në vitin 2010 në rreth 5,2 milionë pasagjer⁵¹. Ndryshimet klimatike paraqesin rreze të konsiderueshme për infrastrukturën e transportit, përfshirë dëmtimet nga ngjarjet ekstreme të motit dhe rritjen e kostove të mirëmbajtjes (shihni më tej kapitullin 4 për detaje). Zhvillimi i infrastrukturës së qëndrueshme ndaj klimës dhe promovimi i mënyrave të qëndrueshme të transportit do të jenë vendimtare për t'u përshtatur me këto ndikime (shihni kapitullin 5).

Zhvillimi urban

Aktualisht, Shqipëria është e ndarë në katër rajone, të karakterizuara nga pabarazi të konsiderueshme rajonale, ekonomike, urbano-rurale, ndërrajonale dhe intrarajonale. Qytetet dhe qendrat urbane luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mjedisin socio-ekonomik. Rajoni Tiranë–Durrës është më i zhvilluari ekonomikisht, ndërsa rajonet e tjera janë më rurale, me vendbanime të fragmentuara dhe cilësi më të ulët të kapitalit njerëzor. Urbanizimi është në rritje të shpejtë në Shqipëri, ku popullsia urbane pritet të arrijë në 78,2% të popullsisë së përgjithshme deri në vitin 2050. Shpopullimi i vazhdueshëm i zonave rurale ndikon në ofrimin e disa shërbimeve, si: qasja në kujdesin shëndetësor, ushqim dhe mjete bazë në këto zona. Rritja urbane rrit kërkesën për infrastrukturë dhe shërbime, duke ushtruar presion mbi zonat urbane për zhvillimin e tyre. Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor (PPKH, 2016) përfaqëson një përpjekje të koordinuar për planifikimin hapësinor dhe do të formësojë trajektoren e zhvillimit urban të Shqipërisë në të ardhmen. Për shkak të cenueshmërisë së perceptuar, kërkohej investime dhe përpjekje të konsiderueshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, ku infrastrukturat jetike duhet të bëhen të qëndrueshme ndaj klimës, për të rritur aftësinë ripërtëritëse të vendit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Shihni kapitullin 4 për risqet konkrete klimatike, që ndikojnë te zhvillimi urban, dhe kapitullin 5 për masat e identifikuara dhe të prioritizuara të përshtatjes.

Burimet ujore përbëjnë një burim të rëndësishëm të hidroenergjisë, duke prodhuar rreth 90% të energjisë elektrike të vendit dhe siguruar ujë për ujitje në bujqësi. Aktualisht, për çdo sezon ujitjeje nevojiten rreth 1 miliard metra kub ujë për të ujitur 360.000 hektarë tokë bujqësore. Ngjarjet ekstreme të motit paraqesin risqe për cilësinë e ujit dhe infrastrukturën e furnizimit, përfshirë edhe ato që sigurojnë ujë të pijshëm dhe shërbime higjieno-sanitare për popullsinë. Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përmirësimi i eficiencës së ujitjes janë thelbësore për të përmbushur nevojat e ardhshme për ujë dhe për t'u përshtatur me ndryshueshmërinë klimatike⁵².

Sektori i industrisë në Shqipëri ka shënuar zhvillime shumë pozitive gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Vlera e shtuar nga industria (përfshirë ndërtimin) arriti 26% të PBB-së në vitin 2020. Importet e Shqipërisë u rritën nga 4,41 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2015, në 5,42 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2020, kryesisht nga Italia, Kina, Greqia, Turqia dhe Gjermania. Ndërkohë, eksportet shqiptare u rritën nga 2,2 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2015 në 2,62 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2020, ku produktet kryesore të eksportit përfshijnë këpucë, veshje, naftë bruto dhe hekur të papërpunuar, të eksportuara kryesisht drejt Italisë, Serbisë, Gjermanisë, Spanjës dhe Greqisë. Pavarësisht këtyre tendencave pozitive, ndryshimet klimatike paraqesin një sërë risqesh për sektorin industrial, p.sh., ngjarjet ekstreme si përmbytjet dhe thatësitat mund të ndërpresin zinxhirët e furnizimit, të dëmtojnë infrastrukturën dhe të rrisin kostot e prodhimit. Forcimi i aftësisë ripërtëritëse ndaj klimës në sektorin industrial kërkon diversifikimin e zinxhirëve të furnizimit, përmirësimin e eficiencës energjetike dhe investimin në infrastrukturë të përshtatshme.

⁵¹ SKZHIE III (2022–2030).

⁵² Komunikimi i katërt kombëtar i Shqipërisë për ndryshimet klimatike, 2022.

Në vitin 2019, **sektori i shërbimeve** (i përfaqësuar nga nënsektorët e tregtisë, transportit, veprimtarive tregtare dhe shërbimeve të telekomunikacionit) përbënte rreth 50% të PBB-së së vendit. Që nga fillimi i viteve 2000, Shqipëria është shndërruar në një destinacion kryesor për shërbimet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), falë disponueshmërisë së burimeve, rritjes së vëmendjes ndaj sektorit të shërbimeve, zhvillimit të infrastrukturës dhe incentivave tërheqëse për investimet. Tirana është qendra kryesore e TIK-ut në Shqipëri. Ky sektor ka përjetuar një rritje të qëndrueshme, me rreth 4.005 ndërmarrje aktive në fushën e TIK-ut deri në fund të vitit 2021. Sidoqoftë, ndryshimet klimatike mund të ndikojnë ndjeshëm tek ofrimi i shërbimeve dhe infrastruktura mbështetëse, për shembull, valët e të nxehtit dhe ngjarjet ekstreme të motit mund të ndërpresin rrjetet e telekomunikacionit, ndërsa përmbytjet dhe stuhitë mund të dëmtojnë infrastrukturën logjistike⁵³.


3.4 Kuadri ligjor, institucional dhe i politikave

Republika e Shqipërisë është një **Republikë Kushtetuese** me një President (Kreu i Shtetit), një Kuvend të zgjedhur në mënyrë demokratike (Pushteti Ligjvënës), Këshillin e Ministrave (Pushteti Ekzekutiv) dhe Pushtetin Gjyqësor. Në aspektin administrativ, Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe dhe 61 bashki, që përfshijnë si zona urbane ashtu edhe rurale (bashki dhe komuna)⁵⁴.

Figura më poshtë paraqet strukturën organizative të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, duke renditur ministrat kryesore, agjencitë vartëse dhe institucionet përkatëse.

Figura 2. Struktura organizative e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë sipas Ligjit për Ndryshimet klimatike 155/2020, i ndryshuar.

Burimi: UNDP-ja.



Institucionet që trajtojnë ndryshimet klimatike

Sipas Ligjit për Ndryshimet Klimatike (2020), përgjegjësitë për çështjet e ndryshimeve klimatike ndahen ndërmjet disa **ministrive dhe institucioneve**.

⁵³ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (2023).

⁵⁴ Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve. Hartuar në kuadër të Projektit të UNDP-së për PKP-në, janar 2023.

- **Ministria e Mjedisit (MM)** është ministria qendrore përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe ka në ngarkim politikat dhe legjislacionin për ndryshimet klimatike, si dhe koordinimin në nivel qeveritar. Ajo është, gjithashtu, pika fokale kombëtare për Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Brenda kësaj ministrie funksionon Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), e cila zbaton dhe monitoron këto politika, ndërsa ministritë e linjës dhe agjencitë, autoritetet dhe institutet vartëse adresojnë çështjet e ndryshimeve klimatike në sektorët e tyre përkatës.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)** është institucioni përgjegjës për politikat bujqësore dhe rurale, dhe luan një rol kyç në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, për shkak të cenueshmërisë së lartë të bujqësisë nga klima.

- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)** është përgjegjëse për planifikimin territorial dhe urban, banesat, punimet publike, politikat e zhvillimit territorial, kodet e ndërtimit, rregulloret e përdorimit të tokës dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës kryesore urbane, të gjitha këto me rëndësi thelbësore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. MIE, gjithashtu, mbikëqyr Departamentin e Energjisë, që është përgjegjës për integrimin e përshtatjes ndaj klimës në politikat energjetike dhe planifikimin e infrastrukturës energjetike. Po ashtu, MIE është institucioni kryesor për transportin (rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror) dhe infrastrukturën përkatëse, ku Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është përgjegjës për menaxhimin e rrjetit kombëtar rrugor, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe Autoriteti i Aviacionit Civil integrojnë përshtatjen brenda kompetencave të tyre. **Ministritë e tjera të linjës dhe institucionet publike**, p.sh. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Instituti i Statistikave (INSTAT-i), Kryeministria, etj., kanë role më të tërthorta në çështjet e ndryshimeve klimatike. Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile (AKEC) pranë Ministrisë së Mbrojtjes merret me mbrojtjen civile, përfshirë dhe mbrojtjen nga ndikimet e ndryshimeve klimatike, si: përmblytjet, rrëshqitjet e dherave, zjarret në pyje, etj., nëpërmjet një sërë komitetesh koordinuese, komisionesh dhe grupesh pune në nivel qendror dhe vendor. Megjithatë, menaxhimi i ndryshimeve klimatike në nivel nënkombëtar mbetet ende i dobët, edhe për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme institucionale, teknike dhe individuale në këtë nivel⁵⁵.

- **Shërbimet meteorologjike:** Zhvillimi dhe shpërndarja e informacionit për ndryshimet klimatike mbështeten nga dy institute meteorologjike: Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak pranë Ministrisë së Mbrojtjes⁵⁶.

- **Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK)** përbëhet nga anëtarë ekspertë të AKM-së, AKEC-it, INSTAT-it, IGJEO-s, si dhe përfaqësues nga disa ministri sektoriale⁵⁷, dhe ka një rol koordinues e këshillimor në mbështetje të Ministrisë së Mjedisit për çështjet që lidhen me klimën. Është vlerësuar se ka qenë kryesisht joaktiv që nga viti 2017⁵⁸. Për të ringjallur këtë forum, është përgatitur një draft i rishikuar i urdhrat të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e Grupit Ndërministror të Punës për Ndryshimet Klimatike”, i cili ende nuk është miratuar⁵⁹. GNPNK-ja ndahet në dy nëngrupe: Grupi i Punës

⁵⁵ Vlerësimi i kapaciteteve të bashkive dhe nevojave për trajnim për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Përgatitur në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2023.

⁵⁶ Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

⁵⁷ Ministritë e: Financës, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Infrastrukturës dhe Energjisë, Arsimit dhe Sportit, Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Evropën dhe Punët e Jashtme, etj.

⁵⁸ Raporti për vlerësimin e kapaciteteve kombëtare dhe nevojave për trajnime për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2023.

⁵⁹ Raporti fillestar për procesin e dytë të PKP-së në Shqipëri. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-

për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike (GPZNK) dhe Grupi i Punës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (GPPNK), ndërsa janë përcaktuar rregulla të detajuara për drejtimin, sekretariatit teknik, si dhe manualët e funksionimit dhe formatet e raportimit⁶⁰.

Kapacitetet për menaxhimin e përshtatjes mund të përmirësohen më tej në vend. Disa nga **boshllëqet institucionale**⁶¹ të identifikuar në Shqipëri, në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, përfshijnë:

- Mungesën e mandateve të qarta institucionale për ndryshimet klimatike në shumicën e institucioneve të përcaktuara nga ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, i ndryshuar;
- Mungesën e strukturave të posaçme për çështjet e ndryshimeve klimatike në institucionet përkatëse;
- Mungesën e stafit të posaçëm për ndryshimet klimatike në këto institucione.

Kuadri ligjor dhe i politikave

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE III, 2022–2030) është dokumenti kryesor kombëtar i planifikimit, që përcakton drejtimit dhe prioritetet për zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm të vendit në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në BE. Një analizë e shpejtë përmes “lentës klimatike”⁶² e zbatuar ndaj SKZHIE III⁶³ tregoi se integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike është përmirësuar krahasuar me strategjinë e mëparshme SKZH II (2015–2020). Kjo dëshmohet përmes objektivit të politikave të SKZHIE III për të rritur aftësinë ripërtëritëse të vendit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike nëpërmjet masave të veçanta të përshtatjes, si: integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore dhe në buxhetimin publik; krijimi i një platforme kombëtare të informacionit dhe shërbimeve klimatike; zbatimi i qasjeve të bazuara në ekosisteme dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë; përmirësimi i menaxhimit të rreziqeve nga fatkeqësitë përmes sistemeve të paralajmërimit të hershëm; përshtatja në zonat bregdetare. Megjithatë, ndryshimet klimatike nuk janë integruar në mënyrë të barabartë në të gjithë sektorët prioritarë⁶⁴. Dokumente të tjera të rëndësishme të politikave që fokusohen në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përfshijnë **dokumentin strategjik për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike**, kontributet e rishikuara kombëtare të pikësnyuara (KKP, 2021), **Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës të Republikës së Shqipërisë** (PKEK, 2024), etj.

Në lidhje me negociatat në vazhdim dhe përafrimin e **legjislacionit për klimën të BE-së**⁶⁵ nga Shqipëria, Strategjia e BE-së për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (2021)

në, dhjetor 2022.

⁶⁰ Raporti për vlerësimin e kapaciteteve kombëtare dhe nevojave për trajnime për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2023.

⁶⁰ Raporti fillestar për procesin e dytë të PKP-së në Shqipëri. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, dhjetor 2022.

⁶¹ Raporti për vlerësimin e kapaciteteve kombëtare dhe nevojave për trajnime për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2023.

⁶² Një proces ose mjet analitik për shqyrtimin e një politike, plani ose programi për integrimin e elementeve të ndryshimeve klimatike, duke ndjekur dokumentin “Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në bashkëpunimin për zhvillim: Udhëzim për politikën” (OECD, 2009). Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që një politikëbërës të vendosë nëse një politikë, plan apo program kërcënohet nga ndryshimet klimatike dhe se çfarë ndryshimesh duhen kryer.

⁶³ Dokument udhëzues për mënyrën e përfshirjes së përshtatjes në përditësimet e planeve të zhvillimit të sektorëve dhe një vlerësim i integritit të PNK-së në legjislacionin kombëtar të Shqipërisë, dhe SKZHIE III 2022–2030 për pesë sektorët prioritarë. Përgatitur në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në.

⁶⁴ Dokument udhëzues për mënyrën e përfshirjes së përshtatjes në përditësimet e planeve të zhvillimit të sektorëve dhe një vlerësim i integritit të PNK-së në legjislacionin kombëtar të Shqipërisë, dhe SKZHIE III 2022–2030 për pesë sektorët prioritarë.

⁶⁵ *Acquis* i Bashkimit Evropian (BE) është një tërësi të drejtash dhe detyrimesh të përbashkëta, që përbëjnë bazën e legjislacionit të BE-së, dhe është përfshirë në sistemet ligjore të shteteve anëtare të BE-së.

përcakton një vizion afatgjatë për BE-në për “t’u bërë një shoqëri e qëndrueshme ndaj klimës, plotësisht e përshtatur me ndikimet e pashmangshme të ndryshimeve klimatike deri në vitin 2050”. Kjo strategji synon të forcojë kapacitetin përshtatës të BE-së dhe të minimizojë cenueshmërinë ndaj ndikimeve klimatike, duke: përmirësuar njohuritë mbi ndikimet klimatike dhe zgjidhjet për përshtatje; intensifikuar planifikimin e përshtatjes dhe vlerësimet e riskut klimatik; përshpejtuar veprimet për përshtatje, dhe forcuar qëndrueshmërinë klimatike në nivel botëror⁶⁶. Shqipëria ka nënshkruar, gjithashtu, Agjendën e Gjelbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe marrëveshje të tjera rajonale që lidhen me qëndrueshmërinë dhe veprimin klimatik, të cilat udhëheqin reagimin e saj ndaj përshtatjes klimatike.

Veç kësaj, korniza ligjore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përfshin Ligjin për Ndryshimet Klimatike nr. 155/2020, i ndryshuar dhe VKM-në nr. 889, të dhjetorit 2022, “Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar”. Tre nga pesë objektivat e Ligjit për Ndryshimet Klimatike lidhen me përshtatjen ndaj ndryshimeve **klimatike**: rritja e kapacitetit të përshtatjes në nivel kombëtar dhe vendor; nxitja e zhvillimit ekonomik përmes krijimit të vendeve të punës dhe konkurrencës, duke përfshirë diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore; pjesëmarrja graduale në zbatimin e politikave të BE-së për ndryshimet klimatike. Akte të tjera përkatëse janë: Ligjet për Energjinë, Ligji për Mbrojtjen Civile dhe Deklarata e Riskut Fiskal⁶⁷.

Detaje shtesë dhe një listë e plotë e legjislacionit dhe politikave të Shqipërisë që lidhen me klimën mund të gjenden në aneksin I. Aneksi I: Përmbledhje e kuadrit rregullator dhe politikave.

4. TENDENCAT, SKENARËT, CENUESHMËRITË DHE RISQET KLIMATIKE

Metodologjia për vlerësimin e tendencave dhe skenarëve të ndryshimeve klimatike në Shqipëri u bazua tek një qasje gjithëpërfshirëse, ndërdisiplinore dhe pjesëmarrëse, e cila përfshinte analizimin e kushteve të vëzhguara klimatike dhe ndryshimeve të pritshme klimatike, vlerësimin e risqeve klimatike, analizën e cenueshmërisë së pesë sektorëve kryesorë dhe konsultimin me palët e interesit.

Duke u mbështetur te kjo bazë metodologjike, është thelbësore të kuptohet konteksti aktual klimatik i Shqipërisë si pikë referimi për vlerësimin e ndryshimeve të ardhshme. Sipas klasifikimit klimatik të Köppen, Shqipëria ka klimë mesdhetare, të karakterizuar nga dimra të butë dhe me lagështi, të pasuar nga vera të nxehta dhe të thata. Në këtë klimë tipike mesdhetare, për shkak të topografisë së larmishme, vërehen ndryshime të konsiderueshme klimatike, që variojnë nga dimrat shumë të ftohtë në zonat veriore, verilindore dhe juglindore, deri te verat shumë të nxehta dhe të thata përgjatë bregdetit. Duke marrë në konsideratë ndryshimet hapësinore të elementeve klimatike të përmendura dhe bazuar te ndryshimet e regjimeve të temperaturës dhe reshjeve, klimatologët shqiptarë e ndajnë territorin e Shqipërisë në 4 zona klimatike (shihni më poshtë): Zona Fushore Mesdhetare (ZFM), Zona Kodrinore Mesdhetare (ZKM), Zona Paramalore Mesdhetare (ZPM), Zona Malore Mesdhetare (ZMM) dhe në 13 nënzona

⁶⁶ Strategjia e përshtatjes e BE-së. Krijimi i një Evrope të qëndrueshme ndaj klimës – Strategjia e re e BE-së për Përshtatjen (2021).

⁶⁷ Raporti fillestar për procesin e PKP-së në Shqipëri. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, dhjetor 2022.

Burimi: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë.

Figura në vijim paraqet shpërndarjen hapësinore të temperaturës mesatare vjetore ($^{\circ}\text{C}$) dhe reshjeve vjetore (mm) në Shqipëri për periudhën 1991–2020, duke ilustruar gradientët e theksuar klimatikë nga zonat bregdetare drejt atyre të brendshme dhe malore.




Figura 4. Harta e temperaturës mesatare vjetore ($^{\circ}\text{C}$): reshjet vjetore (mm) (djathtas) të Shqipërisë, 1991–2020.

Burimi: Profili i Riskut Klimatik për Vendin, Banka Botërore (2021).

Në mënyrë plotësuese, figura 5 tregon shpërndarjen bazë (1995–2015) të temperaturave minimale, mesatare dhe maksimale, duke theksuar diapazonin dhe variabilitetin e kushteve vjetore të temperaturës në të gjithë territorin.




Figura 5. Shpërndarjet e temperaturave vjetore⁶⁸.

Burimi: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë.

Kjo larmi gjeografike përkthehet në risqe dhe cenueshmëri klimatike të diferencuara nëpër territor. Shqipëria është e ekspozuar ndaj risqeve të konsiderueshme klimatike dhe fatkeqësive natyrore, me nivele të ndryshme ashpërsie nëpër rajone. Rreziqet natyrore kryesore përfshijnë përmytjet, rrëshqitjet e dherave, zjarret masive, tërmetet, ortelet e dëborës dhe kërcënimet biologjike, si pandemitë dhe sëmundjet e transmetueshme përmes ujit. Cenueshmëria e vendit thellohet më tej nga faktorë socio-ekonomikë, si: rritja e popullsisë, urbanizimi, shterimi i burimeve, varfëria, kapacitetet e kufizuara institucionale, menaxhimi i pamjaftueshëm i riskut nga fatkeqësitë dhe niveli i ulët i pjesëmarrjes komunitare⁶⁹.

4.1 TENDENCAT DHE SKENARËT KLIMATIKË

Tendencat klimatike të vëzhguara

Vëzhgimet e temperaturës ndërmjet viteve 1951 dhe 2020 në Shqipëri tregojnë ndryshime ndërvjetore të temperaturave mesatare vjetore (figura 6). Mund të dallohen tri periudha të veçanta, përkatësisht një rritje e temperaturës mesatare vjetore nga viti 1951 deri në 2020, nga 1971 deri në 2020 dhe nga 1991 deri në 2020. Në të gjithë vendin, vëzhgimet tregojnë një rritje të qartë të temperaturës sipërfaqësore të ajrit: tendencat e temperaturës për periudhën 1991–2020 kanë qenë më të larta se tendencat e regjistruara për periudhën 1951–2020⁷⁰.

⁶⁸Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë – Grupi Ndërmintor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) – Ministria e Mjedisit. Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve. Baastel, janar 2023.

⁶⁹Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, 2023.

⁷⁰Baastel, 2024a.




Figura 6. Tendencat mesatare vjetore të temperaturës sipërfaqësore të ajrit me sinjifikancën e tendencës për çdo dekadë (1951–2023).

Burimi: Grupi i Njohurive për Ndryshimet Klimatike, 2021.

Vëzhgimet e reshjeve nuk paraqesin një tendencë të përcaktuar (figura 7). Që prej viteve 1950, është regjistruar një rënie e lehtë e reshjeve mesatare vjetore, megjithatë kjo rënie nuk është statistikisht domethënëse. Nga ana tjetër, pjesa veriore e zonës bregdetare ka pësuar një rritje të numrit të ditëve me reshje në vit⁷¹. Në përgjithësi, megjithëse modelët sezonale të reshjeve nuk shfaqin ndryshime të mëdha, është vërejtur rritje e intensitetit të reshjeve. Gjithashtu, të dhënat nga Baza e të Dhënave të Ngjarjeve Emergjente tregojnë se përmbytjet kanë qenë rreziku hidrometeorologjik më i shpeshtë në Shqipëri gjatë dy dekadave të fundit, megjithëse nuk është identifikuar ndonjë tendencë e qartë lidhur me shpeshtësinë e tyre⁷².




Figura 7. Tendencat vjetore të reshjeve me sinjifikancën e tendencës për secilën dekadë (1951–2023).

Burimi: Grupi i Njohurive për Ndryshimet Klimatike, 2021.

⁷¹ Hodnebrog et al., 2019.

⁷² Grupi i Bankës Botërore (GBB), 2021.

Shqipëria është prekur edhe nga rritja e nivelit të detit. Siç ilustron në figurën 8, është vërejtur një tendencë në rritje gjatë periudhës 1993–2004. Kjo u pasua nga një periudhë trevjeçare gjatë së cilës luhatja në rritjen e nivelit të detit shfaqti një ulje të përkohshme, përpara se të rifillonte rritje mesatare ndërmjet vitit 2007 dhe 2015-ës⁷³.



Figura 8. Luhatja në rritjen e nivelit të detit (në mm) në Shqipëri në periudhën 1993–2015.

Burimi: Grupi i Njohurive për Ndryshimet Klimatike, 2021.

Detaje të mëtejshme mbi tendencat dhe parashikimet klimatike në nivel bashkiak jepen në **aneksin II**, i cili ofron një perspektivë të lokalizuar, që plotëson analizat në shkallë kombëtare të paraqitura në këtë dokument.

Risqet e ardhshme: Parashikimet për klimën

Për të kuptuar parashikimet për klimën në Shqipëri, më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i pesë skenarëve të përbashkët socio-ekonomikë (SPS)⁷³:

SPS1: Ruajtja e të mirave të përbashkëta globale: kufijtë e sistemeve natyrore po ruhen, me theks të veçantë të mirëqenia e njeriut sesa thjesht të rritja ekonomike. Pabarazitë në të ardhura, si midis vendeve ashtu edhe brenda tyre, po reduktohen. Modelet e konsumit po orientohen drejt minimizimit të përdorimit të burimeve materiale dhe energjisë.

SS2: Zhvillimi në të ardhmen: Trajektoret e të ardhurave midis vendeve ndryshojnë ndjeshëm. Megjithatë ekziston njëfarë bashkëpunimi ndërmjet shteteve, ai mbetet i kufizuar në fushëveprim. Rritja e popullsisë globale është mesatare, duke u stabilizuar në gjysmën e dytë të shekullit. Sistemet mjedisore po përjetojnë njëfarë degradimi.

SPS3: Rivaliteti rajonal: Rishfaqja e nacionalizmit dhe konflikteve rajonale ka bërë që çështjet globale të kalojnë në plan të dytë. Agjendat e politikave po fokusohen gjithnjë e më shumë të siguria kombëtare dhe rajonale. Në të njëjtën kohë, investimet në arsim dhe zhvillim teknologjik po bien, duke kontribuar në rritjen e pabarazive. Disa rajone po përballen me degradim të rëndë mjedisor.

SPS4: Pabarazia: Hendeku ndërmjet shoqërive të zhvilluara dhe bashkëpunuese globalisht dhe atyre që mbeten në faza më të ulëta zhvillimi, të karakterizuara nga të ardhura të ulëta dhe arsimim i kufizuar, po zgjerohet. Ndërkohë që politikat mjedisore janë efektive në trajtimin e sfidave vendore në disa rajone, ato kanë sukses të kufizuar në rajone të tjera.

SPS5: Zhvillimi i mbështetur në lëndët djegëse fosile: Tregjet globale po integrohen gjithnjë e më shumë, duke nxitur inovacionin dhe përparimin teknologjik. Megjithatë, zhvillimi social dhe ekonomik mbështetet në përdorimin e shtuar të burimeve fosile, ku qymyri që zë një pjesë

⁷³ Baastel, 2024a.

të rëndësishme, dhe karakterizohet nga një stil jetese intensiv në përdorimin e energjisë, i përhapur globalisht. Ndërsa ekonomia botërore vijon të zgjerohet, çështjet mjedisore vendore, si ndotja e ajrit, po trajtohen në mënyrë efektive.

Çdo skenar shoqërohet me një rritje të ndryshme të temperaturës mesatare globale.

Tabela 1. Rritja e parashikuar e temperaturës globale sipas skenarëve të ndryshëm.

Burimi: PNNK, 2021.

	Plani afatshkurtër, 2021–2040		Plani afatmesëm, 2041–2060		Plani afatgjatë, 2081–2100	
Skenari	Parashikimi më i mirë (°C)	Intervali më i mundshëm (°C)	Parashikimi më i mirë (°C)	Intervali më i mundshëm (°C)	Parashikimi më i mirë (°C)	Intervali më i mundshëm (°C)
SPS1-1.9	1,5	1,2 deri në 1,7	1,6	1,2 deri në 2,0	1,4	1,0 deri në 1,8
SPS1-2.6	1,5	1,2 deri në 1,8	1,7	1,3 deri në 2,2	1,8	1,3 deri në 2,4
SPS2-4.5	1,5	1,2 deri në 1,8	2	1,6 deri në 2,5	2,7	2,1 deri në 3,5
SPS3-7.0	1,5	1,2 deri në 1,8	2.1	1,7 deri në 2,6	3,6	2,8 deri në 4,6
SPS5-8.5	1,6	1,3 deri në 1,9	2,4	1,9 deri në 3,0	4,4	3,3 deri në 5,7

Ndryshimet e vëzhguara dhe të simuluar në temperaturën mesatare globale të sipërfaqes, në raport me periudhën 1850–1900 paraqiten, duke ilustruar një trajektore të qëndrueshme rritëse në të gjitha SPS-të. Në mënyrë të ngjashme, **figura 10** paraqet rritjen e pritshme të nivelit mesatar global të detit, duke theksuar përshejtimin e rritjes së nivelit të detit në skenarët me shkarkime më të larta.

(a) Global surface temperature change relative to 1850–1900




Figura 9. Ndryshime në temperaturën globale sipërfaqësore krahasuar me periudhën 1850–1900.

Burimi: TS, ndryshimet klimatike 2021: Baza e shkencave fizike. Kontributi i GPI-së për AR6 e PNNK-së.

(a) Global mean sea level rise from 1900–2150




Figura 10. Rritja mesatare globale e nivelit të detit krahasuar me periudhën 1850–1900.

Burimi: TS, ndryshimet klimatike 2021: Baza e shkencave fizike. Kontributi i GPI-së për AR6 e PNNK-së.

Në nivel kombëtar, konteksti socio-ekonomik i Shqipërisë është analizuar nën të njëjtën kornizë të SPS-ve për të vlerësuar cënueshmëritë e mundshme, kapacitetin përshtatës dhe implikimet sektoriale⁷⁴. Ekonomia e brishtë e Shqipërisë, risqet nga fatkeqësitë natyrore, varfëria dhe infrastruktura e pamjaftueshme e bëjnë atë shumë të prekshme nga ndryshimet klimatike. Sfidat mjedisore, si: shpyllëzimi, menaxhimi i dobët i ujëmbledhësve, ndotja dhe zhvillimi bregdetar i parregulluar, së bashku me ndërjegjësimin e ulët për klimën, i ndërlikojnë më tej përpjekjet për përshtatje. Ekonomia e vendit është zhvendosur nga lëndët e para dhe industria drejt një strukture të udhëhequr nga shërbimet, duke ruajtur rritje të qëndrueshme vjetore, e nxitur nga performanca e sektorit privat, eksportet dhe investimet në infrastrukturë. Për më tepër, popullsia e Shqipërisë ka rënë që nga vitet 1960 për shkak të reformave shoqërore dhe shifrave të larta të emigracionit. Me nivele rritjeje të qëndrueshme, parashikohet që popullsia të bjerë më tej, duke arritur në rreth 2,75 milionë banorë deri në vitin 2031. Në vijim, paraqiten skenarët SPS për Shqipërinë⁷⁵:

SPS1	Qëndrueshmëria – Ndjekja e rrugës së gjelbër (sfida të pakta për zbutjen dhe përshtatjen) Në këtë SPS, rruga e qëndrueshme që po ndjek bota do të ndikojë te dinamikat e zhvillimit ekonomik dhe cilësia mjedisore në çdo vend. Mbështetja ndërkombëtare dhe politikat e integritit do të sigurojnë zbatimin e politikave të gjelbra në Shqipëri. Shqipëria do të ketë më shumë investime në arsim, më shumë ofrim të kujdesit shëndetësor, rritje ekonomike mesatare deri në të lartë, të orientuar drejt mirëqenies njerëzore, dhe më pak pabarazi. Për shkak të një popullsie më të arsimuar, vendi do të ketë rritje më të ulët të popullsisë. Popullsia në përgjithësi do të bjerë gjatë të gjithë shekullit. Për shkak të një niveli më të ulët pabarazie, më shumë njerëz do të jenë në gjendje të udhëtojnë për qëllime pushimi, duke ndikuar kështu te sektori i turizmit. Intensiteti më i ulët i përdorimit të burimeve dhe popullsia më e ulët do të sjellin kërkesë më të vogël për ujë. Pritet, gjithashtu, përmirësim në menaxhimin e burimeve ujore. Rregulloret më të forta mjedisore do të ndikojnë, gjithashtu, në sektorin e bujqësisë. Bujqësia do të përjetojë përmirësime në prodhimtari për shkak të zbatimit të praktikave më të mira në sektor dhe përmirësimeve në teknologji. Qëndrueshmëria e lartë nënkupton konsum më të ulët ushqimi, duke ndikuar kështu sërish në prodhimin bujqësor.
SPS2	Rruga e mesme (sfida të moderuara për zbutjen dhe përshtatjen) Ndërsa bota ndjek një rrugë në të cilën tendencat nuk ndryshojnë ndjeshëm nga modelet historike, Shqipëria do të përjetojë zhvillime shoqërore, ekonomike dhe teknologjike të ngjashme me ato që përjeton sot. Përbërja e PBB-së nuk ndryshon, duke bërë që vendi të mbështetet ndjeshëm te sektori i shërbimeve dhe më pak te bujqësia dhe industria. Shqipëria mbetet një ekonomi shërbimesh, me veprimtari të përqendruara kryesisht te shërbimet financiare, mikpritja, tregtia me pakicë dhe më pak te shëndetësia, shërbimet njerëzore, teknologjia e informacionit dhe arsimi. Përpjekjet e pakta për menaxhimin mjedisor do të çojnë në degradim të mëtejshëm të sistemeve mjedisore. Përpjekjet e pakta për arritjen e objektivave të qëndrueshmërisë do të ndikojnë te menaxhimi i burimeve. Kjo rrugë do të shkaktojë rritje ekonomike mesatare, rritje më të lartë të popullsisë krahasuar me SPS1 dhe nivele të ngjashme pabarazie me ato aktuale. Popullsia në përgjithësi do të bjerë gjatë të gjithë shekullit. Ndikimet në sektorët e ndryshëm pritet të jenë, si më poshtë: Kërkesa për ujë do të rritet për shkak të numrit më të madh të popullsisë krahasuar me SPS1. Sektori i turizmit mund të ndikohet nga rritja e popullsisë, por nga ana tjetër, pabarazia e vazhdueshme në popullsi do të ndikojë te kërkesa për turizmin. Ndikimi i ndërthurur i këtyre dy forcave shtytëse mbi turizmin mbetet i paqartë. Më pak fokus dhe zhvillim në teknologji do të ndikojnë te prodhimi bujqësor, duke ulur rendimentin e

⁷⁴ Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, janar 2023.

⁷⁵ Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, janar 2023.

	prodhimit bujqësor.
SPS3	Rivaliteti rajonal - Një rrugë e ashpër (sfida të shumta për zbutjen dhe përshtatjen) Në një skenar të tillë, nivele më të forta nacionalizmi do të çojnë në kufizime të forta në bashkëpunimin ndërkombëtar. Për një vend si Shqipëria, shumë të varur nga mbështetja ndërkombëtare, kjo do të shkaktojë një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike. Zhvillimi i ngadaltë ekonomik, me norma të ulëta rritjeje, duke shkaktuar edhe më shumë pabarazi, janë disa nga karakteristikat e së ardhmes për këtë skenar. Investimet e ulëta në arsim, teknologji dhe kujdes shëndetësor dhe veprimet e kufizuara për mjedisin do të ndikojnë fuqishëm te mirëqenia e popullsisë. Një popullsi më pak e arsimuar do të çojë në norma më të larta të rritjes së popullsisë, krahasuar me skenarët e tjerë. Kërkesa më e lartë për ushqim dhe ujë, e shoqëruar me më shumë shpërfillje ndaj mjedisit, do të shkaktojë keqpërdorim të burimeve. Zhvillimi më i ulët teknologjik do të ndikojë te nivelet e prodhimit në sektorin bujqësor, i cili nga ana tjetër duhet të plotësojë nevojat e një popullsie në rritje. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, nga ana tjetër, do të ndikojë në konsum, duke e ulur atë. Sektori i turizmit do të përballet me rënie për shkak të rritjes së varfërisë dhe pabarazisë ndërmjet rajoneve.
SPS4	Pabarazia – Një rrugë e ndarë (sfida të pakta për zbutjen, sfida të shumta për përshtatjen) Ky skenar paraqet një botë me rritje të pabarazisë. Qasja në arsim dhe kujdes shëndetësor është e mundur vetëm për një pjesë të popullsisë. Kjo shkakton një nivel të lartë shtresëzimi brenda vendit. Kjo do ta ndikojë ndjeshëm Shqipërinë, një vend që aktualisht po përballet me rritjen e shtresëzimit të popullsisë. Kohezioni social i cenuar mund të shkaktojë paqëndrueshmëri të lartë politike dhe konflikte. Fragmentimi vërehet, gjithashtu, në mënyrën e zbatimit të politikave të ndryshme, për shembull në fushën mjedisore. Popullata e të pasurve do të ulet, ndërsa popullata e të varfërve do të rritet.
SPS5	Zhvillimi i mbështetur në lëndët djegëse fosile – Ndjekja e rrugës së shpejtë (sfida të shumta për zbutjen, sfida të pakta për përshtatjen) Ky skenar do të sjellë rritje në të gjithë sektorët në Shqipëri, investime të larta në arsim dhe kujdes shëndetësor, duke shkaktuar më pak pabarazi, rënie të popullsisë, nivele të larta të rritjes ekonomike dhe rritje të veprimeve për mjedisin. Rënia e popullsisë do të shkaktojë kërkesë më të ulët për ujë. Zhvillimi i lartë teknologjik do të rrisë rendimentin e prodhimit në bujqësi. Turizmi do të ndikohet negativisht nga rënia e popullsisë, por pozitivisht nga normat e larta të rritjes ekonomike dhe nivelet më të ulëta të pabarazisë. Efekti i përgjithshëm ndaj turizmit do të rezultojë nga ndërthurja e efekteve të rënies së popullsisë dhe rritjes ekonomike.

Shihni figurën 11 dhe figurën 12, më poshtë për disa nga përshkrimet kryesore të skenarëve të mësipërm⁷⁶.




Figura 11. Skenarët bazë për PBB-në e Shqipërisë.

⁷⁶Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë - Grupi Ndërmnistror i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) - Ministria e Mjedisit. Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve. Baastel, janar 2023.





Figura 12. Skenarët bazë për popullsinë e Shqipërisë.

Temperatura

Ndryshimet e parashikuara vjetore në temperaturën mesatare, në krahasim me periudhën klimatologjike të referencës (1996–2015), pritet të arrijnë deri në 0,8°C (duke u luhatur nga 0,5°C deri në 1,1°C) deri në vitin 2030 dhe 1,3°C (nga 0,8°C deri në 1,9°C) deri në vitin 2050. Nën skenarit të ndërmjetëm SPS2-4.5, rritjet e temperaturës deri në vitin 2100 parashikohen të variojnë ndërmjet 1,4°C dhe 3,1°C në bazë vjetore, dhe ndërmjet 1,9°C dhe 3,9°C gjatë verës. Skenarët me shkarkime të larta dhe shumë të larta, SPS3-7.0 dhe SPS5-8.5, parashikojnë që temperaturat vjetore dhe verore mund të rriten deri në 4,6°C (nga 3,2°C deri në 6,8°C) dhe 6,0°C (nga 4,1°C deri në 8,9°C), përkatësisht, deri në vitin 2100. Të gjitha SPS-të parashikojnë rritje më të ulët të temperaturës në dimër dhe pranverë në krahasim me verën dhe vjeshtën, me ngrohjen më të theksuar të pritshme gjatë verës, sipas skenarëve agresivë SPS3-7.0 dhe SPS5-8.5 (Baastel, 2024a).

Për të vizualizuar këto parashikime, figura⁷⁷ më poshtë paraqet ndryshimet e temperaturës mesatare vjetore sipas skenarëve SPS2-4.5 dhe SPS5-8.5, për vitet 2050 dhe 2100, duke ilustruar shkallën dhe shpërndarjen hapësinore të ngrohjes së pritur në të gjithë territorin e Shqipërisë.



⁷⁷ SPSx-y, x u referohet skenarëve të përbashkët socio-ekonomikë (përkatësisht SPS1 deri te SPS5) dhe y i referohet nivelit të forcës rrezatuese (përkatësisht 1,9; 2,6; 4,5; 6,0 dhe 8,5 W/m²) në vitin 2100.




Figura 13. Ndryshimet e temperaturës mesatare vjetore sipas skenarëve SPS2-4.5 dhe SPS5-8.5.

Variacionet sezonale të ndryshimit të temperaturës janë, gjithashtu, të dukshme. Figura më poshtë paraqet ndryshimet e parashikuara të temperaturës për vitin 2050 në stinë të ndryshme, duke theksuar ngrohjen më të madhe që pritet gjatë verës dhe vjeshtës krahasuar me dimrin dhe pranverën.




Figura 14. Ndryshimet e parashikuara të temperaturës për vitin 2050 në stinë të ndryshme.

Ndryshimet e parashikuara në temperaturat maksimale dhe minimale paraqesin tendenca të ngjashme me ato të temperaturës mesatare. Në skenarin e ndërmjetëm (SPS2-4.5), temperaturat maksimale vjetore pritet të rriten afërsisht me 1,6°C (nga 1,1°C deri në 2,7°C) deri në vitin 2050, dhe 2,5°C (nga 1,6°C deri në 4,1°C) deri në vitin 2100. Skenari më agresiv (SPS5-8.5) parashikon rritje më të mëdha të temperaturave maksimale, veçanërisht gjatë muajve të verës, që mund të arrijnë 2,8°C (nga 1,8°C deri në 4,6°C) deri në vitin 2050. Krahas kësaj, parashikimet tregojnë se temperaturat në përqindëshin e lartë (95%) pritet të rriten më shpejt se temperaturat mesatare, veçanërisht gjatë verës. Rritja e njëkohshme e temperaturave minimale sugjeron, gjithashtu, se intensiteti i valëve të të nxehtit do të rritet, me një rritje të shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes së këtyre fenomeneve, veçanërisht në skenarin SPS5-8.5.

Numri i ditëve të nxehta (përcaktuar si ditë me temperatura maksimale $\geq 35^{\circ}\text{C}$) pritet të rritet, ndërsa numri i ditëve të ftohta (temperatura minimale $< 0^{\circ}\text{C}$) dhe shumë të ftohta (temperatura minimale $< -5^{\circ}\text{C}$) pritet të bjerë në të gjitha zonat klimatike në të gjithë skenarët. Këto tendenca janë veçanërisht të theksuara në skenarët SPS3-7.0 dhe SPS5-8.5, krahasuar me periudhën e referencës.

Temperaturat maksimale dhe minimale absolute pritet të rriten në të gjithë skenarët SPS. Si pasojë, periudhat e përsëritjes së temperaturave ekstreme maksimale pritet të ulen ndjeshëm, ndërsa periudhat e përsëritjes së temperaturave ekstreme minimale pritet të rriten ndjeshëm në të gjithë territorin shqiptar.

Reshjet⁷³

Të gjitha SPS-të tregojnë një rënie të mundshme si të reshjeve vjetore ashtu edhe sezonale krahasuar me periudhën e referencës 1995–2015, për të gjitha periudhat e parashikuara deri në

vitin 2100. Skenari me shkarkime të larta SPS5-8.5 parashikon uljet më të mëdha në përqindjen e reshjeve, me vlerat vjetore dhe të verës që pritet të bien deri në -5,8% (nga -32,7% deri në +17%) dhe -17,6% (nga -56,2% deri në +16,9%) përkatësisht deri në vitin 2050. Nga ana tjetër, uljet më të vogla në përqindjen e reshjeve priten në skenarët SPS1-1.9 dhe SPS1-2.6, përveç gjatë muajve të verës, ku priten ulje deri në -8,1% (nga -25,7% deri në +7,8%) dhe -10,2% (nga -32,5% deri në +9,5%). Diferencat ndërmjet stinëve për reshjet janë më pak të theksuara. Figura më poshtë ilustron këto kontraste sezonale, duke theksuar variabilitetin dhe pasigurinë e ndryshimeve të reshjeve në rajone dhe periudha të ndryshme.




Figura 15. Diferencat sezonale për reshjet.

Rënia e theksuar në përqindëshin e 5-të të ndryshimeve të parashikuara sugjeron një rritje të mundshme të shpeshtësisë së thatësirave, ndërsa rritja e konsiderueshme në përqindëshin e 95-të tregon risk të shtuar për ngjarje reshjesh të dendura. Analizat në skenarë dhe periudha të ndryshme (2030, 2050, 2100), si dhe për një deri në tri ditë radhazi, tregojnë se periudhat e përsëritjes për nivelet maksimale të reshjeve pritet të shkurtohen në të gjithë Shqipërinë. Për shembull, në zonën e Elbasanit, një ngjarje ekstreme reshjesh prej rreth 145 mm/ditë, historikisht e përsëritur një herë çdo 100 vjet, pritet të ndodhë një herë çdo 70 vjet deri në vitin 2050.

Ky trend ilustrohet më tej në figurë, e cila paraqet periudhat e përsëritjes së reshjeve maksimale njëditore, duke treguar se ngjarjet ekstreme të reshjeve pritet të bëhen më të shpeshta, më intensive dhe më të gjata.




Figura 16. Periudhat e përsëritjes, reshjet maksimale, 1 ditë.

Rritja e nivelit të detit⁷³

Të gjitha SPS-të parashikojnë një rritje të nivelit të detit. Në skenarin e ndërmjetëm SPS2-4.5, rritja e nivelit të detit në zonën e Durrësit pritet të arrijë afërsisht 24 cm (nga 6 deri në 30 cm) deri në vitin 2050, dhe 65 cm (nga 17 deri në 83 cm) deri në vitin 2100, krahasuar me periudhën e referencës 1995–2015.

Shtrirja e parashikuar e përmbytjes bregdetare paraqitet në figurën më poshtë, duke theksuar zonat që pritet të preken nga një rritje e nivelit të detit prej 0,33 m, të shënuara me ngjyrë blu⁷⁸.

⁷⁸ UNDP Prodoc: *Advancing Albania's Planning for Medium and Long-Term Adaptation Through the Development of a National Adaptation Planning (NAP) Process* [Prodok: Avancimi i planit të Shqipërisë për përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë përmes zhvillimit të një procesi kombëtar të planifikimit të përshtatjes

Figura 17. Zonat bregdetare me gjasa për t'u përmbytur me rritjen prej 0,33m të nivelit të detit.

Variablat e tjera klimatike⁷³

Shpeshësia dhe kohëzgjatja e kushteve të ftohta pritet të ulen, së bashku me një pakësim të numrit të ditëve me nevojë për ngrohje. Në kontrast, ditët me nevojë për ftohje pritet të rriten, duke reflektuar një kërkesë më të madhe për energji për ftohje. Këto ndryshime janë veçanërisht të theksuara në skenarët SPS3-7.0 dhe SPS5-8.5.

Në përgjithësi, ekziston një konsensus i fortë në të gjithë skenarët mbi drejtimin e ndryshimeve klimatike të parashikuara, megjithëse ekzistojnë variacione në shkallën e tyre. Konkretisht, të gjithë skenarët tregojnë një rritje të temperaturave vjetore, një ulje të reshjeve vjetore, një rritje të nivelit të detit, dhe një shpeshim të ngjarjeve ekstreme si reshjet intensive, thatësitat dhe valët e të nxehtit. Shkalla e këtyre ndryshimeve rritet me kalimin e kohës, me luhatje më të mëdha të parashikuara për vitin 2050 krahasuar me 2030, dhe për 2100 krahasuar me 2050. Për më tepër, shkalla e ndryshimit është ndjeshëm më e madhe në skenarët më agresivë të shkarkimeve.

Për vlerësimet e ashpërsisë së rreziqeve, është thelbësore të merren parasysh të gjithë skenarët. Vlerësimet më të ulëta të ashpërsisë bazohen në skenarin më optimist (SPS1-1.9) për vitin 2030, ndërsa vlerësimet më të larta të ashpërsisë nxirren nga skenarët më ekstremë, zakonisht duke përdorur parashikimet e SPS5-8.5 për vitin 2050. Kjo qasje thekson si progresionin e mundshëm të rreziqeve klimatike, ashtu edhe ndikimin e theksuar të skenarëve të shkarkimeve të kushtet e ardhshme.

Ndryshimet e parashikuara përputhen me tendencat e vëzhguara të rritjes së temperaturës, rritjes së nivelit të detit dhe rritjes së shpeshësisë së ngjarjeve të reshjeve intensive. Kur krahasohen ndryshimet e vëzhguara dhe të parashikuara të variablave klimatike në Shqipëri, konstatohen dy dallime kryesore: i. një intensifikim i tendencave të vëzhguara në parashikime, i reflektuar në temperatura më të larta, rritje më të madhe të nivelit të detit dhe reshje më intensive; dhe ii. një qartësi më e madhe për disa variabla, veçanërisht reshjet vjetore, ku vëzhgimet mbeten të paqarta, por të gjithë skenarët parashikojnë rënie. Një dallim i tretë i rëndësishëm lidhet me natyrën e të dhënave: ndërsa vëzhgimet bazohen në matje reale, parashikimet bazohen në simulime modelesh sipas supozimeve specifike, duke sjellë një shkallë të caktuar pasigurie. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se për Shqipërinë,

(PKP)].

pavarësisht variacioneve në shkallën e ndryshimit sipas skenarit, të gjithë skenarët konvergojnë përgjithësisht në drejtimin e ndryshimeve të parashikuara.

Për të plotësuar analizat e detajuara të paraqitura më sipër, tabela vijuese përmbledh tendencat klimatike të vëzhguara dhe të parashikuara në Shqipëri, duke ofruar një përmbledhje të temperaturës, reshjeve, rritjes së nivelit të detit dhe ngjarjeve ekstreme në skenarë dhe periudha të ndryshme kohore.

Tabela 1: Përmbledhje e ndryshimeve klimatike të vëzhguara dhe të parashikuara në Shqipëri⁷⁹.

Tendencat klimatike të vëzhguara		Ndryshimet klimatike të parashikuara		
Temperatura				
Temperatura vjetore: rritje por nuk dihet se deri në çfarë mase	Temperatura vjetore: rritje	SPS1-1.9: 2030: 0,8°C 2050: 0,9°C	SPS2-4.5: 2030: 0,8°C 2050: 1,5°C	SPS5-8.5: 2030: 1°C 2050: 2°C
Reshjet				
Reshjet vjetore: nuk ka vëzhgime përfundimtare	Reshjet vjetore: rënie	SPS1-1.9: 2030: 2,4% 2050: 2,7%	SPS2-4.5: 2030: 2,7% 2050: 4,4%	SPS5-8.5: 2030: 3,6% 2050: 5,8%
Niveli i detit				
Rritje	Rritje	SPS1-1.9: 2030: 11cm 2050: 20cm	SPS2-4.5: 2030: 11cm 2050: 24cm	SPS5-8.5: 2030: 11cm 2050: 28cm
Ngjarjet ekstreme të motit				
Shpeshtësia dhe intensiteti i thatësirës: nuk ka informacion	Shpeshtësia dhe intensiteti i thatësirës: rritje	Rënie e theksuar në nivelin e 5% (të reshjeve).		
Shpeshtësia dhe intensiteti i reshjeve të dendura: nuk ka informacion për shpeshtësinë, rritje intensiteti	Shpeshtësia dhe intensiteti i reshjeve të dendura: rritje	Periudhat e përsëritjes së ditëve me > 100 mm reshje:		
		SPS2-4.5: 2050: 16,7		SPS5-8.5: 2050: 15,9
Shpeshtësia dhe intensiteti i valëve të të nxehtit: nuk ka informacion	Shpeshtësia dhe intensiteti i valëve të të nxehtit: rritje	Numri mesatar i valëve të të nxehtit/vit:		
		SPS1-1.9: 2030: 3 2050: 3	SPS2-4.5: 2030: 4 2050: 4	SPS5-8.5: 2030: 4 2050: 4
Shpeshtësia dhe intensiteti i ditëve shumë të ftohta: nuk ka informacion	Shpeshtësia dhe intensiteti i ditëve shumë të ftohta: rënie	Numri i rasteve me Tmin < -5°C		
		SPS1-1.9: 2030: 24 2050: 24	SPS2-4.5: 2030: 24 2050: 24	SPS5-8.5: 2030: 24 2050: 24

⁷⁹ Vlerësimi i riskut klimatik të sektorit të zhvillimit urban. Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes i Shqipërisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Baastel, korrik 2024 (përfshirë, gjithashtu, edhe në raportin për sektorët e tjerë: bujqësi dhe turizëm).

		24	18	16
--	--	----	----	----

4.2 CENUESHMËRITË KLIMATIKE DHE RISQET NË NIVEL KOMBËTAR

Shqipëria është e ekspozuar ndaj rrezeve gjeologjike (tërmete, rrëshqitjeve të shkëmbinjve dhe dherave), por rreziqet hidro-meteorologjike, si: përmbytjet (të shpejta), thatësitat, rrëshqitjet e dherave dhe zjarret në pyje janë rreziqet më të shpeshta, duke përbërë më shumë se 90% të dëmeve të regjistruara⁸⁰. Në vitin 2023, bazuar në cenueshmërinë dhe gatishmërinë ndaj risqeve dhe krizave, Indeksi i Vendeve ND-GAIN⁸¹ e renditi Shqipërinë në vendin e 80-të (nga 185 vende të vlerësuara)⁸². Kjo krahasohet negativisht me vendet e tjera të BE-së dhe, gjithashtu, renditet pas vendeve të Ballkanit Perëndimor⁸³. Shqipëria ka përjetuar shumë raste përmbytjesh gjatë shekullit të fundit: sipas Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Fatkeqësitë (DesInventar), janë regjistruar 504 raste përmbytjesh në ultësirën perëndimore gjatë periudhës 1900–2018⁸⁴. Në rastet e thatësisë, veçohet thatësira e viteve 1989–1991, e cila preku mbi 3 milionë njerëz dhe shkaktoi rreth 24 milionë dollarë amerikanë humbje ekonomike; ekonomisë shqiptare iu deshën gati gjashtë vjet për t’u rikthyer në nivelet para thatësisë⁸⁵. Thatësitat shkaktojnë, gjithashtu, mungesa të rënda energjie: thatësira e vitit 2007 uli prodhimin e hidrocentralit të Fierzës me 33%. Të gjitha cenueshmëritë e shkaktuara nga ndryshimet klimatike do të kenë pasoja të rëndësishme për sektorët kryesorë ekonomikë dhe do të paraqesin pengesa të konsiderueshme për zhvillimin e vazhdueshëm të vendit. Vlerësimet e kujdesshme tregojnë se dëmet ekonomike të lidhura me klimën mund të arrijnë deri në 7% të PBB-së vetëm në vitin 2050⁸⁶.

Për të analizuar këto cenueshmëri në mënyrë sistematike, vlerësimet e riskut të ndërmarra në këtë NAP kanë përdorur kornizën konceptuale për vlerësimet e rrezikut klimatik, siç paraqitet në Raportin AR6 të PNNK për Ndikimet, Përshtatjen dhe Cenueshmërinë (2022). Kjo kornizë konsideron se risku është potenciali për pasoja (efekte ose ndikime) mbi sistemet natyrore dhe njerëzore, që rezulton nga ndërveprimi ndërmjet rrezikut, ekspozimit dhe cenueshmërisë, e cila nga ana e saj është rezultat i ndërveprimit të ndjeshmërisë ose brishtësisë së një sistemi dhe kapacitetit të tij për t’u përgatitur dhe për të reaguar. Më poshtë paraqitet korniza konceptuale dhe më tej përkufizimet. Figura 18 paraqet një skemë ku tregohet marrëdhënia ndërmjet klimës dhe proceseve socio-ekonomike.

⁸⁰ Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike, 2022.

⁸¹ Universiteti i Notre Damit – Nisma për Përshtatje Globale (GAIN). Indeksi për vendin përmblendh cenueshmërinë e vendit ndaj ndryshimeve klimatike dhe sfidave të tjera botërore në ndërthurje me gatishmërinë e vendit për të përmirësuar aftësinë ripërtëritëse.

⁸² 2023 ND GAIN. Sa më i lartë numri, aq më e lartë cenueshmëria dhe aq më e ulët gatishmëria.

⁸³ Mali i Zi i 56-ti, Maqedonia e Veriut e 59-ta, Serbia e 76-ta dhe Bosnjë dhe Hercegovina e 79-ta.

⁸⁴ M. Bogdani. “Raport për ndikimin e ndryshueshmërisë dhe ekstremeve klimatike aktuale te burimet ujore (ujërat nëntokësore, furnizimi me ujë) në DLDM”.

⁸⁵ *The Future of Water in Agriculture in Albania: A Broad Sector Rethinking* [E ardhmja e ujit për bujqësinë në Shqipëri: Një rikonceptim i gjerë sektorial]. Banka Botërore, 2014.

⁸⁶ Shqipëri – Raporti i Klimës dhe Zhvillimit për Vendlin. Banka Botërore, 2024.




Figura 18. Marrëdhënia ndërmjet klimës dhe proceseve socio-ekonomike.

Tabela 2: Vlerësimi i riskut: koncepte dhe përkufizime.

Koncepti	Përkufizimi
Rreziku	Ngjarja ose prirja e mundshme natyrore ose e shkaktuar nga njeriu që mund të sjellë humbje, lëndime ose pasoja të tjera shëndetësore, si dhe dëme e humbje të pasurisë, infrastrukturës, mjeteve të jetesës, ofrimit të shërbimeve, ekosistemeve dhe burimeve.
Ekspozimi	Prania e njerëzve, llojeve ose ekosistemeve, funksioneve, shërbimeve dhe burimeve mjedisore, infrastrukturës ose aseteve ekonomike, sociale apo kulturore në vende dhe mjedise që mund të preken negativisht nga ndryshimet në variablat klimatike.
Cenueshmëria	Prirja për t'u prekur negativisht. Cenueshmëria përfshin ndjeshmërinë ndaj dëmit dhe kapacitetin përshtatës.
Ndjeshmëria	Shkalla në të cilën një sistem mund të ndikohet negativisht ose pozitivisht nga një ekspozim i caktuar ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përcaktohet nga atributet natyrore dhe/ose fizike të sistemit.
Kapaciteti përshtatës	Mundësitë ose mungesa e mundësive për t'u përshtatur me klimën aktuale ose të pritshme dhe efektet e saj. Në sistemet njerëzore, përshtatja synon të zbusë ose shmangë dëmet ose të shfrytëzojë mundësitë e dobishme. Në disa sisteme natyrore, ndërhyrja njerëzore mund të lehtësojë përshtatjen ndaj klimës së pritshme dhe efekteve të saj. Kapaciteti përshtatës u referohet faktorëve që lidhen me disponueshmërinë e informacionit dhe njohurive, ekzistencën e strukturave institucionale të qëndrueshme dhe të koordinuara, ekzistencën e burimeve njerëzore, teknologjike dhe infrastrukturë, si dhe disponueshmërinë e burimeve financiare.
Ndikimi	Pasojë e ndodhjes së një rreziku. Efekti ndaj sistemeve natyrore dhe njerëzore, që ndodh si rezultat i ngjarjeve dhe fenomeneve ekstreme të motit dhe klimës, si dhe i ndryshimeve klimatike (p.sh. efektet ndaj jetës, mjeteve të jetesës, shëndetit, ekosistemeve, ekonomive, shoqërive, kulturave, shërbimeve dhe infrastrukturës).
Risku	Potenciali për ndodhjen e pasojave kur diçka me vlerë është në rrezik dhe kur rezultati është i pasigurt. Shpeshherë, termi risk përdoret për t'iu referuar pasojave të mundshme negative të një rreziku të lidhur me klimën, ose të reagimeve për përshtatjen ose zbutjen ndaj atij rreziku, ndaj jetës, mjeteve të jetesës, shëndetit dhe mirëqenies, ekosistemeve dhe llojeve, aseteve ekonomike, sociale dhe kulturore, shërbimeve (përfshirë shërbimet e ekosistemit) dhe infrastrukturës. Risku zakonisht paraqitet si probabiliteti i ndodhjes së ngjarjeve ose prirjeve të rrezikshme shumëzuar me ndikimet nëse këto ngjarje ose prirje ndodhin. Risku është rezultat i ndërveprimit midis cenueshmërisë, ekspozimit dhe rrezikut.

Madhësia e vogël e Shqipërisë e rrit riskun klimatik, në kuptimin që një ngjarje ekstreme mund të ndikojë më lehtë një pjesë të madhe të vendit sesa në një vend më të madh. Gjithashtu, përqendrimi i popullsisë në bregdet (në vitin 2020 rreth një e treta e popullsisë jetonte në zonat bregdetare, dhe ky numër po rritet si pasojë e migrimit të brendshëm) e rrit riskun klimatik, pasi një pjesë e madhe e popullsisë dhe veprimtaritë e saj ekonomike përgjatë bregdetit janë të

ekspozuara ndaj përmbytjeve dhe rritjes së nivelit të detit. Përqendrimi i popullsisë në një zonë të vetme (Tiranë–Durrës, ku në vitin 2031 pritet të jetojë rreth 35% e popullsisë së Shqipërisë), gjithashtu, e rrit riskun klimatik të Shqipërisë. Për më tepër, përqendrimi i konsiderueshëm ekonomik në disa sektorë, p.sh. varësia e lartë nga turizmi bregdetar, transporti rrugor për njerëzit dhe transporti detar për mallrat, si dhe hidroenergjetika për prodhimin e energjisë elektrike, e bën vendin të cenueshëm nga risqet e lidhura me klimën në këta sektorë të rëndësishëm. Cenueshmëria e popullsisë shqiptare ndaj fatkeqësive natyrore përkeqësohet nga varfëria, infrastruktura me cilësi të ulët, ndërtimet e pakontrolluara dhe një sërë faktorësh mjedisorë të ndikuar nga njeriu, që nga shpyllëzimi i shpejtë, menaxhimi i dobët i baseneve ujore, degradimi në rritje i tokës e deri te ndotja mjedisore⁸⁷.

Dimensionet gjinore luajnë gjithashtu rol në cenueshmërinë nga klima në Shqipëri. Rezultatet e anketimit treguan se 39% e të anketuarve pranojnë ekzistencën e dallimeve midis aftësive të burrave dhe grave për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike, ndërsa 53% pohuan se burrat janë më të aftë për të trajtuar sfidat klimatike⁸⁸. Kjo theksohet nga fakti që burrat në shumicën e rasteve marrin vendime për investimet dhe financat brenda familjes, duke kufizuar aftësinë e grave për të zbatuar masa përshtatjeje, veçanërisht në zonat rurale dhe për gratë e angazhuara në bujqësi⁸⁹. Gjithashtu, lëvizshmëria e grave shpesh është më e kufizuar krahasuar me burrat, gjë që kufizon kapacitetin e tyre përshtatës, duke penguar qasjen në tregje, shërbime dhe mundësi ekonomike alternative gjatë problematikave të shkaktuara nga fenomenet klimatike. Të moshuarit, foshnjat, personat me aftësi të kufizuara ose me sëmundje, si edhe grupet e varfra dhe të marginalizuara, janë gjithashtu në mënyrë disproporcionale të rrezikuar nga ndryshimet klimatike. Këto risqe përfshijnë rritjen e cenueshmërisë nga sëmundjet respiratore, ndjeshmëri më të madhe ndaj infeksioneve gjatë proceseve të pastrimit pas fatkeqësive, si dhe ndjeshmëri më të lartë ndaj temperaturave ekstreme.

4.3 VLERËSIMET E RISQEVE KLIMATIKE NË NIVEL SEKTORIAL

Projekti i NAP-it ndërmori Vlerësime të detajuara të Riskut Klimatik (VRK)⁹⁰ për 5 sektorët prioritarë të identifikuar (bujqësinë, turizmin, energjinë, transportin dhe zhvillimin urban)⁹¹. Risqet aktuale në të gjithë sektorët u vlerësuan për Rritjen e temperaturës, Intensitetin e reshjeve dhe Rritjen e nivelit të detit (RRND). Risqet e ardhshme u përqendruan te: Rritja e temperaturës, Ulja e reshjeve, RRND-ja dhe Thatësisirat. Kjo bëri të mundur Vlerësime Risku të kombinuara për sektorët e ndryshëm prioritarë dhe nënsektorët e tyre të identifikuar, siç paraqitet më poshtë.

Bujqësia

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë socio-ekonomikë të ekonomisë shqiptare dhe një nga sektorët që konsiderohet më i cenueshëm nga ndryshimet klimatike. Ndryshimet e temperaturave dhe modeleve të reshjeve mund të ulin rendimentin e kulturave bujqësore, ndërkohë që degradimi i tokës dhe rritja e kërkesës për ujë paraqesin sfida shtesë. Kullotat, pyjet, burimet gjenetike, llojet dhe racat, toka dhe pjelloria e saj, burimet ujore dhe produktiviteti i tyre janë të gjitha nën ndikimin e drejtpërdrejtë të ndryshimeve klimatike. Rritja e temperaturave, ulja e reshjeve, ndryshimi i regjimit të reshjeve, depërtimi i ujit të

⁸⁷ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2023–2030. Ministria e Mjedisit, 2023.

⁸⁸ Komunikimi i Katërt Kombëtar (2022).

⁸⁹ INSTAT, 2023.

⁹⁰ Vlerësimi u mbështet te korniza konceptuale për vlerësimet e riskut klimatik, siç paraqitet në Raportin AR6 të PNNK-së për Ndikimet, Përshtatjen dhe Cenueshmërinë (2022).

⁹¹ Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e bujqësisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2024.

detit/kripëzimi i akuiferëve bregdetarë⁹², ngjarjet ekstreme të motit, si dhe fenomenet e lidhura, si zjarret në pyje, përmbytjet, thatësitë dhe kripëzimi, infektimet dhe sëmundjet e reja që shfaqen si rezultat i kushteve të ndryshuara klimatike, të gjitha ndikojnë në bujqësi⁹³. Risqet aktuale dhe Risqet e ardhshme në bujqësi, siç janë vlerësuar në VRK për Zonat e ndryshme Agro-Ekologjike (ZAE) dhe nënsektorët përkatës, janë vlerësuar si më poshtë⁹⁴:

Tabela 3: Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e bujqësisë.

ZAE DHE NËNSEKTORËT NË BUJQËSI	PËRGJITHËSISHT	
	Risku aktual	Risku i ardhshëm (skenari më i mirë - më i keq ⁹⁵)
ZAE		
Ultësira	Shumë i lartë	Shumë i lartë
Kodrinore e ndërmjetme	I lartë	I lartë – Shumë i lartë
Malet veriore dhe qendrore	I ulët	I ulët - Mesatar
Malësitë jugore	Mesatar	Mesatar - I lartë
NËNSEKTORËT		
Kulturat e përkohshme	I lartë	Shumë i lartë
Kultura të përhershme	Mesatar	Mesatar – Shumë i lartë
Gjdhët dhe kuajt	Mesatar	I lartë – Shumë i lartë
Derrat dhe shpendët	I ulët	I ulët - Mesatar
Delet dhe dhitë	I ulët	I ulët - Mesatar

Ndërsa shqetësimet për risqet aktuale në bujqësi mund të jenë të ndërthurura, risqet e ardhshme janë vazhdueshëm shumë shqetësuese dhe madje alarmuese në skenarin e ardhshëm më të keq. Ultësira është ZAE-ja me risk shumë të lartë si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen, ndërsa zona kodrinore e ndërmjetme është ZAE-ja e dytë më e ekspozuar ndaj riskut. Malet veriore dhe qendrore janë ZAE-ja më pak e ekspozuar ndaj riskut; kjo zonë mund të përfitojë nga një sezon më i gjatë rritjeje si për kulturat verore, ashtu edhe për ato dimërore, çka potencialisht mund të kompensojë rritjen e stresit nga uji dhe nxehtësia, që pritet gjatë muajve të verës. Megjithatë, në periudhë shumë afatgjatë, ky përfitim mund të vihet sërish në rrezik nga rritja e vazhdueshme e stresit nga uji dhe nxehtësia. Sipas nënsektorëve, kulturat bujqësore janë më të ekspozuara ndaj riskut, si aktualisht, po ashtu edhe në të ardhmen e parashikuar, në varësi të llojit të kulturës, skenarit SPS dhe harkut kohor, ku risqet në skenarin më të keq bëhen shumë të larta. Kulturat e përkohshme janë në përgjithësi me risk më të lartë, veçanërisht në planin afatshkurtër. Në nënsektorët e blegtorisë, risqet variojnë nga të ulëta deri në shumë të larta, me bagëtinë e trashë dhe kuajt që janë më të ekspozuar ndaj riskut, me risk shumë të lartë në skenarin më të keq klimatik. Derrat, shpendët, delet dhe dhitë kanë vlerësime më të ulëta risqesh, duke qenë mesatare në skenarin më të keq.

Turizmi

Turizmi është një sektor kyç ekonomik dhe mjaft i cënueshëm nga ndryshimet klimatike. Shtimi i përmbytjeve lumore për shkak të reshjeve të dendura dhe të gjata⁹⁶, ekstremet e temperaturës (veçanërisht nxehtësia), rritja e nivelit të detit (RRND) dhe erërat e forta tashmë

⁹² Të pranishëm në 5/12 bashkitë bregdetare: Shkodër, Lezhë, Fier, Vlorë, Himarë, siç përcaktohet në Komunikimin e Katërt Kombëtar të Shqipërisë drejtuar UNFCCC-së (2022).

⁹³ Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike, 2022.

⁹⁴ Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e bujqësisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2024.

⁹⁵ Skenari më i mirë: Parashikimet e SPS1-1.9 deri në vitin 2030; Skenari më i keq: SPS5-8.5 deri në vitin 2050.

⁹⁶ Në 6 nga 12 bashkitë bregdetare (Lezhë, Kurbin, Durrës, Rrogzhinë, Fier, Vlorë)

kanë ndikuar në sektorin e turizmit në Shqipëri. Turizmi bregdetar, atraksioni kryesor turistik në vend, është veçanërisht i ndjeshëm ndaj përmbytjeve dhe erozionit të plazheve, ndërsa ndryshimet në modelet e temperaturës dhe reshjeve mund të ndikojnë gjithashtu në turizmin malor dhe atë rural. Faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në tërheqjen ndaj ofertës turistike të Shqipërisë si pasojë e ndryshimeve klimatike janë: dëmtimi i trashëgimisë kulturore; shkatërrimi i biodiversitetit dhe i peizazheve natyrore, si detare po ashtu edhe bregdetare⁹⁷. Në një aspekt potencialisht të favorshëm, me periudha të ngrohta më të gjata, turizmi bregdetar, që mbizotëron në zonën bregdetare, mund të zgjatet përtej muajve me kërkesë më të lartë të korrikut dhe gushtit, duke e shpërndarë më mirë sezonin dhe përfitimet ekonomike⁹⁸.

Risqet aktuale dhe risqet e ardhshme në turizëm, siç janë vlerësuar në VRK për nënsektorët e ndryshëm të turizmit bregdetar, ekoturizmit, turizmit qytetar dhe artistik, si dhe turizmit të trashëgimisë kulturore, janë vlerësuar si më poshtë⁹⁹:

Tabela 4: Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e turizmit.

NËNSEKTORËT E TURIZMIT	PËRGJITHËSISHT	
	Risku aktual	Risku i ardhshëm (skenari më i mirë - më i keq)
Bregdetar	I ulët	I lartë – Shumë i lartë
Ekoturizmi	Mesatar	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Qytetar dhe artistik	I ulët	Mesatar – I lartë
Trashëgimia kulturore	Mesatar	Mesatar – Shumë i lartë

Vlerësimet e riskut për turizmin rriten me kalimin e kohës, nga risku aktual drejt riskut të ardhshëm, madje deri në nivel alarmant në skenarin më të keq. Sipas nënsektorëve, ekoturizmi është më i ekspozuari ndaj riskut, ndërsa në skenarët më të mirë, turizmi i qytetar dhe artistik dhe trashëgimia kulturore janë segmentet më pak të ekspozuara ndaj riskut. Megjithatë, “më pak të ekspozuara ndaj riskut” nuk do të thotë “pa risk”, pasi, për shembull, rritja e parashikuar e nivelit të detit mund të dëmtojë ndjeshëm qytetet bregdetare (turizmi urban) dhe vendndodhjet e trashëgimisë kulturore bregdetare (turizmi kulturor), megjithëse në një shkallë më të vogël sesa vendndodhjet në brendësi të territorit. Disa dallime në vlerësimet e riskut mund të shpjegohen gjithashtu nga mënyra se si nënsektorët kanë përfituar tashmë nga zhvillimi i vazhdueshëm në Shqipëri dhe pritet të përfitojnë më tej, duke rritur aftësinë e tyre ripërtëritëse nëpërmjet zhvillimit të ardhshëm.

Energjia

Ndryshimet në reshje, disponueshmërinë e ujit dhe avullimin do të ndikojnë në disponueshmërinë e hidroenergjisë, e cila prodhon 96% të energjisë elektrike të vendit. Variabiliteti i shkaktuar nga ndryshimet klimatike në prurjet e lumenjve mund të ulë prodhimin hidroenergjetik, duke rrezikuar sigurinë energjetike. Rritja e temperaturave gjithashtu shton kërkesën për energji për ftohje, duke ushtruar presion ndaj sistemit energjetik. Infrastruktura hidroenergjetike mund të dëmtohet gjatë ngjarjeve të reshjeve të dendura, përfshirë rrjetin e shpërndarjes, gjë që mund të përkeqësojë më tej humbjet e energjisë elektrike.

Risqet aktuale dhe risqet e ardhshme në sektorin e energjisë, siç janë vlerësuar në VRK për nënsektorët e ndryshëm të trajtuar (naftë, gaz dhe qymyr; hidroenergji; dru zjarri; erë dhe diell; transmetim dhe shpërndarje), janë vlerësuar si më poshtë¹⁰⁰:

⁹⁷ KKP, 2021

⁹⁸ Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike, 2022.

⁹⁹ Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e turizmit: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

¹⁰⁰ Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e energjisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe

Tabela 5: Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e energjisë.

NËNSEKTORËT E ENERGJISË	PËRGJITHËSISHT	
	Risku aktual	Risku i ardhshëm (skenari më i mirë – më i keq)
Nafta, gazi dhe qymyri	Shumë i ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Hidroenergjëtika	I ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Dru zjarri	I ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Energjia e erës dhe energjia diellore	Shumë i ulët	I ulët – Mesatar
Transmetimi dhe shpërndarja	Mesatar	Mesatar – Shumë i lartë

Vlerësimet e riskut në energji rriten nga risku aktual drejt riskut të ardhshëm, deri në nivel të konsiderueshëm kur merret parasysh skenari më i keq. Ndërsa shqetësimet për risqet aktuale mund të jenë nga të ulëta në të moderuara, risqet e ardhshme janë alarmante, veçanërisht në skenarin më të keq, i cili lidhet ngushtë me uljen e disponueshmërisë së ujit. Nënsektorët e transmetimit dhe shpërndarjes, drurëve të zjarrit dhe hidroenergjisë janë më të ekspozuar ndaj riskut. Nënsektori i energjisë së erës dhe diellit është më pak në risk, megjithatë, deri më tani, këta nënsektorë përfaqësojnë vetëm një pjesë shumë të vogël të prodhimit të energjisë (1% në vitin 2023).

Transporti

Transporti rrugor dhe hekurudhor janë të prirur ndaj fatkeqësive të lidhura me klimën (p.sh. reshje të rrëmbyeshme, stuhi dhe erëra ekstreme, rritje e nivelit të detit, përmbytje, rrëshqitje dherash, valë të nxehti dhe degradim i lidhur me nxehtësinë), të cilat ndikojnë në shumë mënyra mbi infrastrukturën, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e tyre¹⁰¹. Risqet aktuale dhe Risqet e ardhshme në sektorin e transportit, siç janë vlerësuar në VRK për nënsektorët e ndryshëm të trajtuar (rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror), janë përcaktuar, si më poshtë:

Tabela 6: Risqet klimatike aktuale dhe të ardhshme në sektorin e transportit.

NËNSEKTORËT E TRANSPORTIT	PËRGJITHËSISHT	
	Risku aktual	Risku i ardhshëm (skenari më i mirë – më i keq)
Transporti rrugor	I ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Transporti hekurudhor	I ulët	I ulët – Shumë i lartë
Transporti detar	Shumë i ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Transport ajror	Shumë i ulët	I ulët – Mesatar

Vlerësimet e riskut për transportin rriten nga risku aktual drejt riskut të ardhshëm dhe në mënyrë të ndjeshme kur merret parasysh skenari më i keq i riskut, ku disa risqe arrijnë edhe në nivele alarmante. Një faktor i rëndësishëm që çoi në vlerësime shumë të larta të riskut në skenarin më të keq është rritja e parashikuar e reshjeve intensive dhe dëmet që ato mund të shkaktojnë në nënsektorët e transportit (veçanërisht në atë rrugor dhe hekurudhor) nëpërmjet erozionit, përmbytjeve dhe rrëshqitjeve të dherave. Përveç reshjeve intensive, temperatura mesatare vjetore dhe nxehtësia ekstreme pritet të ndikojnë kryesisht te nënsektorët e transportit hekurudhor dhe detar, ndërsa rritja e parashikuar e nivelit të detit ndikon kryesisht te nënsektori i transportit detar. Sipas nënsektoreve, transporti rrugor, hekurudhor dhe detar janë më të ekspozuar ndaj riskut, ndërsa transporti ajror është më pak në risk. Megjithatë, nënsektori i transportit hekurudhor përfaqëson vetëm një pjesë shumë të vogël të transportit të përgjithshëm.

Zhvillimi urban

Ngjarjet ekstreme të motit, duke përfshirë valët e të nxehtit, thatësi të zgjatur, reshjet e dendura dhe përmbytjet, paraqesin sfida të konsiderueshme ndaj infrastrukturës urbane,

analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2024.

¹⁰¹ Raporti fillestar për procesin e PKP-së në SHQIPËRI. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, dhjetor 2022.

furnizimit me ujë dhe sistemeve të menaxhimit të mbetjeve. Ndikimet e ndryshimeve klimatike te zonat urbane janë disproporcionalisht më të larta për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe aseteve, veçanërisht në zonat me risk të lartë, që ndërthuren me kushtet që theksojnë rreziqet (p.sh., rritja e vërshimeve si pasojë e mbulimit të tokës, rritja e nivelit të detit dhe depërtimi i detit, efektet e ishujve urbanë të nxehtësisë, etj.)¹⁰². Shpesh, për shkak të reshjeve të dendura dhe përmytjeve në Tiranë, transporti, energjia elektrike, infrastruktura e ujësjellësit dhe industria e vogël kanë qenë shumë të cenueshme¹⁰³. Kjo mund të sjellë vështirësi ekonomike, si dhe shtimin e sëmundjeve dhe sfidave për shëndetin publik¹⁰⁴ në një përqindje në rritje të popullsisë urbane në Shqipëri (parashikohet të jetë 78.2% në vitin 2050).

Sipas vlerësimit në VRK-në për zonat e ndryshme klimatike dhe nënsektorët e shqyrtuar (rezidencial, social, prodhues, rrjeti i furnizimit), risqet aktuale dhe risqet e ardhshme në sektorin e zhvillimit urban¹⁰⁵ u vlerësuan si më poshtë:

Tabela 7: Risqet aktuale dhe të ardhshme klimatike në sektorin e zhvillimit urban.

ZONAT KLIMATIKE URBANE DHE NËNSEKTORËT	PËRMBLEDHJE	
	Risku aktual	Risku i ardhshëm (skenari më i mirë - më i keq i mundshëm)
ZONAT KLIMATIKE¹⁰⁶		
ZMF	I ulët	Shumë i lartë – Shumë i lartë
ZMK	I ulët	Shumë i lartë – Shumë i lartë
ZMP	I ulët	I lartë – Shumë i lartë
ZMM	I ulët	I lartë – Shumë i lartë
NËNSEKTORËT		
Rezidencial	I lartë	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Social	I lartë	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Prodhues	I ulët	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Rrjeti i furnizimit	I ulët	Shumë i lartë – Shumë i lartë

Në të katërta zonat klimatike urbane risku aktual rritet në të ardhmen, kryesisht si “Shumë i lartë”, si për skenarin më të mirë të mundshëm, ashtu edhe për skenarin më të keq të mundshëm. Në veçanti, risku i ardhshëm në qytetet me popullsinë më të lartë (Tirana, Durrësi, Vlora, Fieri, Shkodra, Elbasani) dhe zona më e urbanizuar në vend (brezi bregdetar) vlerësohet si “Shumë i lartë”. Risku i ardhshëm për qytetet e tjera është “I lartë” për skenarin më të mirë të mundshëm dhe “Shumë i lartë” për skenarin më të keq të mundshëm. Në të gjithë nënsektorët urbanë (rezidencial, social, prodhues dhe furnizues) vihet re një rritje në “Risqe shumë të larta” në të ardhmen.

Ndërsektorial

Në këtë vlerësim ndër-sektorial vlerësohen risqet kombëtare, ndërsektoriale në vend dhe përdoren tabelat përmbledhëse të klasifikimit të riskut në raportet sektoriale¹⁰⁷.

¹⁰² *First Mediterranean Assessment Report (MAR1)* [Raporti i Parë i Vlerësimit për Mesdheun].

¹⁰³ *City of Tirana, Adapting Our City to a Changing Climate: Vulnerability Assessment and Adaptation Action Plan for Tirana* [Qyteti i Tiranës, Përshtatja e qytetit tonë ndaj ndryshimeve klimaterike: vlerësimi i cenueshmërisë dhe plani i veprimit për përshtatje për Tiranën, 2015].

¹⁰⁴ *First Mediterranean Assessment Report (MAR1)* [Raporti i Parë i Vlerësimit për Mesdheun].

¹⁰⁵ *Climate risk assessment of urban development; support to filling gaps in climate change adaptation data and risk analysis* [Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e zhvillimit urban; mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike]. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

¹⁰⁶ ZMF: Zona e Mesdhetare Fushore; ZMK: Zona Mesdhetare Kodrinore; ZMP: Zona Mesdhetare Paramalore; ZMM: Zona Mesdhetare Malore

¹⁰⁷ *Cross-Sectoral Risk Assessment* [Vlerësimi i riskut ndërsektorial]. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

Tabela 8: Risqet aktuale dhe të ardhshme klimatike ndërsektoriale.

NËNSEKTORI	Risku aktual	Risku i ardhshëm (skenari më i mirë – më i keq i mundshëm)
BUJQËSIA		
Kulturat e përkohshme	I lartë	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Kulturat e përhershme	Mesatar	Mesatar – Shumë i lartë
Gjedhët dhe kuajt	Mesatar	I lartë – Shumë i lartë
Derrat dhe shpendët	I ulët	I ulët – Mesatar
Delet dhe dhinë	I ulët	I ulët – Mesatar
TURIZMI		
Turizmi bregdetar	I ulët	I lartë – Shumë i lartë
Ekoturizmi	Mesatar	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Qytetar dhe artistik	I ulët	Mesatar – I lartë
Trashëgimia kulturore	Mesatar	Mesatar – Shumë i lartë
ENERGJIA		
Nafta, gazi dhe qymyri	Shumë i ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Hidroenergjetika	I ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Dru zjarri	I ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Energjia e erës dhe energjia diellore	Shumë i ulët	I ulët – Mesatar
Transmetimi dhe shpërndarja	Mesatar	Mesatar – Shumë i lartë
TRANSPORTI		
Transporti rrugor	I ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Transporti hekurudhor	I ulët	I ulët – Shumë i lartë
Transporti detar	Shumë i ulët	Mesatar – Shumë i lartë
Transporti ajror	Shumë i ulët	I ulët – Mesatar
URBAN		
Rezidencial	I lartë	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Social	I lartë	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Prodhues	I ulët	Shumë i lartë – Shumë i lartë
Rrjeti i furnizimit	I ulët	Shumë i lartë – Shumë i lartë

Për ta përmbledhur, vlerësimet tregojnë se risqet kombëtare klimatike në Shqipëri vijnë duke u rritur me kalimin e kohës, si edhe pesimizmin e skenarit. **Sektorët e zhvillimit urban, bujqësisë dhe turizmit kanë nivelin më të lartë të riskut**, ndërsa sektorët e energjisë dhe transportit kanë nivele më të ulëta (vlen për risqet aktuale dhe ato të ardhshme). Arsyeja kryesore për këtë është ndjeshmëria e bujqësisë dhe turizmit ndaj ndryshimeve të variablave klimatike, ndërsa për sektorin e zhvillimit urban arsyeja kryesore është ndjeshmëria ndaj rritjes së temperaturave dhe valëve të të nxehtit duke marrë parasysh efektet e ishujve urbanë të nxehtësisë, si edhe përqendrimi i konsiderueshëm i sektorit të zhvillimit urban në bregdet. Sa u përket risqeve të ardhshme: nënsektorët e kulturave të përkohshme, ekoturizmit dhe zhvillimit urban janë më të rrezikuarit. Nënsektorët më pak të rrezikuar janë derrat dhe shpendët, delet dhe dhinë, energjia e erës dhe energjia diellore dhe transporti ajror.

Ky vlerësim duhet të kombinohet me një vlerësim të rëndësisë relative të sektorëve në Shqipëri. **Risqet klimatike në zhvillimin urban** janë kyç duke qenë se, pas një procesi të fuqishëm urbanizmi, pothuajse dy të tretat (62%) e popullsisë së vendit jetonte në zona urbane në vitin 2020, dhe parashikohet që ky numër të rritet. Gjithashtu, qytetet janë qendra ekonomike, të cilat përqendrohen veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike të vendit,

përfshirë shërbimet dhe industrinë. Edhe risqet klimatike në **sektorin e turizmit**, veçanërisht ato të nënsektorit të turizmit bregdetar, janë me rëndësi ekonomike për Shqipërinë. Risku i lartë për **bujqësinë** përbën shqetësim sa i përket punësimit dhe sigurisë ushqimore, veçanërisht në zonat e mëdha rurale të vendit.

Risqet që lidhen me rreziqe të ndryshme klimatike ndërveprojnë dhe ndërthurja e tyre, ose ndryshe **risqet e përbëra ose të ndërlikuara**, mund të jenë më të rënda sesa risqet e izoluar. Gjithashtu, sektorët dhe nënsektorët janë të ndërlidhur; risqet në një sektor nënkuptojnë risqe për sektorë të tjerë, p.sh., zhvillimi urban dhe transporti.

Shqipëria ekspozohet edhe ndaj **risqeve ndërkufitare klimatike**, pra, risqeve që lidhen me ndikimin e ndryshimeve klimatike në rrjetet dhe burimet e përbashkëta me vendet e tjera, veçanërisht turizmi, transporti dhe energjia. Nëse marrim parasysh risqet e përbëra dhe ndërkufitare, risqet klimatike në Shqipëri mund të vlerësohen vetëm si të larta ose shumë të larta.

Sektori i shëndetësisë është veçanërisht i ndjeshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Rritja e temperaturave mesatare dhe intensifikimi i valëve të të nxehtit kontribuojnë në rritjen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, veçanërisht te grupet vulnerabël, përfshirë të moshuarit, fëmijët dhe personat me sëmundje kronike. Ndryshimet në regjimin e reshjeve, përmytjet dhe ngjarjet e tjera ekstreme klimatike rrisin rrezikun e sëmundjeve të transmetuara nga uji dhe vektorët, si dhe ndikojnë në aksesin dhe funksionimin e infrastrukturës dhe shërbimeve shëndetësore. Sistemi shëndetësor përballët gjithashtu me rreziqe operationale gjatë përmytjeve, thatësirave dhe ndërprerjeve të energjisë dhe furnizimit me ujë, duke e bërë të domosdoshme përfshirjen e masave të përshtatjes për forcimin e qëndrueshmërisë së tij

Disa faktorë rrisin risqet e përgjithshme klimatike në Shqipëri. Sipërfaqja e vogël e vendit, përqendrimi i popullsisë në zonat bregdetare dhe aglomeratet kryesore, mbështetja e madhe në turizmin bregdetar, transportin rrugor dhe energjinë hidroelektrike e bëjnë vendin veçanërisht cenueshëm. Disa grupe të popullsisë janë më të rrezikuara për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore, nevojës për kujdes, vendndodhjes, situatës ekonomike, gjinisë, ose një ndërthurjeje të këtyre faktorëve. Njerëzit që jetojnë në lagje të marginalizuara, kryesisht në zona me rrezik përmytjeje përgjatë brigjeve të lumenjve, janë veçanërisht të rrezikuar, si prej valëve të të nxehtit, ashtu edhe prej reshjeve të dendura të shiut. Në krahasim me burrat, gratë janë më të cenueshme ndaj rreziqeve klimatike. Risqet klimatike mund të sjellin situata kritike në këto komunitete të cenueshme nëse nuk ka sisteme të mbrojtjes sociale që integrojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe rrjetet e sigurisë. Menaxhimi mjedisor i papërshtatshëm, ku përfshihet shpyllëzimi, keqmenaxhimi i pellgjeve ujëmbledhëse dhe menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve, rrit edhe risqet klimatike në të gjithë sektorët. Mangësitë në legjislacionin për klimën, kapacitetet njerëzore, të dhënat dhe pajisjet mund t'i përkeqësojnë më tej risqet klimatike në vend dhe të pengojnë përpjekjet për përshtatjen dhe menaxhimin e fatkeqësive.

Ndërsa disa faktorë të tjerë mund t'i ulin risqet klimatike në Shqipëri. Diversiteti i konsiderueshëm i ekosistemeve në vend dhe natyra kodrinore e bregdetit Jon kontribuojnë në aftësitë ripërtëritëse të vendit. Gjithashtu, rritja e parashikuar e PBB-së dhe e PBB-së për frymë do të rrisë kapacitetet e vendit për përshtatje. Zbatimi i rregulloreve, strategjive dhe planeve evropiane kontribuon në integrim më të mirë të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, rrit kapacitetet e vendit për përshtatje dhe ul risqet klimatike¹⁰⁸.

4.4 CENUESHMËRITË KLIMATIKE DHE RISQET NË NIVEL VENDOR

Pjesa më e madhe e vijës bregdetare të Shqipërisë shtrihet përgjatë Detit Adriatik dhe karakterizohet nga një **zonë** e sheshtë dhe e ulët **bregdetare**, që përfaqëson 11,78% të

¹⁰⁸ *Cross-Sectoral Risk Assessment* [Vlerësimi i riskut ndërsektorial]. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

sipërfaqes së përgjithshme të Shqipërisë dhe është e banuar nga 1/3 e popullsisë së përgjithshme të vendit. Si pasojë, sistemet bregdetare, përfshirë zonat e banuara, janë veçanërisht të ndryshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe të cënueshme ndaj rritjes së nivelit të detit dhe ndryshimeve në intensitetin dhe frekuencën e përmbytjeve.

Projekti i NAP-it ndërmori hartimin e “**Planeve Vendore të Përshtatjes**” (PVP) në 8 bashki¹⁰⁹ për periudhën 2022–2024. PVP-të u hartuan sipas udhëzimeve të stafit teknik bashkiak përmes mbledhjes së të dhënave, ngritjes së kapaciteteve, identifikimit të masave prioritare të përshtatjes dhe përgatitjes së planit të përshtatjes për të trajtuar ndikimet negative të ngjarjeve ekstreme të motit dhe për të siguruar investime afatgjata. Risqet dhe cënueshmëritë kyç sipas bashkive janë si më poshtë¹¹⁰:

- **Durrës:** Vera më e nxehtë dhe më e thatë, dimri më i lagësht dhe moti ekstrem kërcënojnë biodiversitetin, gjendjen e dherave dhe peizazhet, duke sjellë degradim të mundshëm të ruajtjes së karbonit në dhera;

- **Elbasan:** Temperaturat e larta, stuhitë e dendura të shiut dhe risqet për biodiversitetin dhe burimet ujore kërcënojnë turizmin, bujqësinë dhe pasuritë natyrore, duke sjellë shqetësime të konsiderueshme si erozioni, rrëshqitja e dheut dhe mungesa e ujit;

- **Fier:** Bashkia është e cënueshme nga temperaturat në rritje dhe stuhive të shpeshta e të dendura dhe përmbytjet, të cilat parashikohet të përkeqësohen me kalimin e kohës, paraqesin rrezikun më të madh në të gjithë sektorët;

- **Gjirokastrë:** Vera më e nxehtë, dimri më i lagësht dhe moti ekstrem kërcënojnë veprimtaritë e bashkisë, burimet natyrore dhe pasuritë me rëndësi për turizmin dhe industrinë vendase;

- **Krujë:** Janë identifikuar pak mundësi dhe cënueshmëritë lidhen me rritjen e temperaturave, stuhitë e dendura të shiut dhe kërcënimet për biodiversitetin dhe gjendjen e dherave;

- **Kukës:** Kryesisht ka risqe nga përmbytjet dhe reshjet e dendura të shiut dhe rritja e temperaturave sjell verë më të thatë dhe dimër më të lagësht, duke ndikuar në të gjithë sektorët.

- **Përmet:** Problematikat e ngutshme përfshijnë përmbytjet, valët e të nxehtit dhe pakësimin e reshjeve të dëborës, të cilat ndikojnë në infrastrukturë, në botën e egër dhe në shëndetin publik, duke sjellë përkeqësimin e risqeve për shkak të reshjeve të dendura të shiut;

- **Vlorë:** Vend i cënueshëm ndaj temperaturave në rritje, stuhive të dendura të shiut dhe përmbytjeve, që kërcënojnë të gjithë sektorët dhe ku nevojitet, ndër të tjera, infrastrukturë e përmirësuar dhe ajër i kondicionuar.

Në një vlerësim të bazuar në GIS i risqeve klimatike, ekspozimit dhe cënueshmërisë socio-ekonomike në Shqipëri u përdorën të dhëna nga skenarët e përmbytjeve për të riprodhuar hartat e riskut duke kombinuar probabilitetin e përmbytjeve me intensitetin e ndikimit. Nga rezultatet e vlerësimit u zbulua se 60 nga 61 bashki preken nga përmbytjet e lumenjve, që ndodhin 1 herë në 100 vjet, ndërsa 17 bashki janë të ekspozuara ndaj skenarëve të rritjes së nivelit të detit me 33 cm, 90 cm dhe 100 cm.

5. MASAT E PËRSHTATJES, VLERËSIMET DHE VEPRIMET PRIORITARE NË SHQIPËRI

5.1 Masat e përshtatjes në nivel sektorial

Në kuadër të procesit të NAP-it u identifikua një grup prej 151 “Masash përshtatjeje” për pesë sektorët prioritarë, duke përfshirë masat ndërsektoriale¹¹¹. Ato bazohen në masa ose

¹⁰⁹ Në zonat e: Durrësit, Elbasanit, Fierit, Gjirokastrës, Krujës, Kukësit, Përmetit, Vlorës.

¹¹⁰ Kriteret ndërsektoriale të identifikuar të bazuara në evidenca për kuadrin e priorizimit; procesi i priorizimit është vënë në zbatim për alternativat e përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

¹¹¹ *Identification of adaptation measures*. Albania national adaptation planning: support to filling gaps in climate

veprime për përshtatje të identifikuar në kuadrin përkatës të politikave të Shqipërisë¹¹², ose në nivel ndërkombëtar, dhe u diskutuan dhe u analizuan më tej me ekspertë të sektorit.

Masat e identifikuar të përshtatjes në **sektorin e bujqësisë** ndahen në nëntë nënseksione: i. Të përgjithshme (4 masa specifike përshtatjeje); ii. Menaxhimi i kullotave (5); iii. Menaxhimi i zjarreve (2); iv. Ruajtja e burimeve, specieve dhe racave gjenetike vendase të kulturave dhe bagëtive (6); v. Promovimi i specieve/varieteteve rezistente/tolerante ndaj të nxehtit, thatësirës dhe kripërave (2); vi. Menaxhimi i specieve invazive për bujqësi (2); vii. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmbytjet, si nga lumenjtë, ashtu edhe nga rritja e nivelit të detit (4); viii. Menaxhimi i praktikave më të mira dhe bujqësisë inteligjente në lidhje me klimën (7); dhe ix. Vlerësimi i ujit të përdorur në sektorin e bujqësisë dhe masat për eficiencën e ujit (9). Kështu, identifikohen 41 masa gjithsej në bujqësi.

Për **pylltarinë**, identifikohen gjithsej 30 masa përshtatjeje në nënseksionet e mëposhtme: i. Të përgjithshme (6 masa); ii. Menaxhimi i pyjeve (5); iii. Monitorimi i gjendjes së pyjeve (5); iv. Ripyllëzimi, pyllëzimi dhe masat teknologjike (14).

Për **sektorin e turizmit**, janë identifikuar 24 masa gjithsej, të cilat ndahen në nënseksionet e mëposhtme: i. Të përgjithshme (6 masa); ii. Mbrojtja e ndërtesave dhe infrastrukturave ekzistuese nga ndryshimet klimatike (4); iii. Rivendosja e një brezi të gjelbër përgjatë bregdetit për të mbrojtur tokën nga erozioni dhe për qëllime restaurimi (5); iv. Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga turizmi (5); dhe v. Masat që përfshijnë zonat malore (4).

Në **sektorin e energjisë**, 22 masat e identifikuar janë: i. Të përgjithshme (4 masa specifike); ii. Mobilizimi i burimeve për të zbatuar planin për eficiencën e energjisë (8); iii. Kompostimi duke përfshirë rikuperimin e energjisë nga mbetjet bujqësore - biomasa (3); iv. Vlerësimi i prodhimit dhe konsumit të energjisë (6); dhe v. Të tjera (1).

Për **sektorin e transportit**, 10 masat e identifikuar ndahen në: i. Të përgjithshme (4 masa specifike); ii. Diversifikimi i sektorit të transportit (5); dhe iii. Të tjera (1).

Për **sektorin e zhvillimit urban**, 13 masat e identifikuar ndahen në: i. Të përgjithshme (4); ii. Mbrojtja e ndërtesave dhe infrastrukturës ekzistuese nga ndryshimet klimatike (4); dhe iii. Promovimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë në mjediset urbane (5).

Janë identifikuar tri **fusha** të përgjithshme **ndërsektoriale** kyç për masat e përshtatjes: i. koordinimi i përmirësuar për ndryshimet klimatike (me 10 masa specifike përshtatjeje); ii. përmirësimi i sistemeve të të dhënave dhe informacionit (integruar në masat sektoriale); dhe iii. zgjidhje të bazuara në ekosistem dhe zgjidhje të bazuara në natyrë (të integruara në masat sektoriale).

Plani identifikon gjithashtu aktivitete për forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave strategjike të Planit Kombëtar të Përshtatjes dhe mbështesin vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore për popullsinë, sidomos gjatë ngjarjeve ekstreme klimatike

5.2 Masat e përshtatjes në nivel vendor

Në zbatim të Ligjit “Për ndryshimet klimatike”, masat e mëposhtme u identifikuan masat e mëposhtme të përshtatjes gjatë hartimit të planeve vendore të përshtatjes në 8 bashki¹¹³, të cilat

change adaptation data and risk analysis. [Identifikimi i masave të përshtatjes. Plani Kombëtar i Përshtatjes i Shqipërisë: mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.] Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

¹¹² P.sh.: KKP; SKNK 2020–2030; Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm; Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin; Plani i Veprimit për Përshtatje për Tiranën; Projektplanin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën; Strategjia për Transportin dhe Plani i Veprimit (2016–2020) etj.

¹¹³ Planet Vendore të Përshtatjes për 8 bashki. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025. Në to përshkruhen rrethanat vendore dhe risqet klimatike, si dhe identifikohen masat e

renditen më poshtë, siç përshkruhen për secilën bashki¹¹⁴ dhe sipas llojit të veprimeve të përshtatjes:

Tabela 9: Masat e përshtatjes të identifikuar në 8 bashki.

BASHKIA/ LLOJI I MASAVE TË PËRSHTATJES	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Krujë	Kukës	Përmet	Vlorë	GJITHSEJ
Politika dhe qeverisja	32	26	15	17	15	15	18	21	159
Kapaciteti shkencor, teknik dhe shoqëror	21	17	11	10	10	16	10	12	107
Zbatimi i masave për ndryshimet klimatike	31	14	12	12	8	18	14	13	122
Përshtatja e mjedisit natyror mbështetës	31	10	7	10	7	16	16	16	113
Forcimi i menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë	17	11	10	11	10	3	12	11	85
Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi	14	15	4	13	13	13	13	12	97
MASAT E PËRSHTATJES GJITHSEJ	146	93	59	73	63	81	83	85	683
MASAT PRIORITARE TË PËRSHTATJES GJITHSEJ ¹¹⁵	43	45	47	45	44	41	40	51	356

Mesatarisht, u identifikuan rreth 85 masa përshtatjeje dhe 45 “masa prioritare” për çdo bashki.

- Masat e përbashkëta të përshtatjes të përmendura për të gjitha bashkitë ishin:
 - Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional;
 - Rritja e financimit për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
 - Ngritja e një grupi drejtues me përfaqësues të përshtatshëm të stafit nga të gjitha departamentet kryesore për të siguruar zbatimin e suksesshëm të veprimeve të planit vendor të veprimit;
 - Rritja e kapaciteteve shkencore, teknike dhe sociale që synojnë gjenerimin e evidencave shkencore për të mbështetur vendimmarrjen, identifikimin e zonave me risk të lartë dhe rritjen e ndërgjegjësimit;
 - Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjëse dhe zhvillimi i kapaciteteve sipas nevojës për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë rolin e mjedisit natyror.
- Krahas këtyre, në bashki të ndryshme u përmendën edhe sa vijon:
- Përditësimi ose kryerja e vlerësimeve të reja të cenueshmërisë dhe riskut;
 - Mbrojtja e infrastrukturës së banesave, aseteve bashkiake dhe pronave nga dëmtimet dhe degradimi i mëtejshëm për shkak të faktorëve klimatikë;
 - Krijimi i zgjidhjeve bioinxhinierike ose zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të mbrojtur mjediset nga erozioni;
 - Kryerja e punimeve në infrastrukturë për të luftuar erozionin dhe për të mbrojtur mjediset e cenueshme;
 - Forcimi i menaxhimit vendor të riskut nga fatkeqësitë;
 - Rishikimi ose hartimi i planeve specifike, p.sh., plani i menaxhimit të pyjeve në Kukës, plani i menaxhimit të ujërave sipërfaqësore në Përmet etj.

5.3 Vlerësimi i përshtatjes dhe veprimet prioritare të përshtatjes në Shqipëri

U ndërmor prioritizimi i mëtejshëm i masave të përshtatjes të identifikuar fillimisht¹¹⁶. U zbatua një proces prioritizimi përmes Analizës me Shumë Kriteria (MCA), që përfshinte kritere për fizibilitetin (financiar, teknik, institucional), përfitimet sociale (pranueshmëria sociale, barazia gjinore dhe përfitimet për grupet e cenueshme) dhe përputhshmëria strategjike (përputhja me strategjitë kombëtare, potenciali i uljes së cenueshmërisë, qëndrueshmëria

përshtatjes, të cilat më pas u vlerësuan dhe u prioritizuan.

¹¹⁴ Durrës, Elbasan, Kukës, Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Krujë, Përmet.

¹¹⁵ Siç tregohet në Planet Vendore të Përshtatjes të bashkive, të hartuara në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në, 2024.


¹¹⁶ Kriteret ndërsektoriale të identifikuar të bazuara në evidenca për kuadrin e prioritizimit; procesi i prioritizimit është vënë në zbatim për alternativat e përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

mjedisore dhe përfitimet e ndërsjella nga zbutja). Më pas u identifikuan gjithsej 66 masa prioritare në sektorë të ndryshëm (bujqësia dhe pylltaria: 21; turizmi: 11; energjia: 8; transporti: 7; zhvillimi urban: 9; ndërsektoriale: 10).

Nga këto 66 masa, 21 që u konsideruan masa investimi “të gjelbra”¹¹⁷ dhe “gri”¹¹⁸, iu nënshtruan Analizës së Kosto-Përfitimit (AKP)¹¹⁹ për periudhën 2026–2036, përmes së cilës u vlerësua efikasiteti ekonomik i secilës masë përmes llogaritjes së Raporteve të Kosto-Përfitimit (RKP¹²⁰) dhe Vlerës Aktuale Neto (VAN¹²¹). Këtu nuk u përfshinë masat “e buta”¹²² të zhvillimit të kapaciteteve për të cilat është e vështirë të kryhet një AKP (sidomos lidhur me përfitimet). Procesi i AKP-së përfshiu sa më poshtë:

- Konsultimet me palët e interesit për të mbledhur informacion të detajuar rreth kostos dhe synimit gjeografik;
- Analizën e GIS-it dhe referencat e strategjive kombëtare për të vlerësuar fushëveprimin dhe shkallën e ndërhyrjeve kur të dhënat ishin të paplota;
- Transferimet e përfitimeve dhe kostove nga ndërhyrje të ngjashme kombëtare ose rajonale, në mungesë të të dhënave parësore;
- Analizën e ndjeshmërisë duke përdorur norma të ndryshme zbritjeje për të marrë parasysh pasigurinë.

Në përgjithësi, analiza tregoi se portofoli i masave të propozuara tenton të gjenerojë kthime pozitive ekonomike, ku shumica e ndërhyrjeve tregojnë VAN-e pozitive dhe raporte të forta kosto-përfitim. Disa masa i përkasin kategorisë “**me ndikim të lartë dhe pasoja minimale**”. Këto masa ofrojnë përfitime të konsiderueshme neto që tejkalojnë qartazi kostot e tyre dhe konsiderohen strategjikisht optimale për zbatim për shkak të raporteve të forta kosto-përfitim dhe qëndrueshmërisë në kushte pasigurie. Masat e tjera klasifikohen si “**me ndikim të ulët dhe pasoja minimale**”, duke treguar se zbatimi i tyre mbetet i dobishëm edhe në mungesë të ndikimeve të rënda të ndryshimeve klimatike, shihni, gjithashtu:



¹¹⁷ Masat “e gjelbra” mbështeten në zgjidhje të bazuara në natyrë, si restaurimi i ekosistemit, ripyllëzimi ose menaxhimi i qëndrueshëm i tokës, të cilat rrisin qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, ndërkohë që mundësojnë përfitime të ndërsjella si mbrojtja e biodiversitetit dhe ofrimi i shërbimeve të ekosistemit.

¹¹⁸ Masat “gri” përfshijnë zgjidhje inxhinierike ose teknologjike, si infrastruktura me aftësi ripërtëritëse, sistemet e kullimit ose sistemet e paralajmërimit të hershëm, të projektuara për të zvogëluar ekspozimin fizik ndaj risqeve klimatike.

¹¹⁹ Kriteret ndërsektoriale të identifikuar të bazuara në evidenca për kuadrin e prioritizimit; procesi i prioritizimit është vënë në zbatim për alternativat e përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

¹²⁰ Gjithashtu, këtu u përfshinë disa periudha kohore më të gjata deri në vitin 2050.

¹²¹ Në AKP pjesëtohen përfitimet totale të zbritura me kostot totale të zbritura për të vlerësuar qëndrueshmërinë ekonomike.

¹²² Për më shumë detaje rreth përkufizimit të masave “të buta”, “të gjelbra” dhe “gri” shihni seksionin 6, më poshtë: Plani i zbatimit të PKP-së.

Figura 19 më poshtë, dhe planin e zbatimit, tabela 10, në kapitullin tjetër për detaje mbi masat e përshtatjes.




Figura 19. Prioritizimi i masave të përshtatjes sipas ndikimit dhe mundësia për pasojë të mëdha.

Analiza e KP-së nxori në pah disa kufizime që duhen marrë parasysh dhe duhen vlerësuar për interpretimin e saj:

- Mangësitë në të dhëna dhe kufizimet analitike: Një sërë masash nuk mund të vlerësoheshin plotësisht për shkak se mungonin të dhëna;
- Performancë e ulët ose negative ekonomike: Këto rezultate ngrenë shqetësime në lidhje me qëndrueshmërinë ekonomike sipas supozimeve aktuale;
- Ndjeshmëria ndaj parametrave kryesorë: Disa masa tregojnë ndjeshmëri ndaj luhatjeve në parametrat e të dhënave, të cilat duhet të rishikohen më tej.

Disa **rekomandime** nga AKP-ja janë:

- Afatshkurtra: T'i jepet përparësi zbatimit të masave me performancë të lartë dhe risk të ulët me AKP të mirë-argumentuara;
- Afatmesme: Të përmirësohen vlerësimet e kostos dhe përfitimit, veçanërisht për ato masa që aktualisht konsiderohen të paqarta ose negative;
- Afatgjata: Të institucionalizohet integrimi i analizës ekonomike në hartimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve të përshtatjes, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve dhe instrumenteve kombëtare.

Përmes këtij ushtrimi gjithëpërfshirës të përcaktimit të përparësive, duke përfshirë MCA-në dhe AKP-në, dolën masat përfundimtare të prioritizuara dhe të kostuara të përshtatjes në planin e zbatimit, shihni kapitullin tjetër.

6. PLANI I ZBATIMIT TË NAP-it.

Zbatimi i masave prioritare të përshtatjes kërkon një qasje zbatimi të mirëmenduar, me veprimtari, afate kohore, buxhete, role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, si dhe tregues të përshtatshëm monitorimi. Për këtë qëllim, si pjesë e procesit të NAP-it, u përgatit dhe u verifikua **plani i zbatimit të NAP-it** për të krijuar një kuadër koherent dhe të zbatueshëm për të udhëhequr zbatimin e masave prioritare të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri në të gjithë sektorët kryesorë: bujqësi dhe pylltari, energji, turizëm, zhvillim urban, transport dhe fusha ndërsektoriale¹²³. Plani i zbatimit është hartuar për t'i shndërruar prioritetet sektoriale të përshtatjes në ndërhyrje konkrete që janë teknikisht të realizueshme, financiarisht të qëndrueshme dhe përfshirëse në aspektin social. Plani kontribuon në uljen e cenueshmërisë që lidhet me klimën (si sektoriale, ashtu edhe territoriale), duke rritur njëkohësisht kapacitetin institucional të vendit, koordinimin ndër-institucional dhe aftësitë ripërtëritëse afatgjata. Ai nxit

¹²³ Plani i zbatimit për veprimet e prioritizuara dhe të kostuara të përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

një mjedis bashkëpunues që u mundëson të gjithë aktorëve përkatës (qeveritarë, bashkiakë, joqeveritarë, të sektorit privat) të angazhohen në mënyrë të efektshme në procesin e zbatimit, duke siguruar që masat e përshtatjes t'u përgjigjen si prioriteteve kombëtare, ashtu edhe nevojave vendore.

Për arritjen e këtij qëllimi, plani është strukturuar për:

1. Krijimin e kushteve institucionale dhe operacionale për zbatim efektiv, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë në nivel kombëtar dhe vendor.

2. Forcimin e bashkëpunimit shumënivelësh dhe ndërsektorial midis ministrive, agjencive publike, bashkive dhe palëve të tjera kryesore të interesit për të siguruar harmonizimin, koherencën dhe angazhimin për zbatimin e masave të përshtatjes.

Kjo gjë siguron që masat e përshtatjes të zbatohen në mënyrë efektive, koherente dhe të qëndrueshme në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

6.1 Masat prioritare në kuadër të NAP-it

Për të lehtësuar kategorizimin e 66 masave të përshtatjes, ato janë ndarë në tre kategori bazuar në qasjen që përdorin për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike:

- **Masat e buta** u referohen ndërhyrjeve jostrukturore, si kërkimi dhe vlerësimet e riskut, ngritja e kapaciteteve, veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimi, mekanizmat e qeverisjes dhe koordinimit, instrumentet e planifikimit dhe rregullatore, si dhe mjetet financiare ose të bazuara në incentiva. Përmes këtyre masave synohet forcimi i kuadrove institucionale dhe i kapaciteteve dhe krijimi i kushteve të favorshme për përshtatje (kapacitetet e përshtatjes). Ndërhyrjet e buta përbëjnë **numrin më të madh të masave** (45 nga 66 masa); kjo gjë thekson rolin kritik të qeverisjes, kapaciteteve dhe sistemeve të bazuara në njohuri për përshtatjen e efektshme;

- **Masat e gjelbra** shfrytëzojnë restaurimin, ruajtjen ose menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve për të pakësuar risqet klimatike dhe për të ofruar përfitime të shumta të ndërsjella, duke përfshirë përmirësimin e biodiversitetit dhe ofrimin e shërbimeve të ekosistemit. Disa shembuj janë restaurimi i ekosistemit, ripyllëzimi, teknikat agroekologjike dhe zgjidhjet e bioinxhinierisë, të cilat ndonjëherë klasifikohen si zgjidhje të bazuara në natyrë ose përshtatje të bazuar në ekosistem. Ndërhyrjet e gjelbra përfaqësojnë **15 ndërhyrje** gjithsej;

- **Masat gri** përfshijnë zgjidhje inxhinierike ose teknologjike të hartuara për të ulur ekspozimin fizik ndaj risqeve klimatike. Këtu përfshihet infrastruktura me aftësi ripërtëritëse, sistemet e kullimit dhe mbajtja e ujit, muret mbrojtëse, sistemet fizike të paralajmërimit të hershëm etj. Ndërhyrjet prioritare gri janë më të pakta në numër, me **6 ndërhyrje** në Planin e Zbatimit, pasi për këto ndërhyrje nevojitet kapital i lartë, por ato janë thelbësore për mbrojtjen e infrastrukturës dhe shërbimeve kritike nga ngjarjet ekstreme të klimës.

Paralelisht, 66 masat prioritare të përshtatjes janë të ndara sipas sektorëve për të adresuar cenueshmëritë specifike. Ato plotësohen me një kategori “masash ndërsektoriale”, që mbulon ndërhyrjet që sjellin përfitime përshtatjeje për të gjithë sektorët dhe/ose lehtësojnë koordinimin dhe zbatimin e përgjithshëm të NAP-it. Ndërhyrjet kyç për çdo sektor përmbledhen si më poshtë:

- **Masat ndërsektoriale të përshtatjes** (10 gjithsej) janë të dobishme për shumë sektorë. Shpesh këto janë veprime që mundësojnë forcimin e koordinimit rajonal me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës (p.sh., një Udhërrëfyes për Përshtatjen e Ballkanit Perëndimor për risqet ndërkufitare), përmirësimin e sistemeve të të dhënave klimatike (përmirësimin e rrjetit hidrometeorologjik dhe shkëmbimin e të dhënave) dhe pilotimi i mekanizmave novatorë të financimit. Këto veprime ndërsektoriale luajnë rol të rëndësishëm në përpjekjet e përgjithshme të përshtatjes, duke siguruar koherencë dhe duke shfrytëzuar sinergjitë në veprimet sektoriale;

- Masat e përshtatjes në **bujqësi** (në total 8) përfshijnë përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe infrastrukturës për aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike (p.sh., rehabilitimin e

sistemeve të ujitjes dhe të kullimit dhe promovimin e mbledhjes së ujit të shiut në zonat me risk ndaj thatësisë, zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë në tokat bujqësore (si restaurimi i fushave aluvionale dhe mbrojtja e brigjeve të lumenjve për të zvogëluar riskun nga përmbytjet në tokën bujqësore), ofrimin e mbrojtjes financiare për fermerët (sigurimi i kulturave bujqësore ose fondet e kompensimit për humbjet nga fatkeqësitë klimatike) dhe përmirësimin e shërbimeve bujqësore (hartimin e një Plani Veprimi për llojet invazive në kushte klimatike në ndryshim dhe rritjen e kapacitetit të monitorimit të klimës për zonat bregdetare dhe bujqësore);

- Në sektorin e **pylltarisë**, 13 masat prioritare përqendrohen në restaurimin e ekosistemit dhe ripyllëzimin në shkallë të gjerë. Masa më kërkuese e planit është një program mbarëkombëtar i pyllëzimit dhe agropylltarisë për të restauruar tokat e degraduara dhe për të përmirësuar aftësitë ripërtëritëse të pellgjeve ujëmbledhëse. Masa të tjera sektoriale përfshijnë krijimin e fidanishteve rajonale pyjore për specie rezistente ndaj thatësisë dhe programe për të ndihmuar migrimin e specieve të rralla/endemike drejt habitateve të përshtatshme ndërkohë që klima ndryshon. Ndërhyrje të tjera prioritare synojnë mbrojtjen nga përmbytjet dhe erozioni përmes restaurimit të brezave të gjelbër bregdetarë dhe lumorë, duke zbatuar kontrollin e integruar të erozionit dhe duke rritur aftësitë ripërtëritëse të zonave të mbrojtura. Janë prioritetizuar edhe masat për ngritjen e kapaciteteve, si forcimi i menaxhimit të zjarreve në peizazh dhe vënia në zbatim e skemave të Pagesës për Shërbimet e Ekosistemit (PSHE) për të financuar ruajtjen e pyjeve;

- Në sektorin e **turizmit** përfshihen 11 ndërhyrje prioritare, të cilat janë kryesisht masa “të buta” duke pasur parasysh nevojat e sektorit të turizmit për planifikim dhe kapacitete. Këtu përfshihen planifikimi hapësinor i bazuar te klima për zhvillimin e turizmit (për të shmangur zonat me rrezik të lartë si fushat aluvionale ose vijat bregdetare me erozion), përditësimi i standardeve të ndërtimit dhe programeve të incentivave për mbrojtjen e objekteve turistike nga ndryshimet klimatike, si dhe reformat politike dhe rregullatore për të integruar menaxhimin e riskut klimatik në veprimtaritë turistike. Një masë e rëndësishme e bazuar në ekosistem në turizëm është nisma për mbrojtjen e trashëgimisë nënujore të gjirit të Vlorës. Masat e tjera përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve, p.sh., trajnimi i operatorëve turistikë lidhur me praktikën e përshtatjes, krijimi i qendrave të njohurive digjitale për turizmin me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbatimi i rregulloreve për mbrojtjen e pasurive natyrore;

- Ka 9 masa për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane në **zhvillimin urban**. Disa masa përfshijnë integrimin e ndryshimeve klimatike në planifikimin urban dhe territorial: p.sh., përditësimi i masterplaneve të qytetit për të marrë parasysh rritjen e nivelit të detit dhe riskun nga përmbytjet, si dhe ridrejtimi i zhvillimeve të reja larg zonave me risk të lartë. Një tjetër fushë kyç ndërhyrjeje është rritja e aftësive ripërtëritëse të ndërtesave dhe përmirësimi i infrastrukturës urbane përmes masave si: kryerja e vlerësimeve të riskut klimatik në nivel qyteti dhe hartave të cënueshmërisë për të orientuar investimet, hartimi i planeve të reagimit ndaj emergjencave të përmbytjeve për bashkitë dhe vlerësimi i alternativave për kullimin e qëndrueshëm urban. Masat “e gjelbra” specifike përfshijnë nismat për gjelbërim urban dhe ripyllëzim për të krijuar korridore të gjelbra dhe për të zbutur efektet e ishujve të nxehtësisë;

- Tetë masat e përshtatjes në **sektorin e energjisë** trajtojnë si ofertën, ashtu edhe kërkesën për energji. Në aspektin e ofertës/infrastrukturës, synohet mbrojtja e infrastrukturës energjetike nga moti ekstrem përmes një mase të gjerë “gri”. Një masë tjetër përqendrohet në përmirësimin e aftësive ripërtëritëse në sistemet e gjenerimit të energjisë hidroelektrike, ku përfshihet optimizimi i operacioneve të rezervuarëve për realitetet e reja klimatike dhe përforcimin e digave dhe strukturave përkatëse. Në aspektin e kërkesës, masat përfshijnë promovimin e teknologjive efikase të ftohjes për valët e të nxehtëtit, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator përmes qasjeve të reja si zbatimi i standardeve të performancës së energjisë për ndërtesat.

Gjithashtu, ka masa eksploruese si menaxhimi lidhur me kërkesën dhe studimet e ruajtjes së energjisë për të shtuar fleksibilitetin e sistemit energjetik në rast të ndryshueshmërisë klimatike;

- Në **sektorin e transportit**, 7 masat prioritare janë kryesisht strategjike ose të përqendruara në planifikim, duke reflektuar nevojën për të mbrojtur sistematikisht rrjetin e transportit nga ndryshimet klimatike, p.sh., përmes vlerësimeve të rregullta të cënueshmërisë dhe riskut klimatik për infrastrukturën rrugore. Masa të tjera u japin përparësi zgjidhjeve bioinxhinierike për stabilizimin e rrugëve dhe studimet gjeologjike për të udhëhequr projektimin e rrugëve në zonat me rrezik erozioni. Një masë shumë e rëndësishme e gjelbër është integrimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë në infrastrukturën e transportit. Sa u përket politikave, masat përfshijnë përditësimin e standardeve të projektimit të transportit dhe programeve të mirëmbajtjes për të marrë parasysh risqet klimatike (udhëzime për projektimin e rrugëve me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës) dhe krijimin e partneriteteve novatore të financimit për të financuar projekte për transportin me aftësi ripërtëritëse.

Në aneksin IV, më poshtë, paraqitet një hartë me vendndodhjet e masave për pylltarinë, bujqësinë dhe ZBN, në të cilën përmbliidhen 66 masat e përshtatjes duke përfshirë sektorin, llojin e masës, kostot e përlogaritura dhe periudhën e zbatimit:

Tabela 10: Plani i Zbatimit të NAP-it¹²⁴.

Nr.	Spektori	Masat e përshtatjes	Lloji i ndërhyrjes*	Kostoja (dollarë amerikanë)	Periudha**
1	Ndërsektorial	Forcimi i aftësive ripërtëritëse rajonale: Mbështetja e Udhërrëfyesit për Përshtatjen e Ballkanit Perëndimor	Masë e butë	315.000	ASH
2	Ndërsektorial	Optimizimi i koordinimit të klimës: Forcimi i kornizës së GNPKN-së	Masë e butë	420.000	ASH
3	Ndërsektorial	Rritja e kapaciteteve për përshtatje: Mbështetja për grupin teknik të ndryshimeve klimatike dhe krijimi dhe forcimi i kapaciteteve të Grupit Drejtues	Masë e butë	745.000	ASH
4	Ndërsektorial	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj klimës përmes sistemeve të përmirësuar të të dhënave	Masë e butë	1.500.000	ASH
5	Ndërsektorial	Zgjidhje të bazuara në natyrë dhe skema zhvilluesish për fitim neto të biodiversitetit	E gjelbër	242.793.396	AM
6	Ndërsektorial	Nxjtja e ndërgjegjësimit për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe trajnimi për përshtatje dhe butje	Masë e butë	1.500.000	ASH
7	Ndërsektorial	Mekanizmat novatorë të financimit për klimën: Pilotimi i strategjive të financimit të qëndrueshëm	Masë e butë	6.080.000	ASH
8	Ndërsektorial	Pilotimi i vlerësimeve të menaxhimit të riskut për bizneset me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike	Masë e butë	200.000	ASH
9	Ndërsektorial	Promovimi i përshtatjes klimatike me ndjeshmëri gjinore: Trajnimi i palëve të interesit, krijimi i instrumenteve gjithëpërfshirëse, forcimi i kapaciteteve institucionale në sektorin shëndetësor	Masë e butë	143.000	AM
10	Ndërsektorial	Edukimi i komuniteteve: Përshtatja dhe rritja e ndërgjegjësimit për fatqeqësitë	Masë e butë	3.025.000	ASH
11	Bujqësia	Fuqizimi i fermerëve: mbështetja financiare për infrastrukturën me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike	Masë e butë	29.600.000	ASH
12	Bujqësia	Mbrojtja e fermerëve: Programet e kompensimit dhe ndihmës për rimëkëmbjen nga fatqeqësitë	Masë e butë	102.250.000	AM
13	Bujqësia	Plani i veprimit për llojet invazive në kushtet e ndryshueshme klimatike	Masë e butë	160.000	AM
14	Bujqësia	Forcimi i mbrojtjes nga përmbytjet: Restaurimi i brigjeve të lumenjve dhe zgjerimi i fushave aluvionale përgjatë lumenjve kryesorë të Shqipërisë	Zona gri	179.022.000	ASH
15	Bujqësia	Zbatimi i krijimit të habitatit dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të luftuar erozionin e tokës	E gjelbër	41.787.500	ASH
16	Bujqësia	Rritja e kapaciteteve të IGEO-s (Institutit të Gjeoshkencave) për monitorimin bregdetar dhe ofrimin e të dhënave mbi ndryshimet dhe risqet mjedisore	Masë e butë	322.200	ASH
17	Bujqësia	Zgjerimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse në bujqësi	Zona gri	249.123.998	ASH
18	Bujqësia	Siguria e qëndrueshme e ujit përmes Infrastrukturës së mbledhjes së ujit të shiut	Zona gri	75.849.163	ASH
19	Pylltari	Rritja e efikasitetit të pylltarisë nëpërmjet pajtueshmërisë rregullatore të BE-së	Masë e butë	17.600.000	ASH
20	Pylltari	Promovimi i pylltarisë së qëndrueshme: Fondi i pyllëzimit dhe nismat e prokurimit të gjelbër	Masë e butë	8.540.000	ASH
21	Pylltari	Rijetëzimi i tokave të dëmtuara: Integrimi i ZBN-së dhe PBE-së me praktikën e agropylltarisë	E gjelbër	1.494.738.115	ASH
22	Pylltari	Forcimi i mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave: Investime në kapacitetet njerëzore dhe burimet e zjarfikësve	Masë e butë	475.000	ASH
23	Pylltari	Mbështetja e pyllëzimit: Vendosja e fidanishve rajonale për llojet rezistente ndaj thatësisë	E gjelbër	2.249.360	ASH
24	Pylltari	Mbështetja e migrimit të specieve të rralla dhe endemike të pyjeve në lartësi më të mëdha	E gjelbër	894.780	ASH
25	Pylltari	Restaurimi i ekosistemeve jetësore: Mbrojtja dhe rigjenerimi i brezave të gjelbër bregdetarë dhe lumorë dhe ekosistemeve mbrojtëse	E gjelbër	145.561.688	ASH
26	Pylltari	Financimi i qëndrueshëm përmes pagesës për shërbimet e ekosistemit (PSHE)	Masë e butë	16.000.000	AGJ
27	Pylltari	Restaurimi dhe aftësitë ripërtëritëse të ekosistemit të integruar: Trajtimi i erozionit të tokës në rajonet kryesore të Shqipërisë	E gjelbër	62.573.351	AGJ
28	Pylltari	Lufta kundër erozionit dhe përmbytjeve: Restaurimi strategjik i habitateve dhe ripyllëzimi në rajonet kryesore të Shqipërisë	E gjelbër	124.943.176	ASH
29	Pylltari	Menaxhimi i qëndrueshëm i peizazhit: Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe biodiversitetit në ligenin e Viroit në Gjirokastrë	E gjelbër	479.334	AGJ
30	Pylltari	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura	E gjelbër	257.461.805	AM
31	Pylltari	Restaurimi i shtresave pyjore për të mbrojtur kulturat në Vlorë	E gjelbër	3.282.947	AM

¹²⁴ Plani i zbatimit për veprimet e prioritizuara të përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. 2023–2025. Këtu paraqitet pa veprimtari dhe tregues.

Nr.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji i ndërhyrjes*	Kostoja (dollarë amerikanë)	Periodha**
32	Turizmi	Planifikimi hapësinor strategjik për turizmin: Ridrejtimi i zhvillimit nga zonat me risk të lart	Masë e butë	600.000	ASH
33	Turizmi	Mbrojtja e infrastrukturës turistike dhe trashëgimisë kulturore nga ndryshimet klimatike: Paketat e incentivave për mbrojtjen e infrastrukturës së sektorit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore nga ndryshimet klimatike	Masë e butë	800.000	AM
34	Turizmi	Planifikimi strategjik për qëndrueshmërinë bregdetare: Zonat buferike dhe përshtatja e barrierave detare	Masë e butë	504.000	AM
35	Turizmi	Mbrojtja e gjirit të Vlorës: Ruajtja e habitateve të posidonias dhe trashëgimisë kulturore nënujore nga ndikimet klimatike	E gjelbër	3.606.119	AGJ
36	Turizmi	Forcimi i kuadrit politik dhe rregullator për turizmin e qëndrueshëm: Rishikimi i politikave dhe përmirësimi rregullator	Masë e butë	120.500	ASH
37	Turizmi	Integrimi i të dhënave klimatike për turizëm të qëndrueshëm: Udhëzimet për menaxhimin e qëndrueshëm të biznesit dhe raportimin kombëtar	Masë e butë	290.000	ASH
38	Turizmi	Mbrojtja e infrastrukturës turistike nga ndryshimet klimatike: Projektme përshtatëse për zbutjen e risqeve klimatike	Zona gri	TBC	ASH
39	Turizmi	Mbrojtja e zonave bregdetare: Rregullore të integruara, planifikim dhe menaxhim për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm	Masë e butë	657.000	AM
40	Turizmi	Ngritja e kapaciteteve me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Trajnimi i operatorëve turistikë për praktikën e qëndrueshme dhe strategjitë e përshtatjes	Masë e butë	430.000	ASH
41	Turizmi	Qendrat digjitale për turizmin me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Ndarja e njohurive dhe praktikave më të mira	Masë e butë	34.000	ASH
42	Turizmi	Mbrojtja e pasurive turistike dhe trashëgimisë kulturore: Zbatimi i rregullore për pasuritë turistike dhe restaurimi i ekosistemeve për zhvillim të qëndrueshëm	Masë e butë	1.450.000	ASH
43	Zhvillimi urban	Planifikimi detar dhe territorial për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Përgatitja për rritjen e nivelit të detit dhe mjediset në ndryshim	Masë e butë	290.000	AM
44	Zhvillimi urban	Planifikimi hapësinor strategjik për uljen e riskut: Ridrejtimi i zhvillimeve dhe menaxhimi i risqeve nga përmbytjet nga ujërat sipërfaqësore	Masë e butë	3.027.000	ASH
45	Zhvillimi urban	Skemat e incentivave për të rritur aftësitë ripërtëritëse të ndërtesave ndaj temperaturave ekstreme	Masë e butë	2.715.000.000	AGJ
46	Zhvillimi urban	Integrimi i hapësirave të gjelbra në zhvillimin e infrastrukturës publike përmes prokurimit publik të gjelbër	Masë e butë	380.000	AM
47	Zhvillimi urban	Restaurimi i korridoreve të gjelbra: Nismat për ripyllëzim dhe gjelbërim urban	E gjelbër	568.544	AM
48	Zhvillimi urban	Vlerësimi i riskut klimatik për Durrësin, Elbasanin, Fierin dhe më gjerë: Krijimi i një harte gjithëpërfshirëse të cënueshmërisë	Masë e butë	196.000	ASH
49	Zhvillimi urban	Planet e emergjencës për raste përmbytjesh	Masë e butë	2.500.000	ASH
50	Zhvillimi urban	Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: Vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit	E gjelbër	TBC	ASH
51	Zhvillimi urban	Projektim i qëndrueshëm urban: Ruajtja dhe restaurimi i zonave të përshkueshme dhe të infiltrimit	Masë e butë	1.200.000	AGJ
52	Energjia	Mbrojtja e infrastrukturës energjetike nga erërat e forta: Rehabilitimi i nënstacioneve dhe linjave të transmetimit	Zona gri	986.298.000	AM
53	Energjia	Rritja e efikasitetit të ndërtesave: Certifikatat e Performancës së Energjisë dhe standardet e qëndrueshmërisë	Masë e butë	3.500.000	AM
54	Energjia	Eksplorimi i potencialit të sektorit të energjisë: Studime për menaxhimin e kërkesës dhe ruajtjen e energjisë	Masë e butë	2.900.000	AM
55	Energjia	Mbrojtja e infrastrukturës energjetike: Monitorimi i zonave të emergjencës dhe riskut	Masë e butë	875.000	ASH
56	Energjia	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj valës së të nxehtit përmes vendosjes efikase të teknologjisë së kondicionimit të ajrit dhe strehimeve për mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike	Masë e butë	38.200.000	AGJ
57	Energjia	Optimizimi i energjisë së rinovueshme për sisteme me aftësi ripërtëritëse: Investime në inovacionin e rrjetit dhe magazinimin	Masë e butë	176.850.000	AGJ
58	Energjia	Promovimi i barazisë gjinore në sektorin e energjisë: Trajnimi dhe mbështetja e grave në projektet për energjinë e rinovueshme	Masë e butë	4.900.000	ASH
59	Energjia	Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse në sistemet e energjisë hidroelektrike Operacione të optimizuara dhe infrastrukturë e përforcuar	Zona gri	747.050.000	ASH
60	Transporti	Analiza e rregullt e cënueshmërisë dhe riskut dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse për infrastrukturën rrugore	Masë e butë	457.000	ASH
61	Transporti	Studimet gjeologjike për rrugët e qëndrueshme: Zgjidhje bioinxhinierike për të ulur risqet nga erozioni dhe përmbytje	Masë e butë	2.900.000	AM
62	Transporti	Promovimi i lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: hartimi dhe rishikimi i planeve të lëvizshmërisë urbane	Masë e butë	1.200.000	ASH
63	Transporti	Përshtatja e infrastrukturës kritike të transportit: Vlerësimi i avancuar i riskut dhe zgjidhje të projektimit me aftësi ripërtëritëse	Masë e butë	2.700.000	ASH
64	Transporti	Integrimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe përshtatjes së bazuar në mjedis për aftësitë ripërtëritëse të sektorit të transportit: Përmirësimi i infrastrukturës përmes përshtatjes së bazuar në natyrë dhe ekosisteme	E gjelbër	2.029.460.000	AM
65	Transporti	Politikat e transportit për aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Përfshirja e përshtatjes ndaj klimës në kuadrin rregullator	Masë e butë	218.000	ASH
66	Transporti	Partneritete novatore për transport të qëndrueshëm: Financimi për infrastrukturën e transportit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës	Masë e butë	1.900.000	AGJ
TOTALI I PËRGJITHSHËM PËR NAP-in				9.800.696.976	

*Lloji: E butë, e gjelbër, gri.

**Periodha kur pritet të fillojë zbatimi i masave: ASH: Afatshkurtër: 2026–2028; AM: Afatmesme: 2029–2031; AGJ: Afatgjatë: 2032–2036. Më poshtë jepen më shumë detaje lidhur me afatin.

Secila nga 66 masat e përshtatjes të paraqitura më sipër u nda në një grup prej dy deri në dhjetë nënveprimtarish specifike për çdo masë, të cilat janë hapat ose veprimtaritë specifike të

nevojshme për arritjen e përgjithshme të qëllimit të secilës masë. Këto veprimtari paraqiten në **aneksin III**, si dhe në Planin e veçantë të Zbatimit që ofron një nivel më të gjerë detajesh.

Për të mbështetur zbatimin efektiv të masave të përshtatjes dhe veprimtarive përbërëse, u përgatit një grup skedash informuese përmbledhëse për secilën masë, të cilat janë të disponueshme në dokumentin e plotë të Planit të Zbatimit. Këto skeda informuese shërbejnë si mjet praktik për të konsoliduar informacionin kyç për secilën ndërhyrje të propozuar, duke ofruar një përmbledhje të standardizuar që lehtëson vendimmarrjen, koordinimin ndërmjet aktorëve, mobilizimin e burimeve dhe zbatimin përfundimtar. Gjithashtu, u hartuan dokumente koncepti të shkurtra për shumicën e masave për të siguruar mobilizim të mëtejshëm të burimeve (të paraqitura në një dokument të veçantë).

6.2 Qeverisja dhe përgjegjësitë për zbatimin e NAP-it

Në kuadrin institucional të Shqipërisë, qeverisja për ndryshimet klimatike koordinohet përmes një sistemi me shumë nivele, siç tregohet në kapitullin (3.4) 3. Në nivel kombëtar, Ministria e Mjedisit (MM) është autoriteti kryesor për mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave mjedisore dhe klimatike, pjesë e së cilës është dhe Njësia për Ndryshimet Klimatike, e cila vepron si pikë fokale kombëtare për UNFCCC-në. Gjithashtu, ministria drejton GNPNK-në, që luan rol kyç në sigurimin e koordinimit ndërsektorial, harmonizimit institucional, integritetit dhe vendimmarrjes për veprimet klimatike. Grupi i Punës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (GPPNK) në GNPNK shqyrton zbatimin e NAP-it.

Në praktikë, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike zbatohet nga ministritë dhe agjencitë sektoriale përkatëse, shpeshherë në koordinim të ngushtë me autoritetet bashkiake. Ministritë, institucionet dhe autoritetet e mëposhtme të sektorit kanë rol kyç në zbatimin e NAP-it dhe të këtij plani zbatimi (shihni kapitullin 3; 3.4): MM-ja, MBZHR-ja, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Financave (MF), Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke përfshirë institucionet dhe agjencitë e tyre vartëse.

Masat prioritare të NAP-it duhet të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me 61 bashkitë e vendit, të cilat kanë rol kritik në planifikimin dhe zbatimin e përshtatjes, pasi ato menaxhojnë përgjegjësi kyç si infrastruktura vendore (rrugët, sistemet e kullimit, ujësjellësi), rregullimi i përdorimit të tokës, mbrojtja e mjedisit dhe ofrimi i shërbimeve publike.

Për ta vënë në zbatim këtë sistem qeverisjeje me shumë nivele dhe për të siguruar qartësi në shpërndarjen e përgjegjësiave për veprimin klimatik, Plani i Zbatimit përdor një qasje të strukturuar dhe hierarkike, shihni edhe figurën 20, më poshtë:

- **Subjektet përgjegjëse për veprimet për përshtatje:** Këtu përfshihen ministritë qeveritare, agjencitë dhe sipas rastit autoritetet bashkiake përgjegjëse për udhëheqjen e zbatimit të masave dhe veprimtarive për përshtatje specifike për sektorin. Këto subjekte janë të ngarkuara me ekzekutimin dhe monitorimin e veprimeve në fushat e tyre përkatëse të kompetencës, duke siguruar një qasje të integruar, shumësektoriale dhe koherente lidhur me përshtatjen ndaj klimës. Për veprime të caktuara të drejtuara në nivel vendor, bashkitë do të veprojnë si subjekte kryesore zbatuese në koordinim me homologët kombëtarë;

- **Organe qeveritare të lidhura:** Këto janë institucione, mandatet e të cilave lidhen me masën/veprimtarinë e përshtatjes dhe të cilat mbështesin zbatimin e tyre duke ofruar kontribut teknik, harmonizim të politikave ose burime operationale. Këto mund të përfshijnë ministri të tjera, agjenci kombëtare ose institucione publike që kontribuojnë në zbatimin e komponentëve specifikë të masës së përshtatjes ose ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë ndërsektoriale;

- **Partnerë të tjerë kyç:** Kjo kategori përfshin aktorë joqeveritarë, si sektori privat, organizatat e shoqërisë civile, akademia, organizatat me bazë komunitare (OBK), media dhe komunitetet vendase. Këto palë interesi kontribuojnë përmes ekspertizës teknike, kërkimit, mbulimit dhe mobilizimit të komunitetit. Gjithashtu, luajnë rol thelbësor në gjenerimin dhe

ndarjen e të dhënave për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të përshtatjes. Pjesëmarrja e tyre siguron që strategjitë e përshtatjes të jenë gjithëpërfshirëse, të orientuara nga shkenca dhe të bazuara në realitetet vendase.




Figura 20. Marrëveshjet institucionale për planin e zbatimit¹²⁵.

Shihni tabelën 11, më poshtë, për institucionet kryesore përgjegjëse për masat e përshtatjes, ndërsa informacionin e mëtejshëm mbi institucionet kryesore dhe mbështetëse të caktuara për secilin veprim përshtatjeje mund ta gjeni në **skedat e detajuara informuese** të përshtatjes të paraqitura në një dokument të veçantë.

6.3 Afati për zbatimin

Afati i propozuar për planin e zbatimit mbulon periudhën midis viteve 2026 dhe 2036 për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike për masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, që synojnë rritjen e aftësive ripërtëritëse. Ky afat i zgjatur ofron kohë të mjaftueshme për ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e infrastrukturës, integrimin e politikave dhe monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm për të vlerësuar progresin dhe për të bërë rregullimet e nevojshme.

Viti i fillimit të zbatimit për secilën masë përshtatjeje u përcaktua bazuar në analizën dhe gjykimin e ekspertëve, duke marrë parasysh kapacitetet institucionale dhe operacionale të vendit dhe politikat, strategjitë dhe veprimet sektoriale që janë vënë tashmë në zbatim. Kjo u plotësua nga niveli i përcaktuar i prioritetit dhe renditja e prioriteteve specifike për sektorin. Kjo qasje e kombinuar siguroi një afat kohor të shkallëzuar që rrit fizibilitetin, qëndrueshmërinë dhe koordinimin, siç përcaktohet përmes viteve të fillimit të propozuara për secilën masë të shpërndarë si më poshtë:

- **Masat afatshkurtra** do të **fillojnë** në një kohë **ndërmjet viteve 2026 dhe 2028**, duke pasur parasysh urgjencën e tyre ose periudhat e nevojshme më të gjata për zbatim;
- **Masat afatmesme** do të **fillojnë të zbatohen midis viteve 2029 dhe 2032**;
- **Masat afatgjata** do të **fillojnë midis viteve 2033 dhe 2036**, duke pasur parasysh kompleksitetin e tyre, sasinë më të madhe të fondeve të nevojshme ose kërkesën për studime të mëparshme përpara se të fillojë zbatimi.

¹²⁵ Plani i zbatimit për veprimet e prioritetuara dhe të kostuara të përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.




Figura 1. Periudhat e zbatimit.

Kohëzgjatja e **periudhës së zbatimit për masat e përshtatjes** ndryshon pasi varet nga veprimtaritë specifike të masës së përshtatjes, duke filluar nga **1 vit deri në 10 vjet**. **Vitet e vazhdimësisë mbulojnë periudhën 2037–2042** dhe këto janë vitet **deri në përfundimin e ekzekutimit të të gjitha masave**, megjithatë, në këtë periudhë nuk do të fillojnë masa të reja.

Plani i Zbatimit do të rishikohet në mesin e periudhës për rregullime të mundshme dhe do të vlerësohet drejt fundit për të përcaktuar një plan të ri zbatimi me masa vijuese dhe/ose të reja përshtatjeje

Tabela 11: Koha dhe përgjegjësitë për planin e zbatimit

Nr.	Masat e përshtatjes	Përgjegjësitë	Vitet e zbatimit																		Vitet e vazhdimësisë				
			Fillimi i periudhës afatshkurtër			Fillimi i periudhës afatmesme				Fillimi i periudhës afatgjatë															
			2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042						
1	Forcimi i aftësive ripërtëritëse rajonale: Mbështetja e Udhërrëfyesit për Përshtatjen e Ballkanit Perëndimor	MM, Bashkitë																							
2	Optimizimi i koordinimit të klimës: Forcimi i kornizës së GNPKN-së	MM, Bashkitë																							
3	Rritja e kapaciteteve për përshtatje: Mbështetja për grupin teknik të ndryshimeve klimatike dhe krijimi dhe forcimi i kapaciteteve të Grupit Drejtues	MM, Bashkitë																							
4	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj klimës përmes sistemeve të përmirësuar të të dhënave	MM																							
5	Zgjidhje të bazuara në natyrë dhe skema zhvilluesish për fitim neto të biodiversitetit	MM, Bashkitë																							
6	Nxiti i ndërgjegjësimit për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe trajnimi për përshtatje dhe zbutje	MAS, ASPA																							
7	Mekanizmat novatorë të financimit për klimën: Pilotimi i strategjive të financimit të qëndrueshëm	MF, Bashkitë																							
8	Pilotimi i vlerësimeve të menaxhimit të riskut për bizneset me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike	MEKI																							
9	Promovimi i përshtatjes klimatike me ndjeshmëri gjinore: Trajnimi i palëve të interesit, krijimi i instrumenteve gjithëpërfshirëse dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në sektorin shëndetësor	MSHMS, ASPA																							
10	Edukimi i komuniteteve: Përshtatja dhe rritja e ndërgjegjësimit për fatkeqësitë	MAS																							
11	Fuqizimi i fermerëve: mbështetja financiare për infrastrukturën me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike	MBZHR																							
12	Mbrojtja e fermerëve: Programet e kompensimit dhe ndihmës për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë	MBZHR																							
13	Plani i veprimt për llojet invazive në kushtet e ndryshueshme klimatike	MBZHR																							
14	Forcimi i mbrojtjes nga përmytjet: Restaurimi i brigjeve të lumenjve dhe zgjerimi i fushave aluvionale përgjatë lumenjve kryesorë të Shqipërisë	MBZHR, Bashkitë																							
15	Zbatimi i krijimit të habitatit dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të luftuar erozionin e tokës	MBZHR, Bashkitë																							
16	Rritja e kapaciteteve të IGEO-s për monitorimin bregdetar dhe ofrimin e të dhënave mbi ndryshimet dhe risqet mjedisore	MBZHR																							
17	Zgjerimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse në bujqësi	MBZHR, Bashkitë																							
18	Siguria e qëndrueshme e ujit përmes Infrastrukturës së mbledhjes së ujit të shiut	MBZHR, Bashkitë																							
19	Rritja e efikasitetit të pylltarisë nëpërmjet natueshmërisë rregullatore të BE-së	MTM																							

Nr.	Masat e përshatjes	Përgjegjësitë	Vitet e zbatimit																	Vitet e vazhdimësisë				
			Fillimi i periudhës afatshkurtër			Fillimi i periudhës afatmesme				Fillimi i periudhës afatgjatë														
			2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042					
20	Promovimi i pylltarisë së qëndrueshme: Fondi i pyllëzimit dhe nismat e prokurimit të gjelbër	MTM																						
21	Rijetëzimi i tokave të dëmtuara: Integrimi i ZBN-së dhe PBE-së me praktikën e agropylltarisë	MM, Bashkitë																						
22	Forcimi i mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave: Investime në kapacitetet njerëzore dhe burimet e zjarrrfikësve	MM, Bashkitë																						
23	Mbështetja e pyllëzimit: Vendosja e fidanishteve rajonale për llojet rezistente ndaj thatësisë	MM, Bashkitë																						
24	Mbështetja e migrimit të specieve të rralla dhe endemike të pyjeve në lartësi më të mëdha	MM, Bashkitë																						
25	Restaurimi i ekosistemeve jetësore: Mbrojtja dhe rigjenerimi i brezave të gjelbër bregdetarë dhe lumorë dhe ekosistemeve mbrojtëse	MM, Bashkitë																						
26	Financimi i qëndrueshëm përmes pagesës për shërbimet e ekosistemit (PSHE)	MBZHR																						
27	Restaurimi dhe aftësitë ripërtëritëse të ekosistemit të integruar: Trajtimi i erozionit të tokës në rajonet kryesore	MM, Bashkitë																						
28	Lufta kundër erozionit dhe përmbytjeve: Restaurimi strategjik i habitateve dhe ripyllëzimi në rajonet kryesore të Shqipërisë	MM, Bashkitë																						
29	Menaxhimi i qëndrueshëm i peizazhit: Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe biodiversitetit në liqenin e Viroit në Gjirokastrë	MM, Bashkitë																						
30	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura	AKZM, Bashkitë																						
31	Restaurimi i shtresave pyjore për të mbrojtur kulturat në Vlorë	MBZHR, Bashkitë																						
32	Planifikimi hapësinor strategjik për turizmin: Ridrejtimi i zhvillimit nga zonat me risk të lartë	MM, MTKS																						
33	Mbrojtja e infrastrukturës turistike dhe trashëgimisë kulturore nga ndryshimet klimatike: Paketat e incentivave për mbrojtjen e infrastrukturës së sektorit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore nga ndryshimet klimatike	MM, MTKS																						
34	Planifikimi strategjik për qëndrueshmërinë bregdetare: Zonat buferike dhe përshatja e barrierave detare	MM, MTKS, Bashkitë																						
35	Mbrojtja e gjirit të Vlorës: Ruajtja e habitateve të posidonias dhe trashëgimisë kulturore nënujore nga ndikimet klimatike	MTM, MTKS, Bashkitë																						
36	Forcimi i kuadrit politik dhe rregullator për turizmin e qëndrueshëm: Rishikimi i politikave dhe përmirësimi rregullator	MM, MTKS																						
37	Integrimi i të dhënave klimatike për turizëm të qëndrueshëm: Udhëzimet për menaxhimin e qëndrueshëm të biznesit dhe raportimin kombëtar	MM, MTKS																						
38	Mbrojtja e infrastrukturës turistike nga ndryshimet klimatike: Projektme përshatëse për zbutjen e risqeve klimatike	MM, MTKS																						
39	Mbrojtja e zonave bregdetare: Rregullore të integruara, planifikim dhe menaxhim për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm	MM, MTKS																						
40	Ngritja e kapaciteteve me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Trajnimi i operatorëve turistikë për praktikën e qëndrueshme dhe strategjitë e përshatjes	MM, MTKS																						
41	Qendrat digjitale për turizmin me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Ndarja e njohurive dhe praktikave më të mira	MM, MTKS																						
42	Mbrojtja e pasurive turistike dhe trashëgimisë kulturore: Zbatimi i rregulloreve për pasuritë turistike dhe kulturore dhe restaurimi i ekosistemeve për zhvillim të qëndrueshëm	MM, MTKS																						
43	Planifikimi detar dhe territorial për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Përgatitja për rritjen e nivelit të detit dhe mjediset në ndryshim	MIE																						
44	Planifikimi hapësinor strategjik për uljen e riskut: Ridrejtimi i zhvillimeve dhe menaxhimi i risqeve nga përmbytjet nga ujërat sipërfaqësore	MIE																						
45	Skemat e incentivave për të rritur aftësitë ripërtëritëse të ndërtesave ndaj temperaturave ekstreme	MIE																						
46	Integrimi i hapësirave të gjelbra në zhvillimin e infrastrukturës publike përmes PPGJ-së	MIE																						
47	Restaurimi i korridoreve të gjelbra: Nismat për ripyllëzim dhe gjelbërim urban	MM, Bashkitë																						
48	Vlerësimi i riskut klimatik për Durrësin, Elbasanin, Fierin dhe më gjerë: Krijimi i një harte gjithëpërfshirëse të cënueshmërisë	MIE, Bashkitë																						
49	Planet e emergjencës për raste përmbytjesh	MIE, Bashkitë																						
50	Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: Vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit	MIE, Bashkitë																						
51	Projektim i qëndrueshëm urban: Ruajtja dhe restaurimi i zonave të përshkueshme dhe të infiltrimit	MIE, Bashkitë																						
52	Mbrojtja e infrastrukturës energjetike nga erërat e forta: Rehabilitimi i nënstacioneve dhe linjave të transmetimit	Operatori i Sistemit të Transmetimit në Shqipëri																						
53	Rritja e efikasitetit të ndërtesave: Certifikatat e Performancës së Energjisë dhe standardet e qëndrueshmërisë	MIE																						
54	Eksplorimi i potencialit të sektorit të energjisë: Studime për menaxhimin e kërkesës dhe ruajtjen e energjisë	MIE																						
55	Mbrojtja e infrastrukturës energjetike: Monitorimi i zonave të emergjencës dhe riskut	MIE																						
56	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj valës së të nxehtësisë përmes vendosjes efikase të teknologjisë së kondicionimit të ajrit dhe strehimeve për mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike	MIE, Bashkitë																						
57	Optimizimi i energjisë së rinovueshme për sisteme me aftësi ripërtëritëse: Investime në inovacionin e rrjetit dhe magazinimin	MIE																						
58	Promovimi i barazisë gjinore në sektorin e energjisë: Trajnimi dhe mbështetja e grave në projektet për ER-në	MIE																						
59	Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse në sistemet e energjisë hidroelektrike: Operacione të optimizuara dhe infrastrukturë e përfortuar	MIE																						
60	Analiza e rregullt e cënueshmërisë dhe riskut dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse për infrastrukturën rrugore	MIE – Infrastruktura e transportit,																						

Nr.	Masat e përshtatjes	Përgjegjësitë	Vitet e zbatimit												Vitet e vazhdimësisë					
			Fillimi i periudhës afatshkurtër			Fillimi i periudhës afatmesme				Fillimi i periudhës afatgjatë										
			2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042	
		Bashkitë																		
61	Studimet gjeologjike për rrugët e qëndrueshme: Zgjidhje bioinxhinierike për të ulur risqet nga erozioni dhe përmbytje	MIE – Infrastruktura e transportit, Bashkitë																		
62	Promovimi i lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: hartimi dhe rishikimi i planeve të lëvizshmërisë urbane	MIE – Infrastruktura e transportit, Bashkitë																		
63	Përshtatja e infrastrukturës kritike të transportit: Vlerësimi i avancuar i riskut dhe zgjidhje të projektimit me aftësi ripërtëritëse	MIE – Infrastruktura e transportit, Bashkitë																		
64	Integrimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe përshtatjes së bazuar në mjedis për aftësitë ripërtëritëse të sektorit të transportit: Përmirësimi i infrastrukturës përmes përshtatjes së bazuar në natyrë dhe ekosisteme	MIE – Infrastruktura e transportit, Bashkitë																		
65	Politikat e transportit për aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Përfshirja e përshtatjes ndaj klimës në kuadrin rregullator	MIE – Infrastruktura e transportit, Bashkitë																		
66	Partneritete novatore për transport të qëndrueshëm: Financimi për infrastrukturën e transportit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës	MIE – Infrastruktura e transportit																		

6.4 Kostot e parashikuara për planin e zbatimit

Në total, do të nevojiten rreth 9.8 miliardë dollarë amerikanë për zbatimin e 66 ndërhyrjeve për përshtatje, siç përcaktohet përmes analizës së detajuar të kostos (shihni tabela 10 më sipër për koston e përllogaritur për çdo masë). Këto kosto janë shpërndarë midis masave ndërsektoriale dhe sektoriale të planifikuara në këtë plan zbatimi të NAP-it, siç paraqitet në tabelën më poshtë, në rend zbritës të koston:

Tabela 12: Totali i masave dhe kostove për sektor.

Sektori	Nr. i masave	% e masave	Kostoja (dollarë amerikanë)	% e koston
Zhvillimi urban	9	13%	2.723.161.544	28%
Pylltari	13	20%	2.134.799.556	21%
Transporti	7	11%	2.038.835.000	21%
Energjia	8	12%	1.960.573.000	20%
Bujqësia	9	13%	678.114.861	7%
Ndërsektoriale	10	15%	256.721.396	2%
Turizmi	11	16%	8.491.619	1%
GJITHSEJ	66	100	9.800.696.976	100

Nga tabela 10 mund të shohim se zhvillimi urban ka koston më të lartë të përllogaritur (me 9 masa), i ndjekur nga pylltaria (13 masa) dhe transporti (7 masa), ndërsa turizmi ka koston më të ulët të përllogaritur me 11 masa.

Gjatë përllogaritjes së koston së përgjithshme për secilin lloj ndërhyrjeje (shihni tabela 13), mund të vihet re se ndërhyrjet “e gjelbra” përbëjnë pjesën më të madhe të kostove të NAP-it (45%) me 15 masa. Kjo thekson rëndësinë që u jepet qasjeve me zgjidhje të bazuara në natyrë për të trajtuar cenueshmëritë në vend. Megjithatë, masat “gri” të ndërhyrjes kanë më shumë kosto, pasi vetëm për 6 masa nevojitet 23% e buxhetit të përgjithshëm të NAP-it dhe janë të përqendruara specifikisht në sektorët e energjisë (mbrojtja e infrastrukturës nga ndryshimet klimatike) dhe bujqësisë (përforsimi i infrastrukturës bujqësore dhe të kullimit)¹²⁶. Në fund, për ndërhyrjet “e buta” u nevojit rreth 32% e kostove totale, por paraqesin numrin më të lartë të masave: 45, gjë që tregon se normalisht ky lloj ndërhyrjesh kërkon më pak burime, të përqendruara në veprime të tilla si forcimi i kapaciteteve, krijimi i një kuadri të fortë politikash dhe rregullator, ose krijimi i mekanizmave të rinj të koordinimit.

¹²⁶ Vlen të përmendet se disa nga kostot e infrastrukturës gri të sektorëve të turizmit dhe zhvillimit urban mbeten ende për t'u konfirmuar, pasi duhet të përcaktohet infrastruktura e synuar që do të adresohet.

Tabela 13: Nevojat e vlerësuara për buxhet sipas llojit të ndërhyrjes.

Lloji i ndërhyrjes	Kostot e përlogaritura (dollarë amerikanë)	Kostot e përlogaritura (%)	Nr. i masave të përshtatjes	Masat e përshtatjes (%)
Ndërhyrja e gjelbër	4.410.400.115	45%	15	23%
Ndërhyrje e butë	3.152.953.700	32%	45	68%
Ndërhyrje gri	2.237.343.161	23%	6	9%
Totali i përlogaritur	9.800.696.976	100%	66	100%

Sa i përket kohës, pra kohës së fillimit të zbatimit të masës së përshtatjes, angazhimet buxhetore dhe shpenzimet aktuale buxhetore janë siç tregohen në tabelën më poshtë:

Tabela 14: Buxheti i përlogaritur sipas afatit.

Periudha kohore	Planifikimi/angazhimet e buxhetit		Propozimi për përlogaritjen vjetore të buxhetit (disbursimet)	
	Buxheti i përlogaritur për datën e fillimit të masës (dollarë amerikanë)	Numri i masave	Disbursimet e përlogaritura (dollarë amerikan)	% e buxhetit të përgjithshëm
Afatgjatë (2033–2036)	3.017.008.804	10	6,649,179,967 (disbursimet përfundojnë në vitin 2042)	68%
Afatmesme (2029–2032)	3.637.373.692	18	2.609.730.508	27%
Afatshkurtër (2026–2028)	3.146.314.481	38	541.786.502	6%
Totali i përlogaritur	9.800.696.977	66	9.800.696.977	100%

Tabela 14 paraqet ndarjet e përlogaritura të buxhetit dhe shpenzimet aktuale për periudhën 2026–2036. Ndonëse angazhimet buxhetore janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë periudhës dhjetëvjeçare të planit, shumica e veprimeve afatshkurtra (2026–2028) fillojnë herët sepse ato përfshijnë “masa të buta”, ndërhyrje që janë më të lehta për t’u përgatitur, janë më pak të kushtueshme dhe ndihmojnë në uljen e shpejtë të cenueshmërisë në të gjithë sektorët.

Ndërsa **projektet “e gjelbra” dhe “gri” të infrastrukturës** në përgjithësi fillojnë më vonë (janë afatmesme dhe afatgjata) për shkak të përgatitjes së tyre më të gjatë dhe nevojave më të larta për burime.

Gjithashtu, në tabelë merret parasysh koha e shpërndarjes së buxhetit, e cila mund të shtrihet përtej periudhës zyrtare të Planit, pasi shumë masa zgjasin nga 2 deri në 10 vjet. Për shembull, për një projekt që fillon në vitin 2028 dhe zgjat dhjetë vjet fondet miratohen herët, por disbursimet shpërndahen nga periudha e hershme, e mesme dhe e vonë, deri në vitin 2042, kur pritet të përfundojnë projektet përfundimtare. Pas vitit 2036, nuk fillon asnjë masë e re dhe ky është fundi i ciklit të planifikimit.

Sa i përket totalit të **disbursimeve**, ato shpërndahen në kohë si më poshtë:

- **Periudha afatgjatë: 68% e fondeve të përgjithshme** (≈ 6.65 miliardë dollarë amerikanë), që mbulojnë projekte që kanë filluar ose që vijojnë në këtë fazë;
- **Periudha afatmesme: 27% e fondeve të përgjithshme** (≈ 2.61 miliardë dollarë amerikanë), duke mbështetur shkallëzimin e përpjekjeve të përshtatjes;
- **Periudha afatshkurtër: 6% e fondeve të përgjithshme** (≈ 541.79 milionë dollarë amerikanë), duke paraqitur një fillim me faza të përqendruar në veprime të shpejta dhe themelore.

Në përgjithësi, strategjia buxhetore ndjek një qasje graduale dhe me faza, duke u dhënë përparësi masave të buta të ngutshme, ndërkohë që siguron investime të qëndrueshme në nisma më të mëdha dhe afatgjata të përshtatjes.

Kapitulli 9 ofron më shumë detaje mbi nevojat përkatëse financiare dhe qasjet e përshtatshme të financimit. Informacione të mëtejshme mbi analizën e kostos janë të disponueshme në dokumentin e veçantë të planit të zbatimit.

7. INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE

Përgjegjshmëria gjinore është parim thelbësor i proceseve të NAP-it, siç theksohet edhe nga UNFCCC-ja. Marrëveshja e Parisit pranon shprehimisht se veprimet e përshtatjes duhet të jenë të përgjigjshme gjinore, ndërsa Kuadri i Objektivit Global për Përshtatjen (GGA) kërkon Plane Kombëtare të Përshtatjes të udhëhequra nga vendi, të përgjigjshme gjinore, me pjesëmarrje dhe transparente deri në vitin 2030. Integrimi i perspektivës gjinore në NAP është thelbësor, pasi gratë dhe burrat i përjetojnë ndryshe ndikimet e ndryshimeve klimatike për shkak të pabarazive ekzistuese sociale, ekonomike dhe kulturore. PNNK-ja mbështet faktin se ndryshimet në kapacitetet e përshtatjes midis burrave dhe grave vijnë nga pabarazitë e ndërlikuara sociale, mjedisore, ekonomike dhe kulturore. Kjo gjë është thelbësore për zhvillimin dhe zbatimin e veprimeve të përshtatjes ndaj klimës, që janë vërtet të efektshme dhe gjithëpërfshirëse. Veprimet që nuk i marrin parasysh këto aspekte gjinore rrezikojnë të jenë joefektive dhe mund të përkeqësojnë pabarazitë ekzistuese. **Në thelb, miratimi i një qasjeje të përgjigjshme gjinore për përshtatjen ndaj klimës nuk është vetëm çështje barazie dhe drejtësie sociale, por është me rëndësi edhe për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe me aftësi ripërtëritëse përballë një klime në ndryshim.**

Procesi i NAP-it në Shqipëri përdori një qasje të strukturuar dhe me faza ndaj integrimit të perspektivës gjinore. Një Plan Veprimi për Barazinë Gjinore (PVBGJ)¹²⁷ u hartua nëpërmjet konsultimit me ekspertë, duke siguruar që nevojat dhe perspektivat e grave do të integroheshin gjatë gjithë procesit. PVBGJ-ja trajton aspektet gjinore të ndryshimeve klimatike në pesë sektorët prioritarë dhe ofron një kuadër gjithëpërfshirës për integrimin e konsideratave gjinore në përpjekjet për përshtatje ndaj klimës, duke pranuar se ndikimet e ndryshimeve klimatike i prekin ndryshe gratë dhe burrat. Nga analiza e kryer u identifikuan mangësi të konsiderueshme në aspektin gjinor në të gjithë sektorët, ku gratë përballen me sfida të pabarabarta sa i përket qasjes në burime, pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes dhe përmirësimit të aftësive ripërtëritëse ndaj ndikimeve klimatike.

Objektivat e PVBGJ-së për NAP-in janë:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave në kontekstin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në pesë sektorë prioritarë;
2. Ofrimi i një kuadri gjithëpërfshirës për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e nismave të përgjigjshme gjinore për përshtatjen;
3. Identifikimi dhe adresimi i pabarazive gjinore specifike për sektorin dhe cenueshmërive diferenciale në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
4. Përafrimi i përpjekjeve të Shqipërisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike me praktikën më të mira ndërkombëtare për integrimin e perspektivës gjinore.

Zbatimi i PVBGJ-së si pjesë e NAP-it në Shqipëri do të krijojë strategji më gjithëpërfshirëse, të efektshme dhe të barabarta për përshtatjen ndaj klimës, që adresojnë nevojat dhe cenueshmëritë specifike si të grave, ashtu edhe të burrave. Kjo qasje jo vetëm që përmirëson aftësitë ripërtëritëse të vendit ndaj ndryshimeve klimatike, por kontribuon edhe në qëllimet më të gjera të barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

PVBGJ-ja është e bashkërenduar me një sërë strategjish kombëtare kryesore dhe angazhimesh ndërkombëtare, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ 2021–2030), strategjitë e posaçme për sektorët, Marrëveshjen e Parisit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe mbështet zbatimin e tyre. PVBGJ-ja është një dokument në zhvillim, që u nënshtrohet rishikimit dhe përditësimeve të rregullta ndërkohë që edhe NAP-i evoluon. Ajo përfshin rekomandime për objektiva dhe tregues specifike gjinore për të lehtësuar monitorimin dhe vlerësimin e përgjigjshmërisë gjinore në zbatimin e NAP-it.

¹²⁷ Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore për PKP-në. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

7.1 Sfidat e barazisë gjinore në të gjithë sektorët e NAP-it

Nga analiza e kryer u identifikuan mangësi të konsiderueshme në aspektin gjinor në të gjithë sektorët, ku gratë përballen me sfida të pabarabarta sa i përket qasjes në burime, pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes dhe përmirësimit të aftësive ripërtëritëse ndaj ndikimeve klimatike.

Në **sektorin e bujqësisë**, që kontribuon me 18.6% në PBB-në e Shqipërisë, janë punësuar 440.872 persona (33.9% e punësimit të përgjithshëm), ku gratë përbëjnë 54.4% (239.775 punonjës) krahasuar me burrat me 45.6% (201.097 punonjës). Sektori përballlet me cenueshmëri specifike klimatike, duke përfshirë përmytjet, thatësit, regjimet e parregullta të reshjeve, rënien e prodhimitarisë së kulturave dhe rritjen e shpërthimeve të dëmtuesve. Gratë preken në veçanti për shkak të përfshirjes së tyre në detyra të ndjeshme ndaj klimës, si bujqësia në shkallë të vogël dhe përpunimi pas korrisjes. Gratë përballen me sfida sistematike, duke përfshirë qasjen e kufizuar në dokumentet e pronësisë për tokën, qasjen e kufizuar në hua bujqësore për shkak të mungesës së kolateralit, pjesëmarrjen e ulët të grave në shërbimet e ekstensionit bujqësor (vetëm 8%) dhe pjesëmarrjen e ulët në arsimin profesional bujqësor (16%). Edhe pse përbëjnë shumicën e punonjësve në bujqësi, kontributet e grave kryesisht nuk njihen dhe nënvlerësohen, ku vetëm 10.8% e fermerëve të regjistruar zyrtarisht janë gra (afërsisht 25.896 gra fermere nga totali i të regjistruarve). Efektiviteti në rënie i skemave kombëtare të mbështetjes për gratë (nga 22% në vitin 2018 në 16% në vitin 2023, që përfaqëson një rënie nga afërsisht 52.750 në 38.364 përfituese) i përkeqëson më tej këto probleme.

Në **sektori i turizmit** janë punësuar 42.698 persona sipas Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2024-2030. Ndonëse të dhënat gjinore specifike për turizmin nuk janë të disponueshme në strategji, të dhënat e INSTAT-it për vitin 2022 tregojnë se kategoria më e gjerë e “Tregtisë, Transportit, Akomodimit dhe Ushqimit dhe Shërbimeve të Biznesit dhe Administratës”, punëson 22.5% të fuqisë punëtore femërore në nivel kombëtar dhe 30.9% të fuqisë punëtore mashkullore. Gratë janë më të prekura nga ndryshimet klimatike në këtë sektor, sepse puna e tyre është përqendruar në pozicionet më të cenueshme nga klima, puna sezonale, punësimi informal dhe rolet e orientuara drejt shërbimeve. Gjatë ngjarjeve ekstreme të motit ose ndryshime në regjimet e turizmit, punonjëset gra janë shpesh të parat që humbasin të ardhurat ose punësimin për shkak të statusit të tyre të pasigurt të punësimit dhe qasjes së kufizuar në mundësi alternative ekonomike. Sfidat specifike me të cilat përballen përfshijnë mbizotërimin në punësimin sezonal dhe informal pa siguri në punë, nënpërfaqësimin në rolet drejtuese dhe vendimmarrëse ku formulohen strategjitë e përshtatjes, qasjen e kufizuar në pozicione menaxheriale, më pak mundësi për zhvillim profesional, përgjegjësitë tradicionale të kujdesit familjar, pengesat për sipërmarrjen në turizmin e qëndrueshëm dhe mungesën e të dhënave specifike për gjininë në sektorin e turizmit për hartimin efektiv të politikave.

Zhvillimi urban tregon pabarazi të konsiderueshme gjinore, me sektorin e ndërtimit që punëson 98.179 punonjës, ku burrat përbëjnë 96,3% (94.593 punonjës) krahasuar me gratë me vetëm 3,7% (3.586 punëtorë). Sektori përballlet me sfida specifike, përfshirë përkeqësimin e cilësisë së ajrit nga emetimet bujqësore dhe industriale, ndotjen nga plehurat e azotit që ndikojnë si në cilësinë e ujit, ashtu edhe të ajrit, si dhe ndikimet e teknikave të prerjes dhe djegies së drurëve. Gratë përballen me sfida të pabarabarta, përfshirë infrastrukturën e papërshtatshme, veçanërisht në zonat periferike ku 63% e grave raportojnë kanalizime të pamjaftueshme, zë të kufizuar në proceset e planifikimit urban, shqetësime për sigurinë në hapësirat publike, përgjegjësi të rritura të kujdesit (duke u rritur nga 75% në 79% gjatë krizave, duke prekur rreth 23.908 gra të tjera), nënpërfaqësim në rolet vendimmarrëse dhe qasje të kufizuar në burime në ekonomitë informale urbane.

Sektori i energjisë ka 35.508 punonjës, me pabarazi të konsiderueshme gjinore ku burrat përbëjnë 84,9% (30.129 punëtorë) krahasuar me gratë me 15,1% (5.379 punëtorë). Gratë

përballen me ndikime të pabarabarta për shkak të rolit të tyre kryesor në menaxhimin e energjisë në familje, pavarësisht ndikimit të kufizuar mbi politikat e energjisë. Varfëria energjetike prek veçanërisht familjet me kryefamiljare gra, me kostot e shërbimeve që konsumojnë deri në 17% të shpenzimeve të tyre. Sfidat strukturore të sektorit përfshijnë: një hendek gjinor në paga prej 8,2%, mungesën e të dhënave të ndara sipas gjinisë nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) dhe nënpërfaqësimin e grave në pozicione teknike dhe drejtuese. Mbështetja prej 98% e sektorit të energjia hidroelektrike e thekson ndjeshmërinë ndaj klimës, duke ndikuar veçanërisht në qasjen në energji dhe përballueshmërinë për familjet me kryefamiljare gra dhe familjet me një prind të vetëm. Kjo ndërthurje e varfërisë energjetike, cenueshmërisë klimatike dhe pabarazisë gjinore krijon sfida të ndërlikuara për kapacitetet e përshtatjes.

Sektori i transportit tregon pabarazi të theksuara gjinore, ku burrat përfaqësojnë 91,9% dhe gratë 8,1% të fuqisë punëtore. Cenueshmëria e grave ndaj ndikimeve klimatike rritet nga përdorimi mbizotërues i transportit publik (60%). Sfidat specifike gjinore përfshijnë opsione të kufizuara të transportit rural që ndikojnë në qasjen në shërbimet thelbësore dhe rritje të cenueshmërisë nga ngjarjet ekstreme të motit për shkak të varësisë nga transporti publik. Nënpërfaqësimi i grave në pozicione vendimmarrëse i përkeqëson këto cenueshmëri duke kufizuar zhvillimin e infrastrukturës së përgjigjshme gjinore dhe planifikimin e përshtatjes. Strategjitë e sektorit për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike kërkojnë vëmendje të veçantë ndaj modeleve të lëvizshmërisë së grave dhe kërkesave të sigurisë, veçanërisht gjatë ngjarjeve ekstreme të motit.

7.2 Veprimet për barazinë gjinore

Për secilin sektor, Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore plotëson listën e 66 masave të përshtatjes të prioritetuara për NAP-in, duke përfshirë rekomandime dhe konsiderata specifike për të përfshirë elementet gjinore në hartimin dhe zbatimin e NAP-it. Kjo qasje siguron se:

- Konsideratat gjinore janë përfshirë në kuadrin parësor të përshtatjes ndaj klimës në Shqipëri.

- Zbatimi mbetet në përputhje me prioritetet e përgjithshme kombëtare të përshtatjes.

- Burimet përdoren në mënyrë efikase duke u mbështetur në veprimet e planifikuara ekzistuese.

Veprimi i përgjigjshëm gjinor për të plotësuar masat e përshtatjes të NAP-it synon të:

- Rrisë pjesëmarrjen e grave në proceset e vendimmarrjes që lidhen me përshtatjen ndaj klimës.

- Shtojë qasjen e grave në burime, teknologji dhe informacion të nevojshëm për aftësi ripërtëritëse ndaj klimës.

- Adresojë cenueshmëritë specifike gjinore ndaj ndikimeve klimatike.

- Promovojë lidhshmërinë e grave në nismat për aftësi ripërtëritëse ndaj klimës.

- Sigurojë që përfitimet e përshtatjes të shpërndahen në mënyrë të barabartë.

PVBGJ-ja përshkruan masa **ndërsektoriale** gjinore që shtrihen në të gjitha fushat e përshtatjes. Këto masa krijojnë kushtet e nevojshme për zbatim efektiv dhe gjithëpërfshirës, duke siguruar që barazia gjinore të jetë e integruar vazhdimisht në qeverisje, ngritje kapacitetesh, mbledhjen e të dhënave, financa dhe menaxhim të riskut nga fatkeqësitë. Këtë qasje ndërsektoriale e paraqesin prioritetet e mëposhtme:

- **Qeverisja gjithëpërfshirëse:** Të garantohet **përfaqësimi i balancuar i grave dhe burrave** në Grupin Ndërministror të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) dhe në të gjitha Grupet sektoriale Teknike të Punës (GTP). Të caktohen **pika fokale për çështjet gjinore** në ministritë dhe agjencitë kryesore për të këshilluar dhe monitoruar barazinë gjinore në veprimet e përshtatjes;

- **Zhvillimi i kapaciteteve:** Të ofrohen trajnime mbi gjininë dhe klimën për politikëbërësit, planifikuesit dhe zbatuesit në nivel kombëtar dhe vendor. Të forcohet aftësia e institucioneve për të zbatuar **analizën gjinore, buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe hartimin gjithëpërfshirës të projekteve;**

- **Planifikimi i përgjigjshëm gjinor dhe MVN-ja:** Të zbatohet sistematikisht **analiza gjinore** në të gjitha ciklet e planifikimit të përshtatjes dhe të projektit. Të përdoren **tregues të ndarë sipas seksit** në sistemin e Monitorimit, Vlerësimit dhe të Nxënës (MVN), të gjurmohen pjesëmarrja dhe përfitimet e grave dhe burrave, dhe të sigurohet **buxhetim i përgjigjshëm ndaj gjinisë;**

- **Qasje e barabartë në financa dhe burime:** Të hartohen **mekanizma financimi për përshtatje** (grante, garanci, hua me interes të ulët) për të mbuluar **NMVM-të e drejtuara nga gratë, gratë fermere dhe organizatat e grave.** Të promovohet qasja e grave në titujt e pronësisë për tokën, asetet prodhuese dhe shërbimet këshillimore për të mundësuar rolin e tyre aktiv në përshtatje;

- **Pjesëmarrje domethënëse e shoqërisë civile:** Të përfshihen **organizatat e grave, grupet rinore dhe OSHC-të vendore** në konsultime, hartimin e projekteve dhe monitorim. Të lehtësohen **nismat e përshtatjes të udhëhequra nga komuniteti**, ku si gratë, ashtu edhe burrat mund të udhëheqin dhe të përfitojnë;

- **Menaxhimi me ndjeshmëri gjinore i riskut nga fatkeqësitë:** Të integrohen **sisteme paralajmërimi të hershme që i arrijnë te gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë**, të sigurohen **evakuimi dhe strehimi i sigurt**, si dhe të integrohet **mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore (DHBGJ)** në përgatitjen dhe reagimin ndaj fatkeqësive;

- **Njohuri dhe të dhëna:** Të organizohen **mbledhja, analiza dhe publikimi i të dhënave të ndara sipas seksit dhe moshës** në vlerësimet e riskut klimatik, raportet e monitorimit dhe vlerësimet e politikave. Të mbështetet kërkimi mbi **aspektet gjinore të cënueshmërisë dhe aftësive ripërtëritëse ndaj klimës.**

Përveç kësaj, përfshihen masa specifike për sektorin për të përkthyer konsideratat gjinore në ndërhyrje konkrete në të gjitha fushat prioritare të përshtatjes në Shqipëri:

Ndërsektorial

Nr.	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
1	Institucionalizimi i gjinisë në qeverisjen dhe raportimin e NAP-it (GNPNK dhe Grupet Teknike sektoriale të Punës)	Nënpërfaqësimi i grave në organet vendimmarrëse; rrjedha e kufizuar e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe seksit	Përditësimi i TR-së; kërkesa për ndarjen sipas seksit/moshës/cënueshmërisë në raportet sektoriale; rishikimi vjetor për barazinë gjinore	Gratë në institucione, stafi bashkiak, pikat kombëtare fokale për çështjet gjinore, OSHC-të e udhëhequra nga gratë	# takime të GNPNK-së/GTP-së me agjendë gjinore; % e raporteve sektoriale me të dhëna të ndara sipas seksit; përqindja e masave që raportojnë rezultate me diferenca gjinore	M2 – Optimizimi i koordinimit klimatik (Forcimi i kuadrit të GNPNK-së)
2	Protokolli kombëtar i përgjigjshëm gjinori i monitorimit dhe vlerësimit të përshtatjes	Tregues të fragmentuar; ndarje jokonsistente gjinore	Hartimi i fletëve të referencës për protokollet dhe treguesit; integrimi i SK-së/KC-së dhe verifikimit	Gratë në institucione, pikat fokale gjinore, OSHC-të kombëtare	# tregues me ndarje sipas seksit/moshës; # fleta reference të plotësuara për treguesit; % e masave sektoriale me tregues të përgjigjshëm gjinorë	M9 - Promovimi i monitorimit dhe trajnimit me ndjeshmëri gjinore për përshtatjen klimatike
3	Mundësi për qasje në financimin të përgjigjshëm gjinor për ndryshimet klimatike	Qasje e kufizuar në financimin për përshtatje për NMVM-të dhe OSHC-të e drejtuara nga gratë	Grante/garanci të vogla për projektet pilot të përshtatjes	NMVM-të në pronësi të grave, gratë sipërmarrëse, grupet e grave në zonat rurale, familjet në nevojë, OSHC-	# i organizatave të financuara të drejtuara nga gratë; % e portofolit që shkon për projekte të udhëhequra nga gratë; % e projekteve të mbështetura për më	M7 - Mekanizmat novatorë të financimit për klimën

Nr.	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
				të e drejtuara nga gratë	shumë se 24 muaj	
4	Protokolle MRF-je dhe emergjence me ndjeshmëri gjinore	Ndikime disproporcionale të gratë në raste fatkeqësish; DHBGJ dhe risqet e sigurisë	Standardizimi i komunikimeve të riskut, strehët e sigurta, sistemet e ankesave dhe referimeve	Familje me kryefamiljare gra, punonjëse informale gra, gra dhe vajza të cënueshme, grupe vendase grash	# bashki që miratojnë protokollin; # strehë që përmbushin standardet gjinore; % e grave që raportojnë qasje të sigurt gjatë emergjencave	M10 – Edukimi i komuniteteve dhe forcimi i ndërgjegjësimit për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë

Bujqësia dhe pylltaria

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
1	Qasje e barabartë në tokë, hua dhe shërbime ekstensionit	Pronësi e kufizuar e tokës dhe hua bujqësore; shtrirje e ulët e shërbimeve të ekstensionit për gratë	Ndihmë ligjore për titujt e pronësisë; agrofinancimi i përshtatur sipas gjinisë; objektivi prej 40% për shërbime ekstensionit për gratë	Gratë fermere dhe gratë në zona rurale; NMVM-të bujqësore në pronësi të grave	# gra me tituj pronësie mbi tokën; # gra që përfitojnë nga huat bujqësore të personalizuara; % e grave në shërbimet e ekstensionit; % që miratojnë praktikatat e BMK-së	M11 dhe M12 – Mbështetja e fermerëve dhe rimëkëmbja nga fatkeqësitë; M17 – Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të ujitjes; M15 – Zbatimi i krijimit të habitatit dhe ZBN-ve për të luftuar erozionin e tokës
2	Bursa dhe AFPT i sigurt për bujqësi inteligjente ndaj klimës që siguron pjesëmarrjen e grave	Nënpërfaqësimi i vajzave dhe të rejave në trajnimin bujqësor	Bursa studimi; mjedise të sigurta mësimore; kurrikula inteligjente ndaj klimës	Vajzat dhe të rejat në AFPT bujqësore dhe universitete	# bursa të dhëna për vajzat; % e të diplomuarave femra në programet e BMK-së; % e të diplomuarave të punësuar në vende pune inteligjente për klimën	M17 – Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të ujitjes (elementi i ngritjes së kapaciteteve)
3	Grupet e prodhuesve dhe kooperativat e udhëhequra nga gratë për ZBN	Përjashtimi nga lidershipi dhe tregjet	Mbështetja e kooperativave të drejtuara nga gratë; lidhja me ujitjen, farat rezistente ndaj thatësirës dhe shërbimet hidrometeorologjike.	Gratë fermere, gratë sipërmarrëse në bujqësi, gratë në OSHC-të vendore	# kooperativa të drejtuara nga gratë; % e grave në pozicione drejtuese; ndryshimi i rendimentit në parcelat e menaxhuara nga gratë	M14 – Mbrojtje nga përmbytjet (brigjet e lumenjve/fushat aluvionale); M15 – Zgjidhje të bazuara në natyrë kundër erozionit
4	Punë të orientuara drejt gjinisë në fidanishtet pyjore dhe pyllëzime	Pjesëmarrje e ulët e grave në zinxhirët e vlerave të pylltarisë	Vendosja e kuotave dhe orare fleksible për gratë në fidanishte; trajnim për lidership	Gratë në zonat rurale, NMVM-të në pronësi të grave, gratë që punojnë në pylltari	# gra të trajnuara/të punësuar; % e grave në menaxhimin e fidanishteve; shkalla e mbijetesës së fidanëve 12–24 milionë	M23–M31 – Masat Pyjore (Fidanishte rajonale për llojet e pemëve vendase rezistente ndaj thatësirës, migrimi i asistuar i specieve, zonat buferike dhe restaurimi)

Turizmi

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
1	Planifikimi hapësinor i riskut klimatik me këndvështrim gjinor	Gratë e caktuara në punë bregdetare/sezonale me risk të lartë; përfaqësim i pamjaftueshëm në planifikim	Integrimi i të dhënave të riskut dhe gjinisë; ridrejtimi i aseteve të reja nga zonat e riskut; kërkesa për pjesëmarrjen e grave	Punonjëse gra në turizëm, sipërmarrëse gra, planifikuese vendore dhe OSHC	# plane bashkiake që marrin parasysh gjininë; # leje me klauzola përshtatjeje dhe sigurie; % e grave që raportojnë qasje më të sigurt	M32 - Planifikimi hapësinor strategjik për turizmin;
2	Stimuj të dedikuar për mbrojtjen nga ndryshimet klimatike të	Mangësitë në financa dhe të dhëna për bizneset turistike të grave	Grante/hua për hijesim, kullim, eficiencë të ujit; kritere të qasjes gjinore	NMVM-të e turizmit në pronësi të grave;	# i NMVM-ve të drejtuara nga gratë, të përmirësuara; % e objekteve që	M33 – Incentiva për mbrojtje nga ndryshimet klimatike; M36 - Forcimi i

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
	NMVM-ve të drejtuara nga gratë			punonjëset sezonale gra	përbushin listën e kontrollit të mbrojtjes nga ndryshimet klimatike; vijimësia e të ardhurave pas ngjarjeve klimatike	kuadrit politik dhe rregullator për turizmin e qëndrueshëm
3	Veprime të bazuara në të dhëna: trajnime dhe qendra digjitale për gratë	Pak gra në menaxhim; qasje e kufizuar në të dhëna klimatike/mentorim	Udhëzime praktike, rrjete të mësimi elektronik dhe mentorimit për gratë	Gra sipërmarrëse, staf me femra në turizëm, menaxhere gra	# gra të trajnuara/të mentoruara; % e grave në role menaxheriale; moduli i të dhënave klimatike të turizmit është funksional	M37 – Integrimi i të dhënave klimatike; M40 - Ngritja e kapaciteteve të operatorëve me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike

Zhvillimi urban

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
1	Hapësira publike të sigurta ndaj të nxehtit dhe me ndjeshmëri gjinore	Stresi nga i nxehti; shqetësimet për sigurinë; role të rënda kujdesi	Pemë/hije, dhoma ftohjeje, ndriçim/kanalizime të sigurta	Familje me kryefamiljare gra dhe familje të cënueshme; pika fokale për gratë në bashki	# hapësira të përshtatura; % e grave që raportojnë rehati/siguri të shtuar; ulje e incidenteve të lidhura me të nxehtin	M46 - Integrimi i hapësirave të gjelbra në zhvillimin e infrastrukturës publike përmes prokurimit publik të gjelbër M47 - Restaurimet e korridoreve të gjelbra: nisma për ripyllëzim dhe gjelbërim urban M50 - Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit
2	Menaxhimi gjithëpërfshirës i riskut nga përmytjet në komunitet	Familjet me kryefamiljare femra janë shumë të ekspozuara	Grupe të udhëhequra nga gratë për përgatitje, simulime, kujdes për ligatinat/brigjet e lumenjve	Familje me kryefamiljare gra dhe familje të cënueshme; shoqata vendore të grave	# komunitete të prekura; % e grave në simulime; reduktim i kohës së evakuimit (sipas gjinisë)	M49- Planet e emergjencës në raste përmytjesh M50 - Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit M51 - Projektim i qëndrueshëm urban: ruajtja dhe restaurimi i zonave të përshkueshme dhe të infiltrimit
3	Gratë në planifikimin e përshtatjes së qytetit	Nënpërfaqësim në planifikimin vendor	Vende të rezervuara dhe mentorim për gratë dhe OSHC-të	Stafi bashkiak gra; OSHC-të e drejtuara nga gratë	Politika e kuotave e miratuar; % e takimeve planifikuese me ≥40% gra; # plane që pasqyrojnë nevojat e grave	Ndërsektoriale
4	Mbështetje për strehim të qëndrueshëm për gratë	Cënueshmëria e familjeve me kryefamiljare femra dhe të ulëta	Grante/kuponë për hidroizolim, ventilim, mbrojtje nga përmytjet	Familje me kryefamiljare femra dhe me të ardhura të ulëta	# familje të mbështetura me kryefamiljare femra; % ulje e humbjeve; rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj përmytjeve/përmirësimi i energjisë	M45 - Skemat e incentiveve për të rritur aftësitë ripërtëritëse të ndërtesave ndaj temperaturave ekstreme M48 - Vlerësimi i riskut klimatik për

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
						Durrësin, Elbasanin, Fierin dhe më gjerë: Krijimi i një harte gjithëpërfshirëse të cenueshmërisë

Energjia

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
1	Lehtësimi i synuar i varfërisë energjetike për gratë	Varfëria energjetike në familjet me kryefamiljare gra	Lehtësim tarifash dhe pajisje efikase	Familje me kryefamiljare femra dhe me të ardhura të ulëta	# familje të mbështetura; % ulje e ngarkesës së energjisë	Ndërsektoriale
2	Trajnimi dhe punësimi i grave në OM-të e burimeve të rinovueshme	Pjesëmarrje e ulët e grave në punët teknike të energjisë	Kurse dhe praktika profesionale të shkurtra me shërbime/BRE	Vajzat dhe të rejat në STEM/AFPT; profesioniste gra	# gra të trajnuara; % e grave në vende pune në OM; mbajtja në punë ≥12 muaj	Ndërsektoriale
3	Financim për PV dhe EE për NMVM-të e grave	Kapitali i kufizuar për investimet në energji të udhëhequra nga gratë	Grante/hua dhe AT për PV dhe EE	NMVM-të në pronësi të grave	# NMVM të drejtuara nga gratë që përdorin PV/EE; % ulje e kostos së energjisë; vijimi i gjatë goditjeve	M56 - Rritja e aftësisë ripërtëritëse ndaj valës së të nxehtit përmes vendosjes efikase të teknologjisë së kondicionimit të ajrit dhe strehimeve për mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike M58 - Optimizimi i energjisë së rinovueshme për sisteme me aftësi ripërtëritëse: Investime në inovacionin e rrjetit dhe magazinimin
4	Të dhëna të detyrueshme të energjisë të ndara sipas seksit	Mungesa e të dhënave të energjisë sipas gjinisë	Kërkesa nga shoqëritë dhe ERE për të publikuar të dhëna gjinore	Gratë në institucione, analiste gjinore, OSHC-të	Lëshimi i autorizimit për raportim; # grupe të dhënash të publikuara; # politika të informuara	Ndërsektoriale

Transporti

Nr.	Veprimi	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e NAP-it
1	Transport publik i sigurt ndaj klimës për gratë	Shqetësime për sigurinë, ekspozimi ndaj të nxehtit/përmbajtjeve	Hijesim, ndriçim, butona emergjence; rrugë emergjence	Punonjëset gra që mbështeten në transportin publik; udhëtarët femra të cenueshme	# qendra transporti të rimodeluara; % e grave që raportojnë qasje më të sigurt; reduktim i kohës së udhëtimit gjatë risqeve	Ndërsektoriale
2	Gratë në planifikimin dhe operacionet e transportit	Nënpërfaqësim në bordet sektoriale	Kuota dhe mentorim për gratë në planifikim dhe operacione	Planifikueset gra, stafi bashkiak, OSHC-të	# gratë në komisione; % e planeve me analizë të lëvizshmërisë gjinore	Ndërsektoriale
3	Projektet pilot të lëvizshmërisë dhe qasjes së grave në zonat rurale	Mundësi të kufizuara të transportit rural	Shërbime që i përgjigjen kërkesës, ecje/çiklizëm i sigurt drejt shërbimeve dhe tregjeve	Gratë në zonat rurale, gratë dhe vajzat e cenueshme	# programe pilot të vëna në zbatim; # udhëtime thelbësore për gratë; kohë e kursyer.	Ndërsektoriale
4	Financim klimatik i i përgjigjshëm gjinor për transportin	Mangësi në financim për transport me aftësi ripërtëritëse në dobi të grave	PPP/instrumente financimi për të përmirësuar asetet në mënyrë të paanshme	Përdorueset gra, udhëtarët e pambrojtura, sipërmarrëset gra	# instrumente të projektuara; kapital privat i mobilizuar; % e projekteve që përdorin teknologji me ndikim të ulët	M66 - Partneritete novatore për transport të qëndrueshëm

8. KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT

Angazhimi proaktiv i palëve të interesit në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike është thelbësor për ta kthyer përshtatjen në prioritet kombëtar, për të siguruar

mbështetjen dhe për të nxitur vendime dhe veprime kolektive për të arritur aftësi ripërtëritëse afatgjata. Në këtë drejtim, angazhimi me palët kryesore të interesit dhe komunikimi i mesazheve të duhura në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike luan rol kyç për zbatimin me sukses të NAP-it. Për këtë qëllim, si pjesë e procesit të NAP-it, u hartua me kujdes një Plan Komunikimi dhe Angazhimi të Palëve të Interesit (PKAPI) për të forcuar kapacitetet e palëve të interesit me mjete specifike për sektorin, udhëzues komuniteti për udhëheqësit vendorë dhe burime edukative për të ndërtuar njohuri rreth klimës tek të rinjtë. Përmes komunikimit të synuar dhe gjithëpërfshirës, synohet shndërrimi i përshtatjes ndaj klimës nga një kuadër politikash në një lëvizje të pranueshme nga palët e interesit në të gjitha nivelet e shoqërisë, politikëbërësit, institucionet qeveritare, sektori privat, komunitetet vendase, akademja, media, organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) dhe partnerët ndërkombëtarë.

Duke njohur rëndësinë e përfshirjes, **PKAPI thekson angazhimin e grupeve të cënueshme, grave dhe të rinjve si pjesëmarrës aktivë në proceset e përshtatjes ndaj klimës.** Gjithashtu integron nisma për të fuqizuar fëmijët në moshë shkollore, si fushata të udhëhequra nga nxënësit, *workshop*-e dhe projekte ndërvepruese që inkurajojnë praktikant inteligjente ndaj klimës, si mbjellja e pemëve, kursimi i energjisë dhe riciklimi. Përmes nxitjes së angazhimit të të rinjve, strategjia synon të ndërtojë një brez të ri që do të çojë përpara përpjekjet për përshtatje. Mjetet ndërvepruese si *workshop*-et virtuale, platformat e rrëfimit të historive dhe anketat online do të thellojnë angazhimin dhe do të mbledhin vlerësime.

8.1 Objektivat kryesorë të komunikimit dhe angazhimit

Qëllimi kryesor për planin e angazhimit të palëve të interesit është:

Të pozicionohet përshtatja ndaj klimës si prioritet kombëtar në Shqipëri nëpërmjet shfrytëzimit të komunikimit strategjik si një mjet për angazhimin e palëve të interesit, nxitjen e veprimit kolektiv dhe përmirësimin e aftësisë ripërtëritëse afatgjatë në të gjithë sektorët kyç të ekonomisë.

Ky qëllim materializohet në pesë objektiva që do të udhëheqin të gjitha veprimtaritë e komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit të NAP-it:

1. Rritja e ndërgjegjësimit për klimën

Ky objektivi thekson rritjen e ndërgjegjësimit kombëtar për risqet klimatike dhe masat e përshtatjes përmes mesazheve të synuara, fushatave digjitale dhe shtrirjes së aktiviteteve në komunitet. Veprimtaritë do të paraqesin risqet klimatike, do të shfaqin praktikant e suksesshme të përshtatjes dhe do të luftojnë keqinformimin, duke siguruar që publiku i gjerë të njohë rëndësinë e përshtatjes për zhvillimin me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

2. Forcimi i koordinimit institucional

Ky objektivi përqendrohet në krijimin e partneriteteve dhe koordinimit midis institucioneve dhe sektorëve për të siguruar që ministritë, bashkitë dhe agjencitë teknike të kenë njohuritë dhe burimet e nevojshme për të integruar përshtatjen në vendimmarrje. Veprimtaritë do të përfshijnë *workshop*-e, seanca trajnimit dhe konsultime me ekspertë, duke siguruar që vendimmarrësit dhe palët e interesit të kenë qasje në njohuri të besueshme dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të efektshme për prioritetet e përshtatjes.

3. Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në narrativat e politikave

Ky objektivi siguron që politikëbërësit të mbështeten me instrumente komunikimi (të tilla si përmbledhje politikash, dialogë dhe mjete të synuara për advokim), që përfshijnë përshtatjen në planet kombëtare dhe vendore të zhvillimit. Duke lidhur përshtatjen me përfitimet ekonomike dhe sociale, PKAPI-i do të nxisë angazhim më të fortë politik dhe integrimin e prioritetëve klimatike në politika dhe plane.

4. Fuqizimi i zërave të cënueshëm

Ky objektivi promovon përfshirjen duke krijuar mundësi angazhimi në planifikimin e përshtatjes dhe vendimmarrje për grupet e cënueshme. Veprimtaritë do të përfshijnë *workshop*-e të synuara, materiale edukative të përshtatura dhe nisma shkollore, duke u mundësuar grave,

të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara të formësojnë agjendën e Shqipërisë për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike.

5. Vazhdimi i angazhimit dhe dialogut

Ky objektiv thekson rëndësinë e vazhimit të angazhimit me kalimin e kohës. Aktivitetet do të përqendrohen në paraqitjen e arritjeve lidhur me përshtatjen, krijimin e platformave ndërvepruese për ndarjen e njohurive dhe vlerësimet e vazhdueshme, si dhe promovimin e bashkëpunimit me sektorin privat për të siguruar burime dhe për të nxitur veprime të vazhdueshme.

Parimet udhëzuese

Të gjitha veprimtaritë e komunikimit dhe angazhimit në NAP do të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme udhëzuese:

- **Shpërndarja e mesazheve të bazuara në shkencë:** Sigurimi që komunikimi për përshtatjen të bazohet në të dhënat klimatike, vlerësimet e riskut dhe studimet sektoriale, siç përshkruhet në NAP;

- **Angazhimi i shumë palëve të interesit:** Forcimi i bashkëpunimit midis qeverisë, sektorit privat, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë për të përshpejtuar përshtatjen;

- **Lokalizimi i strategjive:** Sigurimi që PVP-të komunikohen dhe zbatohen në mënyrë të efektshme në nivel bashkiak;

- **Përfshirja dhe barazia:** Prioritizimi i qasjeve të përgjigjshme gjinore dhe i vendimmarrjes me pjesëmarrje për të përforcuar zërat e grave, të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara;

- **Transparenca dhe llogaridhënia:** Vendosja e mekanizmave të qartë monitorues për të ndjekur ecurinë e NAP-it, angazhimin publik dhe ndikimin në komunikim.

8.2 Audiencat kryesore

Grupet e synuara të audiencës për PKAPI-në ndahen si më poshtë:

- **Institucionet qeveritare** udhëheqin zbatimin e NAP-it të Shqipërisë duke integruar përshtatjen në politikat sektoriale dhe duke siguruar koherencë ndërmjet veprimeve kombëtare dhe vendore. Ministria e Mjedisit, së bashku me ministritë kryesore të linjës dhe bashkitë, koordinon planifikimin dhe financimin, ndërsa qeveritë vendore i përshtatin masat sipas risqeve rajonale. Këto veprime mbështeten përmes një strategjie komunikimi me anë të dokumenteve të shkurtra të politikave, ngritjes së kapaciteteve dhe raporteve të progresit;

- **Spektori privat** luan rol thelbësor përmes investimeve në teknologjinë inteligjente për klimën dhe PPP-të, të udhëhequra nga fushata ndërgjegjësimi, forume dhe udhërrëfyes investimesh që paraqesin përfitimet ekonomike të përshtatjes;

- **Shoqëria civile** siguron përfshirjen dhe angazhimin e komunitetit, mbështetur nga mjetet, platformat me pjesëmarrje dhe partneritetet mediatike;

- **Akademia** ofron të dhëna dhe kërkime për të orientuar vendimet e bazuara në evidenca, me përpjekje me anë të të cilave synohet që gjetjet të jenë më të arritshme përmes ndarjes së njohurive dhe dialogut mbi politikat;

- **Mediat** mbështesin ndërgjegjësimin dhe llogaridhënien publike nëpërmjet trajnimeve, rrëfimit të historive dhe fushatave për aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës;

- **Partnerët ndërkombëtarë**, përfshirë GCF-në, UNDP-në dhe donatorët dypalësh, ofrojnë financim dhe mbështetje teknike, me bashkëpunim të vazhdueshëm të ruajtur përmes raportimit të progresit dhe dialogut të nivelit të lartë.

Gjithashtu, përshtatja ndaj klimës në Shqipëri duhet t'u japë përparësi grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, si gratë, popullatat rurale dhe komunitetet me të ardhura të ulëta, të cilat përballen me risqet më të mëdha klimatike. Përfshirja e tyre siguron që përpjekjet për përshtatje të jenë të drejta, të përshtatshme për kontekstin vendor dhe të qëndrueshme, duke u mbështetur te njohuritë e vlefshme të komunitetit. NAP-i thekson komunikimin gjithëpërfshirës përmes formateve të qasshmërisë si gjuhët vendase, materialet vizuale dhe

radioja e komunitetit për të nxitur pjesëmarrjen, veçanërisht në zonat rurale. Metodën pjesëmarrëse, si *workshop*-et dhe fokus grupet, krijojnë hapësira që këto grupe të formësojnë vendimet për përshtatje. Adresimi i barrierave si transporti dhe qasshmëria, si dhe promovimi i angazhimit me ndjeshmëri gjinore dhe të përshtatshëm në aspektin kulturor, i fuqizon më tej komunitetet për të marrë pjesë në përmirësimin e aftësive ripërtëritëse ndaj klimës.

8.3 Mesazhet kryesore të komunikimit për NAP-in

Objektivat, parimet udhëzuese dhe audiencat e synuara ndihmuan në hartimin e mesazheve kryesore që duhet të përcillen për të komunikuar siç duhet NAP-in. Këto janë përmbledhur në tabelat më poshtë, duke paraqitur si fillim mesazhet kryesore për NAP-in në vija të përgjithshme dhe më pas mesazhet kyç për sektorët kryesorë prioritarë të përshtatjes. Të dyja tabelat përfshijnë edhe audiencën e synuar për secilin mesazh, dhe mënyrën se si ato lidhen me secilin prej pesë objektivave kryesorë të komunikimit dhe angazhimit:

Tabela 15: Objektivat e komunikimit të NAP-it.

Objektivi i komunikimit	Fushat e fokusit të komunikimit	Mesazhet kryesore	Audienca e synuar
Objektivi 1: Rritja e ndërgjegjësimin për klimën	Përshtatja ndaj klimës si nxitës i rritjes ekonomike të qëndrueshme	- Përshtatja ndaj klimës është thelbësore për mbrojtjen e jetesës, stabilitetin ekonomik dhe trashëgiminë natyrore të Shqipërisë. - Investimi në përshtatje sot siguron një të ardhme të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. - Çdo sektor dhe komunitet luan një rol; veprimet vendore përmirësojnë aftësitë ripërtëritëse kombëtare. - Politikat më të forta të përshtatjes në pesë sektorët prioritarë rrisin konkurrueshmërinë, sigurojnë financim për klimën dhe krijojnë vende pune të gjelbra. - Shndërrimi i përshtatjes në prioritet kombëtar siguron që Shqipëria të përmbushë angazhimet e saj në Marrëveshjen e Parisit dhe OZHQ-të.	Publiku i gjerë, komunitetet vendase dhe të rinjtë, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile.
Objektivi 2: Forcimi i koordinimit institucional	Veprime bashkëpunimi për një të ardhme me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës	- Përshtatja është e suksesshme kur të gjitha institucionet, sektori privat, academia dhe komunitetet punojnë së bashku. - Partneritetet në bujqësi, energji, turizëm, transport dhe planifikim urban sigurojnë që veprimet e përshtatjes të jenë të qëndrueshme dhe të efektshme. - Partneritetet publike-private (PPP) shfrytëzojnë inovacionin dhe financimin për zgjidhjet për përshtatje. - Bujqësia inteligjente në lidhje me klimën rrit sigurinë ushqimore dhe krijon qëndrueshmëri në punë, veçanërisht për gratë në zonat rurale. - Infrastruktura e energjisë, transportit dhe turizmit siguron rritje dhe qëndrueshmëri afatgjatë. - Diversifikimi drejt energjisë së rinovueshme rrit sigurinë afatgjatë të energjisë, duke reduktuar gjurmën e karbonit të Shqipërisë. - Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i njohurive harmonizojnë burimet dhe novacionin për një Shqipëri inteligjente ndaj klimës. - Sektori privat luan rol vendimtar në financimin e zgjidhjeve të përshtatjes.	Politikëbërësit kombëtarë dhe vendorë, autoritetet bashkiake, udhëheqësit e sektorit privat, academia.
Objektivi 3: Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në narrativat e politikave	Përfshirja e përshtatjes ndaj klimës në kuadrot e qeverisjes dhe politikave	- Integrimi i përshtatjes në politikat kombëtare dhe bashkiake siguron zhvillim të qëndrueshëm. - Përshtatja ndaj klimës është investim, jo kosto, përmes së cilës garantohet siguria ekonomike e Shqipërisë. - Risqet klimatike duhet të merren parasysh në të gjitha vendimet e planifikimit dhe financimit. - Vendimet e sotme politike formësojnë aftësitë ripërtëritëse të Shqipërisë së nesërme. - Politikëbërësit luajnë rol vendimtar në sigurimin e financimit për klimën dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. - Udhëheqja e fortë dhe vendimet transparente nxisin politika të qëndrueshme dhe sigurojnë financim ndërkombëtar. - Përshtatja është investim në sigurinë ekonomike, jepini përparësi në vendimet tuaja. - Udhëheqja e fortë nxit politika të qëndrueshme. Bëhuni zëri që mbështet të ardhmen klimatike të Shqipërisë.	Politikëbërës kombëtarë dhe vendorë, udhëheqës të komunitetit me ndikim dhe donatorë. Gazetarët dhe mediat.
Objektivi 4: Fuqizimi i zërave të cënueshëm	Veprim gjithëpërfshirës për klimën: Askush të mos mbetet pas	- Ndryshimi i klimës na prek të gjithëve, por grupet e cënueshme mbajnë barrën më të madhe. Përshtatja duhet të sigurojë që askush të mos mbetet pas. - Zgjidhjet e bazuara në komunitet, të drejtuara në nivel vendor, e bëjnë përshtatjen të efektshme dhe të qëndrueshme. - Investimi në përshtatje përmirëson jetesën, mbron popullatat e cënueshme dhe përmirëson aftësitë ripërtëritëse sociale. - Gratë, të rinjtë dhe komunitetet e marginalizuara duhet të jenë pjesë aktive e vendimmarrjes për klimën. - Përshtatja gjithëpërfshirëse siguron barazi, pjesëmarrje dhe përfitime të ndërsjella	Gratë, të rinjtë, popullatat rurale dhe komunitetet e marginalizuara. Organizatat e shoqërisë civile që punojnë për përfshirjen sociale.

		<i>për të gjithë.</i> - Përshtatja është një proces i vazhdueshëm që kërkon udhëheqje dhe bashkëpunim të qëndrueshëm. - Historitë e suksesit nga PVP-të demonstrojnë ndikimin e përpjekjeve të përshtatjes dhe nxisin replikimin. - Shqipëria po ndërton një të ardhme me aftësi ripërtëritëse; historitë tona të suksesit tregojnë rrugën për të ecur përpara. - Platformat e bashkëpunimit dhe ndarjes së njohurive, si dhe mjetet e komunikimit, mbështesin angazhimin afatgjatë. - Shfaqja e progresit frymëzon të tjerët; së bashku, mund t'i shkallëzojmë këto suksese për një ndikim më të madh. - Përfshirja e sektorit privat është thelbësore për të zgjeruar dhe financuar zgjidhje me aftësi ripërtëritëse	Qeveritë kombëtare dhe bashkiake dhe aktorët e sektorit privat. Mediat dhe institucionet arsimore për të vazhduar ndërgjegjësimin publik.
--	--	--	---

Tabela 16: Mesazhet e komunikimit të NAP-it.

Sektori	Prioritetet e përshtatjes të NAP-it	Mesazhet kryesore	Përfitimet	Përputhja me angazhimet	Audienca e synuar
Bujqësia dhe pylltaria	Bujqësi inteligjente ndaj klimës dhe ujitje efikase	Bujqësi inteligjente ndaj klimës dhe ujitje efikase -Përshtatja ul risqet e thatësirave dhe përmbytjeve, duke siguruar kultura të qëndrueshme për familjet shqiptare. Ujitja efikase dhe ruajtja e dherave mbrojnë ekonominë bujqësore në Shqipëri. Ujitja me eficiencë të lartë uji përmirëson aftësitë ripërtëritëse për fermerët. Investimi në kultura me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës forcon jetesën rurale dhe qëndrueshmërinë afatgjatë. Fuqizimi i grave dhe fermerëve të vegjël për përshtatjen siguron mirëqenien e komunitetit. Për pylltarinë: menaxhimi i zjarreve në peizazh forcon përshtatjen klimatike duke lidhur parandalimin, gatishmërinë dhe restaurimin pas zjarrit me mbrojtjen e pyjeve, kullotave, biodiversitetit dhe mjeteve të jetesës rurale.	- Mbron sigurinë ushqimore dhe ekonomitë rurale. - Ul risqet nga thatësirat dhe moti ekstrem. - Mbështet fermerët e vegjël, veçanërisht gratë. - Zvogëlon riskun nga zjarret në pyje dhe kullota përmes parandalimit dhe menaxhimit të peizazhit. - Forcon sigurinë dhe gatishmërinë e komuniteteve rurale, zonave të mbrojtura dhe strukturave vendore përballë zjarreve. - Mbështet restaurimin ekologjik pas zjarrit dhe ruajtjen e shërbimeve kryesore të ekosistemit.	- OZHQ 2 – (Zero uri) - Angazhimet e Shqipërisë sipas Marrëveshjes së Parisit. - Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.	Fermerët, kooperativat rurale, agrobizneset, politikëbërësit bujqësorë, Institucione, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor.
Energjia	Diversifikimi i burimeve të energjisë dhe rritja e efikasitetit	-Nuk mjafton vetëm energjia hidroelektrike për të përballuar nevojat e ardhshme energjetike të Shqipërisë; diversifikimi është thelbësor. -Energjia e rinovueshme nxit rritje të qëndrueshme dhe vende pune të gjelbra. Investimet në energjinë diellore dhe të erës pakësojnë shkarkimet dhe rrisin sigurinë energjetike. -Eficiencia e energjisë forcon aftësitë ripërtëritëse: veprimet e vogla sot sigurojnë stabilitet nesër. -Diversifikimi ul cenueshmërinë nga thatësira dhe goditjet klimatike.	- Mundëson sigurinë e energjisë afatgjatë. - Ul varësinë nga energjia hidroelektrike dhe cenueshmërinë nga thatësirat. - Krijon vende pune të gjelbra dhe mbështet rritjen me karbon të ulët.	- OZHQ 7 (Energji e përballeshme dhe e pastër) - Strategjia Kombëtare për energjinë e rinovueshme. - Objektivat e UNFCCC-së dhe objektivat për aderimin në BE për ndryshimet klimatike.	Politikëbërësit për energjinë, shoqëritë e shërbimeve, investitorët e energjisë së rinovueshme, bizneset, institucionet financiare.
Turizmi	Infrastrukturë me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe nisma të qëndrueshme	- Përshtatja mbron ekosistemet dhe asetet turistike të Shqipërisë. - Restaurimi dhe ripyllëzimi i bregdetit mbrojnë destinacionet kryesore të Shqipërisë. - Ekoturizmi ruan trashëgiminë natyrore teksa krijon edhe vende pune.	- Mbron zonat bregdetare dhe malore. - Forcon ekonomitë vendore dhe vendet	- OZHQ 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike) - Strategjia	Operatorët turistikë, pronarët e hoteleve, qeveritë vendore, agjencitë ndërkombëtare të turizmit

	të ekoturizmit	- Turizmi inteligjent ndaj klimës rrit reputacionin botëror të Shqipërisë si destinacion i qëndrueshëm. - Turizmi i qëndrueshëm siguron rritje dhe konkurrueshmëri afatgjatë të komunitetit. - Turizmi inteligjent ndaj klimës rrit reputacionin botëror të Shqipërisë si destinacion kryesor të ekoturizmit.	e punës. - Përmirëson profilin e turizmit të qëndrueshëm të Shqipërisë.	Kombëtare për Turizëm të Qëndrueshëm. - Angazhime rajonale për turizëm miqësor me klimën.	
Transporti	Mbrojtja e infrastruktura kritike të transportit nga ndryshimet klimatike dhe promovimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane	- Transporti me aftësi ripërtëritëse e mban Shqipërinë të lidhur dhe pakëson ndërprerjet. - Rrugët dhe urat rezistente ndaj përmbytjeve dhe të nxehtit mbrojnë jetesën dhe tregtinë. - Infrastruktura e qëndrueshme ul kostot afatgjatë të riparimit. - Transporti i qëndrueshëm urban pakëson shkarkimet dhe përmirëson lëvizshmërinë për të gjithë qytetarët. - Investimet inteligjente ndaj klimës në sistemet e transportit mbështesin rritjen ekonomike dhe integrimin në BE.	- Siguron qasje të besueshme në mallra, shërbime dhe tregje. - Ul kostot e riparimit me kalimin e kohës. - Përmirëson lidhjen dhe sigurinë.	- OZHQ 9 (Industri, novacion dhe infrastrukturë) - Mbështet objektivat afatgjatë të përshtatjes të Shqipërisë.	Planifikues të transportit, inxhinierë bashkiakë, zhvillues të infrastrukturës, politikëbërës
Zhvillimi urban	Infrastruktura e gjelbër, menaxhimi i riskut nga përmbytjet dhe planifikimi urban inteligjent ndaj klimës	- Qytetet e gjelbra përmirësojnë cilësinë e ajrit, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e jetës. - Planifikimi inteligjent ndaj klimës ul risqet nga përmbytjet dhe i nxehti. - Përshtatja e udhëhequr nga komuniteti nxit rritjen dhe përgatitjen gjithëpërfshirëse. - Menaxhimi i përmbytjeve në zonat urbane mbron shtëpitë, bizneset dhe infrastrukturën kritike.	- Zvogëlon zonat e të nxehtit urban dhe risqet klimatike. - Mbron banesat dhe infrastrukturën. - Përmirëson aftësitë ripërtëritëse të komunitetit dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive.	- OZHQ 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme). - Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike. - Udhëzimet e BE-së për aftësitë ripërtëritëse urbane.	Planifikues urbanë, arkitektë, udhëheqës bashkiakë, politikëbërës për strehimin, zhvillues privatë.

8.4 Plani i veprimit për komunikim dhe angazhim të palëve të interesit

Mesazhet janë përfshirë në PKAPI-në e NAP-it, të cilat përmbledhen në tabelën 17:

Tabela 17: Plani i komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit.

Veprimtaritë	Treguesit	Synimi	Periudha kohore	Palët përgjegjëse	Buxheti tregues (dollarë amerikanë) ¹²⁸	Potenciali i ndikimit në komunikim
Objekti 1: Rritja e ndërgjegjësimit për klimën						
Të zhvillohen fushata multimediale specifike për sektorin (TV, radio dhe media sociale) duke u përqendruar në përshtatjen ndaj klimës në pesë fusha zhvillimi, përfshirë materiale edukative të përshtatshme për moshën për shkollat fillore dhe të mesme, si dhe organizimin e aktiviteteve komunitare të ndërgjegjësimit	Numri i fushatave Numri i audiencave të arritura	6 fushata (5 për secilin sektor dhe një e përgjithshme) 1.000.000 shikime/dëgjues	Janar 2026 – dhjetor 2028	Ekipi i NAP-it dhe ekspertët e komunikimit dhe shoqëritë mediatike	500.000	Ndërgjegjësim mbarëkombëtar, i përshtatur me sfidat dhe mundësit specifike të sektorit, duke nxitur angazhim në të gjithë Shqipërinë
Të krijohen mjete vizuale (p.sh., infografikë, postera, video) që tregojnë histori suksesi vendase për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në të pesë sektorët kryesorë, duke synuar audiencat më të	Numri i materialeve të krijuara dhe të shpërndara për secilin sektor kyç	5.000 materiale të shpërndara	Maj 2027	Të gjitha palët kyç të interesit	70.000	Të kuptuarit e zgjeruar të praktikave të suksesshme të përshtatjes, duke nxitur replikimin dhe mbështetjen

¹²⁸ Veprimtaritë e komunikimit të PKAPI-së përfshihen në buxhetin e përgjithshëm të PKP-së të përshkruar në seksionet e planit të zbatimit (më sipër) dhe financimit të PKP-së (më poshtë).

reja.						
Të lehtësohen vizitat në terren me gazetarët në rajonet më të prekura nga ndryshimet klimatike, duke u mundësuar të dëshmojnë drejtpërdrejt ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe ta lidhin atë me politikat më të gjera të përshtatjes.	Numri i vizitave në terren Numri i gazetarëve pjesëmarrës	3 vizita në terren 30 gazetarë të angazhuar	Qershor 2026 – dhjetor 2027	Gazetarët Shoqatat e medias; ekspertët e klimës.	80.000	Raportim i përforcuar për klimën, me shtim të historive investigative mbi sfidat dhe përgjigjet e përshtatjes.
Të krijohen përmbajtje mediatike të bazuara në fakte që sfidojnë drejtpërdrejt keqinformimin me evidencë shkencore, duke përfshirë nismat e verifikimit të fakteve në fushatat mediatike.	Numri i artikujve që hedhin poshtë faktet dhe nismat për verifikimin e fakteve Numri i mediave të angazhuara	10 artikuj të publikuar për verifikimin e hollësishëm të fakteve 5 media kryesore të përfshira	Janar 2026 – dhjetor 2028	Gazetarët investigativë; Ekipi i Komunikimit; Institucionet Shkencore.	90.000	Ulje e numrit të keqinformatave rreth klimës, rritja e besueshmërisë së lajmeve që lidhen me klimën.
Të promovohet gazetaria investigative klimatike, ku gazetarët pyesin në mënyrë aktive politikëbërësit dhe kërkojnë llogaridhënie mbi angazhimet për përshtatje.	Numri i historive investigative të publikuara Numri i seancave të trajnimit për gazetarët	8 raporte invstigative të publikuara 4 seanca trajnimi	Qershor 2026 – dhjetor 2028	Institucionet e Trajnimit të Gazetarëve.	150.000	Forcim i pavarësisë së medias në raportimin për klimën, duke sjellë diskutim publik më të informuar.
Objekti 2: Forcimi i koordinimit institucional						
Të zhvillohen <i>workshop</i> -e, trajnime dhe takime shumësektoriale me palët e interesit për bujqësinë, energjinë, transportin dhe turizmin për të përcaktuar rolet e tyre në strategjitë e përshtatjes.	Numri i <i>workshop</i> -eve, trajnimeve etj., sipas sektorit Numri i pjesëmarrësve	25 <i>workshop</i> -e, takime trajnimi etj. 600 pjesëmarrës	Qershor 2026 – qershor 2028	Ministritë Sektoriale; Partnerët e Sektorit Privat	200.000	Të kuptuarit më të qartë të roleve, gjë që sjell strategji përshtatjeje më kohezive përfshirëse.
Të krijohet një grup i posaçëm ekspertësh për klimën, duke u siguruar që gazetarët dhe politikëbërësit të kenë qasje të drejtpërdrejtë në informacion të besueshëm për raportim dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë.	Numri i profileve të ekspertëve të disponueshëm Numri i konsultimeve me ekspertë	1 grup ekspertësh i krijuar 50 konsulta të ofruara	Janar 2026 – dhjetor 2027	Ekspertë të sektorëve UNDP Gazetarët	75.000	Cilësi e përmirësuar e diskutimit për ndryshimet klimatike në media dhe politikëbërje.
Të sigurohet bashkëpunim më i gjerë midis gazetarëve dhe punonjës kërkimor-shkencor të klimës, për t'i bërë të dhënat e ndërlikuara më të arritshme për publikun.	Numri i bashkëpunimeve Numri i raporteve të thjeshtuara të publikuara për klimën	5 <i>workshop</i> -e me gazetarë ekspertë 10 raporte të publikuara për klimën	Prill 2026 – dhjetor 2028	Institucionet kërkimore për klimën Gazetarët UNDP	100.000	Rritje e saktësisë shkencore në lajmet për klimën dhe materialet për ndërgjegjësimin publik.
Të organizohen programe trajnimi për gazetarët me ekspertë të klimës për të ofruar njohuri të specializuara mbi strategjitë e përshtatjes, kuadrot e politikave dhe interpretimin e të dhënave.	Numri i programeve të trajnimit Numri i gazetarëve të trajnuar	4 programe 80 gazetarë të trajnuar	Janar 2026 – dhjetor 2028	Gazetar UNDP Institucione trajnimi; ekspertë të klimës.	180.000	Kapacitet i forcuar për gazetari klimatike me cilësi të lartë.
Të publikohen instrumente mbi praktikatat inteligjente ndaj klimës për bujqësinë dhe turizmin, si dhe infrastrukturën e gjelbër për zhvillimin urban.	Numri i instrumenteve të shpërndara/shkarkuara	5000 kopje 3000 shkarkime	Shkurt 2027	Ekspertë të sektorit; Ekipi i komunikimit	100.000	Udhëzime praktike për palët e interesit, duke nxitur miratimin e masave të përshtatjes.
Objekti 3: Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në narrativat e politikave						
Të hartohen dokumente politikash që theksojnë përfitimet ekonomike nga	Numri i përmbledhjeve të shpërndara të politikave	5 dokumente të shkurtër të ndara me 150	Shkurt 2027 – dhjetor	Ministria e Financave; Ministritë	150.000	Angazhim më i fortë politik për integrimin e

energji e rinovueshme, sistemet me aftësi ripërtëritëse dhe hapësirat e gjelbra urbane.	Vlerësimet e politikëbërësve	politikëbërës	2027	Sektoriale		përshtatjes në politikat kombëtare.
Të organizohen dialogë mbi politikat e nivelit të lartë me palët kryesore të interesit në sektorët e bujqësisë, energjisë dhe transportit.	Numri i dialogëve të mbajtur Rezultatet e politikave	5 dialogë Rekomandimet e politikave të miratuara	Shtator 2027	Ministritë e Sektorit; specialistët e advokimit	100.000	Harmonizim i përsheptuar i politikave me prioritetet e përshtatjes.
Objektivi 4: Fuqizimi i zërave të cënueshëm						
Të lehtësohen <i>workshop</i> -e, takime, trajnime etj., të synuara për gratë dhe të rinjtë mbi bujqësinë inteligjente ndaj klimës, eficientë e energjisë dhe turizmin e qëndrueshëm.	Numri i <i>workshop</i> -eve Numri i pjesëmarrësve	15 <i>workshop</i> -e, takime, aktivitete 300 pjesëmarrës	Janar 2027 – dhjetor 2027	Grupet e grave; udhëheqësit e komuniteteve	75.000	Pjesëmarrje e fuqizuar e grupeve të cënueshme në proceset e përshtatjes.
Të krijohen dhe të shpërndahen materiale edukative të përshtatura për komunitetet dhe shkollat në zonat urbane dhe rurale, me fokus në angazhimin e të rinjve në proceset e përshtatjes. Kjo do të realizohet përmes përmirësimit të sistemeve të të dhënave, duke shfrytëzuar një mundësi të rëndësishme për forcimin e përdorimit të të dhënave klimatike të ndara sipas moshës dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve.	Numri i materialeve të shpërndara Shkalla e angazhimit të shkollës dhe komunitetit	10.000 kopje 200 shkolla	Nëntor 2027	Ministria e Arsimit; OJQ-të	100.000	Angazhimi i nxitur nga të rinjtë siguron ndryshime afatgjata të sjelljes në aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës.
Të forcohen programet e njohurive, veçanërisht në shkolla, përfshirë zhvillimin e moduleve të synuara të trajnimit, për t'i ndihmuar brezat e rinj të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin mbi klimën.	Numri i shkollave të angazhuara Numri i seancave të ndërgjegjësimit	100 shkolla 20 seanca ndërgjegjësimit	Shtator 2026 – dhjetor 2028	Ministria e Arsimit; OJQ-të	100.000	Përmirësim i qëndrueshmërisë së të rinjve ndaj keqinformimit mbi klimën.
Objektivi 5: Vazhdimi i angazhimit dhe dialogut						
Të theksohen arritjet e përshtatjes përmes blogjeve, videove dhe buletineve që shfaqin përpjekjet në të pestë sektorët.	Numri i historive të ndara të suksesit Metrikat e angazhimit	15 histori suksesi 1.000.000 shikime	Janar 2028 – dhjetor 2028	Ekipi i komunikimit; udhëheqësit vendorë të projekteve	100.000	Ecure e qëndrueshme dhe rritje e investimeve në praktikatat e suksesshme të përshtatjes.
Të vihet në funksion një platformë digjitale për të monitoruar ecurinë e përshtatjes dhe për të angazhuar palët e interesit me përditësime dhe mundësi për vlerësime.	Vënia në funksion e platformës Përdorues aktivë Dhënia e vlerësimeve	1 platformë 5.000 përdorues aktivë	Tetor 2027 – mars 2028	Ekipi i TI-së; ekipi i komunikimit	60.000	Angazhimi i vazhdueshëm nxit transparencën dhe planifikimin bashkëpunues për përshtatje.

9. FINANCIMI I NAP-it

Kostot e përgjithshme për planifikimin e NAP-it 2026–2036 arrijnë në 9.8 miliardë dollarë amerikanë, si paraqitet në Planin e Zbatimit për veprimet e prioritarizuara¹²⁹, i cili përfshin koston e veprimeve të përshtatjes dhe të veprimeve të integruara të perspektivës gjinore dhe të komunikimit.

Financimi i kësaj shume të konsiderueshme kërkon planifikim të plotë dhe identifikim të burimeve dhe instrumenteve të përshtatshme të financimit të brendshëm dhe të jashtëm. Për të

¹²⁹ Plani i zbatimit i Shqipërisë për veprimet e prioritarizuara të përshtatjes. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2024a5.

adresuar këtë çështje, është hartuar një **strategji financimi**, për të cilën është kryer një analizë e detajuar e nevojave dhe boshllëqeve në financim, duke identifikuar qasjet strategjike për të mobilizuar financat, duke marrë parasysh ciklet dhe opsionet e planifikimit të buxhetit kombëtar.

Kjo Strategji Financimi e NAP-it do të sigurojë mobilizimin dhe alokimin efektiv të burimeve financiare të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për zbatimin e prioritetëve të përshtatjes të Shqipërisë dhe ofron sa më poshtë:

1. Analizë të boshllëqeve në financim, duke krahasuar kostot e përgjithshme të pritshme dhe nevojat e parashikuara të disbursimit në raport me buxhetet e disponueshme, duke treguar se aktualisht ka një hendek të përgjithshëm prej rreth 93% të nevojave të financimit dhe ky hendek ndryshon sipas sektorit;

2. Identifikim të pengesave kryesore për arritjen e objektivit të buxhetit, siç janë pengesat ekonomike dhe angazhimi i fragmentuar i donatorëve, pjesëmarrja e ulët e sektorit privat në financimin për përshtatje ose nevoja për reforma të caktuara politike; së bashku me mekanizmat mundësues trajtimin e tyre;

3. Qasje strategjike për të mobilizuar financimin vendas, ndërkombëtar, publik, privat dhe të përzier për klimën;

4. Qasje të propozuar për të prioritetizuar investimet dhe zbatim gradual gjatë gjithë dekadës së ardhshme;

5. Plan financimi për të mobilizuar dhe menaxhuar burimet e financimit të nevojshme për harmonizimin e nevojave të identikuara me burimet më të përshtatshme të financimit.

Këto elemente kyçe të strategjisë së financimit përmbledhen më poshtë dhe paraqiten më hollësisht në dokumentin e veçantë: Strategjia e Financimit të NAP-it.

9.1 Nevojat për financim për përshtatje

Në përgjithësi, nevojat e Shqipërisë për përshtatje janë të konsiderueshme, me një shumë të përlogaritur prej 9.8 miliardë dollarësh amerikanë të nevojshëm për të financuar 66 masat prioritare të përshtatjes sipas Planit të Zbatimit të NAP-it 2026–2036, prandaj lind nevoja për një Strategji Financiare që siguron mobilizimin dhe të alokimin efektiv të burimeve financiare të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për zbatimin e prioritetëve të përshtatjes të Shqipërisë.

Nevojat për financim për përshtatje janë më të mëdha në sektorin e zhvillimit urban dhe infrastrukturës (~2.7 miliardë dollarë amerikanë), **e ndjekur nga pylltaria** (~2.1 miliardë dollarë amerikanë), **transporti** (~2.03 miliardë dollarë amerikanë) **dhe energjia** (~1.96 miliardë dollarë amerikanë). Nevojat e sektorit të bujqësisë për përshtatje janë më të moderuara (~0.6–0.7 miliardë dollarë amerikanë), ndërsa buxhetet e turizmit dhe ato ndërsektoriale përbëjnë një pjesë të vogël të kostos së përgjithshme të NAP-it (përkatesisht ~0.8 miliardë dollarë amerikanë dhe ~0.3 miliardë dollarë amerikanë).

Nëse këto alokime përlogariten në plan vjetor dhe krahasohen me PBB-në aktuale të Shqipërisë (e përlogaritur në 28.37 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2025), shpenzimet afatshkurtra (2026–2028) ato korrespondojnë me një mesatare prej afërsisht 180.6 milionë dollarësh amerikanë në vit, duke përfaqësuar rreth 0.6% të PBB-së (Tabela 18). Për periudhën afatmesme (2029–2032), investimi mesatar vjetor prej 652.4 milionë dollarësh amerikanë korrespondon me afërsisht 2.3% të PBB-së. Gjatë periudhës afatgjatë (2033–2042), investimi mesatar vjetor do të arrijë afërsisht 664.9 milionë dollarë amerikanë, që është i barabartë me rreth 2.3% të PBB-së së vitit 2025. Megjithatë, nëse ekonomia e Shqipërisë rritet me një ritëm të qëndrueshëm prej 3.5% në vit, PBB-ja do të rritet në afërsisht 39.5 miliardë dollarë amerikanë deri në vitin 2036 dhe do të arrijë në gati 48.9 miliardë dollarë amerikanë deri në vitin 2042. Në këtë skenar, disbursimi vjetor i përshtatjes prej 576.5 milionë dollarësh amerikanë në vit gjatë 17 viteve (2026–2042) do të përfaqësojë rreth 1.18% të PBB-së së

parashikuar për vitin 2042, duke treguar se rritja e PBB-së ka të ngjarë të ndihmojë në lehtësimin e barrës fiskale vjetore relative¹³⁰.

Analiza e tabelës së kostimit parashikon shpërndarjen e kostove për periudhën 2026–2030, e cila përkon me fazën fillestare të zbatimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes. Buxheti total i kërkuar për këtë periudhë arrin në 167,898,414,878 lekë, duke reflektuar nevojat e konsiderueshme për financimin e masave prioritare të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Nga kjo shumë, 2,745,951,869 lekë përbëjnë kosto korrente, ndërsa pjesa dërrmuese, 142,890,893,485 lekë, lidhet me kosto kapitale, çka tregon një orientim të fortë drejt investimeve konkrete dhe ndërhyrjeve në terren.

Në aspektin e burimeve financiare, tabela reflekton një kombinim të financimit të brendshëm dhe atij të huaj. Për periudhën 2026–2028, bazuar në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) të institucioneve, parashikohet një financim prej 5,501,789,981 lekë nga buxheti i shtetit dhe 8,207,168,883 lekë nga financimi i huaj. Ndërkohë, për vitet 2029–2030 parashikohet një rritje e ndjeshme e mbështetjes financiare, ku 5,694,668,552 lekë pritet të mbulohen nga PBA dhe 129,981,164,051 lekë nga financimi i huaj, duke reflektuar nevojën për investime më të mëdha në fazat e avancuara të zbatimit të planit.

Në total, burimet e sigurta të identifikuara arrijnë në 143,883,001,486 lekë, ndërsa diferenca midis nevojave totale dhe financimit të siguruar përbën një hendek financiar prej 24,015,413,392 lekë, ose rreth 16.69% të koston totale. Ky hendek, megjithëse relativisht i moderuar në raport me volumin e përgjithshëm të investimeve, thekson nevojën për mobilizimin e burimeve shtesë financiare, përfshirë rritjen e aksesit në fondet ndërkombëtare për klimën, forcimin e bashkëpunimit me partnerët e zhvillimit dhe eksplorimin e mekanizmave inovativë të financimit.

Ndërkohë, është e rëndësishme të theksohet se, edhe pse kostoja totale e strategjisë është referuar në rreth 9.8 miliardë lekë, kjo vlerë i referohet një horizonti kohor më të gjerë që shtrihet deri në vitin 2042. Edhe pse strategjia parashikon masa për periudhën 2026–2036, një pjesë e masave të saj kanë një natyrë afatgjatë dhe vijnë të zbatohen edhe pas vitit 2036, duke reflektuar kompleksitetin dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve të nevojshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Tabela 18: Investimi i parashikuar për periudhën 2026–2042.

Periudha	Disbursimi i parashikuar vjetor (në dollarë amerikanë)	Totali (milionë dollarë amerikanë)	% e PBB-së (në vitin 2025)
2026–2028	180.6	542	0.6
2029–2032	652.4	2610	2.3
2033–2042	664.9	6649	2.3
Mesatarja/total i	576.5	9800	

Pavarësisht shumës së nevojshme, ky nivel investimi konsiderohet i realizueshëm fiskalisht, veçanërisht nëse mbështetet nga financimi koncesionar, alokimet buxhetore me faza dhe integrimi i plotë në kuadrot kombëtarë të investimeve publike. Ndonëse këto shuma mund të jenë frikësuese, **kostoja e mosveprimit do të ishte më e lartë, pasi dëmtimet e rënda prej klimës mund të zhbëjnë vite të tëra zhvillimi. Investimi në aftësi ripërtëritëse është në thelbësor për investimin në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe rritjes ekonomike dhe do të sjellë një kthim të konsiderueshëm në të gjithë sektorët prioritarë ku duhet të investohet më shumë**, pra, bujqësi, energji, transport dhe zhvillim urban, nëpërmjet humbjeve të shmangura (të përlllogaritura në më shumë se 17 miliardë dollarë amerikanë pa asnjë veprim), potencialit ekonomik të përshpejtuar (5.3 miliardë dollarë amerikanë) dhe përfitimeve të

¹³⁰ Strategjia e Shqipërisë e financimit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

shtuara sociale dhe mjedisore (2.5 miliardë dollarë amerikanë). Kjo barazohet me një ndikim të përgjithshëm prej gati 24.8 miliardë dollarësh amerikanë në një shpenzim prej 9.8 miliardë dollarësh amerikanë, pra, një raport përfitim-kosto prej afërsisht 2,5.

9.2 Angazhimet ekzistuese dhe boshllëqet në financim

Pavarësisht përpjekjeve më të fundit për të nxitur financimin për përshtatje, financimi ekzistues është goxha i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e identifikuar për financimin për përshtatje. Qeveria Shqiptare ka caktuar afërsisht 310 milionë dollarë amerikanë për veprime për përshtatje në të gjithë sektorët në Programin e saj Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe strategjitë kombëtare sektoriale, ku përqindjet më të mëdha shkojnë për pylltarinë (194 milionë dollarë amerikanë) dhe bujqësinë (80 milionë dollarë amerikanë). Partnerët ndërkombëtarë, përfshirë BE-në, Bankën Botërore, Fondin e Gjellbër për Klimën (FGJK) dhe të tjerë, po mbështesin përshtatjen përmes granteve dhe huave, por jo në shkallën e kërkuar.

Tabela 19 më poshtë përmbledh nevojat për investime në përshtatje sipas sektorit, fondet e përgjithshme të angazhuara ose të alokuara tashmë nga fondet publike (2025–2027), si dhe fondet nga burimet ndërkombëtare. Gjithashtu, ai thekson mangësitë e mbetura të financimit që duhen adresuar.

Tabela 19: Nevojat e parashikuara për financim për përshtatje, financimi aktual dhe boshllëqet sipas sektorit¹³¹.

Sektori	Kostoja e përllogaritur (dollarë amerikanë)	Fondet publike kombëtare të angazhuara ¹³²	Fondet ndërkombëtare ¹³³	Fondet aktuale të angazhuara	Hendeku gjatë periudhës totale në dollarë amerikanë	% e hendekut gjatë periudhës totale
Bujqësia	678.114.861	~80 milionë dollarë amerikanë	~68 milionë dollarë amerikanë	~148 milionë	529 milionë	78
Pylltari	2.134.799.556	~193 milionë dollarë amerikanë	~7 milionë dollarë amerikanë	~200 milionë	1.933 milionë	91
Zhvillimi urban	2.723.161.544	~4 milionë dollarë amerikanë	~23.5 milionë dollarë amerikanë	~27.5 milionë	2.695 milionë	99
Turizmi	8.491.619	~1 milion dollarë amerikanë	~13 milionë dollarë amerikanë	~14 milionë	0	0
Energjia	1.960.573.000	~22 milionë dollarë amerikanë	~275 milionë dollarë amerikanë	~297 milionë	1.663 milionë	85
Transporti	2.038.835.000	~1 milion dollarë amerikanë	~2,5 milionë dollarë amerikanë	~3.5 milionë	2.035 milionë	100
Ndërsektorial	256.721.396	2.7 milionë dollarë amerikanë	4 milionë dollarë amerikanë	~6.7 milionë	249 milionë	97
Gjithsej	9.800.696.976	306 milionë dollarë amerikanë	393 milionë dollarë amerikanë	699 milionë dollarë amerikanë	9.107 milionë dollarë amerikanë	93

Më sipër ilustron se Shqipëria përballet me boshllëqe të konsiderueshme në financim në shumicën e sektorëve, me një hendek kritik prej 93%. Vetëm 7% e fondeve të nevojshme është angazhuar përmes Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027. Me përjashtim të turizmit i cili nuk tregon asnjë boshllëk, boshllëqet në financim janë të larta në të gjithë sektorët e tjerë, ku për pylltarinë, zhvillimin urban dhe sektorët ndërsektorialë janë identifikuar nivele hendeku mbi 90% dhe madje gati 100% (transporti). Këto mungesa tregojnë se do të duhet financim i konsiderueshëm për të mbështetur nevojat e financimit për përshtatje në këtë NAP.

9.3 Pengesat për të kapërcyer hendekun e financimit për përshtatje

Kuadri i financimit për përshtatje në Shqipëri përballet me një sërë pengesash për shpërndarjen e fondeve për përshtatjen në shkallë të gjerë:

1. Pengesat ekonomike dhe angazhimi i fragmentuar i donatorëve

- Kosto të larta fillestare të masave kryesore (p.sh., ujitja, mbrojtja e bregdetit) në tregjet e kapitalit të pazhvilluara dhe mungesa e lëshimit të obligacioneve të gjelbra.

¹³¹ Strategjia e Shqipërisë e financimit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

¹³² Përfshirë buxhetin e PBA-së 2025–2027.

¹³³ Të siguruara dhe të planifikuara.

- Qasje e kufizuar në instrumentet e zbutjes së riskut, me një treg të përforcuar sigurimi që është shumë i nevojshëm, veçanërisht për komunitetet rurale.

- Peizazhi i fragmentuar i donatorëve shkakton dublikim dhe boshllëqe, ku përshtatja ndaj turizmit është veçanërisht e nënfinancuar.

- Të dhënat e pamjaftueshme të fizibilitetit dhe kthimet e paqarta ulin interesin për financim koncesionar ose nga MDB-ja për projektet e përshtatjes.

2. Sfidat specifike për sektorët

- Energjia: Varësia e madhe nga energjia hidroelektrike dhe mungesa e magazinimit e ekspozojnë sektorin ndaj thatësirës; rregulloret e paqarta pengojnë investimet private.

- Transporti: Dëmet e shpeshta nga përmbytjet dhe mungesa e standardeve të qëndrueshmërisë në tendera pengojnë mbrojtjen nga ndryshimet klimatike.

- Bujqësia dhe pylltaria: Fermave të vogla nuk u ofrohet kredi dhe sigurim, duke kufizuar përvetësimin e praktikave inteligjente për klimën; gjithashtu, nevojiten stimuj të rinj për mirëmbajtjen dhe ripyllëzimin e zonave pyjore për të financuar përshtatjen në sektor.

- Turizmi: Shumë i ekspozuar ndaj erozionit dhe ndryshimeve të motit; pak mjete financiare ose PPP për turizëm me aftësi ripërtëritëse.

- Urban: Urbanizimi i shpejtë dhe zbatimi i papërshtatshëm i kodeve vonojnë infrastrukturën e gjelbër dhe me aftësi ripërtëritëse.

3. Mangësitë në përgatitjen dhe koordinimin e projektit

- Pak projekte “që mund të financohen” me studime të plota fizibiliteti kufizojnë qasjen në fonde të mëdha.

- Mungesa e një organi koordinues institucional ose sekretariati nën drejtimin e GNPKNK-së shkakton mbivendosje të donatorëve.

- Nuk ka një sistem të unifikuar të gjurmimit të financimit për klimën për të monitoruar, raportuar ose harmonizuar shpenzimet për përshtatjen.

4. Pjesëmarrje e ulët e sektorit privat

- Investime minimale private në përshtatje (përbën 5% të fondeve kombëtare për përshtatjen) për shkak të mungesës së mjeteve për uljen e riskut, incentivave fiskale dhe qartësisë rregullatore.

- Ekosistemi i financimit të gjelbër është ende në fazat e hershme: Nuk ka obligacione ose produkte sigurimi për klimën dhe ka programe pilot të kufizuara të huadhënies ESG të udhëhequra vetëm nga disa banka.

- Hapat e hershëm përfshijnë financimin e kombinuar në kuadër të programeve rrugore dhe projektet pilot të PPP-së.

5. Kufizime institucionale, rregullatore, të tregut dhe të kapaciteteve

- Legjislacioni dytësor i vonuar dhe tarifat e paharmonizuara dekurajojnë PPP-të në sektorin e ujit dhe infrastrukturës.

- Nuk ka fonde kombëtare për klimën apo sisteme efektive të etiketimit të buxhetit për të kanalizuar financimin.

- Fokus i kufizuar në barazi; rajonet malore si Kukësi dhe Dibra mbeten të pafinancuara pavarësisht cenueshmërisë së lartë.

6. Reformat rregullatore dhe të politikave

- Rritja e alokimit të buxhetit të brendshëm dhe përshpejtimi i një Fondi Kombëtar të Përshtatjes do të përmirësonte stabilitetin e financimit.

- Angazhimi proaktiv me mekanizmat e BE-së dhe WBIF-së mund të nxisë projekte më të mëdha në shkallë rajonale.

- Ngritja e sistemeve të fuqishme të monitorimit dhe vlerësimit do të tregonte ndikim dhe do të siguronte fonde të mëtejshme.

7. Sfidat tjera

- Pasiguria klimatike mund të shkaktojë nënvlerësim të madh të kostove të përshtatjes (p.sh., mbrojtja e nivelit të detit në Durrës).

- Sistemet e dobëta të MRV-së dhe mungesa e treguesve të standardizuar pengojnë vlerësimin e efektivitetit të përshtatjes dhe justifikimin e investimeve.

9.4 Mekanizmat mundësues për të kapërcyer hendekun e financimit të përshtatjes

Për të lehtësuar qasjen në financim, mund të përdoren një sërë mekanizmash mundësues në vend:

- **Struktura të përziera financimi.** Strategjia e Financimit të Përshtatjes e Shqipërisë varet nga përshkallëzimi i financimit të përzier, duke kombinuar kapitalin koncesionar dhe atë tregtar për të ulur riskun e investimeve private, duke përfshirë disa instrumente dhe projekte pilot të zbatueshme, si garancitë dhe lehtësirat e ndarjes së riskut; Fondi i Gjellbër për Rritje (FGJRR) dhe një projekt pilot i obligacioneve të përshtatjes së turizmit, të cilat janë në diskutim e sipër;

- **Integrimi i përshtatjes në financimin e zhvillimit.** Strategjia e përshtatjes e Shqipërisë përqendrohet në integrimin e aftësive ripërtëritëse ndaj klimës në të gjitha financimet e zhvillimit, duke siguruar që infrastruktura e re të mbrohet nga ndryshimet klimatike. Partnerët ndërkombëtarë si BEI-ja dhe WBIF-ja kërkojnë shqyrtimin e riskut klimatik, me projekte pilot të suksesshme në Shkodër dhe Tiranë që demonstrojnë fizibilitetin. Kështu, Plani i Zbatimit identifikon mundësitë e bashkëfinancimit, si shfrytëzimi i fondeve të FGJK-së për projekte të mbështetura nga BE-ja, dhe priorizon 66 masa me kosto efektive që përbëjnë interes për donatorët dhe investitorët. Megjithatë, rritja e financimit kërkon mundësimin e reformave, finalizimin e etiketimit të buxhetit për klimën, vendosjen e çmimeve të karbonit dhe harmonizimin e tarifave për të tërhequr PPP-të. Zbatimi i legjislacionit për përdorimin e tokës, sistemet e përmirësuara të të dhënave dhe kapaciteti i zgjeruar teknik dhe institucional janë gjithashtu thelbësore. Së fundi, nxitja e bashkëpunimit midis qeverisë, sektorit privat dhe komuniteteve është me rëndësi për zhvillimin e një tregu funksional për zgjidhje të bazuara në natyrë që mbështesin aftësitë ripërtëritëse afatgjata ndaj klimës dhe rritjen e qëndrueshme.

9.5 Qasje strategjike

Mobilizimi efektiv i burimeve dhe financimi i prioritetëve të përshtatjes të Shqipërisë do të kërkojë një strategji shumëplanëshe, që kombinon mobilizimin e burimeve vendase, qasjen e përmirësuar në financimin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike, angazhimin më të madh me sektorin privat dhe zhvillimin e instrumenteve financiare novatore, si dhe masat ndërsektoriale që rrisin kapacitetin përshtatës të vendit¹³⁴.

Mobilizimi i burimeve vendase

Forcimi i **kontributeve vendase** është thelbësor për shfrytëzimin e fondeve ndërkombëtare dhe sigurimin e qëndrueshmërisë. Kjo mund të bëhet përmes:

- **Shtimit të fondeve nga buxheti i shtetit**, ku Shqipëria që do të angazhohet për mobilizimin e të paktën 20% të nevojave të përgjithshme për financim nga burimet vendase deri në vitin 2030;

- **Demonstrimit nga ana e ministrive** se si alokimet e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) mbështesin NAP-in dhe komponentët e përshtatjes së KKP-së së saj;

- **Prezantimit të një sistemi të Etiketimit të Buxhetit për Klimën (EBK)** për të gjurmuar shpenzimet për përshtatje (aktualisht në zhvillim e sipër);

- **Krijimit të një instrumenti për shqyrtimin e buxhetimit të gjellbër**, ku çdo zë në buxhetin kombëtar klasifikohet sipas rëndësisë së tij për shpenzimet e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (e lartë-mesatare-e ulët);

- **Përshtatjes së instrumenteve financiar me objektivat klimatikë** (p.sh., tatimet, taksat dhe subvencionet);

¹³⁴ Strategjia e Shqipërisë e financimit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Hartuar në kuadër të projektit të UNDP-së për PKP-në. Ministria e Mjedisit, 2023–2025.

- Përfshirjes nga Kontrolli i Shtetit e shpenzimeve të etiketuara si përshtatje në ciklin e tij vjetor të kontrollit;

- Mobilizimit të buxheteve bashkiake për të financuar ndërhyrje të vogla vendore për përshtatje;

- Krijimit të një Fondi Kombëtar për Klimën për të bashkuar burimet publike.

Rishikimit dhe korrigjimit të tarifave të shërbimeve, për të pasqyruar faktorët e jashtëm mjedisor dhe për të krijuar një mjedis më me interes për investimet private në infrastrukturën e lidhur me përshtatjen.

- Monitorimit dhe shfrytëzimit të sukseseve, për të demonstruar përdorimin efikas të fondeve, gjë që mund të ndihmojë në mobilizimin e më shumë fondeve.

- Nxitjes së programeve kombëtare të financimit të kërkimit shkencor dhe inovacionit drejt projekteve që adresojnë prioritetet e përshtatjes klimatike në sektorët kryesorë të planit, me qëllim përmirësimin e bazës së të dhënave, zhvillimin e zgjidhjeve të bazuara në evidencë dhe mbështetjen e vendimmarrjes për rritjen e reziliencës deri në vitin 2050, në përputhje me kuadrin institucional dhe strategjitë kombëtare të kërkimit dhe inovacionit.

Financimi ndërkombëtar për ndryshimet klimatike

Qasja në financimin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike mbetet thelbësore për mbylljen e hendekut të financimit për përshtatje në Shqipëri. Qeveria synon të forcojë partneritetet me fonde të mëdha, përfshirë Fondin për Klimën e Gjellbër (GCF), Fondin Global të Mjedisit (GEF), Fondin për Përshtatje (FP) dhe IPA III të BE-së, teksa përgatit një propozim kryesor për përshtatje shumësektoriale për dorëzimin në FGJK në vitin 2025. Ky propozim përputhet me Programin Kombëtar të FGJK-së për Vendin dhe prioritetet e kostos së Planit të Zbatimit, duke shfrytëzuar bashkëfinancimin vendas dhe dypalësh për të maksimizuar ndikimin.

Për të përmirësuar koordinimin dhe efikasitetin, do të krijohet një mekanizëm i dedikuar për koordinimin e tubacionit në kuadër të Njesisë së Koordinimit të Financave për Klimën (CFCU) në Ministrinë e Mjedisit. Kjo do të përmirësojë përgatitjen e projektit, do të mbështesë propozimet shtesë të Gatishmërisë së FGJK-së dhe do të forcojë projektimin e instrumenteve financiare. Shqipëria do të thellojë edhe pjesëmarrjen në nisma rajonale, si Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, dhe do të mobilizojë financim ndërkufitar përmes WBIF-së dhe Dritares së Përshtatjes së BEI-së.

Burimet kryesore të financimit përfshijnë mbështetjen në shkallë të gjerë të FGJK-së për përshtatjen ndërsektoriale, grantet e GEF-së dhe FP-së për veprime të bazuara në ekosistem dhe në nivel komuniteti, si dhe financimin IPA III për mbrojtjen e infrastrukturës nga ndryshimet klimatike dhe reformat e politikave. Financimi plotësues nga MDB-të, agjencitë e OKB-së dhe donatorët dypalësh (p.sh., Gjermania, Zvicra, SHBA-ja) do të përmirësojë zbatimin. Së fundi, instrumentet novatore si shkëmbimet e borxhit për natyrën, duke shfrytëzuar kapitalin natyror të Shqipërisë, siç është lumi Vjosa, ofrojnë potencial të pashfrytëzuar për të financuar zgjidhje të bazuara në natyrë dhe për të forcuar aftësitë ripërtëritëse afatgjata ndaj klimës.

Mobilizimi i kapitalit privat

Sistemi financiar i Shqipërisë është shumë i përqendruar te bankat, ku ndërmarrjet, veçanërisht NVM-të, mbështeten kryesisht në financimin e borxhit nga bankat dhe institucionet e mikrofinancës. Tregjet e kapitalit mbeten të pazhvilluara, obligacionet e gjelbra praktikisht mungojnë dhe ndërmjetësit financiarë jobankarë janë të kufizuar, duke kufizuar qasjen në instrumente të ndryshme financimi. Zbulimi i dobët i korporatave mbi risqet klimatike dhe mungesa e një baze të dhënash të unifikuar mbi shkarkimet dhe performancën e investimeve pengojnë më tej flukset e qëndrueshme të investimeve. Kostot e larta fillestare dhe mekanizmat e pamjaftueshëm të ndarjes së riskut pengojnë pjesëmarrjen private në projektet e energjisë së rinovueshme, infrastrukturës dhe përshtatjes, ndërsa PPP-të mbeten të nënshfrytëzuara.

Miratimi i standardeve ESG dhe të qëndrueshmërisë të harmonizuara me BE-në, siç janë Taksonomia e Financave të Qëndrueshme dhe CSRD-ja, është ende në fazat e hershme. Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti teknik i kufizuar ndërmjet firmave i bëjnë bizneset shqiptare me më pak interes për investitorët e gjelbër dhe rrezikojnë t'i përjashtojnë ata nga tregjet e BE-së. Ndërkohë, bankat tregtare kanë qenë të ngadalta në zhvillimin e produkteve financiare të lidhura me klimën për shkak të ekspertizës së kufizuar dhe kuadrove të papërshtatshëm të vlerësimit të riskut klimatik.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, Shqipëria po piloton modele të përziera financimi, si Fondi Adriatik për Aftësitë Ripërtëritëse, i cili kombinon grantet e FGJK-së, huat e BEI-së dhe kapitalin privat për të financuar projekte të ekoturizmit dhe agropylltarisë, duke arritur një raport 1:3 të përdorimit publik-privat. Shkallëzimi i kësaj qasjeje do të kërkojë mjete më të forta për zbutjen e riskut, financim koncesionar dhe qartësi rregullatore. Qeveria planifikon të zgjerojë mekanizmat e financimit të përzier dhe të PPP-ve, të lëshojë obligacione të gjelbra dhe me aftësi ripërtëritëse, të krijojë instrumente sigurimesh dhe risku nga katastrofat, si dhe të prezantojë incentiva financiare dhe linja huaje koncesionare. Mobilizimi i financave private do të jetë thelbësor për shkallëzimin e investimeve në përshtatje dhe përmirësimin e aftësive ripërtëritëse afatgjata ndaj klimës, për të cilat fushat kryesore të fokusit duhet të përfshijnë veprimet e mëposhtme:

- Të zgjerohet përdorimi i Partneriteteve Publike-Private¹³⁵ (PPP);
- Të prezantohen obligacionet të gjelbra dhe klimatike¹³⁶;
- Të pilotohen instrumentet e sigurimit¹³⁷;
- Të forcohet Përgjegjësia Sociale të Korporatave¹³⁸ (PSK).

Instrumente novatore

Shqipëria po zbaton instrumente novatore financimi për të zgjeruar portofolin e saj të financimit për përshtatje dhe për të rritur qëndrueshmërinë fiskale. Një studim fizibiliteti për obligacionin e parë të gjelbër të vendit është planifikuar për vitin 2026, duke u bazuar në përvojat rajonale nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Në bujqësi dhe zgjidhje të bazuara në natyrë, projektet pilot të financimit të klimës të bazuara në rezultate do të lidhin disbursimet me rezultate të matshme, të tilla si restaurimi i ekosistemit ose rendimentet e përmirësuara nën stresin klimatik. Shqipëria po angazhohet edhe në krijimin e një strukture rajonale të sigurimit të riskut klimatik (SECRIF) për të ofruar mbulim kundër ngjarjeve ekstreme të motit për qeveritë, bashkitë, fermerët dhe NVM-të. Këto nisma synojnë të diversifikojnë burimet e financimit, të mobilizojnë investimet private dhe të forcojnë menaxhimin e riskut klimatik. Suksesi i tyre do të varet nga koordinimi i fortë institucional, mbështetja e vazhdueshme e donatorëve dhe reformat rregullatore për të tërhequr kapital në shkallë të gjerë përmes mekanizmave si platformat e bashkëinvestimit dhe marrëveshjet e financimit të përzier.

9.6 Afati dhe zbatimi i propozuar për strategjinë e financimit të NAP-it

Financimi i NAP-it kërkon një qasje të mirëmenduar dhe të ndarë në faza për të shfrytëzuar burimet e disponueshme, duke siguruar njëkohësisht fonde shtesë. Qasja e propozuar për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të NAP-it strukturohet, si më poshtë:

Afatshkurtër (2026–2028)

¹³⁵ Partneritetet Publike-Private (PPP) janë një mjet që qeveritë mund ta përdorin për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve të nevojshme të infrastrukturës. PPP-të janë një mënyrë kontraktimi për shërbime, duke përdorur novacionin dhe ekspertizën e sektorit privat, dhe shpesh ato shfrytëzojnë financimin privat. (Banka Botërore).

¹³⁶ Një obligacion është një produkt investimi me të ardhura fikse ku individët i japin hua para një qeverie ose shoqërie me një normë interesi të caktuar për një periudhë të paracaktuar.

¹³⁷ P.sh., Sigurimi i bujqësisë ose i indeksit të motit.

¹³⁸ Përgjegjësia Sociale e Korporatave është një koncept menaxhimi me anë të të cilit kompanitë integrojnë shqetësimet sociale dhe mjedisore në operacionet e tyre të biznesit.

Një total prej 56% e masave të përshtatjes në Planin e Zbatimit janë në kategorinë e fillimit të periudhës afatshkurtër, duke pasqyruar rolin e tyre themelor në mundësimin e përparimit më të gjerë të përshtatjes, veçanërisht për masat “e buta” që kërkojnë më pak përgatitje (p.sh., ato të përqendruara në koordinim dhe komunikim). Kostoja e menjëhershme afatshkurtër “e butë”, me fokus në krijimin e kushteve lehtësuese, funksionalizimin e fondit të përshtatjes, sigurimin e fondeve fillestare të FGJK-dhe të donatorëve për projektet “e gatshme”, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe integrimin e përshtatjes në buxhetet vjetore, është rreth 219 milionë dollarë amerikanë. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria ka disa burime në dispozicion. Alokimet kombëtare ofrojnë një bazë për shpenzimet për vendin (~160 milionë dollarë amerikanë gjatë viteve 2026–2028 në të gjithë sektorët) dhe gjatë kësaj periudhe disa projekte donatorësh do të disbursojnë, duke arritur potencialisht në një total prej ~37 milionë dollarësh amerikanë shtesë. Disa nga masat e hershme me fitim të shpejtë janë mbuluar tashmë: për shembull, hartimi i planeve dhe rregulloreve (ICZM turistike, planet urbane) financohen përmes granteve qeveritare ose granteve të vogla. Megjithatë, projektet me kapital intensiv në pylltari, urbanizim dhe transport mbeten kryesisht të pafinancuara në planin afatshkurtër, gjë që nënkupton potencialisht pak progres fizik në këto aspekte deri në vitin 2028 përtej studimeve dhe projekteve pilot.

Afatmesme (2029–2032)

Kjo periudhë është kritike, pasi shumë investime në përshtatje duhet të arrijnë kulmin. Nëse të gjitha projektet e planifikuara realizohen, aspekti i financimit në vitet 2029–2032 mund të përmirësohet, duke mbledhur potencialisht 500–600 milionë dollarë amerikanë shtesë. Sektorë si bujqësia mund të mbyllin pjesën më të madhe të hendekut të tyre deri në vitin 2030 nëse zbatohen projektet e planifikuara. Nevojat e turizmit mund të përmbushen kryesisht edhe nëpërmjet integritit në projekte të tjera. Por urbanizmi, pylltaria, energjia dhe transporti mund të mbartin hendeqe të mbetura deri në vitin 2032, të zgjatura më tej deri në vitin 2036. Problemi është se Shqipëria rrezikon të lërë shumë risqe klimatike pa u adresuar, duke shkaktuar potencialisht humbje ekonomike dhe njerëzore që i tejkalojnë shumë kostot e investimit.

Afatgjatë (2033–2050)

Rreth 11% e masave janë planifikuar me një fillim afatgjatë, duke theksuar nevojën për të filluar shumicën e aktiviteteve pa vonesë. Në planin afatgjatë (2033–2050) duhet të trajtohet jo vetëm pjesa e mbetur e planit, por edhe të arrihet përshtatje me kushtet në ndryshim. Nëse deri në vitin 2032 Shqipëria arrin të mobilizojë ~25% të fondeve të nevojshme, ~60% e mbetur (afërsisht 5.3 miliardë dollarë amerikanë) bëhet hendek afatgjatë. Në planin afatgjatë, strategjia parashikon flukse të qëndrueshme financimi me alokim më të madh të buxhetit të brendshëm dhe mekanizma të vetëmjaftueshëm. Investimi proaktiv tani mund të zvogëlojë kostot e ardhshme. Nëse nuk bëhet një materializim, deri në vitin 2050, Shqipëria mund të përballlet me dëme të konsiderueshme vjetore klimatike prej qindra milionash, të cilat do ta rëndojnë ekonominë.

Më poshtë përshkruhet renditja e strategjisë së financimit për nevojat:

- **2025/2026 – Përgatitja dhe pilotimet e hershme.** Një riprogramim i vetëm prej 30 milionë dollarësh amerikanë nga linjat e PBA-së të nënshfrytëzuara është ndarë për dhjetë projekte pilot “me kosto të ulët dhe ndikim të lartë” dhe për hartimin e propozimeve të plota të FGJK-së/IPA-s së BE-së;

- **2026–2028 – Zbatimi afatshkurtër.** Grupi i parë i 24 masave prioritare, në vitin 2026: 50 milionë dollarë amerikanë; 2027: 75 milionë dollarë amerikanë; 2027: Obligacion i gjelbër prej 100 milionë dollarësh amerikanë; 2028 – Shkallëzimi i financimit të përzier (në total 200 milionë dollarë amerikanë);

- **2029–2030 – Hua dhe grante dypalëshe.** 200 milionë dollarë amerikanë në hua koncesionare të BEI-së për Fazën e 2-të të aftësive ripërtëritëse në transport dhe energji; 150

milionë dollarë amerikanë në financim të Bankës Botërore për investime në bujqësi të bazuara në ekosisteme dhe në aftësitë ripërtëritëse të bashkisë; 100 milionë dollarë amerikanë në grante dypalëshe (KfW, JICA, donatorë nordikë) për të mbështetur asistencën teknike dhe gatishmërinë ndërsektoriale. Deri në fund të vitit 2030, pesëdhjetë nga gjashtë masat do të jenë financiar plotësisht dhe do të jenë vënë në zbatim, me disbursime kumulative që arrijnë afërsisht 600 milionë dollarë amerikanë, rreth 75% të paketës afatshkurtër prej 800 milionë dollarësh amerikanë;

- **2031–2033 – Institucionalizimi dhe punimet kryesore kapitale.** Lëshimi i obligacioneve të gjelbra të dyta prej 200 milionë dollarësh forcon tregjet e brendshme të kapitalit dhe mbështet digat rajonale të ruajtjes së ujit dhe kontrollit të përmbajtjeve; 300 milionë dollarë bashkëfinancim me hua fleksible nga BEI/Banka Botërore financojnë korridoret kryesore të gjelbra urbane dhe ndërtimin e digave.

- **2034–2035 – Integrimi dhe qëndrueshmëria.**

Plani i detajuar i financimit (2026–2028)

Plani prioritar afatshkurtër synon të përshtatë nevojat e identifikuar për investime me burimet më të përshtatshme të financimit, kombëtare, ndërkombëtare, publike dhe private, duke adresuar njëkohësisht pengesat kryesore dhe boshllëqet e kapaciteteve institucionale që mund të pengojnë zbatimin efektiv. Gjithashtu, shihni më poshtë për një përmbledhje, tabelën 20 dhe dokumentin e strategjisë së financimit të NAP-it.

Tabela 20: Plani i detajuar i financimit 2025–2028.

Sektorët	Burimet kryesore të financimit	Vëllimi i përlogarit (dollarë amerikanë)	Angazhimi kombëtar	Angazhim ndërkombëtar	Hendeku	Periudha kohore	Gatishmëria për propozim	Institucionet kryesore	Modaliteti i bashkëfinancimit / përputhja e donatorëve
Ndërsektoriale	FGJK-ja; buxheti i Ministrisë së Financave; grante teknike dypalëshe	256.721.396	6.705.576	35.000	249.980.820	2025–2035	Tremujori i dytë i vitit 2025 (dokument koncepti i FGJK-së)	Ministria e Financave; MTM; NDA	30% etiketim kombëtar; grantet e FGJK-së; mbështetja teknike e UNDP-së
Bujqësia	FGJK-ja; buxheti i FM-së; IFAD; IPARD-i i BE-së	678.114.861	97.740.426	51.037.406	529.337.029	2025–2029	Tremujori i tretë i vitit 2025 (propozimi i plotë i FGJK-së)	Ministria e Bujqësisë; MTM; NDA	30% e buxhetit kombëtar; në përputhje me linjat e IPARD-it dhe IFAD-it të BE-së
Pylltari	Banka Botërore (BNRZH); FGJK-ja; grantet dypalëshe	2.134.799.557	193.912.596	6.924.050	1.933.962.911	2026–2028	Tremujori i katërt i vitit 2025 (koncepti i BNRZH-së)	Ministria e Mjedisit, MF	Hua e kombinuar nga BNRZH-ja + 25% bashkëfinancim nga bashkitë
Turizmi	IPA III e BE-së; BERZH-i; PPP-të e sektorit privat	8.491.619	4.346.901	10.285.819	0	2026–2029	Tremujori i katërt i vitit 2025 (gazsjellësi i IPA-s së BE-së)	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit; NDA; Autoritetet vendore	PPP-të me operatorët turistikë; bashkëfinancim nëpërmjet Programit të BE-së për Turizmin
Zhvillimi urban	Banka Botërore (IDA); FGJK-ja; buxheti bashkiake	2.723.161.544	4.060.192	23.491.259	2.695.610.093	2026–2030	Tremujori i parë i vitit 2026 (dokument koncepti i IDA-s)	Ministria e Infrastrukturës; MTM; Bashkitë	25% e buxhetit bashkiak; hua koncesionare të MDB-s; grantet e IFC-së
Energjia	BEI; Banka Botërore (BNRZH); IFC-ja	1.960.573.000	224.477.993	72.482.385	1.663.612.622	2027–2031	Tremujori i dytë i vitit 2026 (Shprehje interesi nga BEI)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; NDA	Kuadrot e PPP-ve; garancitë e KE-së; 20% kapital privat
Transporti	BEI; BERZH; buxheti kombëtar	2.038.835.000	1.228.960	2.455.520	2.035.150.520	2027–2032	Tremujori i tretë i vitit 2026 (Misioni i vëzhgimit i BERZH-it)	Ministria e Infrastrukturës; MF; Bashkitë	Huat koncesionare të MDB-së; fondet kombëtare të përputhjes

Strategjia e Financimit të NAP-it shënon hap vendimtar drejt krijimit të një të ardhmeje me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, duke ofruar një plan të qartë për të mobilizuar miliardat e nevojshme për përshtatje, duke kombinuar burimet ndërkombëtare, vendase dhe private përmes mjeteve praktike dhe novatore të financimit. Strategjia përputhet me objektivat e integritetit në BE dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, duke theksuar partneritete të forta midis qeverisë, partnerëve të zhvillimit, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Suksesi do të varet nga angazhimi

i qëndrueshëm politik, koordinimi efektiv dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve. Teksa sfidat vijojnë, si për shembull, sigurimi i investimeve private, përmbushja e kriterëve të donatorëve dhe forcimi i përdorimit efektiv të fondeve, përfitimet e përshtatjes së hershme dhe proaktive i tejkalojnë kostot e mosveprimit. Duke e përkthyer këtë strategji në investime konkrete në infrastrukturë me aftësi ripërtëritëse, bujqësi inteligjente ndaj klimës dhe mbrojtje të ekosistemit, Shqipëria mund të mbrojë ekonominë dhe komunitetet e saj, duke zbuluar njëkohësisht mundësi të reja për rritje të qëndrueshme. Me zbatimin në proces, përfshirë propozimin e FGJK-së dhe etiketimin e buxhetit për klimën deri në vitin 2025, Shqipëria është e gatshme të bëhet model rajonal për financimin për aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës përmes largpamësisë, bashkëpunimit dhe veprimit.

10. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE TË NXËNIT

Zbatimi efektiv i Planit Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë kërkon një sistem për të ndjekur progresin, për të vlerësuar efektivitetin dhe për të nxitur të nxënit e vazhdueshëm. Për këtë qëllim, u hartua një dokument kuadër i brendshëm i **monitorimit, vlerësimit dhe të nxënit (MVN)** për të vënë në funksion një sistem gjithëpërfshirës dhe të integruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe politik të Shqipërisë dhe të udhëhequr nga dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 889/2022.

Në këtë kuadër, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 889/2022 përcakton zyrtarisht kuadrin e Shqipërisë për monitorimin dhe raportimin për klimën, duke përcaktuar themelet institucionale dhe procedurale për funksionalizimin e sistemit MVN. Ai specifikon se:

1. Monitorimi i masave kombëtare të përshtatjes përfshin mbledhjen sistematike të informacionit nga institucionet përgjegjëse për të gjurmuar ecurinë e veprimeve të përshtatjes dhe arritjen e objektivave të përshtatjes të përcaktuara në NAP.

2. Monitorimi përfshin mbledhjen e të dhënave nga institucionet që operojnë në sektorët e prekur nga ndryshimet klimatike, duke përfshirë ujin, bujqësinë, turizmin, biodiversitetin, pylltarinë, energjinë, transportin, infrastrukturën dhe zhvillimin urban.

3. Vlerësimi i veprimeve të përshtatjes përqendrohet në përcaktimin e efektivitetit, ndikimit, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe në masën në të cilën janë arritur objektivat specifikë të përshtatjes.

Gjithashtu, VKM-ja nr. 889/2022, urdhëron një qasje të strukturuar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave. Ministria e Mjedisit do të jetë organi qendror për koordinimin e Monitorimit dhe Vlerësimit, mbikëqyrjen e të dhënave dhe raportimin të strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh.: UNFCCC-ja, BE-ja. Ministritë e linjës dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) duhet t'i vënë në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) të dhëna mbi masat e përshtatjes çdo vit (deri më 31 mars), duke ndjekur formatet e VKM-së. Pikat e Fokale Sektoriale nga ministritë përkatëse të sektorit, në bashkëpunim me njësitë e tyre përkatëse statistikore, mbledhin dhe raportojnë të dhëna monitorimi specifike për sektorin në MM/AKM, bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Pastaj AKM-ja verifikon dhe përpunon raportet dhe të dhënat e marra sipas metodologjisë së MV-së të miratuar nga ministri.

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEUM) dhe institucione të tjera kërkimore sigurojnë informacione të lidhura me klimën, zhvillojnë studime dhe mbështesin zhvillimin e metodologjive dhe instrumenteve teknike në sistemin MRV (Matja, Raportimi dhe Verifikimi) për ndryshimin e klimës. Instituti i Statistikave (INSTAT) siguron të dhëna socio-ekonomike mbi popullsinë dhe të dhëna të tjera përkatëse. Edhe sektori privat mund të paraqesë të dhëna dhe të kontribuojë në MV nëpërmjet angazhimit në nismat e përshtatjes. GPPNK në kuadër të GNPVK koordinon mbledhjen, shqyrtimin dhe dorëzimin e këtyre raporteve. Po ashtu, sistemi i MV i NAP-it mbështet përputhshmërinë e Shqipërisë me detyrimet e saj ndërkombëtare dhe rajonale të raportimit, p.sh. ndaj UNFCCC-së (veçanërisht raportet dyvjeçare të transparencës,

komunikimet e përshtatjes dhe komunikimet kombëtare), si dhe ndaj Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në vijim të VKM-së dhe konsideratave të mësipërme, ky kuadër i Monitorimit, Vlerësimit dhe të Nxënit (MVN) është zhvilluar përmes një procesi më të gjerë konsultimi. Zbatimi i sistemit MVN në NAP do të:

- Mbështesë transparencën dhe llogaridhënien përmes ndarjes së rezultateve me palët e interesit dhe publikun, duke rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë.
- Garantojë ndjekjen gjithëpërfshirëse të progresit, duke trajtuar kështu nevojat e grupeve të ndryshme të popullsisë dhe rajoneve të ndryshme.
- Promovojë bashkëpunimin, koordinimin dhe ndarjen e njohurive ndërsektoriale.
- Përmirësojë eficiencën e burimeve duke përdorur të dhënat dhe instrumentet ekzistuese, si dhe duke forcuar argumentin për përshkallëzimin e qasjeve të suksesshme.
- Nxisë të nxënit.
- Kontribuojë në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë sipas kornizave të BE-së dhe atyre ndërkombëtare.

10.1 Kuadri i rezultateve

Kuadri i zhvilluar nga MVN e NAP-it përbëhet nga Kuadri i rezultateve, i cili paraqet se si masat e NAP-it do t'i bëjnë sektorët prioritarë më të qëndrueshëm dhe me aftësi ripërtëritëse, të mbështetur nga zbatimi i masave ndërsektoriale që do të forcojnë kapacitetin përshtatës në të gjithë këta sektorë. Kjo, në fund, do të çojë drejt përmbushjes së objektivit të NAP-it, që është: “Shqipëria e aftë të përshtatet ndaj ndryshimeve klimatike përmes reduktimit të cenueshmërisë, rritjes së qëndrueshmërisë dhe forcimit të kapacitetit përshtatës”, në përputhje me objektivat kryesore të UNFCCC, Objektivin Global për Përshtatjen (OGP) dhe Strategjinë Evropiane për Përshtatjen ndaj Klimës. Kjo, me kalimin e kohës, duhet të çojë drejt Objektivit Kombëtar të Përshtatjes, që është: “Një Shqipëri me aftësi ripërtëritëse e përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike”, që do të mbështesë vizionin e përgjithshëm e: “Një Shqipërie dinamike, të sigurt, të begatë dhe të qëndrueshme, që është e lidhur ngushtë me Evropën”, siç është përshtatur nga SKZHIE. Shikoni figurën 21, më poshtë:




Figura 21: Kuadri i rezultateve të NAP-it.

Kuadri i rezultateve i mësipërm i referohet masave të zbatimit të NAP-it, të përmendura në tabelën 10 në dhe të detajuara më tej në **aneksin III**, ku janë detajuar veprimtaritë dhe treguesit.

10.2 Komponenti i monitorimit

Komponenti i monitorimit i MVN-së ndjek progresin e zbatimit të NAP-it përmes një sistemi të strukturuar treguesish. Sistemi MVN përdor tregues cilësorë dhe sasiorë që ndjekin progresin për:

1. Forcimin e aftësive ripërtëritëse (2 tregues), reduktimin e cenueshmërisë (2) dhe përmirësimin e kapacitetit përshtatës (5) në nivel kombëtar (shihni kuadrin e rezultateve më sipër);

2. Rezultatet e përshtatjes sektoriale (25 tregues, shihni kuadrin e rezultateve më sipër);

3. Zbatimi i masave individuale të përshtatjes (165 tregues, shihni kuadrin e rezultateve më sipër dhe aneksin IV: Plani i Veprimit, që propozon treguesit për 66 masat).

Përveç treguesve të performancës, është zhvilluar një grup plotësues treguesish të procesit për të monitoruar përparimin në aspektin institucional, rregullator, financiar dhe të koordinimit në kuadër të NAP-it. Këta tregues nuk masin rezultatet direkte ose ndikimet e masave të përshtatjes, por monitorojnë ngritjen dhe forcimin e sistemeve dhe mjedisit mundësues që kërkohet për një përshtatje të qëndrueshme dhe të efektshme të kuadrit të NAP-it të dytë. Treguesit e përzgjedhur bazohen në praktikat më të mira nga kornizat e konsoliduara (GIZ, TAMD, OECD) dhe janë përshtatur sipas strukturës së qeverisjes në Shqipëri dhe nevojave të zbatimit të NAP-it.

Tabela 21: Treguesit e procesit të NAP-it:

Emërtimi i treguesit	Niveli	Njësia matëse	Institucionet përgjegjëse	Objektivi specifik i lidhur me treguesin	Klasifikimi i treguesve	Burimi i të dhënave për monitorimin e ecurisë së treguesit	Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Përshkrimi / Metodologjia
Funksionaliteti i GNPKNK-së	Kombëtar	Përqindja e takimeve formale të mbajtura me pjesëmarrjen e të paktën 80% të institucioneve anëtare	Ministria e Mjedisit, Sekretariati i GNPKNK-së	Sigurimi i efektshmërisë operacionale të Grupit Ndërmësor të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK)	Vlerësimi sasior	Procesverbalet e takimeve të GNPKNK-së, listat e pjesëmarrjes, raportet e sekretariatit	Sekretariati i GNPKNK-së, MM	Mat rregullsinë dhe gjithëpërfshirjen në takimet formale të GNPKNK-së. Fokusohet në shpeshësinë e takimeve dhe nëse është arritur kuorumi (80% e institucioneve anëtare).
Shkalla e zbatimit të masave të përshtatjes	Kombëtare / Nënkombëtare	Përqindja e masave të përshtatjes me prioritet sipas NAP-it, të planifikuara për zbatim gjatë vitit.	MM, Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV), Pikat Fokale Rajonale të Klimës	Monitorimi i përparimit vjetor të zbatimit të masave të përshtatjes me prioritet sipas NAP-it, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel nënkombëtar.	Vlerësimi sasior	Raportet vjetore të progresit nga MTM dhe NJQV-të	MM, NJQV-të, Pikat Fokale Rajonale të Klimës	Llogarit përqindjen e masave afatshkurtra prioritare të përshtatjes (siç përcaktohen në Planin e Zbatimit të NAP-it) që janë zbatuar në mënyrë të efektshme brenda afatit të planifikuar.
Integrimi i përshtatjes në kuadrot sektoriale dhe kombëtare të politikave	Kombëtare / Sektoriale	Përqindja e dokumenteve të miratuara të politikave që integrojnë masat e përshtatjes ndaj klimës të lidhura me NAP-in.	MM, Ministrinë e linjës:	Vlerësimi i shkallës të integritetit të objektivave të përshtatjes ndaj klimës në instrumentet e reja ose të rishikuara të politikave	Vlerësimi sasior	Dokumente zyrtare të politikave, botime ministrorë, raporte monitorimi të MTM/NAP-it.	MM, Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike dhe Politikave Mjedisore, Pikat fokale për klimën në ministrinë e linjës	Rishikimi i të gjitha dokumenteve të politikave të miratuara në nivel kombëtar dhe sektorial gjatë një periudhe dyvjeçare, për të identifikuar nëse integrojnë qartazi masat për përshtatjen ndaj klimës, që përputhen me prioritetet e NAP-it.
Disponueshmëria dhe aksesueshmëria në financimin e përshtatjes	Ndërsëktoriale	(a) Dollarë amerikanë të alokuar dhe të shpërndarë çdo vit; (b) % e fondeve të shpërndarë në nivelet nënkombëtare/vendore	MM	Monitorimi i disponueshmërisë së fondeve për përshtatje dhe shkallën në të cilën fondet arrijnë aktorët e decentralizuar/vendore.	Vlerësimi sasior	Raportet e buxhetit kombëtar, të dhënat e shpërndarjes së donatorëve, mjetet e ndjekjes së financave klimatike të MF/MTM.	Ministria e Financave MM	Gjurmimi i të gjithë financimeve (kombëtare dhe ndërkombëtare) të alokuara dhe të shpërndara për veprimet e përshtatjes të lidhura me NAP-in për çdo vit. Një komponent i dytë ndjek pjesën e këtij financimi që është përfituar në nivel nënkombëtar/vendor.
Angazhimi i palëve të interesit në procesin e NAP-it	Niveli bashkiak / kombëtar	Numri i instrumenteve të pilotuara për angazhimin e palëve të interesit	MM, NJQV-të, Organizata të shoqërisë civile (OSHC)	Sigurimi që konsultimet me palët e shumta të interesit dhe instrumentet pjesëmarrëse të integrohen dhe funksionojnë në të gjitha nivelet gjatë zbatimit të NAP-it	Vlerësimi sasior	Të dhënat e angazhimit të palëve të interesit të MTM-së, raportet nga NJQV-të dhe OSHC-të	Të dhënat e angazhimit të palëve të interesit të MM-së, raportet nga NJQV-të dhe OSHC-të	Matja e numrit të mekanizmave të angazhimit të palëve të interesit të pilotuar formalisht gjatë vitit të raportimit si pjesë e procesit të zbatimit të NAP-it. Instrumentet mund të përfshijnë <i>workshop</i> -e, konsultime vendore, nisma shkencore qytetare, ose platforma të reagimit digjital.
Numri i zyrtarëve të trajnuar në planifikimin e përshtatjes dhe MRV	Kombëtare / Nënkombëtare	Numri i individëve	MM	Garantimi që stafi përkatës në të gjithë sektorët dhe nivelet të pajiset me njohuritë për të integruar përshtatjen në proceset e planifikimit dhe MRV.	Vlerësimi sasior	Raportet e trajnimit, regjistrimi i pjesëmarrjes, të dhënat institucionale të MV-së.	Departamenti për Ndryshimet Klimatike i MM-së	Ky tregues përcakton numrin e individëve unikë të trajnuar çdo vit në tema të lidhura me planifikimin e përshtatjes dhe/ose MRV-së. Pjesëmarrësit duhet të kenë përfunduar të paktën 75% të seancave të trajnimit dhe të kenë marrë një certifikatë
Disponueshmëria e vlerësimeve të përditësuara të riskut klimatik	Sektoriale	Numri i vlerësimeve	MM, Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO)	Garantimi i disponueshmërisë së informacionit të përditësuar të riskut dhe cenueshmërisë klimatike në sektorët kyç për të informuar planifikimin e përshtatjes.	Vlerësimi sasior	Raportet e vlerësimit sektorial, botimet e IGJEO-s, arkivat e MM-së	IGJEO, Ministrinë sektoriale, Departamenti për Ndryshimet Klimatike i MM-së	Ky tregues gjurmon numrin e vlerësimeve zyrtare të riskut dhe cenueshmërisë të përditësuara gjatë ciklit të raportimit dhe identifikon mbulimin e tyre në sektorë të ndryshëm.
Rishikime katërvjeçare të zbatimit të NAP-it	Kombëtar	Po/Jo; Numri i vlerësimeve të zhvilluara; në rrugën e duhur / devijuar	Grupi Ndërmësor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK)	Garantimi i vlerësimit të rregullt dhe në kohë të progresit në zbatimin e masave të përshtatjes dhe trajtimit i pengesave.	Analiza cilësore, sasiore dhe të përbëra	Raportet zyrtare të rishikimit të zbatimit të KPK-së, raportimi i brendshëm i MTM-së, procesverbalet e takimeve	Grupi Ndërmësor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK)	Tregues i përbërë që ndjek (1) nëse rishikimi katërvjeçar është kryer (Po/Jo), (2) numrin total të rishikimeve të kryera sipas kalendarit, dhe (3) vetëvlerësimin cilësor të progresit (në rrugë e duhur / devijuar) të nxjerra nga gjetjet e rishikimit.

10.3 Komponenti i vlerësimit

Funksioni i vlerësimit i MVN-së ka për synim interpretojë të dhënat e përpunuara për të kuptuar se çfarë është arritur, çfarë mbetet për t'u përmirësuar dhe si kontribuojnë veprimet e përshtatjes në uljen e nivelit të cenueshmërisë dhe forcimin e aftësive ripërtëritëse me kalimin e kohës, nëpërmjet:

- **Rezultateve të përshtatjes**, përfshirë këtu ndryshimet në nivelin e cenueshmërisë, ekspozimin dhe kapacitet për përshtatje, si dhe forcimin e aftësive ripërtëritëse në nivel kombëtar dhe vendor; dhe

- **Performancës së procesit të NAP-it**, duke përfshirë efektshmërinë e strukturave të qeverisjes, koordinimin ndërinstitucional, zbatimin në nivel sektorial dhe përafrimin me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të përshtatjes.

Shihni tabelën 22, më poshtë, modalitetet dhe përgjegjësitë e vlerësimit:

Tabela 22: Modalitetet dhe përgjegjësitë e vlerësimit.

Mekanizmi	Institucionet drejtuese	Qëllimi	Frekuenca	Produktet	Pjesëmarrësit
1. Vlerësimi vjetor i performancës	MM, AKM	Ndjekja e progresit drejt objektivave të NAP-it dhe PVP-së duke përdorur treguesit	Çdo vit (deri më 31 mars)	Raport vjetor i sintezës; përditësime në panelin e treguesve	Ministritë sektoriale, bashkitë, AKM, INSTAT
2. Vlerësim i pavarur dyvjeçar	Vlerësues i jashtëm i porositur nga MM-ja	Vlerësimi i efektshmërisë, ndikimit, eficientës dhe qëndrueshmërisë; informon KPT-në e UNFCCC-së	Çdo 2 vjet (deri më 15 maj)	Raporti i vlerësimit të pavarur	MM, AKM, GNPKN/GPPNK, ekspertë të jashtëm
3. <i>Workshop</i> -e të vlerësimit sektorial	Ministritë sektoriale, GNPKN/GPPNK,	Vlerësimi i progresit specifik për sektor, identifikimi i pengesave dhe propozimi i korrigjimeve të kursit të veprimit	Çdo vit ose çdo dy vite	Raportet e <i>workshop</i> -eve; planet e përditësuara të veprimit	Pikat fokale të sektorit, institute kërkimore
4. Shqyrtimi i të nxënir në nivel vendor	Pikat fokale të PVP-së / bashkitë	Reflektimi mbi zbatimin e PVP-së, mbledhja e reagimeve në nivel vendor, vlerësimi i efektshmërisë	Çdo vit	Raportet vendore të të nxënir	Aktorët bashkiakë, komunitetet, OSHC-të vendore
5. Cikli i reagimeve për MVN-në / menaxhimi përshtatës	MM, AKM, GNPKN	Përshtatja e politikave dhe planifikimit në bazë të gjetjeve të MVN-së	Në zbatim e sipër	Masat e përditësuara të NAP/PVP, rishikimi i treguesve	Të gjithë organet raportuese, planifikuesit
6. Kuadri i treguesve MVN	MM, AKM, INSTAT, Akademikët	Garantimi që treguesit janë praktikë, të matshëm dhe në përputhje me objektivat	Rishikohet çdo dy vite	Matriksa e treguesve MVN	Ekspertët teknikë, ofruesit e të dhënave
7. Platforma e shqyrtimit të palëve të interesit	MM, OSHC, Akademikët	Promovimi i transparencës, mbledhja e reagimeve, mbështetja e llogaridhënies	Çdo vit	Raportet publike, paneli i treguesve, të dhënat nga palët e interesit	Publiku i gjerë, sektori privat, akademikët, OSHC-të.

10.4 Komponenti i të nxënir

Funksioni i të nxënir në sistemin MVN është hartuar për të:

- Forcuar kujtesën institucionale duke identifikuar çfarë funksionon, çfarë jo dhe pse;
- Promovuar menaxhimin përshtatës duke integruar mësimet e nxjerra në planifikimin në zbatim e sipër dhe atë të ardhshëm;
- Nxitur bashkëpunimin ndërsektorial dhe ndarjen e njohurive;
- Ngritur kapacitetet në nivel kombëtar dhe vendor për zhvillimin e aftësive ripërtëritëse klimatike.

Kjo do të institucionalizohet përmes mjeteve në vijim:

- Platforma kombëtare për ndarjen e njohurive, e cila do të shërbejë si arkiv digjital për të informacionin rreth përshtatjes, praktikave të mira dhe mjeteve për mbështetjen e vendimeve.
- Ofriti të mbështetjes për komunitetet e praktikës dhe grupet sektoriale të punës për të vazhduar dialogun midis cikleve të planifikimit dhe gjatë viteve të raportimit.
- Vlerësimet e të nxënir në nivel vendor do të zhvillohen çdo vit nga pikat fokale të bashkive dhe PVP-së.
- Zhvillimit të *workshop*-eve për vlerësimin sektorial çdo vit ose çdo dy vite nga ministritë sektoriale, në koordinim me GNPKN-në dhe GPPNK-në.
- Platformave kombëtare të palëve të interesit, të drejtuara nga MM dhe GNPKN, të cilat do të bëjnë bashkë përfaqësues nga ministritë e linjës, akademikët, organizata të shoqërisë civile dhe sektori privat.
- Produkte publike të dijes, si panele treguesish, përmbledhje të politikave, dhe raporte të sintezuara të të nxënir, për të siguruar që gjetjet e vlerësimit dhe mësimet e nxjerra të shpërndahen gjerësisht.

Gjetjet e nxjerra përmes sistemit MVN, përfshirë përfundimet e vlerësimit, rishikimet e të nxënir dhe reagimet e palëve të interesit, do të integrohen në mënyrë formale në iteracionin tjetër të ciklit të zbatimit të NAP-it, përmes:

- **Rishikimit të masave të përshtatjes**, veçanërisht atyre që shfaqin efektshmëri të kufizuar ose kërkojnë përshtatje.
- **Rregullimit të treguesve** në kuadrin MVN për të pasqyruar më mirë risqet e reja, prioritetet dhe disponueshmërinë e të dhënave.

- Përmirësimi të koordinimit të mekanizmave, bazuar në vlerësimin e pengesave dhe mbivendosjes institucionale

Ristrukturimit të përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë mbështetjen për qeveritë vendore dhe angazhimin ndërsektorial.

Rezultatet e rishikimit të mesëm të NAP 2030 do të shërbejnë si udhërrëfyes për planifikimin katërvjeçar të ardhshëm të përshtatjes në Shqipëri dhe do të ndikojnë në zbatimin e mëtejshëm, duke kontribuar në përditësimin e Planit të Zbatimit të NAP-it dhe të komponentëve të sistemit MVN, përfshirë Matricën e Referencës së Treguesve dhe Fletët e Referencës së Treguesve.

Zbatimi i sistemit MVN për NAP-in e Dytë të Shqipërisë do të ndjekë një qasje me faza, të renditura më poshtë:

Faza 1: Organizimi institucional. Kjo fazë do të përqendrohet në krijimin dhe komunikimin e marrëveshjeve institucionale të nevojshme për të mbështetur kuadrin MVN të NAP-it.

Faza 2: Ngritja e kapaciteteve për MVN-në: Ngritja e kapaciteteve të synuara do të kryhet për të pajisur palët e interesit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zbatuar kuadrin MVN.

Faza 3: Testimi pilot. Kuadri MVN do të jetë pjesë e testimit pilot për gjurmimin e progresit të zbatimit të NAP-it gjatë vitit 2026, vitit të parë të zbatimit të NAP-it. Mësimet e nxjerra gjatë kësaj faze do të dokumentohen për prezantime më të gjera.

Faza 4: Operacionalizimi. Duke filluar nga viti 2027, kuadri MVN do të operacionalizohet plotësisht, ku do të përfshihet edhe validimin i treguesve dhe fletëve të referencës për të gjitha masat e mbetura të KPK-së.

Faza 5: Rishikimi dhe përsosja. Faza përfundimtare do të përqendrohet në vlerësimin e performancës së NAP-it në krahasim me kuadrin e rezultateve përkatëse, që do të zhvillohet nëpërmjet shqyrtimit afatmesëm të vitit 2030 dhe nëpërmjet një vlerësimi përfundimtar në vitin 2036.

LISTA E REFERENCAVE

Adapting to Climate Change: A Planning Guide for State Coastal Managers (n.d.). [Përshtatja me ndryshimet klimatike: Një Udhëzues planifikimi për menaxherët shtetërorë të zonave bregdetare] (n.d). SHBA. *Climate Resilient Toolkit* [Paketa e masave për aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës].

Adapting to Climate Change: CDP Guidance for UK Local Authorities. [PËRSHTATJA ME NDRYSHIMET KLIMATIKE: Udhëzuesi i KMD-së për autoritetet vendore të MB-së] (2022). KMD.

Plani i përshtatjes i Mongolisë (2024–2030). Qeveria e Mongolisë.

Komunikimi i tretë kombëtar i Shqipërisë 3. (2016). Qeveria e Shqipërisë.

Komunikimi i katërt kombëtar i Shqipërisë 4. (2022). Qeveria e Shqipërisë.

Kontributi Kombëtar Pikësnyar (KKP) i rishikuar për Shqipërinë. (2021). Qeveria e Shqipërisë

Raporti i Parë Dyvjeçar i Shqipërisë. (korrik, 2021). Qeveria e Shqipërisë.

Plani Kombëtar i Përshtatjes i Shqipërisë: Raporti i parë i progresit (mars, 2023) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Shqipëri, Rrjeti botëror i NAP-it.

Baastel. (2024). *Climate Risk Assessment of the Agricultural Sector: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis* [Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e bujqësisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike**].

Baastel. (2024). *Climate Risk Assessment of the Energy Sector: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis*. [Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e

energjisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike].

Baastel. (2024). *Climate Risk Assessment of the Tourism Sector: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis* [Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e turizmit: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike].

Baastel. (2024). *Climate Risk Assessment of the Transport Sector: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis* [Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e transportit: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike].

Baastel. (2024). *Climate Risk Assessment of Urban Development: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis* [Vlerësimi i riskut klimatik në sektorin e zhvillimit urban: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike].

Baastel. (2024). *Cross-Sectoral Risk Assessment* [Vlerësimi i riskut ndër-sektorial].

Baastel. (2024). *Identification of Adaptation Measures [Identifikimi i masave të përshtatjes]*. *Albania National Adaptation Planning: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis* [Plani Kombëtar i Përshtatjes i Shqipërisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike].

Baastel. (2024). Planet vendore të përshtatjes për tetë bashkitë: Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Përmet dhe Vlorë.

California Adaptation Planning Guide [Udhëzuesi i Planifikimit për Përshtatjen në Kaliforni]. (2020). Shteti i Kalifornisë.

City of Tirana [Qyteti i Tiranës]. (2015). *Adapting Our City to a Changing Climate: Vulnerability Assessment and Adaptation Action Plan for Tirana* [Përshtatja e qytetit tonë ndaj ndryshimeve klimaterike: Vlerësimi i cenueshmërisë dhe plani i veprimit për përshtatje për Tiranën].

Climate and Socio-Economic Data Compiled and Analysed for the Agriculture Sector, Including Socio-Economic Indicator Modelling [Të dhënat klimatike dhe socio-ekonomike të mbledhura dhe të analizuara për sektorin bujqësor, duke përfshirë modelimin e treguesve socio-ekonomikë]. (n.d.). Paolo Bacca & Narin Panariti. UNDP.

Climate Change 2022: Impacts, Adaptation and Vulnerability [Ndryshimet klimatike 2022: Ndikimet, përshtatja dhe cenueshmëria]. (2022). Paneli ndërqeveritar për ndryshimet klimatike (PNNK). Raporti i gjashtë vlerësues, UNFCCC.

Climate Change Adaptation and Resilience Planning: Programme Summary and Guide for Cities [Planifikimi i përshtatjes dhe qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike: Përmbledhje e programit dhe udhëzues për qytetet]. (2023), KMD.

Strategjia për Ndryshimet Klimatike në Shqipëri 2020–2030: Monitorimi i Planit të Veprimit 2019–2021. (janar, 2022). Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Shqipëri.

Climate Risk Country Profile: Albania [Profili i riskut klimatik i vendit: Shqipëri]. (2021). Banka Botërore.

Commission Staff Working Document [Dokument Pune i Stafit të Komisionit]. (2023). *Albania 2023 Report: Communication on EU Enlargement Policy* [Raporti i Shqipërisë 2023: Komunikimi për politikën e zgjerimit të BE-së]. Komisioni Evropian.

Cross-Sectoral Risk Assessment [Vlerësimi i riskut ndër-sektorial]. Baastel. (2024).

EU Adaptation Strategy: Forging a Climate Resilient Europe – A New EU Adaptation Strategy. (2021) [Strategjia e përshtatjes së BE-së: Ndërtimi i një Evrope të qëndrueshme ndaj klimës – një strategji e re e përshtatjes së BE-së]. Komisioni Evropian.

European Climate Law [Ligji Evropian për Klimën] (2021). Bashkimi Evropian.

European Climate Risk Assessment Report [Raporti evropian i vlerësimit të riskut klimatik]. (2024). Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM).

Forging a Climate Resilient Europe – The New EU Strategy on Adaptation to Climate Change [Ndërtimi i një Evrope të qëndrueshme ndaj klimës – strategjia e re e BE-së për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike]. (2021). Komisioni Evropian.

Gap Analysis of IGEO: Contribution to Climate Services and the NAP [Analiza e mangësive e IGJEO: kontributi në shërbimet klimatike dhe NAP]. (n.d.) Narin Panariti & Paolo Bacca. UNDP.

Identification of Adaptation Measures [Identifikimi i masave të përshtatjes]. (2024). *Albania National Adaptation Planning: Support to Filling Gaps in Climate Change Adaptation Data and Risk Analysis* [Plani Kombëtar i Përshtatjes i Shqipërisë: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike]. Baastel.

Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik (janar, 2023). *Report on National Capacity and Training Needs Assessment on Climate Change Adaptation* [Raporti për vlerësimin e kapaciteteve kombëtare dhe nevojave për trajnime në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike](PNK).

Inventory of Sectoral, Territorial, and International/Regional Adaptation Projects, and of NGO-Driven Adaptation Activities [Inventari i projekteve të përshtatjes sektoriale, territoriale dhe ndërkombëtare/rajonale, si dhe i veprimtarive të përshtatjes të drejtuara nga OJQ-të]. (n.d.). Paolo Bacca & Narin Panariti. UNDP.

Gjetjet kyçe të Raportit 2023 për Shqipërinë (2023). Bashkimi Evropian.

Ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, i ndryshuar. Republika e Shqipërisë.

Grupi i ekspertëve për vendet më pak të zhvilluara. (2012). *National Adaptation Plans: Technical Guidelines for the National Adaptation Plan Process* [Planet kombëtare të përshtatjes: udhëzime teknike për procesin e planit kombëtar të përshtatjes]. Bonn, Gjermani: Sekretariati i UNFCCC.

Planet vendore të përshtatjes për tetë bashkitë: Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Përmet dhe Vlorë. (2024). Baastel.

Moldova National Climate Change Adaptation Programme Until 2030 [Programi kombëtar i Moldavisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2030]. (2023). Qeveria e Moldavisë.

Municipalities Capacities and Training Needs Assessment on Climate Change Adaptation [Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave për trajnime të bashkive në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike]. (shkurt, 2023). Joël Ruet & Ledina Gjoknuri. UNDP.

National Adaptation Planning (NAP) to Climate Change in Albania: Framework for the Country Process [Plani Kombëtar i Përshtatjes (NAP) ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri: Kuadri për Procesin e Vendit]. (2019). Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Shqipëri.

Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive 2023–2030. (2023). Qeveria e Shqipërisë.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030. (2023). Qeveria e Shqipërisë.

Strategjia kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020. (2015). Qeveria e Shqipërisë.

Outcome of the First Global Stocktake: Draft Decision [Rezultati i vlerësimit të parë global: Projektvendimi] -/CMA.5. (2023). Konferenca e palëve që shërbeu si takimi i palëve për Marrëveshjen e Parisit. Emiratet e Bashkuara Arabe UNFCCC.

Marrëveshja e Parisit. (2015). Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKNK)

Planning for Adaptation to Climate Change: Guidelines for Municipalities [Plani për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike: Udhëzime për bashkitë]. (n.d.). BE/ACT.

Report on Socio-Economic Scenarios [Raport për skenarët socio-ekonomikë]. (2023). Elona Pojani. UNDP.

Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans [Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor]. (2020). Bashkimi Evropian.

Stocktaking Report for the NAP Process in Albania [Raporti i pasqyrimin për procesin e NAP-it në Shqipëri]. (dhjetor, 2022). Paolo Bacca, Narin Panariti, et al. UNDP.

The Adaptation Support Tool. (n.d.). *Climate-ADAPT*, European Environment Agency (EEA) [Instrumenti i mbështetjes për përshtatje. (n.d.). Climate-ADAPT, Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM)]. <https://climate-adapt.eea.europa.eu/en/knowledge/tools/adaptation-support-tool>.

UNDP. (n.d.). *Prodoc: Advancing Albania's Planning for Medium and Long-Term Adaptation Through the Development of a National Adaptation Planning (NAP) Process* [Prodok: avancimi i planit të Shqipërisë për përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë përmes zhvillimit të një procesi kombëtar të planifikimit të përshtatjes (NAP)].

Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara. (2023). *Adaptation Gap Report 2023: Underfinanced. Underprepared. Inadequate Investment and Planning on Climate Adaptation Leaves World Exposed* [Raporti i mangësive në përshtatje 2023: I nënfinancuar. I papërgatitur. Investimi dhe planifikimi i pamjaftueshëm në përshtatjen ndaj klimës e lënë botën të ekspozuar]. Nairobi.

Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara. (2023). *National Adaptation Planning: Emerging Lessons Learned from UNEP Projects* [Plani Kombëtar i Përshtatjes: Mësimet e nxjerra nga projektet e UNEP-it]. Nairobi.

Deklarata e Zagrebit. (6 maj 2020). Bashkimi Evropian.

ANEKSET

ANEKS I

PËRMBLEDHJE E KUADRIT RREGULLATOR DHE POLITIKAVE

Përmbledhje e legjislacionit kryesor, politikave, planeve dhe strategjive, lidhur me veprimet klimatike:

Tabela 23: Kuadri Legjislativ dhe Rregullator.

Legjislacioni	Viti	Përmbledhje
Ligji nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura"	2017	Përcakton rregulloret për ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, duke forcuar mbrojtjen e biodiversitetit, restaurimin ekologjik dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për mjedisin.
Ligji nr. 9867, "Për rregullat dhe procedurat që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare të specieve të egra të florës dhe faunës së rrezikuara".	2008	Rregullon tregtinë ndërkombëtare të specieve të egra të florës dhe faunës të rrezikuara, duke siguruar përputhshmërinë me CITES, parandalimin e tregtisë së paligjshme, mbrojtjen e biodiversitetit dhe përafrimin me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për ruajtjen.
Ligji nr. 9587, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"	2006	Përcakton masat për ruajtjen e ekosistemeve, specieve dhe burimeve gjenetike, parandalimin e humbjes së biodiversitetit, promovimin e përdorimit të qëndrueshëm dhe përafrimin me marrëveshjet mjedisore të BE-së dhe ato ndërkombëtare.
Ligji nr. 7/2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".	2017	Promovon përdorimin e energjisë së rinovueshme, mbështet investimet në energji të pastër, përmirëson eficiencën energjetike dhe përafron me direktivat e BE-së për të siguruar një sistem energjetik të qëndrueshëm, me nivel të ulët karboni.
Ligji nr. 9876, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve të rinovueshme"	2008	Rregullon prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve të rinovueshme, duke promovuar energjinë e qëndrueshme, reduktuar varësinë nga lëndët djegëse, reduktuar shkarkimet dhe përafruar me standardet e BE-së për energjinë e rinovueshme dhe mjedisin.
Ligji nr. 9244, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"	2004	Siguron përdorimin e qëndrueshëm të tokës, parandalon degradimin, rregullon konvertimin, promovon ruajtjen e tokës dhe përafron me politikat mjedisore dhe bujqësore për të mbrojtur sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural.

Legjislacioni	Viti	Përmbledhje
Ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”	2014	Rregullon përdorimin e tokës, planifikimin urban dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit, aftësinë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe përafrimin me standardet e BE-së për planifikimin hapësnor.
Ligji nr. 57/2020, “Për pyjet”	2020	Promovon menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, ruajtjen, pyllëzimin, mbrojtjen e biodiversitetit dhe qëndrueshmërinë klimatike, duke rregulluar përdorimin dhe qeverisjen e pyjeve, si dhe përafrimin me politikat mjedisore të BE-së.
Ligji nr. 103/2016, “Për akuakulturën”	2016	Rregullon zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e burimeve, sigurinë ushqimore dhe përafrimin me standardet e BE-së për të promovuar kultivimin e përgjegjshëm të peshqve dhe rritjen ekonomike.
Ligji nr. 64/2012, “Për peshkimin”	2012	Rregullon menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit, ruajtjen e burimeve detare, praktikën e përgjegjshme të peshkimit dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për të mbrojtur ekosistemet ujore dhe për të mbështetur industrinë e peshkimit.
Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”	2011	Përcakton rregulloret për kontrollin e ndotjes, ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, duke u përafuar me standardet e BE-së për të promovuar qëndrueshmërinë ekologjike dhe qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.
Ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, i ndryshuar	2025	Vendos kuadrin ligjor për zbutjen e shkarkimeve të gazeve serrë, përshtatjen ndaj ndikimeve të klimës, integrimin e politikave klimatike në të gjitha sektorët dhe përafrimin me detyrimet klimatike të BE-së dhe ato ndërkombëtare.
Ligji nr. 9817, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”	2007	Nxit bujqësinë e qëndrueshme, zhvillimin ekonomik rural, sigurinë ushqimore, ruajtjen e burimeve natyrore dhe përafrimin me politikat e BE-së për të rritur konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore në zonat rurale.

Tabela 24: Kuadri i politikave.

Politikat dhe planet	Viti	Përmbledhje
Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027	2022	Nxit menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, agropylltarinë, bujqësinë organike dhe qëndrueshmërinë e peshkimit, duke përmirësuar ekonominë rurale, sigurinë ushqimore dhe përputhjen me politikat mjedisore të BE-së.
Dokumenti i Politikës Pyjore 2030	2018	Përqendrohet në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, pyllëzimin, përmirësimin e qeverisjes, qëndrueshmërinë ndaj klimës dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke nxitur përfshirjen e komunitetit dhe të jetë në përputhje me politikat mjedisore dhe klimatike të BE-së.
Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEP)	2024	Synon të reduktojë shkarkimet, të përmirësojë eficientëcn e energjisë, të integrojë energjitë e rinovueshme dhe të jetë në përputhje me politikat klimatike të BE-së, duke siguruar një sistem energjetik të diversifikuar, të qëndrueshëm dhe me aftësi ripërtëritëse deri në vitin 2030.
Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike	2019	Përkshruan masat zbutëse dhe të përshtatjes në të gjithë sektorët, duke synuar reduktimin e shkarkimeve, aftësinë ripërtëritëse ndaj klimës, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe përputhjen me politikat e BE-së për të nxitur një ekonomi me nivel të ulët karboni dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës.
Plani Kombëtar i Veprimeve për Zbutjen (PKVZ)	2019	Përqendrohet në reduktimin e shkarkimeve të gazrave serrë përmes politikave të qëndrueshme të energjisë, transportit, bujqësisë dhe pylltarisë, në përputhje me objektivat klimatike të BE-së për të mbështetur një ekonomi me aftësi ripërtëritëse dhe me nivel të ulët karboni.
Strategjia e Vendit, Shqipëri 2025–2030	2025	Synon të përshpejtojë integrimin në BE duke zbatuar reforma gjithëpërfshirëse, duke shtuar efektshmërinë institucionale dhe duke nxitur rritjen e qëndrueshme ekonomike, me qëllim arritjen e anëtarësimit të plotë në BE deri në vitin 2030.
Strategjia kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020,	2016	Synon të forcojë demokracinë, të arrijë integrimin në BE dhe të promovojë një ekonomi konkurruese dhe të qëndrueshme, duke siguruar të drejtat themelore të njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.
Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024–2030	2024	Synon të promovojë rritjen e qëndrueshme të turizmit, të përmirësojë infrastrukturën dhe të ruajë trashëgiminë kulturore dhe natyrore duke u përqendruar në gjashtë shtylla kryesore: investimet, politikat fiskale dhe rregullatore, menaxhimin e destinacionit, zhvillimin e produkteve turistike, marketingun dhe ngritjen e kapaciteteve.
Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030	2021	Promovon barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe përfshirjen sociale, duke u përqendruar në pjesëmarrjen ekonomike, vendimmarrjen, parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe përputhshmërinë me politikat gjinore të BE-së dhe ato ndërkombëtare.

ANEKS II

DETAJE MBI TENDENCAT KLIMATIKE TË VËZHGUARA DHE TË PARASHIKUARA NË NIVEL VENDOR

Ky aneks paraqet informacion të detajuar mbi tendencat klimatike të vëzhguara dhe të parashikuara në nivel bashkie, duke ilustruar ndryshimet vendore të temperaturës dhe reshjeve në zona të ndryshme klimatike të Shqipërisë. Shembujt më poshtë e vërtetojnë bashki specifike për të ilustruar heterogjenitetin hapësinor të tendencave të vëzhguara.

Figura 22, më poshtë, jepet një shembull i tendencave të temperaturës të vëzhguara për Elbasanin¹³⁹.




Figura 22. Tendencat e temperaturës të vëzhguara për Elbasanin.

Burimi: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë - Grupi Ndërmënytor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) - Ministria e Mjedisit. National and Sectoral Scenario Development Report [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve]. Baastel, janar 2023.

Për më tepër, më poshtë paraqiten ndryshimet mesatare vjetore të temperaturave për dy periudha të ndryshme kohore, vitet 1961–1990 (linja të prera) dhe 2001–2010 (linja të plota) për Kukësin (veri i Shqipërisë, në Zonën Malore Mesdhetare).




Figura 23. Ndryshimet e temperaturave mesatare ditore (vëzhgime) për periudhën 1961–1990 (norma klimatologjike) dhe 2001–2010 në Kukës.

Burimi: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë – Grupi Ndërmënytor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) - Ministria e Mjedisit. National and Sectoral Scenario Development Report [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve] Baastel, janar 2023.

Sa i përket reshjeve, vëzhgimet paraqesin një reduktim prej rreth 100 mm të totalit vjetor mes viteve 1951 dhe 2001, kryesisht gjatë dimrit dhe pranverës, megjithatë nuk ka një tendencë stinore të dallueshme. Në figurën 24 më poshtë ilustron variabiliteti ndërvjetor i tendencës së reshjeve totale në Kukës.¹⁴⁰

¹³⁹Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë – Grupi Ndërmënytor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) – Ministria e Mjedisit. National and Sectoral Scenario Development Report [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve]. Baastel, janar 2023.

¹⁴⁰Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. National and Sectoral




Figura 24. Reshjet ndërvjetore totale të vëzhguara në Kukës.

Burimi: Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë - Grupi Ndërmintor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) - Ministria e Mjedisit. *National and Sectoral Scenario Development Report* [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve] Baastel, janar 2023.

Më poshtë paraqiten parashikime vendore të temperaturës, reshjeve dhe rritjes së nivelit të detit, duke plotësuar analizat në shkallë kombëtare të diskutuara në raportin kryesor. Këta shembuj ilustronë variacionin hapësinor të ndryshimeve klimatike të parashikuara në zonat kryesore klimatike të Shqipërisë.

Në Kukës,¹⁴¹ temperatura mesatare vjetore (Tmesatare) parashikohet të rritet sipas të gjithë skenarëve të shkarkimeve, ku do të vihet re një rritje më e theksuar gjatë verës dhe vjeshtës.

Deri në vitin 2050, rritjet e temperaturës mund të variojnë nga 0.9°C (SPS1-1.9) deri në 2.0°C (SPS5-8.5) në krahasim me vlerat bazë, ndërsa deri në vitin 2100, rritja mund të arrijë deri në 6.0°C në kushtet e shkarkimeve të larta. Këto tendenca do të thonë valë të të nxehtit më të shpeshta dhe më të zgjatura, veçanërisht në zonat fushore dhe kodrinore.




Figura 25. Ndryshimi i projektuar i temperaturës mesatare (Tmesatare) në dimër dhe verë (°C) për SPSx-y të ndryshme, Kukës.

Tendencat e parashikuara të reshjeve tregojnë një rënie të përgjithshme të totalit vjetor të kombinuar me një rritje të shpeshtësisë dhe intensitetit të ngjarjeve ekstreme të reshjeve. Deri në vitin 2050, reshjet parashikohet të ulen me 2–6% në vit, ku reduktimet më të rëndësishme do të prekin stinën e verës, duke arritur deri në -17% në skenarët me shkarkime të larta.

Në Lezhë, ulja e reshjeve do të shoqërohet me një variabilitet më të lartë shirave dhe me rritjen e probabilitetit të ngjarjeve të reshjeve të shkurtra dhe intensive¹⁴²:

Scenario Development Report [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve] Hartuar në kuadër të projektit të PKP-së nga UNDP-ja. Ministria e Mjedisit, janar 2023.

¹⁴¹Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. National and Sectoral Scenario Development Report [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve] Hartuar në kuadër të Projektit të PKP-së nga UNDP-ja. Ministria e Mjedisit, janar 2023

¹⁴²Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. National and Sectoral Scenario Development Report [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve] Hartuar në kuadër të Projektit të PKP-së nga UNDP-ja. Ministria e Mjedisit, janar 2023




Figura 26. Ndryshimet e parashikuara të reshjeve, vjetore dhe verore (%), zona e Lezhës.

Më në jug, Vlora shfaq modele të ngjashme, me një rënie të reshjeve mesatare vjetore dhe intensitet më të madh gjatë episodeve ekstreme të reshjeve, veçanërisht nën SSP5-8.5.




Figura 27. Ndryshimet e mundshme të reshjeve vjetore në Vlorë.

Në Gjirokastrë, pritet që reshjet të bëhen më të çrregullta dhe të shpërndara në mënyrë jo uniforme, me periudha të alternuara të thatësirës dhe lagështisë, që mund të rrisin riskun e thatësirave dhe përmbytjeve të lokalizuara.




Figura 28. Ndryshimet e mundshme të reshjeve verore sipas skenarëve të ndryshëm, Gjirokastrë.

Në bregdet, parashikimet tregojnë një rritje të qëndrueshme të nivelit të detit, ku zona e Durrësit është një ndër më të ekspozuarat. Në figurën 29, më poshtë, paraqitet parashikimi i rritjes mesatare vjetore të nivelit të detit sipas skenarëve të ndryshëm për Durrësin.¹⁴³

¹⁴³Mbështetje për plotësimin e mangësive në të dhënat dhe analizat e riskut të përshtatjes. Qeveria e Shqipërisë - Grupi Ndërmënyor i Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) – Ministria e Mjedisit. *National and Sectoral Scenario Development Report* [Raporti kombëtar dhe sektorial për zhvillimin e skenarëve] Baastel, janar 2023.




Figura 29. Parashikimi i rritjes së nivelit të detit sipas skenarëve të ndryshëm, Durrës.

ANEKS III

PLANI I DETAJUAR I ZBATIMIT TË MASAVE PRIORITARE TË PËRSHTATJES NË SHQIPËRI

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
1	Ndërsëktorial e	Forcimi i aftësive ripërtëritëse rajonale Mbështetja e udhërrëfyesit për përshtatjen e Ballkanit Perëndimor	Ndërrhyrja e butë:	1.1 Të sigurohet ekspertiza teknike dhe mbështetja këshillimore për Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal në hartimin, strukturimin dhe metodologjinë e Udhërrëfyesit Novator për Përshtatjen ndaj Klimës, duke garantuar që ai të pasqyrojë cenueshmëritë rajonale, nevojat sektoriale dhe parashikimet klimatike deri në vitin 2050. 1.2 Të kontribuohet në zhvillimin e udhërrëfyesit duke shqyrtuar dhe verifikuar draftet, duke mbështetur proceset e angazhimit të palëve të interesit dhe duke siguruar koherencën rajonale. 1.3 Të lehtësohet dialogu dhe koordinimi me palët kryesore të interesit në të gjithë Ballkanin Perëndimor për të siguruar që udhërrëfyesi të pasqyrojë prioritetet kombëtare të përshtatjes dhe të mbështesë bashkëpunimin rajonal.	ASH	1. Përfundimi dhe miratimi zyrtar i Udhërrëfyesit Novator për Përshtatjen ndaj Klimës të Ballkanit Perëndimor. 2. Numri i konsultimeve, <i>workshop</i> -eve ose takimeve rajonale të mbajtura për të zhvilluar dhe përsosur udhërrëfyesin.	Ministria e Mjedisit	315.000
2	Ndërsëktorial e	Optimizimi i Koordinimit të Klimës: Forcimi i Kornizës së GNPKN-së	Ndërrhyrja e butë:	2.1 Të kryhet një shqyrtim institucional i strukturës aktuale të GNPKN-së, mandatit, proceseve të vendimmarrjes dhe mekanizmave të koordinimit të lidhura me përshtatjen ndaj klimës. 2.2 Të identifikohen barrierat dhe mungesat kryesore që pengojnë bashkëpunimin ndërsëktorial dhe zbatimin efektiv të masave të përshtatjes të GNPKN-së. 2.3 Të jepen rekomandime të synuara për përmirësimin e funksionalitetit, kapacitetit koordinues dhe përafrimit strategjik të GNPKN-së me komizat kombëtare të përshtatjes ndaj klimës. 2.4 Të propozohen përmirësime në protokollet e vendimmarrjes brenda GNPKN-së për të rritur transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në planifikimin dhe zbatimin e përshtatjes.	ASH	1. Numri i bashkive me grupe drejtuese operative që takohen rregullisht dhe raportojnë mbi progresin e NAP-it dhe Planit Vendor të Veprimit. 2. Përqindja e anëtarëve të Grupit Teknik të Punës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (GTP) dhe Grupit Drejtues të Bashkive të trajnuar në planifikimin dhe zbatimin e përshtatjes ndaj klimës. 3. Numri i politikave ose veprimeve për përshtatjen ndaj klimës të rekomanduara nga GPT-ja dhe të miratuara në nivel bashkiak.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	420.000
3	Ndërsëktorial e	Rritja e kapaciteteve për përshtatje: Mbështetja për Grupin Teknik të Ndryshimeve Klimatike dhe krijimi dhe fuqizimi i Grupit Drejtues	Ndërrhyrja e butë:	3.1 Të ofrohet mbështetje të synuar për ngritjen e kapaciteteve (p.sh., trajnim teknik, materiale udhëzuese) për Grupin Teknik të Punës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike. 3.2 Të ngrihet një Grup Drejtues në nivel bashkie me role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për të koordinuar dhe monitoruar veprimet vendore të përshtatjes. 3.3 Të ofrohen seanca trajnuese për anëtarët e Grupit Drejtues në lidhje me planifikimin e përshtatjes dhe raportimin e mekanizmave të lidhura me NAP-in dhe Planin Vendor të Veprimit.	ASH	1. Numri i seancave të trajnimit të zhvilluara për Grupin Teknik të Punës për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike. 2. Përqindja e bashkive që kanë ngritur Grupin Drejtues. 3. Numri i anëtarëve të Grupit Drejtues të trajnuar në planifikimin e përshtatjes dhe raportim.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	745.000
4	Ndërsëktorial e	Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse ndaj klimës përmes sistemeve të përmirësuar të të dhënave	Ndërrhyrja e butë:	4.1 Të zhvillohen ose përmirësohen platformat e centralizuara të informacionit mbi klimën për të mundësuar integrimin, ndarjen dhe aksesin e të dhënave në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes. 4.2 Të forcohen kapacitetet institucionale në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave klimatike nëpërmjet trajnimit, sigurimit të instrumenteve dhe zhvillimit të protokolleve standarde. 4.3 Të ngrihen ose të përmirësohen sistemet e monitorimit në kohë reale dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm për risqet që lidhen me klimën. 4.4 Të forcohen kapacitetet për qëndrueshmëri klimatike përmes përmirësimit të sistemeve të të dhënave, duke siguruar integrimin e të dhënave klimatike të ndara sipas moshës dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, si dhe vlerësimin e riskut dhe vulnerabilitetit të fëmijëve dhe adoleshentëve, për të informuar politikatat dhe ndërhyrjet e përshtatjes klimatike dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë. 4.5 Të përmirësohet sistemi shëndetësor rezistent ndaj ndryshimeve klimatike përmes përdorimit të të dhënave klimatike dhe shëndetësore, sistemeve të paralajmërimit të hershëm, politikave dhe institucioneve të integruara, si dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve të përgjigjes. 4.6 Të promovohet nënshkrimi i një Memorandumi Bashkëpunimi ndërmjet ministrive përgjegjëse për mjedisin, shëndetësinë, bujqësinë dhe arsimin, me qëllim koordinimin e kërkitimit shkencor të aplikuar dhe shkëmbimin e të dhënave për temat prioritarë të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, përfshirë zhvillimin e kultivareve rezistente ndaj thatësisë dhe kripëzimit, si dhe studimet mbi ndikimet shëndetësore	ASH	1. Ekzistenca e një platforme operative informacioni për klimën (e re ose e përmirësuar) që ofron të dhëna dhe shërbime të aksesueshme. 2. Numri i anëtarëve të stafit teknik të trajnuar në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave klimatike. 3. Përqindja e zonave të cenueshme të mbuluar nga sistemet e monitorimit në kohë reale dhe paralajmërimit të hershëm. 4. Përqindja e sistemeve të të dhënave klimatike që mbledhin, analizojnë dhe raportojnë të dhëna të ndara sipas moshës dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve. 5. Përqindja e politikave, udhëzimeve ose planeve sektoriale shëndetësore që përfshijnë masat e integritetit të të dhënave klimatike dhe shëndetësore dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm.	Ministria e Mjedisit Ministria e Arsimit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Shëndetësisë	1.500.000

NR.	Sektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				të valëve të të nxehti dhe sëmundjeve vektoriale. Bashkëpunimi synon mbështetjen e politikëbërjes së bazuar në evidencë, forcimin e kapaciteteve kombëtare kërkimore dhe integrimin e rezultateve shkencore në zbatimin e masave sektoriale të planit, në përputhje me mandatet institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. 4.7 Të promovohet integrimi i bazave të të dhënave shkencore të institucioneve të arsimit të lartë me platformën kombëtare të të dhënave klimatike, si dhe sigurimi i aksesit të kontrolluar për komunitetin akademik për përdorimin e këtyre të dhënave në kërkime shkencore, studime dhe teza doktorate, në përputhje me standardet për menaxhimin, shkëmbimin dhe mbrojtjen e të dhënave. 4.8 Të promovohet dhe formalizohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive dhe operatorëve të ujësjellës-kanalizimeve për kryerjen e auditimeve klimatike të rrjeteve, duke mundësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi vulnerabilitetin ndaj risqeve klimatike dhe hartimin e planeve të mirëmbajtjes parandaluese dhe investimeve prioritare.				
5	Ndërsektorial e	Zgjidhje të bazuara në natyrë dhe Skemat e Zhvilluesve për Fitimin e Biodiversitetit	Ndërhyrja e gjelbër	5.1 Të krijohen dhe restaurohen korridoret e gjelbra për lidhshmërinë e biodiversitetit duke identifikuar zonat prioritare dhe duke restauruar bimësinë vendase përmes plantacioneve dhe infrastrukturës miqësore ndaj jetës së egër (ura ekologjike, nënkalime, etj.). 5.2 Të përmirësohen shërbimet e ekosistemit kulturor dhe rekreativ përmes ruajtjes dhe restauruar zonat e mbrojtura për të përmirësuar aksesin publik, duke zhvilluar infrastrukturë për rekreacion të qëndrueshëm (shitje, zona vëzhgimi të jetës së egër, peshkim, zona ekoturizmi, etj.), dhe duke siguruar ruajtjen e peizazheve duke promovuar angazhimin publik. 5.3 Të zbatohet fitimi i biodiversitetit si standardi rregullator në planifikim duke integruar politikën e fitimit neto për projektet e reja të zhvillimit dhe duke krijuar një program kompensimi që u kërkon zhvilluesve të restaurojnë ose kompensojnë humbjen e habitatit. Mund të merren në konsideratë projekte pilot në bashkitë e synuara.	AM	1. Rritje e përqindjes shumëllojshmërisë dhe larmisë së specieve në korridoret e gjelbra të restauruara dhe zonat e mbrojtura. 2. Numri i kilometrave të korridoreve të gjelbra të krijuara ose të restauruara me bimësi vendase dhe infrastrukturë miqësore për jetën e egër. 3. Numri i elementëve të infrastrukturës rekreative të zhvilluar ose të përmirësuar në zonat e mbrojtura të restauruara. 4. Numri i projekteve të reja të zhvillimit që zbatojnë parimet e fitimit neto të biodiversitetit (FNB) përmes kërkesave të kompensimit ose restaurimit. 5. Numri i vendeve të punës të krijuara nëpërmjet zbatimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe nismave të restaurimit të habitatave. 6. Numri i politikave, planeve ose rregulloreve të zhvillimit vendor që kanë integruar zgjidhje të bazuara në natyrë dhe parimet e fitimit neto të biodiversitetit.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	242.793.396
6	Ndërsektorial e	Nxjtja e ndërgjegjësimi t për aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës dhe trajnimi në përshatje dhe masa zbutëse	Ndërhyrja e butë:	6.1 Të zhvillohen dhe ofrohen module të trajnimit të synuar për përshatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike për praktikuesit kryesorë, institucionet publike, bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve kyç. 6.2 Të zhvillohen seanca ndërgjegjësimi për popullsinë e gjerë dhe komunitetet vendore, me fokus në risqet klimatike me prioritet të lartë, përgjigjet praktike të përshatjes dhe strategjitë e qëndrueshmërisë në nivel komuniteti. 6.3 Të organizohen <i>workshop</i> -e dhe të shpërndahen materiale informuese të përshatura për bizneset dhe <i>startup</i> -et, duke theksuar rolin e ekosistemeve në përshatje, duke ofruar shembuj të zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe duke shpalosur mundësitë e financimit në dispozicion për të mbështetur inovacionin me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. 6.4 Të shohet ndërgjegjësimi në nivel bashkiak mbi ndëshmërinë klimatike të zonave të mbrojtura, nëpërmjet fushatave të komunikimit, dialogut me palët e interesit dhe integrimit të temave të lidhura me risqet për ekosistemin në eventet vendore të informimit. 6.5 Forcimi i qëndrueshmërisë klimatike të komuniteteve vulnerabel (përfshirë komunitetet Rome) nëpërmjet aktiviteteve të targetuara për ndërgjegjësim, rritje kapacitetsh dhe komunikim të risikut për komunitetet vulnerabel, përfshirë komunitetet Rome, me qëllim përmirësimin e aksesit në informacion klimatik, sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe masat praktike të përshatjes.	ASH	1. Numri i moduleve të trajnimit të zhvilluara dhe të ofruara për institucionet publike dhe shërbimet kyç. 2. Numri i ngrajeve ndërgjegjëse të zhvilluara në komunitetet e cënueshme ndaj klimës. 3. Numri i <i>workshop</i> -eve me në fokus biznesin të zhvilluara në lidhje të zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe financimin për klimën. 4. Numri i bashkive që kanë zhvilluar veprimtari komunikimi mbi cënueshmërinë e ekosistemit. 5. Përqindja e profesionistëve, përfaqësuesve të institucioneve publike, bashkive dhe ofruesve të shërbimeve kritike që kanë përfunduar trajnime të certifikuara mbi masat e përshatjes dhe zbutjes klimatike. 6. Numri i personave të komuniteteve vulnerabel (përfshirë komunitetet Rome) të përfshira në aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnime	Ministria e Mjedisit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Bashkitë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	1.500.000
7	Ndërsektorial e	Mekanizmat novatorë të financimit të klimës: Pilotimi i strategjive të financimit të qëndrueshëm	Ndërhyrja e butë:	7.1 Të identifikohen dhe vlerësohen mjetet e mundshme të financimit për klimën që janë të rëndësishme në kontekstin kombëtar dhe bashkiak, duke përfshirë skemat e sigurimeve, pagesat për shërbimet e ekosistemit (PSHE), lejet e hyrjes dhe kreditë me kusht. 7.2 Të hartohet një strategji e qëndrueshme e financimit për klimën, ku të përfshihen mjetet të përzgjedhura dhe të përcaktuhen parimet udhëzuese për zbatimin pilot në bashki. 7.3 Të pilotohen mekanizmat e përzgjedhur të financimit në nivel bashkiak në koordinim me autoritetet vendore, për të testuar fizibilitetin, pranimin publik dhe kërkesat institucionale. 7.4 Mbështetje për <i>start-up</i> -et e IAL-ve që ofrojnë zgjidhje teknologjike për përshatjen si AgriTech, sisteme vaditjeje inteligjente, materiale ndërtimi izoluese, etj.	ASH	1. Dokumenti i strategjisë së financimit të klimës është përfunduar dhe është verifikuar zyrtarisht, duke përfshirë mjetet përkatëse të vlerësuar në nivel kombëtar dhe bashkiak. 2. Numri i bashkive që marrin pjesë në zbatimin pilot të mekanizmave të financimit për klimën. 3. Numri i <i>start-up</i> -eve të mbështetura	Ministria e Financave, Ministria e Arsimit	6.080.000
8	Ndërsektorial e	Pilotimi i vlerësimeve të menaxhimit të risikut për bizneset me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës	Ndërhyrja e butë:	8.1 Të kryhen vlerësime të risqeve specifike për sektorin për shoqëri private të zgjedhura për të identifikuar cënueshmëritë klimatike, risqet operacionale dhe mundësitë e përshatjes të personalizuarra për çdo sektor. 8.2 Të zhvillohen dhe përdoren mjete praktike, udhëzues dhe module trajnimi për të ndihmuar shoqëritë të kuptojnë, vlerësojnë dhe integrojnë risqet e lidhura me klimën në proceset e tyre të menaxhimit të risikut. 8.3 Të përmblidhen mësimet e nxjerra dhe rekomandimet nga vlerësimet pilot, të cilat do të udhëheqin më pas përkallëzimin e informimit të sektorit privat për klimën dhe praktikën e menaxhimit të risikut.	ASH	1. Numri i shoqërive private që kanë përfunduar vlerësimet për risqet dhe cënueshmërinë klimatike. 2. Numri i mjeteve praktike dhe materialeve udhëzuese të zhvilluara dhe të ofruara për integrimin e risikut klimatik. 3. Përqindja e bizneseve pjesëmarrëse që zbatojnë masa për zbutjen e risikut bazuar në vlerësimet e tyre. 4. Numri i sektorëve të mbuluar nga vlerësimet pilot të menaxhimit të risikut. 5. Përfundimi i raportit përmblledhës që përshkruan mësimet kryesore të nxjerra, sfidat dhe rekomandimet (po/jo).	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	200.000
9	Ndërsektorial e	Promovimi i përshatjes klimatike me ndëshmëri gjinore: Trajnimi i palëve të interesit dhe zhvillimi i mjeteve	Ndërhyrja e butë:	9.1 Të hartohen dhe zhvillohen seanca trajnimi me ndëshmëri gjinore që synojnë zyrtarët e qeverisjes vendore dhe kombëtare, OJQ-të, udhëheqësit e komunitetit dhe stafin teknik të përfshirë në planifikimin dhe zbatimin e përshatjes ndaj klimës. 9.2 Të zhvillohen dhe shpërndahen materiale dhe mjete praktike me qasje të ndëshme ndaj gjinisë, si udhëzues, lista kontrolli dhe studime rasti, për të mbështetur integrimin e perspektivës gjinore në nismat e përshatjes.	AM	1. Numri i seancave të trajnimit me ndëshmëri gjinore të zhvilluara në nivel kombëtar dhe bashkiak. 2. Numri i mjeteve dhe materialeve të zhvilluara me përgjegjshmëri gjinore (p.sh., lista kontrolli, udhëzime, studime rastesh). 3. Numri i palëve të interesit që morën ose patën akses në materiale me përgjegjshmëri gjinore. 4. Përqindja e trajnimeve ku pati	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Mbrojtjes Sociale, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	143.000

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
		gjitëpërfshirëse		9.3 Të sigurohet pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në trajnimet duke angazhuar aktivisht gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara, si dhe duke trajtuar pengesat në akses si gjuha, vendndodhja dhe orari. 9.4 Përfshirja e elementeve që lidhen me gatishmërinë, reagimin dhe përshtatjen e shërbimeve shëndetësore ndaj rreziqeve dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke integruar në mënyrë të strukturuar dimensionin gjinor në këto procese 9.5 Vlerësimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe operacionale të institucioneve shëndetësore për përballimin e rreziqeve klimatike, duke përfshirë burimet njerëzore, kapacitetet infrastruktururore (shtrëtor, pajisje), sigurimin e furnizimeve bazë (energj, ujë), si dhe zhvillimin e planeve të emergjencës, protokolleve dhe mekanizmave të reagimit ndaj ngjarjeve ekstreme		pjesëmarrje gjinore të balancuar (të paktën 40% gra). 5. Numri i grave, të rinjve dhe individëve të marginalizuar që morën pjesë aktivisht në të paktën një seancë trajnimi për përshtatjen ndaj klimës.		
10	Ndërsëktorial e	Edukimi i komuniteteve: Përshtatja dhe rritja e ndërgjegjësimi t për fatkeqësitë	Ndërhyrja e butë:	10.1 Të hartohen dhe zbatohen materiale dhe veprimtari edukative të përshtatshme për moshën në shkollat fillore dhe të mesme, të fokusuara në ndikimet e ndryshimeve klimatike, masat e përshtatjes, reduktimin e rreziut nga fatkeqësitë dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë, me qëllim pajisjen e fëmijëve dhe adoleshentëve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur me një klimë në ndryshim.. 10.2 Të organizohen evente ndërgjegjësimi me komunitetin, si panaire, ekspozita, <i>workshop</i> -e dhe seanca ndërvepruese për klimën, për të angazhuar banorët mbi qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive dhe praktikave vendore të përshtatjes, duke iu drejtuar veçanërisht medias, politikëbërësve dhe grupeve të marginalizuara, 10.3 Përditësimi i kurrikulave arsimore për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe qëndrueshmërisë afatgjatë	ASH	1. Numri i shkollave që kanë marrë materiale edukative (p.sh., udhëzues, postera, libra aktivitetesh) për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë. 2. Numri i shkollave që integrojnë temat e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes në kurrikulat ose veprimtaritë e tyre jashtëshkollore. 3. Numri i ngjarjeve të ndërgjegjësimi të komunitetit të mbajtura mbi përshtatjen ndaj klimës dhe aftësitë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. 4. Përqindja e fëmijëve dhe adoleshentëve në shkollat fillore dhe të mesme që demonstrojnë njohuri dhe aftësi bazë mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e rreziut nga fatkeqësitë.	Ministria e Arsimit Ministria e Mjedisit	3.025.000
11	Bujqësia	Fuqizimi i fermerëve: mbështetja financiare për infrastrukturën me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike	Ndërhyrja e butë:	11.1 Të hartohen dhe zbatohen skemat e synuara të mbështetjes financiare për t'u mundësuar fermerëve të investojnë në infrastrukturë me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. 11.2 Të prioritetizohet financimi për instalimin e sistemeve mbrojtëse nga breshëri, si rrjetat kundër breshërit ose streha në rajonet që janë më të ekspozuar ndaj stuhive të forta të breshërit. 23.3 Të promovohet modernizimi i serrave duke mbështetur investimet në projekte me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, duke përmirësuar izolimin, automatizuar sistemet e ventilimit dhe duke përdorur teknologjitë me efikasitet të lartë të ujit. 11.4 Të mbështetet krijimi i brezave mbrojtës dhe sistemeve të mbrojtjes nga era, duke përfshirë rreshtat e pemëve ose gardheve, për të zvogëluar ekspozimin ndaj erës, për të parandaluar erozionin e tokës dhe për të rritur stabilitetin e mikroklimës në ferma.	ASH	1. Shuma totale e mbështetjes financiare të alokuar për fermerët për investime në infrastrukturë me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. 2. Sipërfaqja totale (në hektarë) e mbuluar nga sistemet e mbrojtjes nga breshërit të instaluar me mbështetje financiare. 3. Sipërfaqja totale (në m ²) e serrave të përmirësuara ose të ndërtuara me karakteristika të aftësive ripërtëritëse ndaj klimës përmes skemës së financimit. 4. Numri i fermave me mbështetje financiare që përdorin sistemin me brez mbrojtës.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	29.600.000
12	Bujqësia	Mbrojtja e fermerëve: Programet e kompensimit dhe ndihmës për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë	Ndërhyrja e butë:	12.1 Të planifikohen fonde ndihme në rast katastrofash dhe skema ndihme emergjente për të mbështetur fermerët që humbin të ardhura për shkak të katastrofave të lidhura me klimën. 12.2 Të përcaktohen qartazi kriteret për pranueshmëri dhe procedura e aplikimit për të garantuar që familjet bujqësore të prekura të mund të kenë akses të barabartë dhe në kohë në kompensim dhe asistencë. 12.3 Të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi dhe komunikimi për të informuar fermerët rreth disponueshmërisë, kushteve dhe procedurave për mekanizmat e kompensimit. 12.4 Fushata edukimi apo këshillimi për komunitetet në zonat rurale, me qëllim sensibilizimin e këtij komuniteti mbi praktikën më të mira bujqësore, në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të humbjeve në sektorin bujqësor dhe rural.	AM	1. Shuma totale e fondeve të alokuara përmes skemave të kompensimit për fatkeqësitë dhe ndihmë emergjente. 2. Përqindja e komuniteteve bujqësore të synuara që marrin materiale informuese mbi mekanizmat e kompensimit për fatkeqësitë.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	102.250.000
13	Bujqësia	Plani i veprimtari për speciet invazive në kushtet e ndryshueshme klimatike	Ndërhyrja e butë:	13.1 Të kryhen vlerësime të ndjeshme ndaj riskut klimatik për të identifikuar speciet invazive prioritare, shpërndarja, ndikimi ose aftësia ripërtëritëse e të cilave mund të rritet në kushtet e ndryshimit të klimës. 13.2 Të përcaktohen synimet dhe objektivat strategjikë për parandalimin, zbulimin e hershëm, kontrollin dhe zhdukjen e specieve invazive, në përputhje me objektivat kombëtare të biodiversitetit dhe përshtatjes. 13.3 Të zhvillohet një plan zbatimi ku të përcaktohen qartazi fazat, afatet kohore, përgjegjësit dhe nevojat për burime për secilën fazë të ciklit të menaxhimit të specieve invazive. 13.4 Të vendosen protokolle monitorimi dhe mekanizma për mbledhjen e të dhënave për të vlerësuar efektivitetin dhe për të informuar menaxhimin e përshtatjes së specieve invazive në skenarët e ardhshëm klimatikë.	AM	1. Zhvillimi i planit të zbatimit të verifikuar dhe me faza për menaxhimin e specieve invazive, duke integruar synimet strategjike të vlerësimit të riskut klimatik (po/jo). 2. Ekzistenca e një sistemi monitorimi të standardizuar dhe funksional për speciet invazive të ndjeshme ndaj klimës (po/jo).	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	160.000
14	Bujqësia	Forcimi i mbrojtjes nga përmbytjet: Restaurimi i brigjeve të lumenjve dhe zgjerimi i fushave aluvionale përgjatë lumenjve kryesorë të Shqipërisë	Ndërhyrja gri	14.1 Të kryhet modelimi hidrologjik dhe hartëzimi i riskut nga përmbytjet në lumenjtë prioritarë për të identifikuar zonat e cenueshme ku është i nevojshëm restaurimi i brigjeve të lumenjve dhe fushave aluvionale duke marrë në konsideratë edhe standardet e reja të sigurisë dhe nevojën për përditësimin e tyre në përputhje me skenarët klimatikë 14.2 Të bëhet projektimi inxhinierik për punimet e restaurimit të brigjeve të lumenjve dhe digave të cenueshme bazuar në cenueshmëritë e zbuluara. 14.3 Të restaurohen brigjet e lumenjve dhe të riparohen digat: Të vendoset fokusi në restaurimin dhe riparimin e argjinaturave dhe digave të brigjeve të lumenjve përgjatë rrjedhave kryesore të lumenjve si Drini, Buna, Mati, Ishmi dhe Vjosa për të restauruar 300 km të argjinaturave mbrojtëse nga përmbytjet të identifikuara në Strategjinë Kombëtare për Ujitje, Kullim dhe Mbrojtje nga Përmbytjet. Përpjekjet do të synojnë forcimin e infrastrukturës ekzistuese dhe të re të mbrojtjes nga përmbytjet, përmirësimin e kontrollit të erozionit dhe parandalimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e dendura të shiut ose rritja e nivelit të detit. Evidenti praktikë e qëndrueshme që përfshijë bëmësinë natyrore për të përforcuar brigjet e lumenjve dhe për të promovuar aftësitë ripërtëritëse e ekosistemit. 14.4 Monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të	ASH	1. Numri i kilometrave të brigjeve të lumenjve dhe argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytjet të restauruara ose të riparuar në basenet ujore me përparësi. 2. Numri i zonave me rrezik nga përmbytjet të hartëzuara dhe të prioritetizuara sipas modelimit hidrologjik dhe vlerësimit të riskut të përmbytjeve. 3. Numri i segmenteve të lumenjve të restauruar duke përdorur zgjidhje të bazuara në natyrë (p.sh., argjinatura me bimësi, zona buferike bregore) për kontrollin e erozionit dhe përmbytjeve. 4. Numri i sistemeve funksionale të paralajmërimit të hershëm dhe stacioneve të monitorimit të përmbytjeve të instaluar në basenet ujore të cenueshëm. 5. Numri i komuniteteve të arrira përmes fushatave të ndërgjegjësimi për riskun nga përmbytjet dhe veprimtaritë e angazhimit të komunitetit. 6. Numri i bashkive me plane të përditësuara të evakuimit nga përmbytjet dhe strategji të përgatitjes për përmbytjet me bazë komunitet. 7. Numri i planeve inxhinierike të projektuara dhe të përfunduara për	Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), IGJEUM dhe njësitë e qeverisjes vendore.	179.022.000

NR.	Spektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				mbrojtjes së lumenjve: Të ngrihet një sistem monitorim për të ndjekur efektshmërinë e restaurimit të brigjeve të lumit, zgjerimit të fushave aluvionale dhe ndërtimit të barrierave kundër përmytjeve. Si dhe sisteme paralajmërimi të hershëm për t'u përgatitur kundër ndikimeve të mundshme. Inspektimet e rregullta do të sigurojnë që infrastruktura të mbetet e paprekur dhe të vazhdojë të ofrojë mbrojtje. 14.5 Angazhimi i komunitetit dhe ndërgjegjësimi për riskun nga përmytjet: Të angazhohen komunitetet vendore në menaxhimin e riskut nga përmytjet duke rritur ndërgjegjësimin rreth masave të mbrojtjes nga përmytjet, rëndësia së restaurimit të brigjeve të lumenjve dhe rolit të ligatave në zbutjen e përmytjeve. Të inkurajohet pjesëmarrja vendore në veprimtaritë e mirëmbajtjes dhe restaurimit, duke i fuqizuar banorët që të marrin një rol aktiv në mbrojtjen e mjedisit të tyre. Dhe të hartohen plane specifike për evakuimin e popullsisë në rast të risqeve klimatike ekstreme. 14.6 Rishikimi i standardeve të sigurisë dhe përcaktimi i përgjegjëseve institucionale për mbrojtjen nga përmytjet: Të ndërmerret një proces gjithëpërfshirës për rishikimin e standardeve ekzistuese të projektimit dhe sigurisë së veprave të mbrojtjes nga përmytjet, duke marrë në konsideratë kushtet aktuale dhe projektionet e ndryshimeve klimatike, si dhe zhvendosjen e fokusit nga mbrojtja e tokave bujqësore drejt mbrojtjes së zonave të urbanizuara. Ky proces do të bazohet edhe në gjetjet dhe rekomandimet e studimeve ekzistuese (përfshirë studimin për 5 lumenjtë kryesore) dhe praktikatat e Bashkimit Evropian, si dhe do të synojë qartësimin dhe rishikimin e roleve dhe përgjegjëseve institucionale në menaxhimin e riskut nga përmytjet. 14.7 Forcimi i koordinimit institucional dhe rishikimi i ndarjes së përgjegjëseve për menaxhimin e përmytjeve.		restaurimin e brigjeve të lumenjve dhe digave të cenushme		
15	Bujqësia	Zbatimi i krijimit të habitatat dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të luftuar erozionin e tokës	Ndërhyrja e gjelbër	15.1 Identifikoni dhe hartëzoni zonat me rrezik nga erozioni në zonat e synuara. Kryeni analiza gjeohapësimore dhe studime në terren për të hartëzuar zonat e prirura ndaj erozionit, krahasuar me vlerësimin e riskut klimatik për të identifikuar zonat me risk të lartë dhe për të përcaktuar ndërhyrjet në përputhje me strategjitë vendore të përshatjes. 15.2 Të përcaktohen zonat buferike bimore dhe të restaurohen barrierat natyrore duke mbjellë barëra, shkurre dhe pemë vendase përgjatë brigjeve të lumenjve, shpateve të kodrave dhe tokave bujqësore për të stabilizuar tokën dhe për të reduktuar humbjen e sedimenteve. 15.3 Të përdoret agropylltaria dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës për stabilizimin e saj, duke aplikuar sisteme agropylltarie, duke përdorur kultura shumëvjeçare vendase dhe metoda të ndërkulturit për të parandaluar varfërimin e tokës, si dhe duke promovuar teknikat e bujqësisë rigjeneruese. 15.4 Të përdoret bioinxhinieria e tokës dhe infrastruktura e gjelbër për stabilizimin e shpateve, duke përfshirë përfundimin e shpateve të pjerrëta përmes zgjidhjeve bioinxhinierike, përdorimin e gjeotekstilëve dhe mbulesave të kontrollit të erozionit të biodegradueshme dhe shfrytëzimin e specieve vendase me rrënjë të thella për të siguruar ankorimin natyror. 15.5 Të promovohen programet e rryllëzimit dhe ruajtjes së tokës të udhëhequra nga komuniteti për të angazhuar aktivisht fermerët, grupet indigjene dhe organizatat vendore në përpjekjet e restaurimit të tokës, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve.	ASH	1. Numri i zonave me rrezik nga erozioni të identifikuar dhe të hartëzuara duke përdorur vlerësimet gjeohapësimore dhe ato në terren. 2. Numri i hektarëve të restauruar nëpërmjet zonave buferike bimore dhe barrierave natyrore kundër erozionit duke përdorur specie bimore vendase. 3. Numri i hektarëve të tokave të vendosura nën sistemet e menaxhimit të agropylltarisë ose rigjenerimit në zonat me rrezik nga erozioni. 4. Numri i ndërhyrjeve për stabilizimin e shpateve të zbatuara duke përdorur bioinxhinierinë e tokës dhe teknikat e infrastrukturës së gjelbër. 5. Ulja e përqindjes së erozionit të tokës ose shkallës së sedimentimit në zonat e trajtuara. 6. Numri i anëtarëve të komunitetit (p.sh., fermerëve, grupeve indigjene) të trajnuar ose angazhuar në nismat e rryllëzimit dhe konservimit. 7. Numri i planeve vendore të përshatjes ose planeve të përdorimit të tokës që integrojnë masa të kontrollit të erozionit të bazuara në natyrë.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	41.787.500
16	Bujqësia	Rritja e kapaciteteve të IGJEO-s (Instituti të Gjeoshkencave) për monitorimin bregdetar dhe ofrimin e të dhënave mbi ndryshimet dhe risqet mjedisore	Ndërhyrja e butë:	16.1 Të kryhet një vlerësim i nevojave të kapaciteteve të IGJEO-s për të identifikuar mangësitë teknike, njerëzore dhe institucionale që lidhen me monitorimin mjedisor dhe monitorimin e zonave bregdetare. 16.2 Të përmirësohet infrastruktura dhe pajisjet teknike për të mbështetur mbledhjen e të dhënave në kohë reale mbi erozionin bregdetar, depërtimin e ujërave të kripura, cilësinë e ujërave nëntokësore dhe mbulesën bimore në zonat bregdetare të cenushme. 16.3 Të zhvillohen dhe zbatohen protokolle të standardizuara monitorimi për të siguruar saktësinë, qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave në të gjitha zonat bregdetare. 16.4 Të ofrohen programe trajnimi të synuara për stafin dhe partnerët e IGJEO-s mbi metodologjitë e mbledhjes së të dhënave, teledeteksonin dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave që lidhen me ndikimet klimatike në ekosistemet bregdetare.	ASH	1. Ekzistenca e një raporti të përfunduar dhe të verifikuar zyrtarisht për vlerësimin e nevojave të kapacitetit për IGJEO-n (Po/Io) 2. Përqindja e progresit në krijimin e një sistemi operativ të monitorimit bregdetar dhe mjedisor pranë IGJEO-s, ku përfshihet përmirësimi i infrastrukturës, protokollat e standardizuara dhe trajnimi i stafit (%).	Ministria e Mjedisit	322.200
17	Bujqësia	Zgjerimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse në bujqësi	Ndërhyrja gri	17.1 Të hartëzohen dhe identifikohen sistemet ekzistuese të ujitjes dhe statusi i tyre: Të zhvillohet një hartë specifike dhe/ose një listë të qartë e secilit sistem ekzistues të ujitjes dhe statusit të tij, të ndjekur nga një listë e zonave ku nevojitet sisteme të reja dhe studime fizibiliteti. 17.2 Ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes: Të zhvillohen dhe ndërtohen sisteme të reja të ujitjes në rajonet kryesore bujqësore, duke u përqendruar në zgjerimin e mbulimit të ujitjes në 360.000 hektarë. Të prioritetizohet instalimi i teknologjive moderne të ujitjes, siç janë sistemet e ujitjes me pika dhe me spërkatje, për të përmirësuar eficientësinë e ujit dhe për të siguruar prodhimin e të korrave gjatë gjithë vitit. Fushat kryesore të fokusit përfshijnë Durrësin, Elbasanin, Gjirokastrën, Kukësin dhe Vlorën. 17.3 Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese të ujitjes deri në 240.000 hektarë: Të ndërmerret rehabilitimi dhe përmirësimi i sistemeve ekzistuese të ujitjes, duke përfshirë riparimin e infrastrukturës së vjetër, siç janë kanalet, tubat dhe stacionet e pompimit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rehabilitimit të rezervuarëve të ujit dhe digave të demtuara në zona të tilla si Përmeti, duke siguruar një furnizim të besueshëm dhe të qëndrueshëm me ujë për bujqësinë. 17.4 Zhvillimi i praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të ujit: Të promovohet miratimi i praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të ujit në	ASH	1. Numri i sistemeve të reja të ujitjes të ndërtuara dhe i sistemeve ekzistuese të ujitjes të rehabilituara. 2. Sipërfaqja totale e ujitjes (ha) u zgjerua (objektivi: nga 230.000 në 360.000 ha). 3. Përqindja e sistemeve të ujitjes që janë nën monitorim dhe ndjekin programe të rregullta mirëmbajtjeje (%)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	249.123.998

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periodha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				rajonet bujqësore, duke përfshirë përdorimin e teknologjive inteligjente të ujitjes dhe menaxhimit efikas të burimeve ujore. Të trajnohen fermerët në teknikat e ruajtjes së ujit dhe përdorimin efikas të sistemeve të ujitjes për të maksimizuar produktivitetin duke minimizuar humbjet e ujit. 17.5 Monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të kullimit: Të zbatohet një program i rregullt monitorimi dhe mirëmbajtjeje për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të sistemeve të ujitjes. Këtu do të përfshihen inspektime të planifikuara të të gjithë infrastrukturës, riparimi i çdo dëmtimi dhe garantimin që shpërndarja e ujit të jetë efi kase. Po ashtu, programi do të monitorojë performancën e sistemeve të ujitjes në rritjen e produktivitetit bujqësor. 17.6 Zhvillimi i sistemeve të parashikimit dhe planifikimit të kërkesës për ujë për ujitje: Të zhvillohen dhe përdoren modele dhe simulime kompjuterike për parashikimin e nevojave për ujë për ujitje në nivel kombëtar dhe rajonal, duke integruar skenarët e ndryshimeve klimatike dhe trendet e zhvillimit të sektorit bujqësor. Rezultatet e këtyre analizave do të përdoren për planifikimin e investimeve në infrastrukturën ujore (përfshirë rezervuarët e rinj dhe rehabilitimin e atyre ekzistues) dhe për orientimin strategjik të politikave të menaxhimit të burimeve ujore. 17.7 Rishikimi dhe përmirësimi i standardeve të sigurisë dhe projektimit për sistemet e kullimit: Të kryhet një vlerësim i plotë teknik i sistemeve ekzistuese të kullimit (me gravitet dhe me stacione pompimi), të ndërtuara sipas standardeve historike, dhe të rishikohen parametrat e projektimit dhe nivelet e sigurisë në përputhje me kushtet aktuale dhe projektionet e ndryshimeve klimatike.				
18	Bujqësia	Siguria e qëndrueshme e ujit përmes Infrastrukturës së mbledhjes së ujit të shiut	Ndërhyrja gri	18.1 Të vlerësohet vendndodhja, të përcaktohen prioritetet e ndërhyrjeve dhe të kryhet analiza e fizibilitetit në bashkëpunim të ngushtë me fermerët dhe komunitetet vendore. Të hartohen ndërhyrje të përshtatshme për infrastrukturën e ujërave të shiut, rezervat ujore dhe riparimin e digave, bazuar në vlerësimet ekzistuese dhe plotësuese të cënueshmërisë dhe infrastrukturës ujore. 18.2 Ndërtimi i infrastrukturës së mbledhjes së ujit të shiut: Të ndërtohen ose mirëmbahen sistemet e mbledhjes së ujit të shiut në vendndodhjet strategjike të identifikuara në veprimtarinë e mëparshme për të përmirësuar disponueshmërinë e ujit, veçanërisht në zonat e cënueshme ndaj thatësisë dhe mungesës së ujit. Këto sisteme do të mbledhin dhe ruajnë ujën e shiut për përdorim bujqësor, shtëpiak dhe industrial, duke rritur aftësitë ripërtëritëse ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. 18.3 Restaurimi i rezervave ujore dhe riparimi i digave të dëmtuara për të arritur objektivat kombëtare: Të vendoset fokusi në restaurimin e rezervave ekzistuese të ujit për të rritur kapacitetet e tyre për të ruajtur ujën, duke përfshirë pastrimin, përförçimin dhe zgjerimin e rezervuarëve dhe sistemeve ekzistuese për të përmirësuar ruajtjen e ujit për përdorim gjatë periudhave të thatësisë, si dhe riparimin e afërsisht 230 digave të rëndësishme të dëmtuara (të evidentuara me pika blu në hartë), duke siguruar që funksionaliteti i këtyre digave do të mbrojtë furnizimin me ujë për komunitetet dhe ekosistemet, veçanërisht gjatë periudhave me reshje të parregullta. 18.4 Mirëmbajtja periodike e sistemeve të infrastrukturës së mbledhjes së ujit të shiut: Të zbatohet një program gjithëpërfshirës mirëmbajtjeje për sistemet e mbledhjes së ujërave të shiut dhe rezervat e restauruara të ujit. Këtu do të përfshihen inspektime periodike, pastrim dhe riparime për të siguruar funksionalitetin e vazhdueshëm dhe jetëgjatësinë e infrastrukturës. 18.5 Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi për praktikatat e ruajtjes së ujit: Të promovohen praktikatat e ruajtjes së ujit në rajonet e pajisura me infrastrukturë për mbledhjen e ujit të shiut, duke siguruar që bashkitë, komunitetet, fermerët dhe industritë ta përdorin ujën e mbledhur në mënyrë efi kase.	ASH	1. Numri i rezervave të rëndësishme të ujit dhe digave të dëmtuara të restauruara në përputhje me objektivat kombëtare (objektivi: 230 vendndodhje). 2. Kapaciteti total i magazinimit (m³) i restauruar ose i krijuar nëpërmjet rehabilitimit të rezervave ujore dhe infrastrukturës së mbledhjes së ujërave të shiut. 3. Përqindja e sistemeve të mbledhjes dhe magazinimit të ujit të shiut që ndjekin planet aktive të mirëmbajtjes. 4. Përqindja e përdoruesve (familje, fermerë, institucione) në zonat e ndërhyrjes që raportojnë miratimin e praktikave të ruajtjes së ujit.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	75.849.163
19	Pylltari	Rritja e efi kasetit të pylltarisë nëpërmjet pajtueshmërisë rregullatore të BE-së	Ndërhyrja e butë:	19.1 Pajtueshmëria dhe zbatimi: Rishikimi dhe përditësimi i politikave kombëtare: Të sigurohet që politikat kombëtare për pylltarinë të jenë në përputhje me rregulloret e BE-së, siç është Strategjia Pyjore e BE-së për vitin 2030 dhe Rregullorja për Produktet pa Shpyllëzime. Ndryshimet legjislative: Të ndryshohen ligjet ekzistuese për pylltarinë për të përfshirë standardet dhe udhëzimet e BE-së. 19.2 Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve: Miratimi i praktikave të qëndrueshme: Të zbatohen praktikat të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve që përputhen me standardet e BE-së, me fokus në ruajtjen e biodiversitetit dhe aftësi ve ripërtëritëse ndaj klimës Programet e certifikimit: Të promovohen programe certifikimi si KAP (Këshilli i Administrimit të Pyjeve) dhe PMCP (Programi për Miratimin e Certifikimit të Pyjeve) për të siguruar praktika të qëndrueshme të pylltarisë 19.3 Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi: Programet e trajnimit: Të zhvillohen dhe zbatohen programe trajnimi për profesionistët e pylltarisë për rregulloret e BE-së dhe praktikatat e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Ndarja e njohurive: Të lehtësohet ndarja e njohurive dhe praktikave të mira midis palëve të interesit të pylltarisë nëpërmjet <i>workshop</i>-eve dhe seminareve. 19.4 Monitorimi dhe raportimi: Sistemet e monitorimit të pyjeve: Të ndiqen sisteme të forta të monitorimit të pyjeve për të ndjekur pajtueshmërinë me rregulloret e BE-së dhe për të vlerësuar mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e pyjeve. Mbledhja dhe raportimi i të dhënave: Të zbatohen mekanizma të standardizuar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për të siguruar informacion të saktë mbi	ASH	1. Numri i politikave, strategjive ose instrumenteve legjislative kombëtare për pylltarinë të rishikuara për t'u përafëruar me rregulloret e BE-së. 2. Përqindja e zonave pyjore të menaxhuara të certifikuara sipas skemave të njohura të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve (p.sh., KAP, PMCP). 3. Numri i profesionistëve të pylltarisë të trajnuar në praktikatat e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, të harmonizuara me ato të BE-së. 4. Numri i sistemeve të monitorimit të pyjeve të krijuara ose të përmirësuara për t'u harmonizuar me standardet e BE-së për pylltarinë. 5. Numri i platformave të konsultimit ose koordinimit me shumë palë të interesit për të mbështetur qeverisjen e pyjeve në përputhje me BE-në. 6. Shuma totale e financimit ose incentivave financiare të shpërndara për të mbështetur praktikatat e qëndrueshme të pylltarisë dhe pajtueshmërinë e tyre me rregulloret e BE-së. 7. Numri i politikave, udhëzimeve teknike ose instrumenteve të menaxhimit pyjor që integrojnë parimet e MZP-së për uljen e riskut nga zjarret në nivel peizazhi.	Ministria e Mjedisit	17.600.000

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				gjenden e pyjeve dhe menaxhimin e tyre. 19.5 Angazhimi i palëve të interesit Praktikat e bashkëpunimit: Të krijohen platforma bashkëpunimi midis agjencive qeveritare, OJQ-ve dhe palëve private të interesit për të koordinuar përpjekjet në menaxhimin e pylltarisë. Fushatat e ndërgjegjësimit publik: Të zhvillohen fushata të ndërgjegjësimit publik për të edukuar komunitetet rreth rëndësisë të pylltarisë së qëndrueshme dhe pajtueshmërisë me rregullore e BE-së 19.6 Nismat financiare: Programet e financimit: Të zhvillohen programe financimi për të mbështetur nismat e qëndrueshme të pylltarisë dhe pajtueshmërisë me rregulloret e BE-së. Subvencionet dhe grantet: Të ofrohen subvencione dhe grante për pronarët dhe menaxherët e pyjeve që ndjekin praktika të qëndrueshme dhe janë në përputhje me standardet e BE-së. 19.7 Integrimi i kërkesave për menaxhimin e zjarreve në peizazh në rishikimin dhe përditësimin e politikave, udhëzimeve teknike dhe instrumenteve të menaxhimit të pyjeve, duke siguruar përputhje me praktikatat dhe udhëzimet e BE-së për parandalimin e zjarreve përmes menaxhimit të peizazhit, reduktimit të lëndës djegëse dhe rritjes së afësisë ripërtëritëse të peizazheve pyjore.				
20	Pylltari	Promovimi i pylltarisë së qëndrueshme: Fondi i pyllëzimit dhe nismat e prokurimit të gjelbër	Ndërhyrja e butë:	20.1 Të projektohen struktura qeverisëse dhe financuese të Fondit të Pyllëzimit, ku të përfshihen kriteret e pranueshmërisë, fushat prioritare dhe mekanizmat e alokimit, në përputhje me strategjitë kombëtare të adaptimit dhe biodiversitetit. 20.2 Të kryhet vlerësimi hapësior për të identifikuar zonat e degraduara ose të ndjeshme ndaj klimës, të përshatshme për pyllëzim, duke siguruar integritetin ekologjik dhe përputhshmërinë me planet vendore të përdorimit të tokës. 20.3 Të lancohet një fazë pilot e programit të pyllëzimit, ku të përfshihet shpërndarja e financimeve për projekte vendore dhe nisma të bazuara në komunitet. 20.4 Të zhvillohen dhe miratohen udhëzime për prokurimin e gjelbër për sektorin pyjor, duke promovuar durin e siguruar në mënyrë të qëndrueshme dhe praktika miqësore me ekosistemin. 20.5 Të integrohen kriteret e MZP-së në Fondin e Pyllëzimit dhe në nismat e prokurimit të gjelbër, duke prioritetizuar projekte që reduktojnë lëndën djegëse, krijojnë mozaikë pyjorë dhe agropjorë me potencial më të ulët për përhapjen e zjarrit, përdorin specie vendase të përshtatura ndaj thatësirës dhe sigurojnë mirëmbajtje afatgjatë të ndërhyrjeve.	ASH	1. Struktura qeverisëse dhe financuese të Fondit të Pyllëzimit, ku të përfshihen kriteret e pranueshmërisë, fushat prioritare dhe mekanizmat e alokimit (po/jo) 2. Shuma totale e financimit të shpërndarë përmes Fondit të Pyllëzimit për projekte pilot dhe nisma pyllëzimi me baze komunitare. 3. Përqindja e institucioneve dhe agjencive të sektorit pyjor që kanë marrë udhëzuesin e prokurimit të gjelbër. 4. Përqindja e projekteve të Fondit të Pyllëzimit që integrojnë kriteret e MZP-së për uljen e riskut nga zjarret, menaxhimin e lëndës djegëse dhe mirëmbajtjen parandaluese.	Ministria e Mjedisit	8.540.000
21	Pylltari	Rijetëzimi i tokave të dëmtuara: Integrimi i ZBN-së dhe PBE-së me praktikatat e agropylltarisë	Ndërhyrja e gjelbër	21.1 Identifikimi, vlerësimi dhe planifikimi strategjik i vendit. Të klasifikohen rajonet e prekura sipas nivelit të degradimit përmes një ushtrimi hartëzimi të zonave të degraduara në rajonet e identifikuar, për të zhvilluar një plan restaurimi me përparësi. 21.2 Rigjenerimi dhe ripyllëzimi i pyjeve në zonat e synuara: Has, Kukës, Pukë, Fushë-Arrëz, Mirditë, Mat, Klos, Dibër, Bulqizë, Shkodër, Krujë, Korçë, Kolonjë, Vlorë. Veprimtaria synon rivendosjen e specieve vendase të pemëve përmes mbjelljes së specieve vendore dhe rezistente ndaj zjarrit, si dhe përmes përdorimit të teknikave të parandalimit dhe afësisë ripërtëritëse ndaj zjarrit, të tilla si zonat buferike, brezat mbrojtës nga zjarri, ripyllëzimet me specie të përziera dhe brezat e pemëve rezistente ndaj zjarrit, për të minimizuar përhapjen e zjarreve në të ardhmen. 21.3 Të zbatohet ZBN-të dhe bioinxhinieria për mbrojtjen e tokës dhe infrastrukturës në zonat pyjore të synuara në Tropojë, Has, Kukës, Mirditë, Dibër, Mat, Bulqizë, Klos, Bovillë (Tiranë), Krujë, Gramsh, Skrapar dhe Tepelenë. Ndërhyrjet mund të përfshijnë teknika të tilla si mure mbrojtëse, mure mbajtëse me bimësi dhe specie bimërore që stabilizojnë tokën për të parandaluar erozionin. 21.4 Të zbatohen masa për parandalimin, monitorimin dhe zbutjen e riskut nga zjarret, duke përmirësuar sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm, si dhe duke trajnuar komunitetet vendore dhe ekipet e pylltarisë me strategjitë e parandalimit të zjarreve dhe reagimit të shpejtë. 21.5 Të promovohet menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve i bazuar në komunitet. Të angazhohen komunitetet vendore në restaurimin e pyjeve përmes programeve të ngritjes së kapaciteteve, korrjes së qëndrueshme dhe trajnimit për parandalimin e zjarreve. 21.6 Të lidhen ndërhyrjet për restaurimin e tokave të degraduara, agropylltarinë dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë me planifikimin e MZP-së, duke përcaktuar zonat ku këto ndërhyrje mund të ulin vazhdimësinë e lëndës djegëse në peizazh, të krijojnë korridore të sigurta për ndërhyrje dhe të funksionojnë si breza buferikë për mbrojtjen e vendbanimeve dhe komuniteteve vendore.	ASH	1. Sipërfaqja totale (ha) e ekosistemeve pyjore të ripyllëzuara dhe të përmirësuar (objektivi: 169,000ha). 2. Numri i masave ZBN dhe PBE të zbatuara në zonat e degraduara pyjore për të mbështetur rigjenerimin e pyjeve. 3. Numri i masave ZBN dhe bioinxhinierike të zbatuara në zonat e synuara për mbrojtjen e tokës dhe infrastrukturës. 4. Numri i seancave të trajnimit të zhvilluara me komunitetet vendore dhe ekipet pyjore në parandalimin e zjarreve dhe strategjitë e reagimit të shpejtë. 5. Numri i seancave të angazhimit me komunitetet vendore në restaurimin e pyjeve përmes programeve të ngritjes së kapaciteteve, korrjes së qëndrueshme dhe trajnimit për parandalimin e zjarreve. 6. Zonat e tokës së degraduar të identifikuar, hartëzuara dhe klasifikuara sipas nivelit të degradimit. 7. Sipërfaqja (ha) e ndërhyrjeve restauruese dhe agropylltarisë të projektuara me funksion të qartë për reduktimin e riskut nga zjarret në peizazh.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	1.494.738.115
22	Pylltari	Forcimi i mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave: Investime në kapacitetet njerëzore dhe burimet e zjarrfikësve	Ndërhyrja e butë:	22.1 Të kryhet një vlerësim të nevojave për të identifikuar mangësitë në personel, trajnim dhe pajisje për parandalimin dhe reagimin ndaj zjarreve në pyje dhe kullota në zonat e cënueshme ndaj klimës. 22.2 Të hartohen dhe zbatohen programe trajnimi të synuara për personelin e zjarrfikësve, duke u përqendruar në parandalimin e zjarreve të përshtatura ndaj klimës, zbulimin e hershëm dhe strategjitë e reagimit të shpejtë. 22.3 Të përmirësohen dhe blihen pajisje zjarrfikëse të përshtatura për nevojat e pyjeve dhe kullotave, ku përfshihen automjetet, pajisjet mbrojtëse, mjetet e komunikimit dhe sistemet për transportin e ujit. 22.4 Të krijohen ose përmirësohen sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe të monitorimit të riskut nga zjarri, duke integruar të dhënat meteorologjike dhe projeksonet klimatike për të përmirësuar gatishmërinë. 22.5 Të promovohet koordinimi ndër-agjensor dhe të hartohen protokolle operacionale vendore për MZP-	ASH	1. Kryerja e verifikimit të vlerësimit të nevojave për identifikimin e mangësive në personel, trajnim dhe pajisje për parandalimin dhe reagimin ndaj zjarrit në pyje dhe kullota (po/jo) 2. Përqindja e personelit të zjarrfikësve në zonat e cënueshme ndaj klimës të trajnuar në parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj zjarreve të përshtatura ndaj klimës. 3. Sistemi i parandalimit dhe reagimit ndaj zjarreve është funksional, duke përfshirë pajisjet e përmirësuara dhe sistemet funksionale të paralajmërimit të hershëm dhe monitorimit (po/jo). 4. Numri i ushtrimeve të përbashkëta simuluese të kryera për të testuar koordinimin ndër-agjensor jo vetëm për reagimin ndaj zjarrit, por edhe koordinimin për parandalimin, evakuimin, rehabilitimin pas zjarrit dhe raportimin e dëmeve.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	475.000

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				në dhe të zhvillohen ushtrime të përbashkëta simuluese ndërmjet bashkive, strukturave pyjore, zonave të mbrojtura, emergjencave civile, komuniteteve vendore dhe përdoruesve të kullotave, për forcimin e koordinimit dhe kapaciteteve përgjatë gjithë ciklit të menaxhimit të zjarrit. 22.6 Të pilotohet qasja e MZP-së në zonat më të cenueshme ndaj zjarreve në pyje dhe kullota, duke kombinuar hartëzimin e lëndës djegëse, analizën e ekspozimit të komuniteteve dhe infrastrukturës kritike, vlerësimin ekologjik dhe planifikimin e masave parandaluese në nivel peizazhi.		5. Sipërfaqja (ha) e pyjeve, kullotave dhe zonave të mbrojtura të mbuluara nga planifikimi i MZP-së. 6. Numri i planeve ose protokolleve pilot të MZP-së të hartuara dhe të miratuara në nivel vendor/peizazhi.		
23	Pylltari	Mbështetja e pyllëzimit. Ngritja e fidanishteve rajonale për speciet rezistente ndaj thatësirës	Ndërhyrja e gjelbër	23.1 Të përzgjidhet vendi, të blihet toka dhe të zhvillohet infrastruktura për katër fidanishtet. Të kryhen vlerësime të përshtatshmërisë dhe disponueshmërisë së vendit për të identifikuar katër vendndodhjet e përshtatshme. Pas kësaj, të hartohet një plan zbatimi për fidanishtet, ku të përcaktohet infrastruktura e nevojshme (përgatitja e tokës, zonat në hije të përshtatshme për ngritjen e serave, ujitja me pika, rezervuarët e ujit, mjediset e magazinimit etj.). 23.2 Ndërtimi dhe pajisja e fidanishteve rajonale: Të zhvillohen katër fidanishet të vendosura në mënyrë strategjike me sisteme ujtiqe, ruajtje të farërave dhe mjedise të kontrolluara për të optimizuar rritjen e fidanëve. 23.3 Të kultivohen, përhapen dhe mirëmbahen specie vendase të shumëllojshme, të përshtatura ndaj thatësirës dhe kushteve lokale për të siguruar suksesin afatgjatë të pyllëzimit dhe të përfshihet në programin e fidanishteve një komponent për restaurimin pas zjarrit dhe duke shmangur përbërjet pyjore homogjene me potencial të lartë për përhapjen e zjarrit në zonat me risk të lartë. 23.4 Të krijohet një program për mbledhjen dhe ruajtjen e farëve: Të zhvillohet një bankë farërash për të mbledhur dhe ruajtur fara gjenetikisht të larmishme, të përshtatura për mjedisin vendor dhe për operacione të vazhdueshme të fidanishes si dhe afësitë ripërtëritëse të klimës. 23.5 Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për komunitetet vendore: Të mundësohet trajnimi teknik për komunitetet vendore dhe profesionistët e pylltarisë për menaxhimin e fidanishteve, mbledhjen e farërave dhe teknikat e qëndrueshme të mbjelljes. 23.6 Zhvillimi i sistemit të monitorimit për rritjen dhe mbijetesën e fidanëve: Të zbatohet një kuadër monitorimi për të ndjekur shëndetin e fidanëve, shkallët e rritjes dhe mbijetesën pas mbjelljes në vendet e pyllëzimit.	ASH	1. Numri i fidanishteve rajonale pyjore të ngritura për të mbështetur përpjekjet e pyllëzimit dhe ripyllëzimit në tokat pyjore të zhveshura dhe të dëmtuara nga erozioni të prekura nga zjarret dhe prerja e pemëve (objekti: 4 fidanishet). 2. Numri i specieve vendase të përzgjedhura, kultivuara dhe prodhuara në fidanishet për pyllëzim, restaurim pas zjarrit dhe krijimin e strukturave pyjore më rezistente ndaj thatësirës dhe riskut nga zjarret. 3. Sipërfaqja totale (km ²) e tokave pyjore të zhveshura dhe të dëmtuara nga erozioni të prekura nga zjarret në pyje dhe prerja e pyjeve dhe/ose pyjeve të ripyllëzuar. 4. Numri i anëtarëve të komunitetit dhe profesionistëve të pylltarisë të trajnuar në menaxhimin e fidanishteve dhe teknikat e mbjelljes së qëndrueshme.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	2.249.360
24	Pylltari	Mbështetja e migrimit të specieve të rralla dhe endemike të pyjeve në lartësi më të mëdha	Ndërhyrja e gjelbër	24.1 Identifikimi i habitateve të përshtatshme në lartësi të madhe: Të kryhen vlerësime ekologjike për të identifikuar zonat optimale me lartësi të madhe me kushtet e nevojshme klimatike dhe të tokës për zhvendosjen e specieve. 24.2 Zhvillimi i protokolleve të migracionit të ndihmuar: Të jepen udhëzime për transplantimin e specieve të rralla dhe endemike, duke siguruar ndërprerje minimale ekologjike dhe duke maksimizuar suksesin e përshtatjes. 24.3 Të ngrihen parcela eksperimentale të zhvendosjes: Të ngrihen parcela pilot për të monitoruar përshtatjen e specieve dhe për të përsosur praktikën më të mira për migrimet në shkallë të gjerë në të ardhmen. 24.4 Ofrimi i mbështetjes financiare dhe teknike për menaxhimin e habitatit: Të ofrohen incentiva dhe trajnime për palët e interesit vendore për të menaxhuar habitatet e reja në lartësi të madhe, duke mundësuar konservimin afatgjatë. 24.5 Të monitorohet dhe zhvillohet strategjia afatgjatë e përshtatjes: Të zbatohet një program monitorimi i vazhdueshëm për të ndjekur shëndetin e specieve, ndërveprimet me ekosistemin dhe përshtatjet e nevojshme me kalimin e kohës.	ASH	1. Numri i specieve të pemëve pyjore të zbuluara në lartësi më të mëdha. 2. Sipërfaqja totale (ha) e habitateve të përshtatshme në lartësi të madhe të identifikuar që kanë kushte të përshtatshme klimatike dhe tokësore për zhvendosjen e specieve. 3. Shuma e investimit të alokuar për krijimin dhe menaxhimin e zonave të reja në lartësi të madhe (dollarë amerikanë/vit). 4. Numri i seanceve të trajnimit të zhvilluara për krijimin dhe menaxhimin e zonave të reja në lartësi të madhe.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	894.780
25	Pylltari	Rivendosja e ekosistemeve jetësore: Mbrojtja dhe rigjenerimi i brezave të gjelbër bregdetarë dhe lumorë dhe ekosistemeve mbrojtëse	Ndërhyrja e gjelbër	25.1 Të përzgjidhet vendndodhja, të vlerësohet risku dhe të kryhet planifikimi strategjik. Studime hidrologjike, gjeomorfologjike, të vlerësimit të riskut dhe të sensorëve në distancë për të identifikuar zonat e ndërhyrjes dhe për të përcaktuar një plan ndërhyrjeje. 25.2 Të zbatohen masat bioinxhinierike për menaxhimin e erozionit bregdetar në Velipojë, Kepi Rodomit, Bishti i Palles, Kurbin (Patok), Fier (Darzezë), Durrës (Rushkull) dhe Vlorë (Pylli Sodës). Të përdoret arginatūra me bimësi, stabilizimi i dunave dhe restaurimi i ligatinave në zonat bregdetare të ndjeshme për të zbutur erozionin dhe për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet. 25.3 Mbrojtja dhe rigjenerimi i brezave të gjelbër bregdetarë në zonat e Velipojës, Lagunës së Patokut, Rushkullit, Karpenit, Spilësë, derdhejs së Vjosës, Dukatit, Karaburunit, Pishë-Poroës, Lukovës dhe Sarandës. Të mbrohen, zgjerohen, dhe përmirësohen rripat e gjelbër bregdetarë ekzistues dhe mbijellë bimësi vendase, duke përmirësuar lidhshmërinë midis ekosistemeve bregdetare dhe duke ngritur zona buferike bregdetare për të filtruar ndotësit. 25.4 Punime inxhinierike të mbrojtjes bregdetare (infrastruktura gri) në zonat Velipoje, Kune-Vain, Patok-Fushë Kuqe, Rushkull, Divjake-Karavasta, Nartë, dhe Butrint. Ndërhyrjet mund të përfshijnë ndërtimin e arginaturave bregdetare, dallgëthyesve për të reduktuar ndikimin e veprimeve të valëve dhe mure detare për t'u mbrojtur nga baticat e larta dhe stuhite e forta, duke kufizuar tërheqjen bregdetare. Qëndrueshmëria e strukturave do të promovohet duke integruar materiale miqësore me mjedisin, aty ku është e mundur. 25.5 Forcimi i rezistencës së ekosistemit lumor: Të bëhet stabilizimi i tokës me bimë vendase dhe masa kontrolli të erozionit bimor në zonat lumore, veçanërisht në Bovillë dhe në pellgjet ujëmbledhëse të Drinit, Matit, Erzenit, Shkumbinit, Vjosës dhe Semanit, për të zvogëluar sedimentimin dhe për të përmirësuar menaxhimin e përmbytjeve.	ASH	1. Numri i zonave bregdetare ku janë zbatuar masat për erozionin bioinxhinierik. 2. Numri i hektarëve të brezave të gjelbër bregdetarë të restauruar ose të zgjeruar me bimësi vendase. 3. Numri i punimeve të përfunduara të mbrojtjes bregdetare të infrastrukturës gri (p.sh., arginatūra, dallgëthyes, mure detare). 4. Përqindja e strukturave mbrojtëse bregdetare që integrojnë materiale miqësore me mjedisin ose komponentë të bazuar në natyrë. 5. Numri i pellgjeve ujëmbledhëse me masa për stabilizimin e tokës dhe kontrollin e erozionit të zbatuara duke përdorur bimësi vendase. 6. Numri i vlerësimeve të rrezikut bregdetar dhe hidrologjike specifike për vendin të përfunduara për të udhëhequr planifikimin e ndërhyrjeve. 7. Numri i vendeve të monitorimit të krijuara për ndjekjen e restaurimit të ekosistemit bregdetar dhe lumor duke përdorur metoda satelitore dhe të bazuara në terren	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	145.561.688

NR.	Sektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				25.6 Përmirësimi i monitorimit dhe strategjive të menaxhimit përshatës: Të krijohen programe monitorimi afatgjata për ekosistemet bregdetare dhe lumore, duke integruar imazhet satelitore dhe vlerësimet e biodiversitetit në vend për të matur efektivitetin e përpjekjeve të restaurimit.				
26	Pylltari	Financim i qëndrueshëm përmasës për shërbimet e ekosistemit (PSHE)	Ndërhyrja e butë:	26.1 Të kryhet një vlerësim për të identifikuar shërbimet kryesore të ekosistemit (p.sh., rregullimi i ujit, sekuestrimi i karbonit, mbrojtja e biodiversitetit) dhe përfutjesit e tyre kryesore në nivel kombëtar dhe vendor. 26.2 Të zhvillohet një kuader institucional për të mundësuar dhe rregulluar skemat e PSHE-së, duke përfshirë procedurat për kontraktimin, menaxhimin e fondeve, ndajën e përfitimeve dhe monitorimin. 26.3 Të zbatohen marrëveshjet pilot të PSHE-së në zona të zgjedhura duke krijuar kontrata formale midis përfutësve të shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve, me mekanizma për të kanalizuar fondet drejt menaxhimit të qëndrueshëm të tokës dhe ekosistemit. 26.4 Të ofrohet asistencë teknike për palët vendore të interesit për të siguruar pjesëmarrje efektive në skemat e PSHE-së.	AGJ	1. Ekzistenca e një raporti kombëtar vlerësimi që identifikon shërbimet kryesore të ekosistemit dhe përfutjesit e tyre kryesore në nivel kombëtar dhe vendor (Po/Jo). 2. Ekzistenca e një kuadri institucional dhe rregullator për skemat PSHE-së të miratuara zyrtarisht (Po/Jo). 3. Numri i kontratave formale të PSHE-së të nënshkruara midis ofruesve të shërbimeve dhe përfutësve në zonat pilot. 4. Përqindja e paleve të interesit të synuara që marrin asistencë teknike për pjesëmarrjen në skemën PSHE.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	16.000.000
27	Pylltari	Restaurimi dhe afësitë ripërtëritëse të ekosistemit të integruar Trajtimi i erozionit të tokës në rajonet kryesore të Shqipërisë	Ndërhyrja e gjelbër	27.1 Përzgjedhja e vendit, vlerësimi i riskut dhe planifikimi strategjik. Të kryhen studime hidrologjike, geomorfologjike, të vlerësimit të riskut dhe të sensorëve në distancë për të identifikuar zonat e ndërhyrjes dhe për të përcaktuar një plan ndërhyrjeje. 27.2 Të zbatohet bioinxhinieria dhe të përdoret zonat buferike bregore për të luftuar erozionin e tokës: Të përdoren zgjidhje bioinxhinierike si zonat buferike bimore, tarracat dhe speciet bimore vendase rezistente ndaj erozionit për stabilizimin e shpatëve. Të mbrohet dhe të rivendoset bimësia bregore dhe ajo e ligatinave në zonat me rrezik nga erozioni, për të rritur mbajtjen e ujit, për të filtruar ndotësit dhe për të mbështetur biodiversitetin. 27.3 Të rritet angazhimi i komunitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës: Të zhvillohen programe vendore trajnimi për të promovuar praktikatat e qëndrueshme bujqësore dhe pyjore që reduktojnë erozionin e tokës dhe përmirësojnë qëndrueshmërinë e ekosistemit. 27.4 Forcimi i monitorimit dhe strategjive të menaxhimit përshatës: Të monitorohet ekosistemi në aspektin afatgjatë për t'u përgatitur në rast të risqeve klimatike, të ndiqet efektshmëria e përpjekjeve të restaurimit dhe të përsoset qasjet e menaxhimit përshatës.	AGJ	1. Numri i masave të bioinxhinierisë të zbatuara për të luftuar erozionin e tokës dhe për të rritur qëndrueshmërinë e ekosistemit në tokat e degraduara. 2. Sipërfaqja totale (ha) e tokës së degraduar e përmirësuar për të luftuar erozionin dhe për të përbaluar qëndrueshmërinë e ekosistemit në Përmë (objektivi: 3.834,44 ha). 3. Sipërfaqja totale (ha) e tokës së degraduar e përmirësuar për të luftuar erozionin dhe afësitë ripërtëritëse të ekosistemit në Vlorë (objektivi: 374,57 ha).	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	62.573.351
28	Pylltari	Lufta kundër erozionit dhe përmbytjeve: Restaurimi strategjik i habitateve dhe ripyllëzimi në rajonet kryesore të Shqipërisë	Ndërhyrja e gjelbër	28.1 Të përzgjidhen vendndodhjet dhe të identifikohen zonat specifike dhe ndërhyrjet për zbatimin e krijimit dhe restaurimit të habitatit duke reduktuar erozionin e tokës, duke parandaluar përmbytjet dhe duke përmirësuar afësitë ripërtëritëse të ekosistemit në vendndodhjet strategjike të identifikuar. 28.2 Restaurimi i pyjeve dhe kullotave të degraduara në rajonet kryesore: Të zbatohet ripyllëzimi në Durrës (194,84 ha) dhe Fier (931,96 ha) duke synuar zonat e degraduara nga zjarret në pyje, kullotat e tepër dhe shpyllëzimi. 28.3 Krijimi i brezave të gjelbër përgjatë lumenjve Vjosa dhe Seman: Të mbillen lloje pemësh vendase përgjatë lumenjve Vjosë (137,8 ha) dhe Seman (Fier) (55,63 ha), për të stabilizuar brigjet e lumenjve, për të zvogëluar sedimentimin dhe për të zbutur risqet e përmbytjeve. 28.4 Zgjidhje të Bazuar në Natyrë (ZBN) për kontrollin e erozionit dhe përmbytjeve: Të zbatohen ZBN-të, siç janë zgjidhjet e bioinxhinierisë, tarracat dhe barrierat e bimësive, për të restauruar zonat e degraduara dhe për të kontrolluar erozionin e tokës në rajonet pyjore dhe kullotore. 28.5 Restaurimi i fokusuar në ekosistemet bregdetare dhe malore të Vlorës: Të restaurohen ekosistemet kryesore në Dukat, Llogora, Karaburun për të mbrojtur nga erozioni i tokës, dhe Pyllin e Pishë-Poros (6740 ha) për të mbrojtur nga erozioni bregdetar dhe humbja e biodiversitetit. 28.6 Ripyllëzimi i synuar në Dukat të Vjetër: Të restaurohen 354,4 hektarë pyll i degraduar në Dukat të Vjetër (Vlorë), ku erozioni i tokës dhe shpyllëzimi kanë çuar në degradimin e tokës dhe humbjen e tokës prodhuese. 28.7 Integrimi i rehabilitimit pas zjarrit në restaurimin strategjik të habitateve, duke prioritetizuar zonat e djegura me risk të lartë erozioni, humbje të biodiversitetit dhe ndikim mbi komunitetet vendore, si dhe duke lidhur ndërhyrjet e ripyllëzimit me masat për stabilizimin e tokës, rikuperimin ekologjik dhe uljen e riskut të zjarreve të përsëritura.	ASH	1. Sipërfaqja totale (ha) e pyjeve dhe kullotave të degraduara të restauruara nëpërmjet ripyllëzimit dhe kontrollit të erozionit bazuar në bimësi në Durrës dhe Fier (objektivi: 1.126,8 ha) 2. Sipërfaqja totale (ha) e brezave të gjelbër me specie vendase të vendosura përgjatë lumenjve Vjosë dhe Seman (objektivat: 137,8 ha në Vjosë dhe 55,63 ha në Seman) 3. Sipërfaqja totale (ha) e ripyllëzuar në Dukat të Vjetër për të zvogëluar erozionin dhe për të restauruar tokën e degraduar (objektivi: 354,4 ha) 4. Numri i vendeve ku zbatohen zgjidhjet e bazuara në natyrë (p.sh., tarraca, barrierat vegjetative, bioinxhinieri) për kontrollin e erozionit dhe përmbytjeve. 5. Rritja e përqindjes së mbulesës bimore të tokës në zonat pyjore dhe kullotave të restauruara. 6. Numri i vendeve të monitorimit ekologjik të krijuara për të ndjekur rritjen e bimësive, stabilitetin e tokës dhe biodiversitetin në zonat e restauruara. 7. Sipërfaqja totale (ha) e restauruar në pyllin Pishë-Poro për të mbrojtur nga erozioni bregdetar dhe humbja e biodiversitetit (objektivi: 6,740 ha) 8. Sipërfaqja (ha) e zonave të djegura të rehabilituara me masa të kombinuara për kontrollin e erozionit, restaurimin e habitatit dhe reduktimin e riskut të përsëritjes së zjarreve.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	124.943.176
29	Pylltari	Menaxhimi i qëndrueshëm i peizazhit: Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe biodiversitetit në liqenin e Viroit në Gjirokastrë	Ndërhyrja e gjelbër	29.1 Të kryhet vlerësimi i vendndodhjes, planifikimi dhe përfshirja e paleve të interesit, duke realizuar vlerësime ekologjike dhe hidrologjike, hartëzime GIS dhe përdorim të sensorëve në distancë, me qëllim identifikimin e zonave që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përcaktimin e një plani restaurimi që përfshin palët e interesit dhe komunitetet përkatëse. 29.2 Ripyllëzimi me specie vendase: Të zbatohen nisma ripyllëzimi rreth liqenit të Viroit duke përdorur specie vendase pemësh dhe shkurresh për të restauruar zonat e degraduara, për të stabilizuar tokën dhe për të rritur biodiversitetin. Forcimi i zonave buferike bregore do të ndihmojë në uljen e nivelit të sedimenteve në liqen, duke përmirësuar cilësinë e ujit dhe qëndrueshmërinë e ekosistemit. Bimësia rezistente ndaj thatësirës do të ketë përparësi për t'u përshtatur me kushtet klimatike në ndryshim. 29.3 Masat e kontrollit të erozionit: Të ndërmerren masa për kontrollin e erozionit, të tilla si zonat buferike bimore, tarracat dhe teknikatat e bioinxhinierisë për të zvogëluar erozionin e tokës dhe për të parandaluar sedimentimin në liqen. Këto veprime do të mbrojnë cilësinë e ujit dhe do të rrisin afësitë ripërtëritëse të peizazheve përreth. 29.4 Nismat për përmirësimin e cilësisë së ujit: Të	AGJ	1. Sipërfaqja totale (ha) e tokës së restauruar rreth liqenit të Viroit në Gjirokastrë (objektivi: 339,85 ha). 2. Numri i specieve të pemëve vendase të zbuluara në zonat e ripyllëzuara. 3. Sipërfaqja totale (ha) e mbuluar nga masat e kontrollit të erozionit (zona buferike bimore, tarraca dhe teknikatat bioinxhinierike) për të zvogëluar erozionin e tokës dhe për të parandaluar sedimentimin në liqen. 4. Rritja e cilësisë së ujit sipas parametrave fizikë (temperatura, turbullira, ngjyra dhe aroma, totali i lëndëve të ngurta të pezulluara), kimikë (pH, oksigjeni i tretur, nitrati dhe fosfatet, përqendrimi i oksigjenit dhe totali i lëndëve të ngurta të tretura, metale të rënda, kërkesa kimike për oksigjenin dhe kërkesa biologjike për oksigjenin) dhe biologjike (bakteret koliforme, veçanërisht E. coli, diversiteti i makroinvertebrorëve dhe prania e algave), standardeve dhe indekseve (p.sh. Indeksi i Cilësisë së Ujit, ICU).	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	479.334

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				zbatohen masa për të përmirësuar cilësinë e ujit në liqenin e Viroit duke reduktuar burimet e ndotjes, përmirësuar menaxhimin e ujërave të zeza dhe duke promovuar praktikën e qëndrueshme bujqësore në zonat përreth. Këtu përfshihet krijimi i zonave buferike, kontrolli i rrjedhjes së lëndëve ushqyese dhe monitorimi i parametrave të cilësisë së ujit. 29.5 Ruajtja e biodiversitetit dhe përmirësimi i habitatit: Të forcohet ruajtja e biodiversitetit duke restauruar habitatet natyrore, duke rikthyer speciet vendase dhe duke krijuar korridore ekologjike rreth liqenit. Këtu përfshihet mbrojtja e zonave ligatinore, përmirësimi i habitatëve të peshqve dhe përmirësimi i kushteve për shpendët dhe speciet ujore.				
30	Pylltari	Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura	Ndërhyrja e gjelbër	30.1 Vlerësimet e ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe planet specifike të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në zonat e mbrojtura: Të kryhen vlerësime të hollësishme të ndikimit të ndryshimeve klimatike për parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura, me fokus të veçantë në Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli" në Përmet, Parku Kombëtar i Dajtit dhe Parku i Bizë-Martanesh. Këtu do të përfshihet studimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në speciet e rralla dhe endemike, vlerësimi i ndryshimeve në shpërndarjen e habitatëve, identifikimi i zonave të cënueshme dhe identifikimi i masave të përshtatjes. 30.2 Të krijohen dhe zbatohen zona buferike rreth zonave të mbrojtura: Bredhit të Hotovës-Dangëlli, Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa dhe zonave të tjera të mbrojtura, duke integruar MZP-në në planin specifik të përshtatjes dhe menaxhimit përmes hartëzimit të zonave me risk të lartë nga zjarret, menaxhimit të vegjetacionit në hapësirat buferike, protokolleve për vizitorët dhe turizmin gjatë periudhës kritike, si dhe masave për restaurimin ekologjik pas zjarrit, me qëllim uljen e presionëve të jashtme, mbrojtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e funksioneve të ekosistemit. 30.3 Monitorimi i specieve endemike dhe të rralla: Të zbatohet një sistem gjithëpërfshirës monitorimi për speciet endemike dhe të rralla brenda lumit Vjosë dhe Parkut Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli". Vëzhgimet e rregullta do të ndjekin dinamikën e popullatës dhe shëndetin e këtyre specieve, duke siguruar ndërhyrje në kohë nëse do të jetë e nevojshme. 30.4 Ngritja e kapaciteteve në komunitetet vendore dhe paletë e interesit: Të forcohen kapacitetet e komuniteteve vendase, ambientalistëve dhe agjencive qeveritare për të menaxhuar zonat e mbrojtura dhe zonat buferike. Këtu do të përfshihen trajnimet mbi strategjitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, ruajtja e biodiversitetit dhe praktikat e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës.	AM	1. Numri i vlerësimeve të kryera në lidhje me ndikimin e ndryshimeve klimatike. 2. Sipërfaqja totale (ha) e zonave buferike të krijuara rreth Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa dhe zonave të tjera të mbrojtura/numri i planeve të menaxhimit/përshtatjes të zonave të mbrojtura që përfshijnë MZP-në, hartëzimin e zonave me risk të lartë dhe protokollin për parandalim e rehabilitim pas zjarrit. 3. Numri i habitatëve dhe specieve të identifikuar sipas "Natura 2000" në bashkinë e Vlorës, brenda dhe përtej zonave të mbrojtura. 4. Sipërfaqja (ha) e habitatëve të mbrojtura dhe numri i specieve "Natura 2000" nën mbrojtje brenda dhe përtej zonave të mbrojtura	Parqet Kombëtare dhe Zonat e Mbrojtura, Bashkitë	257.461.805
31	Pylltari	Restaurimi i shtresave pyjore për të mbrojtur të korrat në Vlorë	Ndërhyrja e gjelbër	31.1 Të kryhet studime për të përcaktuar vendet optimale për integrimin e shtresave pyjore dhe angazhimin me fermat dhe komunitetet vendore për të përcaktuar zonat dhe ndërhyrjet e nevojshme për të identifikuar opsionet dhe speciet më të mira për të siguruar mbrojtje nga era për kulturat bujqësore. 31.2 Restaurimi i shtresave pyjore midis zonave bujqësore në Vlorë për të mbuluar 345,47 ha. Të promovohet restaurimi i shtresave pyjore midis sipërfaqeve bujqësore në Vlorë, konkretisht në zona të tilla si Dukati i Ri, Tragjasi dhe Radhima. Këto shtresa pyjore do të ndihmojnë në krijimin e mikrohabitatëve që forcojnë biodiversitetin, përmirësojnë pjellorinë e tokës dhe ofrojnë mbrojtje natyrore nga era për të korrat, duke zvogëluar ndikimin negativ të errërave të forta dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë e përgjithshme të të korrave, si dhe duke nxitur mbjelljen e specieve vendase të pemëve që mund të mbështesin biodiversitetin. 31.3 Përfshirja e komunitetit dhe praktikave të qëndrueshme: Të përfshihen fermerët dhe komunitetet vendore në procesin e restaurimit, duke siguruar që shtresat pyjore të mirëmbahen në mënyrë të qëndrueshme me kalimin e kohës. Të ofrohen trajnime dhe burime mbi praktikën e agropylltarisë dhe përfitimet afatgjatë të integritetit të pemëve me kulturat bujqësore.	AM	1. Sipërfaqja totale (ha) e shtresave pyjore midis sipërfaqeve bujqësore të restauruara (objektivi: 345,47 ha). 2. Rritja e përgjithshme të rendimentit mesatar të të korrave në zonat ngjitur me shtresat pyjore të restauruara. 3. Rritja e qëndrueshmërisë e të korrave sipas treguesve agronomikë dhe biofizikë (qëndrueshmëria e rendimentit, hendeuku i rendimentit, toleranca ndaj thatësirës ose përmbajtjeve, rezistenca ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve), fiziologjike dhe gjenetike (thelësia dhe struktura e sistemit rrënjor, përçueshmëria stomatale, temperatura e gjetheve dhe gjenotipet me aftësi ripërtëritëse), mjedisore (shëndeti i tokës dhe lenda organike, agrobiodiversiteti dhe përdorimi eficient i ujit) dhe treguesit dhe kornizat të përbëra (Indeksi i Aftësisë Ripërtëritëse të Kulturave).	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	3.282.947
32	Turizmi	Planifikimi hapësinor strategjik për turizmin: Ridrejtimi i zhvillimit nga zonat me risk të lartë	Ndërhyrja e butë:	32.1 Të kryhet hartëzimi hapësinor i riskut për të identifikuar fushat aluvionale, zonat e akumulimit të ujërave sipërfaqësore dhe zonat buferike të zonave të mbrojtura që janë të papërshtatshme për zhvillimin e turizmit. 32.2 Të hartohen udhëzime për planifikimin hapësinor që integrojnë konsideratat e riskut klimatik, duke përcaktuar zonat pa ndërtim dhe zonat prioritare për riorientimin e turizmit. 32.3 Të angazhohen paletë e interesit - ku përfshihen bashkitë, investitorët në turizëm dhe autoritetet mjedisore - për të marrë pjesë në <i>workshop</i>-e për planifikimin, për të përafshuar planifikimin hapësinor me objektivat ekonomike dhe të konservimit. 32.4 Të krijohen mekanizma financiarë (p.sh., leje me kusht, incentive ose subvencione për ridrejtim) për të mbështetur zhvendosjen ose riprojektimin e zhvillimeve turistike larg zonave me risk të lartë. 32.5 Të aplikohen rregulloret zonimit dhe të zbatohen planet e përdorimit të tokës nëpërmjet monitorimit, inspektimeve dhe gjohave për mosrespektim.	ASH	1. Ekzistenca e një harte hapësinore të riskut që identifikon fushat e përmbajtjeve, zonat e akumulimit të ujërave sipërfaqësore dhe zonat buferike të zonave të mbrojtura të papërshtatshme për zhvillimin e turizmit (Po/Jo). 2. Numri i udhëzimeve të planifikimit hapësinor të zhvilluara dhe të miratuara që përcaktojnë zonat pa ndërtim dhe prioritetet në ridrejtimin për infrastrukturën turistike. 3. Numri i projekteve turistike të zhvillimit të ridrejtuar ose të riprojektuara bazuar në mekanizmat financiarë që mbështesin zhvendosjen nga zonat me risk të lartë. 4. Numri i veprimeve zbatuese të ndërmarta për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret e zonimit dhe planet e përdorimit të tokës të bazuar në informacionin rreth klimës në zonat turistike.	Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	600.000
33	Turizmi	Infrastruktura turistike dhe trashëgimisë kulturore që i reziston klimës: Paketat e incentiveve për të mbrojtur infrastrukturën e sektorit të turizmit dhe trashëgiminë	Ndërhyrja e butë:	33.1 Të përvijohet një plan veprimi afatgjatë për rinovimin e infrastrukturës turistike rezistente ndaj klimës, bazuar në gjetjet nga analiza sektoriale e cënueshmërisë dhe riskut. 33.2 Të zhvillohen dhe miratohen standardet e prokurimit dhe ndërtimit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës për të udhëhequr rinovimet dhe zhvillimet e reja në sektorin e turizmit. 33.3 Të hartohet dhe lançohet një paketë incentiveve financiare për të mbështetur zgjidhjet me eficientë energjie dhe qëndrueshmëri klimatike për komoditetin termik (p.sh. përdorimi i materialeve me albedo të lartë, sistemeve të hijëzimit, cativë të gjelbra,	AM	1. Plani i veprimi për rinovimin e sektorit të turizmit është zhvilluar dhe miratuar zyrtarisht, duke integruar aftësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe gjetjet nga analiza e cënueshmërisë dhe riskut (Po/Jo). 2. Janë zhvilluar standarde prokurimi dhe ndërtimi për infrastrukturën turistike të qëndrueshme ndaj klimës. (Po/Jo). 3. Shuma totale (dollarë amerikanë) e alokuar përmes skemave të incentiveve financiare operacionale për të mbështetur rinovimin e akomodimeve turistike me eficientë energjie dhe me qëndrueshmëri	Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	800.000

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
		kulturore nga ndryshimet klimatike		gjelbërimit vertikal, ventilimit natyror dhe izolimit termik) në strukturat akomoduese turistike. 33.4 Të krijohen mekanizma mbështetës teknikë për të ndihmuar bizneset turistike që të kenë akses në financim, të jenë në përputhje me standardeve të reja dhe që të zbatojnë masat e rinovimit. 33.5 Integrimi i kriterëve të qëndrueshmërisë klimatike në restaurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Të promovohen dhe zbatohen standarde dhe udhëzime për integrimin e kriterëve të qëndrueshmërisë klimatike në restaurimin, konservimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe aseteve të trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për kulturën dhe njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim mbrojtjen e tyre nga rreziqet klimatike		ndaj klimës. 4. Numri i bizneseve turistike që marrin asistencë teknike për të aksesuar financimin dhe për të zbatuar masa rinovimi me qëndrueshmëri ndaj klimës. 5. Udhëzime të miratuara për integrimin e kriterëve të qëndrueshmërisë klimatike në restaurim, konservim dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe aseteve të trashëgimisë kulturore,		
34	Turizmi	Planifikimi strategjik për qëndrueshmëri në bregdetare: Zonat buferike dhe përshtatja e barrierave detare	Ndërhyrja e butë:	Veprimtaritë kryesore për përcaktimin e zonave buferike 34.1.1 Të identifikohen zonat më të ndjeshme ndaj rritjes së nivelit të detit dhe rritjes së niveleve të shtrimit të lumenjve 34.1.2 Të përdoret GIS-i dhe teledeteksioni për të hartëzuar zonat e prirura ndaj përmbytjeve dhe erozionit 34.1.3 Të zhvillohen dhe zbatohen rregullore që përcaktojnë gjerësinë e zonave buferike dhe kufizimet për zhvillimin brenda këtyre zonave 34.1.4 Të sigurohet integrimi i zonave buferike në planet vendore dhe rajonale për përdorimin e tokës 34.1.5 Të edukohen komunitetet rreth rëndësisë të zonave buferike në mbrojtjen nga përmbytjet dhe erozioni 34.1.6 Të angazhohen palët vendore të interesit në procesin e planifikimit dhe zbatimit 34.1.7 Të vendosen zona buferike bimore me specie vendase për të stabilizuar tokën dhe reduktuar erozionin. 34.1.8 Të ndiqen programet e vazhdueshme të monitorimit dhe mirëmbajtjes për të siguruar efektshmërinë e zonave buferike Veprimtaritë kyç për ngritjen e barrierave detare 34.2.1 Të vlerësohet fizibiliteti teknik, ekonomik dhe mjedisor i barrierave detare të instaluar 34.2.2 Të zhvillohen projekte të detajuara dhe plane inxhinierike për barrierat detare, duke marrë në konsideratë kushtet vendore dhe ndikimin e mundshëm 34.2.3 Të sigurohen të gjitha lejet dhe miratimet e kërkuara nga autoritetet përkatëse 34.2.4 Të kryhen vlerësime të hollësishme të ndikimit në mjedis për të identifikuar dhe zburuar efektet e mundshme negative 34.2.5 Të ndërtohen dhe instalohen barrierat detare, për të siguruar që atë të ndërtohen për t'i bërë ballë kushteve vendore mjedisore 34.2.7 Të përcaktohen protokollet për funksionimin e barrierave detare, duke përfshirë procedurat e hapjes dhe mbylljes gjatë stuhive 34.2.8 Zbatoni një orar për inspektime dhe mirëmbajtje të rregullta për të siguruar që portat detare të mbeten funksionale dhe efektive.	AM	1. Numri i zonave bregdetare dhe lumore të cënueshme të identifikuara dhe të hartuara duke përdorur GIS-in dhe mjetet e teledeteksioni. 2. Numri i zonave buferike të përcaktuara ligjërisht dhe të integruara në planet vendore ose rajonale të përdorimit të tokës. 3. Numri i hektarëve të zonave buferike bimore të krijuara ose të restauruara me specie bimore vendase. 4. Numri i vlerësimeve të fizibilitetit të barrierave detare dhe projekteve inxhinierike të përfunduara dhe të miratuara. 5. Numri i portave detare të ndërtuara dhe funksionale me protokollet e përcaktuara në rastet e stuhive. 6. Numri i seancave të ndërgjegjësimit të komunitetit dhe angazhimit të palëve të interesit të zhvilluara për zonat buferike dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet. 7. Përqindja e zonave buferike dhe barrierat detare nën programe aktive monitorimi dhe mirëmbajtjeje.	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Bashkitë	504.000
35	Turizmi	Mbrojtja e Gjirit të Vlorës: Ruajtja e habitateve të posidonia-s dhe trashëgimisë kulturore nënujore kundër ndikimeve të klimës	Ndërhyrja e gjelbër	35.1 Të kryhet hartëzimi i shtratit të detit dhe vlerësimi i livadheve të Posidonia-s për të përcaktuar fushëveprimin dhe opsionet për përpjekjet e restaurimit. 35.2 Të restaurohen dhe zgjerohen livadhet me alga detare Posidonia: Të restaurohen aktivisht livadhet e degraduara të Posidonia-s përmes transplantimit dhe përpjekjeve të konservimit për të rritur qëndrueshmërinë bregdetare. 35.3 Promovimi i zonave natyrore të plazhit dhe mbrojtja e Banquettes Posidonia: Të inkurajohet përdorimi i zonave natyrore të plazhit, duke ruajtur shkëmbinjtë dhe bregun e Posidonia-s për të ruajtur ekuilibrin e ekosistemit, duke përfshirë zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme turistike. 35.4 Monitorimi i ndikimit të klimës në trashëgiminë kulturore nënujore: Të zhvillohen programe monitorimi për të vlerësuar efektet e rritjes së temperaturave të detit dhe erozionit në vendet arkeologjike të zhytura. 35.5 Zbatimi i zonave të mbrojtura detare (ZMD) për konservimin: Të përcaktohen dhe të zbatohen zonat e mbrojtura detare në Gjirin e Vlorës, për të mbrojtur habitatet e Posidonia-s dhe trashëgiminë nënujore nga kërcënimet e shkaktuara nga njeriu dhe ndryshimet klimatike. 35.6 Angazhimi i komuniteteve vendore në përpjekjet për ruajtjen e natyrës: Të promovohet ngritja e kapaciteteve për ruajtjen e natyrës dhe për nxitjen e nismave të udhëhequra nga komuniteti, si dhe i praktikave të turizmit të qëndrueshëm, për të mbështetur ruajtjen e natyrës dhe për të siguruar njëkohësisht përfitime ekonomike për rajonin. 35.7 Të zbatohen sisteme monitorimi të qëndrueshme për të mbrojtur livadhet me alga detare: Të instalohen bova ankori miqësore me mjedisin për të parandaluar dëmtimin e spirancave në livadhet e Posidonia-s dhe ekosisteme të tjera të ndjeshme detare. 35.8 Të ndiqen programet për heqjen e mbeturinave dhe reduktimin e mbetjeve: Të krijohen nisma vendore për pastrimin e plazheve dhe shtratit të detit për të reduktuar ndotjen që ndikon në biodiversitetin detar dhe tërheqjen e turizmit.	AGJ	1. Numri i hektarëve të livadheve me Posidonia të vlerësuar, të restauruara ose të krijuara rishtazi përmes përpjekjeve të transplantimit dhe ruajtjes. 2. Numri i zonave të mbrojtura detare (ZMD) të përcaktuara dhe të zbatuara për habitatet e Posidonia-s dhe mbrojtjen e trashëgimisë nënujore në Gjirin e Vlorës. 3. Numri i sistemeve të qëndrueshme të ankorimit (p.sh., bova miqësore me mjedisin) të instaluar për të mbrojtur livadhet e algave të detit nga dëmtimi prej spirancave. 4. Numri i vendeve të monitorimit të krijuara për të ndjekur ndikimin e ndryshimeve klimatike në trashëgiminë kulturore nënujore në Gjirin e Vlorës. 5. Përqindja më e lartë ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrje të komuniteteve vendore në veprimtaritë e ruajtjes së Posidonia-s dhe trashëgimisë detare. 6. Numri i zonave natyrore të plazhit të përcaktuara dhe të menaxhuara për mbrojtjen e platformave të Posidonia-s dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm. 7. Vëllimi i mbeturinave detare të larguara nga zonat prioritare të Gjirit të Vlorës nëpërmjet fushatave të pastrimit dhe programeve të reduktimit të mbeturinave plastike.	Ministria e Mjedisit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Bashkitë	3.606.119
36	Turizmi	Forcimi i kuadrit politik dhe rregullator për turizmin e qëndrueshëm: Rishikimi i politikave dhe përmirësimi rregullator	Ndërhyrja e butë:	36.1 Të kryhet një shqyrtim diagnostikues të ligjeve, politikave dhe instrumenteve rregullatore që lidhen me turizmin për të identifikuar mangësitë, mospërpulthjet dhe mundësitë për integrimin të dispozitave në të forta për qëndrueshmërinë. 36.2 Të zhvillohen rekomandime për politikat dhe ndryshimet e propozuara për të përfunduar rregulloret e turizmit me objektivat kombëtare të përshtatjes ndaj klimës, standardet e qëndrueshmërisë dhe prioritetet e mbrojtjes së mjedisit. 36.3 Të përditësohen ose zhvillohen instrumente ligjore dhe rregullatore për të përfunduar praktikat e	ASH	1. Rishikimi diagnostikues i politikave dhe rregulloreve që lidhen me turizmin është përfunduar, duke identifikuar mangësitë dhe mundësitë për integrimin e qëndrueshmërisë dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj klimës (Po/Jo). 2. Numri i rekomandimeve për politika ose ndryshime ligjore të propozuara për të forcuar qëndrueshmërinë dhe përshtatjen ndaj klimës në rregulloret e turizmit. 3. Numri i instrumenteve ligjore dhe rregullatore të përditësuara ose të miratuara	Ministria e Mjedisit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	120.500

NR.	Sektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				turizmit të qëndrueshëm, duke përfshirë dispozita specifike për mbrojtjen e mjedisit, kufizimin e përdorimit të tokës në zonat ekologjikisht të ndjeshme dhe kërkesat e afësisive ripërtëritëse ndaj klimës për infrastrukturën turistike.		rishtazi që promovojnë praktikatat e turizmit të qëndrueshëm dhe me afësi ripërtëritëse ndaj klimës.		
37	Turizmi	Integrimi i të dhënave klimatike për turizëm të qëndrueshëm: Udhëzimet për menaxhimin e qëndrueshëm të biznesit dhe raportimin kombëtar	Ndërhyrja e butë;	37.1 Të zhvillohen dhe zbatohen udhëzime për mbledhjen e të dhënave standarde në sektorin e turizmit, duke u përqendruar në treguesit që lidhen me cenueshmërinë ndaj klimës, ndikimet mjedisore dhe performancën e qëndrueshmërisë. 37.2 Të forcohen kapacitetet institucionale dhe teknike të autoriteteve turistike dhe aktorëve të sektorit privat përmes trajnimit dhe asistencës teknike mbi praktikatat e mbledhjes, analizës dhe raportimit të të dhënave. 37.3 Të ngrihen ose të përditësohen platformat digjitale ose bazave e të dhënave për të mbledhur dhe menaxhuar të dhënat për turizmin që lidhen me klimën, duke siguruar ndërveprimin me sistemet kombëtare të raportimit dhe monitorimit.	ASH	1. Janë zhvilluar dhe miratuar zyrtarisht udhëzimet e standardizuara për mbledhjen e të dhënave rreth cenueshmërisë ndaj klimës dhe ndikimin në mjedis në sektorin e turizmit (Po/Jo). 2. Përqindja e palëve të interesit të turizmit të trajnuara mbi praktikatat e mbledhjes, analizës dhe raportimit të të dhënave në lidhje me cenueshmërinë klimatike dhe qëndrueshmërinë mjedisore. 3. Numri i platformave digjitale ose bazave të të dhënave të krijuara ose të përmirësuara për të menaxhuar të dhënat për turizmin që lidhen me klimën, me lidhje me sistemet kombëtare të raportimit.	Ministria e Mjedisit; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	290.000
38	Turizmi	Mbrojtja e infrastrukturës turistike nga ndryshimet klimatike: Projektme përshatëse për zbutjen e risqeve klimatike	Ndërhyrja gri	38.1 Vlerësimi i riskut klimatik për infrastrukturën ekzistuese dhe të planifikuar të turizmit dhe përzgjedhja e vendndodhjes për zonat që janë veçanërisht të ndjeshme për të përcaktuar ndërhyrjet e drejtpërdrejta nga sektori publik dhe për të studiuar potencialin për përfshirjen e sektorit privat. 38.2 Të rishikohen kodet e ndërtimit dhe të analizohet nevoja për përfshirjen e parimeve të tjera të projektimit me afësi ripërtëritëse ndaj klimës, për ndërtimin ose rinovimin e infrastrukturës turistike me afësi ripërtëritëse ndaj klimës, duke e vendosur theksin në zbatimin e tyre. Përcaktimi dhe përfshirja e kritereve të qëndrueshmërisë në projektimin dhe ndërtimin e hoteleve, shtëpive dhe hapësirave rekreative me themele të ngritura, materiale të papërkushme nga përmbajtjet dhe struktura të performuara, si dhe sisteme kullimi për t'i bërë ballet ngjarjeve ekstreme të motit përmes kodeve të ndërtimit. Për më tepër, zbatimi do të përfqohet përmes mekanizmave të auditimit dhe inspektimit. 38.3 Të sigurohet ngritja e kapaciteteve për operatorët dhe ndërtuesit kryesorë të turizmit që do të ndjekin parimet e reja me afësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe praktikatat e mira në sektor, duke përfshirë zgjidhje të bazuara në natyrë për mbrojtjen e vendpushimeve bregdetare dhe zonave rekreative, duke promovuar njëkohësisht edhe biodiversitetin. 38.4 Të zbatohen masa me afësi ripërtëritëse ndaj klimës në zona specifike turistike publike të identifikuar në studimin e risqeve, për të siguruar që infrastruktura të jetë e mbrojtur nga kërcënimet dhe ndikimet e ndryshme klimatike të parashikuara.	ASH	1. Vlerësimi i riskut klimatik është përfunduar dhe standardet e projektimit me afësi ripërtëritëse ndaj klimës janë përfshirë në kodet e ndërtimit të përditësuara për infrastrukturën turistike (Po/Jo). 2. Përqindja e zhvilluesve të turizmit dhe profesionistëve të ndërtimit të trajnuar në teknikat e ndërtimit me afësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë. 3. Numri total i vendeve të infrastrukturës turistike publike të ndërtuara ose të rikonstruara me karakteristika projektimi me afësi ripërtëritëse ndaj klimës në zonat me risk të lartë.	Ministria e Mjedisit; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	TBC
39	Turizmi	Mbrojtja e zonave bregdetare: Rregulloret e integruara, planifikimi dhe menaxhimi për afësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm	Ndërhyrja e butë;	39.1 Të identifikohen zonat më të ndjeshme ndaj rritjes së nivelit të detit, rritjes së nivelit të detit nga stuhtit dhe erozionit në plazhe. 39.2 Përdorimi i GIS-it dhe sensorët në distancë për të hartëzuar zonat me rrezik përmbajtje dhe erozioni 39.3 Të zhvillohen Planet e Menaxhimit të Integruar Bregdetar dhe të Planifikimit Hapësinor Detar. Të hartohen plane gjithëpërfshirëse që trajtojnë afësinë ripërtëritëse ndaj klimës dhe zhvillimin e qëndrueshëm 39.4 Vendosja e rregulloreve për prapambetjen bregdetare: Të zbatohen rregulloret për të siguruar që infrastruktura të jetë e izoluar nga zonat me risk të lartë. 39.5 Të zbatohen ligjet e zonimit: Të rregullohet zhvillimi bregdetar për të parandaluar praktikatat e papërshtatshme. 39.6 Fushatat e ndërgjegjësimit publik: Të edukohen komunitetet rreth rëndësisë së mbrojtjes së zonës bregdetare dhe afësisive ripërtëritëse ndaj klimës 39.7 Përfshirja e palëve të interesit: Të angazhohen palët e interesit vendor, duke përfshirë pronarët e pronave dhe zhvilluesit, në procesin e planifikimit dhe zbatimit 39.8 Të zbatohen sisteme të rregullta të monitorimit dhe mirëmbajtjes për të siguruar efektshmërinë e masave të mbrojtjes bregdetare, duke përfshirë ndjekjen e ndryshimeve në rritjen e nivelit të detit, erozionin bregdetar dhe ndikimet që lidhen me stuhtit. 39.9 Strategjitë e menaxhimit përshatës : Të përdoren të dhënat e monitorimit për të informuar strategjitë e menaxhimit përshatës dhe për të bërë rregullimet e nevojshme.	AM	1. Numri i planeve të menaxhimit të integruar bregdetar dhe planeve hapësinore detare të zhvilluara dhe të miratuara për zonat bregdetare me risk të lartë. 2. Numri i zonave bregdetare të hartëzuara në lidhje me riskun e përmbajtjeve dhe erozionit duke përdorur GIS dhe mjete sensorësh në distancë. 3. Përqindja e projekteve të reja të zhvillimit bregdetar që përputhen me rregulloret e prapambetjes dhe ligjet e zonimit. 4. Numri i stacioneve të monitorimit bregdetar të ngritura ose të përmirësuara për të ndjekur rritjen e nivelit të detit, shkallën e erozionit dhe ndikimet e stuhive. 5. Numri i nismave të ndërgjegjësimit publik dhe angazhimit të palëve të interesit të ndërmarrja për të promovuar qëndrueshmërinë bregdetare dhe zhvillimin e qëndrueshëm bregdetar. 6. Numri i vendimeve të menaxhimit përshatës ose rishikimeve të bëra në planet ose strategjitë bregdetare bazuar në të dhënat e monitorimit.	Ministria e Mjedisit; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	657.000
40	Turizmi	Ngritja e kapaciteteve me afësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Trajnimi i operatorëve turistike për praktikatat e qëndrueshme dhe strategjitë e përshatjes	Ndërhyrja e butë;	40.1 Të hartohen dhe zhvillohen module trajnimit të posaçme për përshatjen ndaj klimës, uljen e riskut dhe praktikatat e turizmit të qëndrueshëm, të përshatës sipas nevojave të llojeve të ndryshme të operatorëve të turizmit (p.sh., hotele, guida turistike, agjenci udhëtimi). 40.2 Të zhvillohen mjete dhe udhëzime praktike për të mbështetur integrimin e afësisive ripërtëritëse ndaj klimës dhe qëndrueshmërisë mjedisore në operacionet e përditshme të turizmit.	ASH	1. Numri i moduleve të trajnimit të posaçme të zhvilluara në lidhje me përshatjen ndaj klimës, uljen e riskut dhe praktikatat e turizmit të qëndrueshëm për operatorët e turizmit. 2. Përqindja e operatorëve turistikë dhe palëve të synuara të interesit që do të trajnohen mbi praktikatat e turizmit të qëndrueshëm dhe me afësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike. 3. Numri i paketave të masave dhe udhëzimeve praktike të zhvilluara për të mbështetur integrimin e afësisive ripërtëritëse ndaj klimës dhe qëndrueshmërisë në operacionet turistike.	Ministria e Mjedisit; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	430.000
41	Turizmi	Qendrat digjitale për turizmin me afësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Ndarja e njohurive dhe praktikave më të mira	Ndërhyrja e butë;	41.1 Të hartohet dhe lançohet një platformë të centralizuar online e përshatës për sektorin e turizmit, miqësore me përdoruesin dhe lehtësisht e aksesueshme për burimet e përshatjes ndaj klimës, udhëzimet e qëndrueshmërisë dhe mjetet praktike. 41.2 Të ngarkohet dhe përditësohet rregullisht përmbajtja, ku përfshihen modulet e trajnimit, studimet e rasteve, mjetet, dokumentet e politikave dhe udhëzuesit teknikë, për të mbështetur praktikatat e qëndrueshme ndaj klimës në turizëm. 41.3 Të promovohet platforma nëpërmjet fushatave ndërgjegjëseuese që synojnë bizneset e sektorit të turizmit, agjencitë publike dhe komunitetet vendor për të inkurajuar përdorimin dhe angazhimin e gjerë.	ASH	1. 41.1 Platformë e centralizuar online për sektorin e turizmit e zhvilluar dhe funksionale që ofron akses në burimet e përshatjes ndaj klimës (Po/Jo) 2. Numri i burimeve të përshatjes ndaj klimës (p.sh., mjete, module trajnimi, dokumente politikash) të ngarkuara dhe të mirëmbajtura në platformë. 3. Numri i palëve të interesit në sektorin e turizmit të arritura përmes fushatave ndërgjegjëseuese që promovojnë përdorimin e platformës online.	Ministria e Mjedisit; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	34.000

NR.	Sektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
42	Turizmi	Mbrojtja e pasurive turistike dhe trashëgimisë kulturore: Zbatimi i rregulloreve për pasuritë turistike dhe kulturore dhe restaurimi i ekosistemeve për zhvillim të qëndrueshëm	Ndërhyrja e butë:	42.1 Të kryhen veprime zbatuese për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret ekzistuese mjedisore dhe të përdorimit të tokës në zonat e zhvillimit të turizmit, veçanërisht në zonat bregdetare dhe pyjore. 42.2 Të promovohen praktikat e ndërtimit të qëndrueshëm duke zhvilluar dhe përhapur udhëzime mbi infrastrukturën turistike me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe infrastrukturën turistike që respekton mjedisin. Këto udhëzime do të përfshijnë praktika të qëndrueshme për të mbrojtur pasuritë bregdetare dhe natyrore të turizmit, me fokus restaurimin e ekosistemeve të degraduara, ruajtjen e biodiversitetit dhe promovimin e qasjeve të projektimit me ndikim të ulët që sigurojnë qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë të aktivitetëve turistike. 42.3 Hartimi i inventarit të riskut klimatik për pasuritë kulturore dhe zhvillimi i planeve të menaxhimit të riskut për sitet arkeologjike, historike, si dhe urbane tradicionale. 42.4 Monitorimi dhe mbrojtja nga rritja e nivelit të detit dhe erozioni nga institucionet e trashëgimisë kulturore në procesin e monitorimit.	ASH	1. Mekanizmi për zbatimin e rregullt të rregulloreve, mjedisore dhe të përdorimit të tokës, që janë në fuqi në zonat e zhvillimit të turizmit (Po/Jo). 2. Udhëzimet për infrastrukturën turistike me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe që respekton mjedisin janë zhvilluar dhe shpërndarë te palët përkatëse të interesit (Po/Jo). 3. Përqindja e projekteve të reja të infrastrukturës turistike në zonat bregdetare dhe pyjore që përfshijnë elemente projektimi me ndikim të ulët, të ndjeshëm ndaj biodiversitetit ose që promovojnë restaurimin e ekosistemeve. 4. Plane menaxhimi të riskut për sitet arkeologjike, historike, si dhe urbane tradicionale. 5. Raporte monitorimi	Ministria e Mjedisit; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	1.450.000
43	Zhvillimi urban	Planifikimi detar dhe territorial për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Përgatitja për rritjen e nivelit të detit dhe mjedisit në ndryshim	Ndërhyrja e butë:	43.1 Të kryhet një vlerësim i cenueshmërisë hapësinore të zonave bregdetare dhe zonave urbane të ulëta për të identifikuar zonat në risk duke përdorur mjetet GIS, parashikimet klimatike dhe të dhënat socio-ekonomike. 43.2 Të zhvillohen udhëzime për planifikimin e përdorimit të tokës bazuar në të dhënat e riskut klimatik, duke përcaktuar zonat prioritare për mbrojtje, menaxhimin e tërheqjes, zhvillimin e kufizuar dhe ngritja e infrastrukturës me aftësi ripërtëritëse. 43.3 Të përgatitet një Plan Zhvillimi Territorial me Aftësi Ripërtëritëse ndaj Klimës që integron përdorimin e tokës të informuar ndaj riskut, kufizimet e zonimit dhe përparësitë e infrastrukturës së përshatjes për të udhëhequr zgjerimin dhe rindërtimin e qëndrueshëm urban në zonat e cenueshme	AM	1. Vlerësimet e cenueshmërisë hapësinore janë përfunduar për zonat bregdetare dhe të ulëta urbane duke përdorur parashikimet e klimës dhe të dhënat socio-ekonomike (Po/Jo). 2. Udhëzimet për planifikimin e përdorimit të tokës janë hartuar duke përfshirë të dhënat për rritjen së nivelit të detit, valëve të stuhive dhe riskun të erozionit (po/Jo). 3. Numri i bashkive ose zonave bregdetare të mbuluara nga Plani i miratuar i Zhvillimit Territorial me Aftësi Ripërtëritëse ndaj Klimës.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	290.000
44	Zhvillimi urban	Planifikimi hapësinor strategjik për uljen e riskut: Ridrejtimi i zhvillimeve dhe menaxhimi i risqeve të përmbytjeve nga ujërat sipërfaqësorë	Ndërhyrja e butë:	44.1 Të kryhet një analizë hapësinore dhe të hartëzohen zonat me risk të lartë në bashkitë e synuara, duke përfshirë fushat aluvionale dhe zonat buferike të zonave të mbrojtura, duke përdorur modelimin hidrologjik dhe të dhënat e përdorimit të tokës. 44.2 Të përgatitet një plan për menaxhimin e ujërave sipërfaqësorë për bashkitë në risk të konsiderueshëm nga përmbytjet, duke identifikuar shkaqet, zonat e cenueshme dhe masat e mundshme zbatuese të bazuara në natyrë ose të projektuara. 44.3 Të integrohen rezultatet në instrumentet e përditësuara të planifikimit hapësinor në nivel bashkiak, duke përfshirë rregulloret e zonimit dhe kufizimet e përdorimit të tokës që parandalojnë zhvillimet e reja në zonat me risk të lartë. 44.4 Të alokohen fondet dhe të ofrohet mbështetje teknike për zbatimin e veprimeve prioritare nga Plani i Menaxhimit të Ujërave Sipërfaqësorë, ku të përfshihet infrastruktura e gjelbër dhe projektet e zbutjes së përmbytjeve.	ASH	1. Numri i bashkive me zona në risk të lartë të hartëzuara duke përdorur modelimin hidrologjik dhe të dhënat e integruara të përdorimit të tokës. 2. Numri i Planeve të Menaxhimit të Ujërave Sipërfaqësorë të zhvilluara për bashkitë në risk të konsiderueshëm përmbytjeje nga ujërat sipërfaqësorë. 3. Numri i instrumenteve të përditësuara të planifikimit hapësinor bashkiak, ku përfshihen rregulloret e zonimit ose kufizimet e përdorimit të tokës në zonat me risk të lartë përmbytjeje. 4. Shuma e fondeve të alokuara ose të mobilizuara për zbatimin e veprimeve me prioritet nga Planet e Menaxhimit të Ujërave Sipërfaqësorë, duke përfshirë zgjidhjet e bazuara në natyrë.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	3.027.000
45	Zhvillimi urban	Skemat e incentiveve për të rritur aftësitë ripërtëritëse të ndërtesave ndaj temperaturave ekstreme	Ndërhyrja e butë:	45.1 Të kryhet një vlerësim i detajuar i stokut kombëtar të ndërtesave për të identifikuar dobësitë dhe për të përcaktuar ndërtesat publike dhe private më të ekspozuara ndaj nxehtësisë dhe performancës së dobët energetike. 45.2 Të hartohet një paketë incentiveve financiare që mbështet instalimin e masave të ftohjes dhe izolimit pasiv, duke bërë dallim të qartë të linjave të mbështetjes për sektorin publik dhe privat. 45.3 T'i jepet përparësi ndërtesave të sektorit publik që ofrojnë shërbime thelbësore (p.sh. spitale, kopshte, shkolla, objektet që ofrojnë strehim në raste emergjente) për fazën e parë të mbështetjes financiare, duke siguruar shpërndarjen e barabartë gjeografike. 45.4 Të lançohet një program mbështetës i synuar për ndërtesat private, duke përfshirë fushata ndërgjegjësimi dhe udhëzime teknike për të inkurajuar marrjen e masave të ftohjes në shtëpi dhe biznese.	AGJ	1. Numri i vlerësimeve të stokut të ndërtesave të përfunduara ku identifikohen dobësitë ndaj të nxehtit dhe performancës së dobët të energjisë në sektorin publik dhe privat. 2. Numri i skemave të incentiveve financiare të hartuara dhe të vëna në funksion për masat e ftohjes pasive dhe izolimit termik në ndërtesat publike dhe private. 3. Numri i ndërtesave publike që ofrojnë shërbime thelbësore (p.sh., spitale, shkolla, objekte që ofrojnë strehim në raste emergjente) që marrin mbështetje financiare për instalimin e masave pasive të ftohjes dhe izolimit. 4. Numri i njësive ekonomike familjare private ose bizneseve që marrin mbështetje financiare ose teknike për zbatimin e zgjidhjeve të ftohjes pasive.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2.715.000.000
46	Zhvillimi urban	Integrimi i hapësirave të gjelbra në zhvillimin e infrastrukturës publike përmes prokurimit publik të gjelbër	Ndërhyrja e butë:	46.1 Të zhvillohen standardet kombëtare vullnetare të Prokurimit Publik të Gjelbër (PPGJ) në përputhje me kriteret e BE-së për PPGJ-në, duke përfshirë në mënyrë specifike kërkesat për integrimin e infrastrukturës së gjelbër dhe elementeve të bazuara në natyrë në të gjitha projektet e infrastrukturës publike. 46.2 Të krijohen udhëzime dhe formate praktike për zyrtarët e prokurimit dhe autoritetet kontraktuese, ku do të përfshihen edhe komponentët e hapësirave të gjelbra në tenderat që lidhen me rrugët, parqet, zonat sportive, parkingjet dhe objektet e tjera publike. 46.3 Të ofrohen programe trajnimi dhe <i>workshop</i> -e ndërgjegjësuere për zyrtarët e prokurimit publik dhe stafin teknik në nivel kombëtar dhe komunal mbi zbatimin e standardeve të PPGJ-së. 46.4 Të zbatohen në mënyrë pilot standardet e reja të PPGJ-së në bashki të përzgjedhura për të vlerësuar fizibilitetin, për të mbledhur reagime dhe për të identifikuar mundësitë për një shtrirje më të gjerë dhe përsosje të qasjes.	AM	1. Numri i standardeve vullnetare të Prokurimit Publik të Gjelbër (PPGJ) të zhvilluara dhe të miratuara që përfshijnë infrastrukturën e gjelbër dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë për projektet e infrastrukturës publike. 2. Numri i udhëzimeve të prokurimit dhe formateve të tenderit të zhvilluara për të mbështetur integrimin e komponentëve të hapësirave të gjelbra në projektet e infrastrukturës publike. 3. Numri i zyrtarëve të prokurimit dhe stafit teknik të trajnuar mbi standardet e prokurimit publik të gjelbër dhe integrimin e infrastrukturës së bazuar në natyrë. 4. Numri i bashkive që po pilotojnë zbatimin e standardeve vullnetare të PPGJ-së në proceset e prokurimit të infrastrukturës publike.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	380.000
47	Zhvillimi urban	Restaurimi i korridoreve të gjelbra: Nismat për ripyllëzim dhe gjelbërim urban	Ndërhyrja e gjelbër	47.1 Të kryhen vlerësime ekologjike dhe mjedisore, si dhe të hartëzohen dhe të prioritetizohen zonat për restaurimin dhe mbjelljen e korridoreve të gjelbra, në përputhje me Planet Vendore të Përshatjes për Gjrokastrën dhe Përmetin. 47.2 Të përgatitet toka e tokës dhe të kryhen veprimtaritë për mbjelljen për të restauruar dhe zhvilluar korridore të reja të gjelbra, duke nxitur lidhshmërinë e hapësirave të gjelbra dhe duke bërë të mundur që hapësirat e gjelbra urbane të zhbusin efektet e nxehtësisë. Ushtrimi i restaurimit dhe mbjelljes synon përmirësimin e cilësisë së tokës, uljen e erozionit, mbrojtjen dhe restaurimin e ekosistemeve dhe uljen e ndikimeve ekstreme të motit.	AM	1. Sipërfaqja totale (km ²) e rigjelbërimit në qytetin e Gjrokastrës. 2. Sipërfaqja totale (km ²) e brezave të gjelbër me pemë rapi dhe plepi të rindërtuara përgjatë lumenjve Drino dhe Vjose. 3. Gjatësia (km) e brezave të gjelbër përgjatë lumit Drino. 4. Gjatësia (km) e brezave të gjelbër përgjatë lumit Vjosa.	Ministria e Mjedisit, Bashkitë	568.544

NR.	Sektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
48	Zhvillimi urban	Vlerësimi i riskut klimatik për Durrësin, Elbasanin, Fierin dhe më gjërë: Krijimi i një harte gjithëpërfshirëse të cenueshmërisë	Ndërhyrja e butë:	48.1 Të mblihdhen dhe të konsolidohen të dhënat ekzistuese për risqet klimatike (përmblytet, valët e stuhive, thatësitrat, valët e të nxehtit dhe stuhitë) nga burime kombëtare dhe vendore për secilën bashki të synuar. 48.2 Të kryhen vlerësime pjesëmarrëse të riskut me autoritetet vendore dhe palët e interesit, për të identifikuar ekspozimin, ndjeshmërinë dhe kapacitetin përshatës të popullatave, infrastrukturës dhe ekosistemeve. 48.3 Të zhvillohen dhe verifikohen Hartën e Cenueshmërisë Klimatike bazuar në GIS për secilën bashki, duke integruar të dhënat mbi shumë rrezeqe dhe treguesit e cenueshmërisë socio-ekonomike.	ASH	1. Numri i bashkive ku kanë përfunduar dhe janë verifikuar Hartat e Cenueshmërisë Klimatike të bazuara në GIS, ku janë integruar të dhënat mbi shumë rrezeqe dhe treguesit e cenueshmërisë socio-ekonomike. 2. Numri i vlerësimeve pjesëmarrëse të riskut të kryera me palët vendore të interesit për të identifikuar cenueshmërinë dhe kapacitetin përshatës në bashkitë e synuara. 3. Numri i të dhënave bashkiake të konsoliduara dhe të integruara në sistemin kombëtar të informacionit mbi risqet klimatike për hartëzimin e cenueshmërisë.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	196.000
49	Zhvillimi urban	Planet e emergjencës për raste përmblytjesh	Ndërhyrja e butë:	49.1 Të hartohen ose përditësohen planet e reagimit ndaj emergjencave të përmblytjeve për bashkitë Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Kukës, Përmet dhe Vlorë, ku të detajohen protokollat të qarta, rolet dhe përgjegjësitë. 49.2 Të kryhen rishikime vjetore dhe ushtrime simulimi për të testuar efektivitetin e planeve të emergjencës, për të vlerësuar mangësitë në kapacitetet e reagimit dhe për të përfshirë mësimet e nxjerra. 49.3 Të identifikohen dhe alokohen burimet e nevojshme të emergjencës (p.sh., pajisje, personel, strehë, sistemet e komunikimit) për të siguruar që bashkitë janë të përgatitura për të zbatuar planet në mënyrë efektive. 49.4 Të trajnohen autoritetet vendore, ekipet e ndihmës së shpejtë dhe udhëheqësit të komunitetit në lidhje me procedurat e emergjencës, protokollat e komunikimit dhe mekanizmat e koordinimit të reagimit ndaj përmblytjeve.	ASH	1. Numri i bashkive ku janë përditësuar dhe miratuar planet për reagim ndaj emergjencave në raste Përmblytjesh, ku përfshijnë protokollat, rolet dhe përgjegjësitë. 2. Numri i ushtrimeve të simulimit të emergjencave nga përmblytjet të zhvilluara çdo vit në bashkitë e synuara për të testuar efektivitetin e planit dhe kapacitetin koordinues. 3. Përqindja e bashkive të synuara ku janë identifikuar dhe alokuar burimet thelbësore për reagim ndaj emergjencave (pajisje, streha, sisteme komunikimi), në përputhje me planet e emergjencës. 4. Numri i autoriteteve vendore, personelit të ndihmës së shpejtë dhe udhëheqësve të komunitetit që janë trajnuar mbi procedurat e emergjencës në rast përmblytjesh dhe për protokollat e koordinimit në bashkitë e synuara.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	2.500.000
50	Zhvillimi urban	Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: Vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit	Ndërhyrja e gjelbër	50.1 Të kryhet vlerësimi dhe planifikimi për të analizuar fizibilitetin dhe vendet me prioritet për shtimin e vëllimit të hapësirave të gjelbra dhe sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban në bashki, duke marrë në konsideratë përdorimin e tokës me fokus në bashkitë e Vlorës, Elbasanit dhe Durrësit, dhe të përcaktohet një plan për zbatimin e ndërhyrjeve. 50.2 Të zbatohen nismat për mbijelljen e pemëve në zonat kryesore urbane, për të rritur mbajtjen e ujit dhe për të zbutur risqet nga përmblytjeve në bashkitë me prioritet. 50.3 Të ndërtohen trotuare të përkueshme dhe sisteme të qëndrueshme të kullimit urban në zonat me risk të lartë: Të zëvendësohen sipërfaqet e papërkueshme nga uji me trotuare të përkueshme nga uji në vendndodhjet kryesore urbane për të përmirësuar ushqyerjen e ujërave nëntokësore dhe për të reduktuar gjasat për përmblytje të menjehershme.	ASH	1. Numri i studimeve të fizibilitetit të kryera për shtimin e vëllimit të hapësirave të gjelbra dhe sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban në Vlorë, Elbasan dhe Durrës. 2. Numri i trotuareve të përkueshme nga uji dhe sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban të ndërtuara.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	TBC
51	Zhvillimi urban	Projektimi i qëndrueshmërisë urbane: Ruajtja dhe restaurimi i zonave të përkueshme dhe të infiltrimit	Ndërhyrja e butë:	51.1 Të zhvillohen politika dhe dispozita rregullatore që përcaktojnë një përqindje minimale të sipërfaqeve të përkueshme nga uji në të gjitha zhvillimet e reja urbane dhe rinovimet e mëdha, ku të përfshihet edhe ndalimi i izolimit të tepët të sipërfaqes. 51.2 Të integrohen zgjidhjet e bazuara në natyrë (ZBN) për përkueshmërinë urbane - të tilla si kanalet biologjike, çatitë e gjelbra, trotuarat e përkueshme dhe kopshtet e shiut - në kornizat e politikave kombëtare dhe vendore dhe kodet e projektimit urban. 51.3 Të hartohen dhe miratohen udhëzime kombëtare për përfshirjen e zonave të përkueshme nga uji dhe karakteristikave të infiltrimit në planifikimin e infrastrukturës dhe punët publike, duke promovuar përdorimin standard të tyre në rrugë, zona parkimi dhe hapësira të hapura.	AGJ	1. Numri i politikave ose rregullore të planifikimit urban të miratuara që përcaktojnë përqindjet minimale të sipërfaqeve të përkueshme nga uji në zhvillimet e reja dhe rinovimet e mëdha. 2. Numri i kornizave të politikave kombëtare ose vendore të përditësuara për të integruar zgjidhjet e bazuara në natyrë (p.sh., kane biologjike, çati të gjelbra, kopshte shiu) për përmirësimin e përkueshmërisë urbane. 3. Numri i udhëzimeve kombëtare të zhvilluara dhe të miratuara zyrtarisht për integrimin e zonave të përkueshme nga uji dhe masave të infiltrimit në zhvillimin e infrastrukturës.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	1.200.000
52	Energjia	Mbrojtja e infrastrukturës energjetike nga erërat e forta: Rehabilitimi i nënstacioneve dhe linjave të transmetimit	Ndërhyrja gri	52.1 Të kryhet një studim mbi nënstacionet elektrike dhe linjat e transmetimit të energjisë të cenueshme dhe të prekura dhe hartimi i ndërhyrjeve për të trajtuar cenueshmëritë e zbuluara. 52.2 Përmirësimi i kullave të transmetimit nëpërmjet projekteve rezistente ndaj erës: Të përfordohen ose zëvendësohen kullat e transmetimit me struktura rezistente ndaj erës, duke përdorur materiale dhe projektme që i rezistojnë ngarkesave të larta të erës. 52.3 Instalimi i izolatorëve dhe kabllove aerodinamikë: Të përdoren përcues dhe amortizatorë aerodinamikë për të reduktuar dritëjt dhe shkakta nga era dhe për të minimizuar risqet e lëvizjeve të shpejta ose thyerjes së kabllove. 52.4 Forcimi i strukturave të nënstacioneve kundër ngarkesave të erës: Të rrijtëzohen nënstacionet nëpërmjet përfordimit të çatave, vendosjes së barrierave kundër erës dhe ankorimit të sigurt të pajisjeve për të parandaluar dëmtimet nga erërat e forta. 52.5 Të ngrihen barrierat bimore kundër erës rreth infrastrukturës energjetike: Të mbillen rreshta me pemë dhe shkurre me afësi ripërtëritëse që do të veprojnë si barrierat natyrore kundër erës, duke reduktuar shpejtësinë e erës dhe duke mbrojtur linjat e transmetimit dhe nënstacionet.	AM	1. Numri i kullave të transmetimit të përmirësuar falë strukturave rezistente ndaj erës. 2. Numri i përcuesve dhe amortizatorëve aerodinamikë të instaluar për të zvogëluar dritëjt dhe shkakta nga era dhe për të minimizuar risqet e lëvizjeve të shpejta ose thyerjes së kabllove. 3. Numri i nënstacioneve të pajisur me çati të përforduara, barrierat bimore kundër erës ose ankorim të sigurt të pajisjeve për të parandaluar erërat e fuqishme që shkaktojnë dëmtime të mëdha. 4. Numri i barrierave bimore kundër erës të ngritura rreth infrastrukturës energjetike për të zvogëluar shpejtësinë e erës dhe për të mbrojtur linjat e transmetimit dhe nënstacionet.	Operatori i Sistemit të Transmetimit në Shqipëri	986.298.000
53	Energjia	Përmirësimi i eficientësisë së ndërtesave: Certifikatat e performancës së energjisë dhe standardet e qëndrueshmërisë	Ndërhyrja e butë:	53.1 Të zhvillohet një kuadër kombëtar për Certifikimin e Performancës Energjetike (CPE), duke përfshirë kriteret e klasifikimit, metodologjinë e vlerësimit dhe procedurat e pajtueshmërisë. 53.2 Të zhvillohen dhe të miratohen standardet e ndërtesave me afësi ripërtëritëse ndaj klimës, duke përfshirë eficientësinë energjetike, ftohjen pasive, menaxhimin e ujit dhe qëndrueshmërinë e materialeve ndaj ngjarjeve ekstreme të motit. 53.3 Të ofrohen udhëzime dhe trajnime teknike për inxhinierët, arkitektët dhe profesionistët e ndërtimit rreth zbatimit të CPE-ve dhe të standardeve të projektimit me afësi ripërtëritëse ndaj klimës.	AM	1. Numri i ndërtesave të lëshuara me certifikatën e performancës energjetike (CPE) në përputhje me kuadrin kombëtar. 2. Numri i standardeve të klimës me afësi ripërtëritëse ndaj klimës të zhvilluara dhe të miratuara zyrtarisht, që trajtojnë eficientësinë energjetike, ftohjen pasive dhe afësitë ripërtëritëse të materialeve. 3. Numri i profesionistëve (inxhinierë, arkitektë, ndërtues) të trajnuar mbi zbatimin e CPE-së dhe standardet e projektimit me afësi ripërtëritëse ndaj klimës.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	3.500.000
54	Energjia	Eksplorimi i potencialit të sektorit të energjisë: Studime për menaxhimin e kërkesës dhe	Ndërhyrja e butë:	54.1 Të kryhet një vlerësim në nivel kombëtar i modeleve aktuale të kërkesës për energji elektrike, duke identifikuar mundësitë për menaxhimin e kërkesës dhe ruajtjen e energjisë për t'iu përgjigjur stresseve në sistemin energjetik të shkaktuara nga klima. 54.2 Të analizohet potenciali teknik dhe ekonomik i	AM	1. Përfundimi i raportit kombëtar të vlerësimit që identifikon modelin e kërkesës për energji elektrike dhe mundësitë për menaxhimin dhe ruajtjen e kërkesës në skenarë të stresit klimatik. 2. Numri i teknologjive të ruajtjes së energjisë të vlerësuar për fizibilitetin	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2.900.000

NR.	Sektori	Masat e përshatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
		ruajtjen e energjisë		teknologjive të ndryshme të ruajtjes së energjisë në skenarë të ndryshëm klimatikë. 54.3 Të identifikohen dhe të priorizohen ndërhyrjet për të rritur fleksibilitetin e rrjetit të energjisë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës, masat rregullatore dhe skemat e nxitjes për menaxhimin e kërkesës dhe integrimin e magazinimit.		teknik dhe ekonomik në skenarë të shumtë të risqeve që lidhen me klimën. 3. Finalizimi i listës së ndërhyrjeve prioritare për rritjen e fleksibilitetit të rrjetit, duke përfshirë mekanizmat e infrastrukturës, rregullatorë dhe financiarë për integrimin e masave të ruajtjes dhe të kërkesës.		
55	Energjia	Mbrojtja e infrastrukturës energjetike: Monitorimi i zonave të emergjencës dhe riskut	Ndërhyrja e butë:	55.1 Të identifikohen dhe të hartëzohen pikat e infrastrukturës energjetike të ekspozuara ndaj risqeve që lidhen me klimën, duke u dhënë përparësi objekteve kritike. 55.2 Të zhvillohet dhe të zbatohet një protokoll monitorimi i bazuar në risk për pikat e identifikuara, duke përfshirë treguesit e paralajmërimit të hershëm dhe prapen për reagimin ndaj emergjencave. 55.3 Të ngrihet një sistem i centralizuar i të dhënave për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit në kohë reale mbi risqet mjedisore që ndikojnë në infrastrukturën energjetike, duke siguruar aksesin e autoriteteve përkatëse për vendimmarrje të shpejtë.	ASH	1. Përqindja e pikave kritike të infrastrukturës energjetike të hartëzuara dhe klasifikuara sipas nivelit të ekspozimit ndaj risqeve që lidhen me klimën. 2. Numri i pikave të infrastrukturës energjetike që ndjekin një protokoll monitorimi të bazuar në risqet operative, ku përfshihen pragjet e paralajmërimit të hershëm. 3. Sistemi i centralizuar i të dhënave për monitorimin në kohë reale të risqeve mjedisore që ndikojnë në infrastrukturën energjetike është funksional dhe i aksesueshëm nga autoritetet e caktuara.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	875 000
56	Energjia	Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse ndaj valës së të nxehtësisë përmes vendosjes efikase të teknologjisë së kondicionimit të ajrit dhe strehëve për mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike	Ndërhyrja e butë:	56.1 Të ofrohet mbështetje financiare dhe teknike për instalimin e sistemeve të ajrit të kondicionuar me efikasitet energjie në ndërtesat në bashki që kanë ekspozim të lartë ndaj nxehtësisë ekstreme, duke i dhënë prioritet atyre të identifikuara në Planet Vendore të Përshtatjes (PVP). 56.2 Të mbështetet zbatimi i masave të rikonstruksionit për izolim termik të përmirësuar dhe ftohje pasive, siç përkrahjet në Planin Kombëtar të Përshtatjes (NAP), duke i kushtuar vëmendje të veçantë familjeve të cënueshme dhe shërbimeve thelbësore. 56.3 Të identifikohen dhe të hartëzohen strehet publike të mundshme për klimën, ku përfshihen bibliotekat, qendrat komunitare dhe hapësirat e gjelbra të mbrojtura nga dielli, duke siguruar mbulim gjeografik të drejtë dhe aksesueshmëri për grupet e cënueshme. 56.4 Të promovohet krijimi dhe përmirësimi i hapësirave publike urbane si streha klimatike, përmes integritimit të bimësive, elementeve të ujit, strukturave që krijojnë hije dhe parimeve të projektimit me aftësi ripërtëritëse ndaj nxehtësisë.	AGJ	1. Numri i ndërtesave të pajisura me sisteme të ajrit të kondicionuar me efikasitet energjie në bashkitë me rrezik nga nxehtësia. 2. Numri i familjeve të cënueshme dhe ndërtesave të shërbimeve thelbësore të rimodeluara për komoditet termik. 3. Numri i strehëve publike klimatike të identifikuara, të hartëzuara dhe të aksesueshme. 4. Sipërfaqja (në m ²) e hapësirës publike urbane e përmirësuar me bimësi, elemente uji ose struktura hijeje.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	38.200.000
57	Energjia	Optimizimi i energjisë së rinovueshme për sisteme me aftësi ripërtëritëse: Investime në inovacionin e rrjetit dhe magazinimin	Ndërhyrja e butë:	57.1 Të promovohet instalimi i sistemeve të energjisë së rinovueshme në zonat e cënueshme ndaj klimës, duke u dhënë përparësi infrastrukturës kritike dhe objekteve publike. 57.2 Të mbështetet përdorimi i teknologjive të rrjetit inteligjent për të përmirësuar shpërndarjen e energjisë në kohë reale, për të rritur fleksibilitetin e rrjetit dhe për të siguruar stabilitetin e sistemit në kushte ekstreme klimatike, përmes ndërthurjes së asistencës teknike, lehtësimit rregullator dhe incentivave financiare të synuara. 57.3 Të lehtësohen investimet në zgjidhjet e ruajtjes së energjisë, të tilla si sistemet e ruajtjes së energjisë në bateri, përmes partneriteve publik-privat, skemave të financimit të synuar dhe mekanizmave të incentivave. 57.4 Të forcohet kuadri rregullator për të përmirësuar proceset e lejeve dhe për të inkurajuar integrimin e energjisë së rinovueshme të decentralizuar në rrjetin kombëtar.	AGJ	1. Kapaciteti i instaluar i energjisë së rinovueshme në zonat e cënueshme ndaj klimës (MÉ). 2. Numri i sistemeve ose komponentëve të rrjetit inteligjent të vendosur në rajonet me prioritet. 3. Kapaciteti i ruajtjes së energjisë i shtuar rrjetit kombëtar (MÉN). 4. Numri i reformave rregullatore të miratuara për të mundësuar integrimin e energjisë së rinovueshme.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	176.850.000
58	Energjia	Promovimi i barazisë gjinore në sektorin e energjisë: Trajnimi dhe mbështetja e grave në projektet për energjinë e rinovueshme	Ndërhyrja e butë:	58.1 Të hartohen dhe të ofrohen programet e trajnimit për gratë, të fokusuara në zhvillimin e aftësive në teknologjitë e energjisë së rinovueshme dhe të përshatja sipas nevojave vendore për energji. 58.2 Të krijohen mundësi mentorimi dhe praktike në sektorin e energjisë për gratë dhe profesionistët e rinj, për të promovuar mundësi afatgjata për karrierë. 58.3 Të ofrohet mbështetje teknike dhe financiare për projektet e energjisë së rinovueshme të udhëhequra nga gratë, veçanërisht në komunitetet e nënshërbyera dhe ato rurale. 58.4 Të promovohet politika të ndjeshme ndaj gjinisë brenda sektorit të energjisë, për të inkurajuar praktikën gjithëpërfshirëse të punësimit, rolet udhëheqëse për gratë dhe mjediset mbështetëse të punës në nismat e energjisë me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës.	ASH	1. Numri i grave të trajnuara në teknologjitë e energjisë së rinovueshme përmes programeve të synuara. 2. Numri i projekteve të energjisë së rinovueshme të udhëhequra nga gratë të mbështetura me asistencë teknike dhe/ose financiare. 3. Krijta e përqindjes së punësimit të grave në sektorin e energjisë së rinovueshme.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	4.900.000
59	Energjia	Krijimi i aftësive ripërtëritëse në sistemet e energjisë hidroelektrike Operacione të optimizuara dhe infrastrukturë e përforcuar	Ndërhyrja gri	59.1 Të përditësohen protokollat e operimit të digave dhe rezervuarëve. Të rishikohen protokollat e menaxhimit të rezervuarëve dhe të përcaktohet mënyra e optimizimit të ruajtjes dhe lëshimit të ujit, bazuar në parashikimet e klimës dhe modelet sezonale në ndryshim. 59.2 Të përmirësohen objektet e hidrocentraleve për të rritur qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Të zbatohet përmirësimi i strukturave të digave dhe turbinave për t'u përballur me thatësitat e zgjatura dhe ngjarjet ekstreme të motit, si reshjet e mëdha të shiut. 59.3 Të përmirësohet menaxhimi i sedimentit në rezervuarë. Të aplikohet thellimi i qëndrueshëm dhe devijimet e kontrolluara, për të ruajtur kapacitetin e magazinimit dhe efikasitetin operacional. 59.4 Të zbatohen sisteme të avancuara monitorimi klimatike dhe hidrologjike. Të vendosen sensorë dhe modele parashikimi për të monitoruar ndryshimet në kohë reale të reshjeve dhe prurjeve të ujit.	ASH	1. Numri i protokolleve të rishikuara të funksionimit të digave dhe rezervuarëve. 2. Numri i objekteve hidroenergjetike të rinovuara me përmirësime strukturore të digave dhe turbinave. 3. Numri i përmirësimeve strukturore të digave dhe turbinave të zbatuara për t'i bërë ballë thatësirave të zgjatura dhe ngjarjeve ekstreme të motit, siç janë reshjet e mëdha të shiut. 4. Numri i rezervuarëve të aplikuar me thellim të qëndrueshëm dhe devijime të kontrolluara për të ruajtur kapacitetin e magazinimit dhe efikasitetin operativ. 5. Numri i vlerësimeve të riskut të kryera në infrastrukturën e hidrocentraleve. 6. Numri i sensorëve dhe modeleve të parashikimit të vendosura në sistemet e avancuara të monitorimit të klimës dhe hidrologjisë për të monitoruar ndryshimet në kohë reale të reshjeve dhe prurjeve të ujit.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	747.050.000
60	Transporti	Analiza e rregullt e cënueshmërisë dhe riskut dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e aftësive ripërtëritëse për infrastrukturën rrugore	Ndërhyrja e butë:	60.1 Të kryhen vlerësime të cënueshmërisë dhe riskut klimatik për infrastrukturën rrugore kritike, urat dhe tunelet në nivel kombëtar, duke u përqendruar në ekspozimin ndaj përmytjeve, rrëshqitjeve të tokës, valëve të nxehtësisë dhe risqeve të tjera të lidhura me ndryshimet klimatike. 60.2 Të përcaktohet një program kombëtar për rivlerësimin periodik të risqeve për infrastrukturën kritike të transportit për t'u siguruar që vlerësimet të përditësohen rregullisht dhe t'i përgjigjen skenarëve klimatikë në zhvillim. 60.3 Të identifikohen dhe të priorizohen ndërhyrjet për reduktimin e riskut në bashkitë me risk të lartë (Durrës, Elbasan, Krutë, Kukës dhe Vlorë), ku do të	ASH	1. Numri i vlerësimeve të përfunduara të cënueshmërisë dhe riskut ndaj klimës për infrastrukturën kritike të transportit. 2. Numri i pikave të infrastrukturës së transportit me risk të lartë që kanë prioritet në ndërhyrje për reduktimin e riskut. 3. Përqindja e planeve të ndërhyrjes së përfunduar për pikat e identifikuara si me prioritet.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	457.000

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				përfshihen përmirësimet strukturore, sistemet e përmirësuar të kullimit dhe masat e stabilizimit të shpateve.				
61	Transporti	Studimet gjeologjike për rrugët e qëndrueshme: Zgjidhje bioinxhinierik e për të ulur risqet nga erozioni dhe përmbytjet	Ndërhyrja e butë:	61.1 Të kryhen studime të hollësishtme gjeologjike dhe gjeoteknike në zonat e identifikuar si të cënueshme, për të vlerësuar stabilitetin e tokës, modelet e erozionit dhe risqet e rrëzimit të dheut, me fokus të veçantë në bashkitë dhe segmentet rrugore të listuara. 61.2 Të hartohen dhe të propozohen zgjidhje bioinxhinierike të përshtatura për kushtet specifike të çdo vendi, si stabilizimi i vegetativit i shpateve, strukturat mbajtëse dhe sistemet e kullimit, në përputhje me nivelin përkatës të risqit.	AM	1. Numri i studimeve gjeologjike dhe gjeoteknike të përfunduara në segmentet e rrugëve të synuara. 2. Numri i segmenteve rrugore me projekte bioinxhinierike të përfunduara dhe të miratuara. 3. Ulje e përqindjes së ndërprerjeve të rrugëve të lidhura me rrëzimet e dheut ose erozionin në segmentet e trajtuara.	Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Bashkitë	2.900.000
62	Transporti	Promovimi i lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Hartimi dhe rishikimi i planeve të lëvizshmërisë urbane	Ndërhyrja e butë:	62.1 Të zhvillohen ose të rishikohen planet e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane në nivel bashkiak, për t'u siguruar që ato të jenë të përshtatura ndaj klimës, ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe në përputhje me prioritetet kombëtare të përshtatjes. Këto plane duhet të mbulojnë elemente që lidhen me përshtatjen, siç janë: a) Udhëzimet për vlerësimin e cënueshmërive dhe risqeve që ndikojnë në rrjetin rrugor; b) Zhvillimi dhe zbatimi i planeve me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës për projektet e infrastrukturës rrugore; c) Përkufizimi i mekanizmave të mirëmbajtjes së rrugës nëpërmjet planeve shumë-vjeçare të mirëmbajtjes së rrugës dhe sistemeve të menaxhimit të aseteve rrugore. 62.2 Të pilotohet zbatimi i Planeve të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës në Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Përmet dhe Fier, duke siguruar planifikim pjesëmarrës, koordinim ndërsektorial dhe përputhje me risqet klimatike të identifikuar. 62.3 Integrimi i sistemeve inteligjente të informacionit dhe digitalizimit për krijën e qëndrueshmërisë së transportit urban. Të zhvillohen dhe integrohen sisteme digjitale për menaxhimin e transportit publik, duke përfshirë bljetimin elektronik dhe tabelat informuese në kohë reale në stacione, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të flukseve të udhëtarëve dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të shërbimit të transportit publik në kushte të ngjarjeve klimatike ekstreme.	ASH	1. Numri i bashkive ku janë zhvilluar ose rishikuar Planet e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane të përshtatura ndaj klimës. 2. Numri i Planeve të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane ku përfshihen vlerësimet e cënueshmërisë dhe hartëzimin e risqeve klimatike. 3. Numri i bashkive që zbatojnë plane shumëvjeçare të mirëmbajtjes së rrugëve me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. 4. Përqindja e projekteve të infrastrukturës rrugore në qytetet pilot të projektuara ose të përmirësuar duke përdorur standarde me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. 5. Numri i konsultimeve pjesëmarrëse të kryera gjatë zhvillimit dhe zbatimit të Planit të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane.	Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Bashkitë	1.200.000
63	Transporti	Përshtatja e infrastrukturës kritike të transportit: Vlerësimi i përparuar i risqit dhe zgjidhje të projektimit me aftësi ripërtëritëse	Ndërhyrja e butë:	63.1 Të kryhen vlerësime të cënueshmërisë dhe risqit klimatik për infrastrukturën detare duke përfshirë në mënyrë të veçantë infrastrukturën portuale dhe zonat me ekspozim të lartë si Porti i Durrësit, hekurudhore dhe infrastrukturën kritike të transportit, duke përdorur modelim të avancuar të klimës për të vlerësuar ekspozimin e ardhshëm ndaj ngjarjeve ekstreme si përmbytjet, thatësitat dhe stuhitë. 63.2 Të integrohen masa e përshtatjes të infrastrukturës në planet kombëtare dhe sektoriale të transportit, si projektet e rrugëve me aftësi ripërtëritëse ndaj përmbytjeve, linja hekurudhore të ngritura, shinat e përforcuara, materialet e ndërtimit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, muret mbrojtëse bregdetare dhe strukturat portuale me aftësi ripërtëritëse ndaj stuhive. 63.3 Të integrohet përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në rregulloret e transportit detar dhe hekurudhor, duke siguruar që standardet e planifikimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes të pasqyrojnë kushtet e parashikuara klimatike dhe kriteret e qëndrueshmërisë. 63.4 Të forcohen sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe protokollet e reagimit ndaj emergjencave për sistemet e transportit, veçanërisht në zonat me risk të lartë, për të zvogëluar ndërprerjet dhe dëmet e shërbimit gjatë ngjarjeve ekstreme meteorologjike. 63.5 Të kryhen vlerësime të dedikuara të cënueshmërisë dhe risqit klimatik për infrastrukturën portuale, si dhe të zhvillohen dhe zbatohen standarde projektimi "climate-proof" për investimet portuale. Gjithashtu, të integrohen masa për menaxhimin e përmbytjeve nga reshjet dhe ato bregdetare në nyjat portuale, duke përfshirë përmirësimin e sistemeve të drenazhimit dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike, si dhe të hartohen plane emergjence klimatike për garantimin e funksionimit të vazhdueshëm të porteve në kushtet e ngjarjeve ekstreme.	ASH	1. Numri i vlerësimeve të cënueshmërisë dhe risqit ndaj klimës të kryera për infrastrukturën kritike të transportit. 2. Përqindja e planeve kombëtare dhe sektoriale të transportit që përfshijnë masa infrastrukture me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës. 3. Numri i rregullorete të përdëtuara detare dhe hekurudhore që përfshijnë standardet e përshtatjes ndaj klimës. 4. Numri i objekteve të transportit të pajisura me sisteme të përparura të paralajmërimit të hershëm dhe protokolle të reagimit ndaj emergjencave. 5. Ulje përqindjeje e kohës së ndërprerjes për shërbimet e transportit gjatë ngjarjeve ekstreme të motit 6. Numri i porteve/infrastrukturave portuale prioritare për të cilat janë kryer vlerësime të cënueshmërisë dhe risqit klimatik dhe janë miratuar plane përshtatjeje që përfshijnë masa për menaxhimin e përmbytjeve dhe përmirësimin e sistemeve të drenazhimit.	Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Bashkitë, Autoriteti Portual Durrës	2.700.000
64	Transporti	Integrimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe përshtatjes së bazuar në mjedis për aftësitë ripërtëritëse të sektorit të transportit: Përmirësimi i infrastrukturës përmes përshtatjes së bazuar në natyrë dhe ekosisteme	Ndërhyrja e gjelbër	64.1 Të kryhet një vlerësim i opsioneve për zbatimin e korridoreve të gjelbra përgjatë infrastrukturës rrugore, për të zburuar ndikimet e ndryshimeve klimatike, duke parandaluar efektin e ishullit të nxehtësisë dhe duke reduktuar risqet e përmbytjeve dhe erozionin. Analiza duhet të identifikojë kilometrat dhe sipërfaqet përreth rrugëve specifike në të cilat do të kryhen ndërhyrje, së bashku me planin e zbatimit dhe analizën e fizibilitetit. 64.2 Brezat buferike bregdetare përgjatë rrugëve që kalojnë pranë lumenjve: Të krijohen zona buferike bimore përgjatë rrugëve pranë lumenjve, për të reduktuar erozionin, stabilizuar brigjet dhe minimizuar dëmet nga përmbytjet. 64.3 Trotare të përkrahshëm nga uji dhe kullues të gjelbër në transportin urban: Zëvendësimi i trotareve konvencionale me alternativa të përkrahshme nga uji. 64.4 Të kryhet pyllëzim dhe të realizohet terracim për parandalimin e rrëzimit të tokës përgjatë rrugëve malore. Të kryhet mbjellja e pemëve dhe bimësisë vendase në shpatet përgjatë rrugëve kryesore të transportit dhe të zbatohen sistemet e terracimeve për të zvogëluar risqet e erozionit të tokës dhe rrëzimit të dheut. 64.5 Mbrojtja e ligatinave bregdetare për me aftësitë ripërtëritëse ndaj transportit: Të restaurohen dhe të ruhen zonat e lagunave bregdetare për të vepruar si barriera natyrore ndaj valëve të stuhive dhe erozionit bregdetar që ndikojnë në infrastrukturën e transportit.	AM	1. Gjatësia (km) e infrastrukturës së transportit (rrugë ose hekurudha) me korridore të gjelbra ose zona buferike bimore. 2. Numri i segmenteve të infrastrukturës së transportit ku janë zbatuar teknikat e bioinxhinierisë ose stabilizimit të shpateve. 3. Numri i brezave buferikë bregorë ose i ligatinave bregdetare të restauruara ose të krijuara për të mbrojtur infrastrukturën e transportit. 4. Përqindja e segmenteve të infrastrukturës së transportit të projektuara ose të rehabilituara rrishtazi që përfshijnë teknologji me ndikim të ulët (p.sh., trotare të përkrahshme nga uji, sisteme të gjelbra kullimi). 5. Numri i urave ekologjike ose kalimeve për kafshët e egra të ndërtuara ose të përmirësuar përgjatë korridoreve të transportit. 6. Ulje e përqindjes së ndërprerjeve të infrastrukturës së transportit për shkak të risqeve që lidhen me klimën (p.sh., përmbytjet, erozioni, rrëzimet e tokës) në zonat me ndërhyrje të ZBN-së.	Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Bashkitë	2.029.460.000

NR.	Sektori	Masat e përshtatjes	Lloji*	Veprimtaritë	Periudha	Treguesit	Përgjegjësi kryesor	Kostoja (dollarë amerikanë)
				64.6 Praktikat e qëndrueshme të thellimit për rrugët ujore të lundrueshme: Të zbatohen teknika të thellimit të përgjegjshme ndaj mjedisit për mirëmbajtjen e rrugëve ujore të transportit, duke ruajtur njëkohësisht biodiversitetin detar. 64.7 Korridore të gjelbra përgjatë autostradave dhe linjave hekurudhore Restaurimi dhe rivendosja e korridoreve të rrethuara me pemë dhe breza të gjelbër përgjatë rrugëve kryesore dhe linjave hekurudhore për të zvogëluar stresin e nxehtësisë, për të siguruar hije, për të thithur ndotësit, për të funksionuar si barriera zhurme dhe për të përmirësuar lidhshmërinë e biodiversitetit. 64.8 Bioinxhinieria për stabilizimin e rrugëve dhe hekurudhave: Të përdoren teknika biologjike për stabilizimin e shpateve, si mbulesa bimore dhe tarraca të mbjella, përgjatë rrugëve të transportit të cënueshme ndaj rrëshqitjeve të dheut ose erozionit në zonat jo-malore. 64.9 Të krijohen vijëzime bregdetare të gjalla për qëndrueshmërinë e transportit bregdetar, duke përdorur shkëmbinj nënujorë me goca deti dhe zona buferike bimore për të stabilizuar vijat bregdetare dhe për të mbrojtur infrastrukturën e transportit nga veprimi i valëve dhe rritja e nivelit të detit. 64.10 Të integrohen ura të gjelbra për kalimet e kafshëve të egra, duke zhvilluar mbikalime dhe nënkallime miqësore me mjedisin për të parandaluar vrasjen e kafshëve dhe për të siguruar migrim të sigurt të llojeve përgjatë rrjetit të transportit.				
65	Transporti	Politikat e transportit me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike: Përfshirja e përshtatjes ndaj klimës në kuadrin rregullator	Ndërhyrja e butë:	65.1 Të rishikohen dhe të ripërpunohen politikat dhe kornizat rregullatore ekzistuese që lidhen me transportin, për të integruar objektivat e përshtatjes ndaj klimës dhe për të siguruar përputhshmëri me strategjitë kombëtare dhe sektoriale të klimës. 65.2 Të krijohen mekanizma koordinimi ndërsektoriale për të përfshirur planifikimin e transportit me përdorimin e tokës, mbrojtjen e mjedisit dhe përpjekjet për përshtatje ndaj klimës, duke promovuar një qasje në nivel sistemi për zhvillimin e infrastrukturës. 65.3 Të zhvillohen dispozita ligjore dhe udhëzime planifikimi që kërkojnë vlerësime të riskut klimatik dhe përfshirjen e masave të përshtatjes në të gjitha projektet e reja të infrastrukturës së transportit. 65.4 Të organizohen konsultime teknike dhe dialog mbi politikat midis ministrive të transportit, mjedisit, zhvillimit urban dhe financave, për të identifikuar sinergjitë dhe për të forcuar koordinimin institucional në planifikimin e transportit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës.	ASH	1. Numri i politikave dhe kornizave rregullatore të transportit të rishikuara për të integruar përshtatjen ndaj klimës. 2. Numri i mekanizmave të koordinimit operativ ndërsektorial të krijuar. 3. Përqindja e projekteve të reja të infrastrukturës së transportit që i nënshtrohen vlerësimeve të riskut klimatik. 4. Numri i dispozitave ligjore ose udhëzimeve të planifikimit të zhvilluara që detyrojnë përshtatjen ndaj klimës në planifikimin e transportit. 5. Numri i konsultimeve teknike ndërministrare dhe dialogëve mbi politikat të zhvilluara.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	218.000
66	Transporti	Partneritete novatore për transport të qëndrueshëm: Financimi për infrastrukturën e transportit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës	Ndërhyrja e butë:	66.1 Të hartohen instrumente financimi të klimës për të mbështetur investimet në infrastrukturë me aftësi ripërtëritëse, integrimin e energjisë së rinovueshme dhe përdorimin e teknologjive ndërtimore me ndikim të ulët në sektorin e transportit. 66.2 Të krijohen partneritete publike-private (PPP) për të mobilizuar bashkëfinancimin për infrastrukturën e transportit me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, duke siguruar përputhshmërinë me prioritetet kombëtare të përshtatjes dhe qëndrueshmëri afatgjatë. 66.3 Të kryhet një vlerësim i nevojave në nivel kombëtar dhe rajonal për të identifikuar mangësitë teknologjike specifike për kontekstin dhe pengesat financiare për miratimin e zgjidhjeve novatore me ndikim të ulët në zhvillimin e infrastrukturës. 66.4 Të zhvillohen incentivat financiare dhe korniza rregullatore për të nxitur përdorimin e materialeve dhe praktikave ndërtimore të avancuara dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës nga kontraktorët privatë dhe zhvilluesit e infrastrukturës.	AGJ	1. Numri i instrumenteve të financimit të klimës të hartuara dhe të vëna në funksionim 2. Volumi i kapitalit privat të mobilizuar përmes PPP-ve 3. Numri i vlerësimeve kombëtare dhe rajonale të nevojave të përfunduara 4. Përqindja e projekteve të infrastrukturës që përfshijnë teknologji me ndikim të ulët 5. Numri i skemave të incentivave financiare dhe rregullatore të zbatuara	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë	1.900.000

*Lloji: Masat e buta u referohen ndërhyrjeve jostrukture, si kërkimi dhe vlerësimet e riskut, ngritja e kapaciteteve, veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimi, mekanizmat e qeverisjes dhe koordinimit, instrumentet e planifikimit dhe rregullatore, si dhe mjetet financiare ose të bazuara në incentiva. Masat e gjelbra shfrytëzojnë restaurimin, ruajtjen ose menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve për të pakësuar risqet klimatike dhe për të ofruar përfitime të shumta të ndërsjella, duke përfshirë përmirësimin e biodiversitetit dhe ofrimin e shërbimeve të ekosistemit. Masat gri përfshijnë zgjidhje inxhinierike ose teknologjike, si infrastruktura me aftësi ripërtëritëse, të projektuara për të zvogëluar ekspozimin fizik ndaj rreziqeve klimatike ku përfshihet infrastruktura me aftësi ripërtëritëse, sistemet e kullimit dhe mbajtjes së ujit, muret detarë, sistemet e paralajmërimit të hershëm, etj.

***Periudha e fillimit të masave: ASH: Fillimi i periudhës afatshkurtër 2026–2028; AM Fillimi i periudhës afatmesme 2029–2031; AGJ Fillimi i periudhës afatgjatë 2032–2036.

ANEKS IV

HARTA PËRFSHIN PYLLTARINË, BUJQËSINË DHE VENDNDODHJET E MASAVE ZBN

